

KISHA E JEZU KRISHTIT E SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME • NËNTOR 2010

Liahona



**Fjalime në
Konferencën e
Përgjithshme**

Presidenti Monson
Nxiti Përgatitjen për
Mision dhe Shërbimin
Misionar



Ai Leu Sytë e Të Verbërit,
nga Walter Rane

Nga dhembshuria që pati për një burrë, i cili qe i verbër që nga lindja, Shpëtimtari "pështyu përdhe, bëri baltë me pështymë dhe leu sytë e të verbrit me të. Pastaj i tha: 'Shko, lahu në pellgun e Siloamit'; . . . Ai shkoi atje, u la dhe u kthye duke parë" (Gjoni 9:6-7).

- 2 Përmbledhje për Konferencën e Përgjithshme Gjysmëvjetore të 180-të

SESIONI I SË SHTUNËS NË MËNGJES

- 4 Ndërsa Prapë Takohemi së Bashku
Presidenti Tomas S. Monson
- 6 Falë Besimit Tuaj
Plaku Xhefri R. Holland
- 9 Qëndroni në Shteg
Rozmari M. Uixom
- 11 Bindja ndaj Profetëve
Plaku Klaudio R. M. Kosta
- 13 Mësimi dhe Mësimdhënia e Ungjillit
Dejvid M. Mek-Konki
- 16 Mendime mbi një Jetë të Përkushtuar
Plaku D. Tod Kristoferson
- 19 Për Gjërat që Kanë më Shumë Rëndësi
Presidenti Diter F. Uhtdorf

SESIONI I SË SHTUNËS PASDITE

- 23 Mbështetja e Drejtuesve të Kishës
Presidenti Henri B. Ajring
- 24 Liria e Zgjedhjes: Thelbësore për Planin e Jetës
Plaku Robert D. Hejls
- 27 Pastë Dritë!
Plaku Kuentin L. Kuk
- 31 Besim – Zgjedhja Ehtë e Juaja
Peshkopi Riçard C. Exhli
- 34 Pikërisht Mbijetesa Jonë
Plaku Kevin R. Dankan
- 36 Pasqyra Tempulli të Përjetësisë: Një Dëshmi për Familjen
Plaku Gerit W. Gong
- 39 Kurrë Mos e Lini Atë
Plaku Nil L. Andersen
- 43 Fuqia Shndërruese e Besimit dhe Karakteri
Plaku Riçard G. Skot

SESIONI I PRIFTËRISË

- 47 Bëhu Shembull për Besimtarët
Plaku Rasëll M. Nelson
- 50 "Ejani tek Unë me Qëllim të Plotë të Zemrës, dhe Unë Do t'Ju Shëroj"
Plaku Patrik Kiëron
- 53 Ai Na Mëson ta Zhveshim Njeriun e Natyrshëm
Plaku Huan A. Uceda

- 55 Krenaria dhe Priftëria
Presidenti Diter F. Uhtdorf
- 59 Shërbeni me Shpirtin
Presidenti Henri B. Ajring
- 67 Tre Parimet e Zgjedhjes
Presidenti Tomas S. Monson

SESIONI I SË DIELËS NË MËNGJES

- 70 Mirëbeso tek Perëndia, Pastaj Shko dhe Bëj
Presidenti Henri B. Ajring
- 74 Pastrimi i Brendësisë së Enës
Presidenti Bojd K. Paker
- 77 Fryma e Shenjtë dhe Zbulesa
Plaku Xhei E. Xhensen
- 80 Bëhu Shembull për Besimtarët
Meri N. Kuk
- 83 Dy Linja Komunikimi
Plaku Dallin H. Ouks
- 87 Dhurata Hyjnore e Mirënjohjes
Presidenti Tomas S. Monson

SESIONI I SË DIELËS PASDITE

- 91 Priftëria e Aaronit
Plaku L. Tom Peri
- 94 Merrni Frymën e Shenjtë
Plaku Dejvid A. Bednar
- 98 Prindërim Trimëror
Plaku Leri R. Lorens
- 101 Prehuni në Shpirtrat Tuaj
Plaku Per G. Malm
- 103 Shmangia e Grackës së Mëkatit
Plaku Jairo Macagardi
- 105 Çfarë Keni Bërë Ju Me Emrin Tim?
Plaku Mervin B. Arnold
- 108 O, Ai Plani Dredharak i të Ligut
Plaku M. Rasëll Ballard
- 111 Derisa Prapë të Takohemi
Presidenti Tomas S. Monson

MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E SHOQATËS SË NDIHMËS

- 112 "Bija në Mbretërinë Time": Historia dhe Puna e Shoqatës së Ndihmës
Xhuli B. Bek
- 116 Të Qëndrueshme dhe të Patundura
Silvia H. Ollred
- 119 Dhe Kini Dhemshuri Për Njërin Duke Përdorur Dallim
Barbara Tompson
- 122 Dashuria Nuk Ligësohet Kurrë
Presidenti Tomas S. Monson
- 64 Autoritetet e Përgjithshme të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme
- 125 Treguesi i Ngjarjeve në Konferencë
- 126 Presidencat e Përgjithshme të Organizatave Ndihmëse
- 126 Mësime për Kohën Tonë
- 127 Lajme të Kishës



Përmbledhje për Konferencën e Përgjithshme Gjysmëvjetoare të 180-të.

SESIONI I PËRGJITHSHËM I SË SHTUNËS NË MËNGJES, 2 TETOR 2010

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson.
Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring. Lutja e hapjes: Plaku Oktaviano Tenorio. Lutja e mbylljes: Plaku Eduardo Gavaret. Muzika nga Kori i Tabernakullit; Mak Uilberg dhe Rajën Mërfi, drejtues; Endriu Ansuorth dhe Klei Kristiansen, në organo: "Guide Us, O Thou Great Jehovah" ["Na Udhëhiq, O Ti Jehova i Madhërishtëm"], *Hymns*, nr. 83; "Let Zion in Her Beauty Rise" ["Le Të Ngrihet Sioni në Bukurinë e Saj"], *Hymns*, nr. 41; "Të Falemi, Zot, për Profetin" *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 36, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar; "Put Your Shoulder to the Wheel" ["Vëriini Shpatullat Punës"], *Hymns*, nr. 252; "Tell Me the Stories of Jesus" ["Tregom' Historitë e Jezusit"], *Children's Songbook*, 57, përshtatur nga Murphy, i pabotuar; "The Morning Breaks" ["Shpërthen Mëngjesi"], *Hymns*, nr. 1, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar.

SESIONI I PËRGJITHSHËM I SË SHTUNËS PASDITE, 2 TETOR 2010

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson. Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring. Lutja e hapjes: Plaku Klaudio D. Zivic. Lutja e mbylljes: Plaku Horge F. Zebalos. Muzika nga një kor i familjeve nga Sendi dhe Drejpër në Juta; Timoti Uorkmen, drejtues; Linda Margets, në organo: "Eni, F'mij të Zoti", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 4, përshtatur nga Lyon, bot. Jackman; "Beautiful Zion, Built Above" ["Sioni e Bukura, Ndërtuar Lart"], *Hymns*, nr. 44; "Lord, I Would Follow Thee" ["Zot, Do Të Vija Pas Teje"], *Hymns*, nr. 220; "Home" ["Shtëpia"], *Children's Songbook*, 192, përshtatur nga Dayley, i pabotuar.

SESIONI I PRIFTËRISË I SË SHTUNËS NË MBRËMJE, 2 TETOR 2010

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson. Drejtimi: Presidenti Diter F. Uhtdorf. Lutja e hapjes: Plaku Markos A. Aidukaitis. Lutja e mbylljes: Plaku Xhejms J. Hamula. Muzika nga një kor i priftërisë nga Qendra e Trajnimit të Misionarëve në Provo; Daglas Brençli dhe Rajën Eget, drejtues; Riçard Eliot, në organo: "Hark, All Ye Nations!" ["Dëgjoni, të Gjithë Ju Kombe!"], *Hymns*, nr. 264, përshtatur nga Ipson, i pabotuar; "Go, Ye Messengers of Heaven" ["Shkoni, Ju Lajmëtarë të Qiellit"], *Hymns*, nr. 327; "Lart në Majën e Malit", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 30; "Thirrur nga Kanë" përshtatur nga Boothe, i pabotuar.

SESIONI I PËRGJITHSHËM I SË DIELËS NË MËNGJES, 3 TETOR 2010

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson. Drejtimi: Presidenti Diter F. Uhtdorf. Lutja e hapjes: Plaku Zherald Kosé. Lutja e mbylljes: Plaku Karlos A. Godoi. Muzika nga Kori i Tabernakullit; Mak Uilberg, drejtues; Klei Kristiansen dhe Riçard Eliot, në organo: "Truth Eternal" ["E Vërtetë e Përvetshme"], *Hymns*, nr. 4; "Jehovah, Lord of Heaven and Earth" ["Jehova, Zot i Qiellit dhe i Tokës"], *Hymns*, nr. 269; "Dear to the Heart of the Shepherd" ["Të Dashur në Zembrën e Bariut"], *Hymns*, nr. 221, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar; "Shëlbuesi i Izraelit", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 5; "Love One Another" ["Ta Doni Njëri-Tjetrin"], *Hymns*, nr. 308, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar; "Tani Le të Gëzojmë", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 32, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar.

SESIONI I PËRGJITHSHËM I SË DIELËS PASDITE, 3 TETOR 2010

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson. Drejtimi: Presidenti Diter F. Uhtdorf. Lutja e hapjes: Plaku Lorens E. Korbrich. Lutja e mbylljes: Peshkopi H. Dejvid Barton. Muzika nga Kori i Tabernakullit; Mak Uilberg dhe Rajën Mërfi, drejtues; Boni Gudlajf, në organo: "Come, Rejoice" ["Eni, Gëzoni"], *Hymns*, nr. 9, përshtatur nga Murphy, i pabotuar; "Lead, Kindly Light" ["Dritë e Dashur Drejtuese"], *Hymns*, nr. 97, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar; "Fëmi i Per'ndis' Jam", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 301; "Sing We Now at Parting" ["Këndoni për Ne në Ndarje"], *Hymns*, nr. 156, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar.

Mbledhja e Përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës, e Së Shtunës në Mbrëmje, 25 Shtator 2010

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson. Drejtimi: Xhuli B. Bek. Lutja e hapjes: Sharon L. Jubenk. Lutja e mbylljes: Marsha G. Bek. Muzika nga një kor i Shoqatës së Ndihmës prej kunjeve në Kiërns të Jutas; Keti Xholi, drejtuese; Linda Margets, në organo: "Numëro Bekimet", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 8, përshtatur nga Kasen, bot. Jackman; "Carry On" ["Vazhdoni Përpara"], *Hymns*, nr. 255, përshtatur nga Nielsen dhe Boothe, i pabotuar (në korno franceze: Kristina Orcutt Tollefson, Mary Lampros dhe Claire Grover); "More Holiness Give Me" ["Më Shumë Shenjtëri Më Jep"], *Hymns*, nr. 131, përshtatur

nga Beebe, bot. Larice; "Shpirti i Perëndisë", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, nr. 28, përshtatur nga DeFord, i pabotuar (në flaute: Tia Jaynes dhe Natalie Hall; soliste vokale: Katherine Dowse, Olivia Dowse, Megan Dowse Broughton, Jayni Dowse, Sally Dowse Duffin dhe Sofia Lee Dowse).

MUNDËSOHEN REGJISTRIME TË KONFERENCËS

Për të gjetur biseda të konferencës së përgjithshme në shumë gjuhë, vizitoni faqen conference.lds.org ose languages.lds.org. Pastaj zgjidhni një nga gjuhët. Përgjithësisht, brenda dy muajve pas konferencës, regjistrime zanore mundësohen edhe në qendrat e shpërndarjes.

MESAZHET E MËSIMIT TË SHTËPISË DHE TË VIZITËS MËSIMORE

Për mesazhet e mësimit të shtëpisë dhe të vizitës mësimore, ju lutemi zgjidhni atë fjalim që i përgjigjet më mirë nevojave të atyre që vizitoni.

NË KOPERTINË

Përpara: Fotografia nga Les Nilsson. Prapa: Fotografia nga Welden C. Andersen.

FOTOGRAFIMI I KONFERENCËS

Pamjet nga konferenca e përgjithshme në Solt-Lejk-Siti u morën nga Craig Dimond, Welden C. Andersen, John Luke, Matthew Reier, Christina Smith, Les Nilsson, Scott Davis, Lindsay Briggs, Cody Bell, Mark Weinberg, Weston Colton, Rod Boam dhe Sarah Carabine; në Argentinë nga Lucio Fleytas; në Brazil nga Lauren Fochetto dhe Ana Claudia Soli; në Republikën Domenikane nga Krista Groll; në Irlandë nga Farris Gerard; në Itali nga Alessandro Dini Ciacci; në Zelandën e Re nga Victoria Taupau; në Afrikën e Jugut nga Kevin Cooney; në Suedi nga Jens Rydgren; dhe në Uruguai nga Abel Gómez Pereyra. Portret i Presidentit Monson nga Busath Photography.



NËNTOR 2010 VËLLIMI 12 NR. 4
LIAHONA 09291 101

Revista ndërkombëtare zyrtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Presidencia e Parë: Tomas S. Monson, Henri B. Ajring, Diter F. Uhtdorf

Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve: Bojd K. Paker, L. Tom Perri, Rasëll M. Nelson, Dallin H. Ouks, M. Rasëll Ballard, Riçard G. Skot, Robert D. Hejls, Xhefri R. Holland, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson

Botues: Paul B. Pieper

Këshilltarë: Stanley G. Ellis, Christoffel Golden Jr., Yoshihiko Kikuchi

Drejtor Administrues: David L. Frischknecht

Drejtor i Artikutjve: Vincent A. Vaughn

Drejtor i Grafikës: Allan R. Loyborg

Redaktor Administrimi: R. Val Johnson

Ndihmësredaktorë Administrimi: Jenifer L. Greenwood, Adam C. Olson

Zëvendësredaktor: Ryan Carr

Ndihmësredaktor: Susan Barrett

Personeli i Redaksisë: David A. Edwards, Matthew D. Flirtton, LaRene Porter Gaunt, Carrie Kasten, Larry Hiller, Jennifer Maddy, Melissa Merrill, Michael R. Morris, Sally J. Odekirk, Judith M. Paller, Joshua J. Perkey, Chad E. Phares, Jan Pinborough, Richard M. Romney, Don L. Searle, Janet Thomas, Paul VanDenBerghe, Julie Wardell

Kryesekretare: Laurel Teuscher

Drejtor Administrues i Artit: J. Scott Knudsen

Drejtor Arti: Scott Van Kampen

Administruese e Prodhimit: Jane Ann Peters

Personeli i Punimit Artistik dhe i Prodhimit: Cali R. Arroyo, Collette Nebeker Aune, Howard G. Brown, Julie Burdett, Thomas S. Child, Reginald J. Christensen, Kim Fenstermaker, Kathleen Howard, Eric P. Johnsen, Denise Kirby, Scott M. Mooy, Ginny J. Nilson

Përgatitja për Shtyp: Jeff L. Martin

Drejtor i Prodhimit: Craig K. Sedgwick

Drejtor i Shpërndarjes: Evan Larsen

Mbikëqyrës i Përkthimit Shqip: Gilles François

Për pajtimet dhe për çmimet jashtë Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, ju lutemi të lidheni me qendrën tuaj vendore të shpërndarjes të Kishës ose me udhëheqësin e lagjes apo degës.

Dërgoni dorëshkrime dhe pyetje në Liahona,
Room 2420, 50 East North Temple Street,
Salt Lake City, UT 84150-0024, USA; ose e-mail:
liahona@ldschurch.org.

Liahona (një term nga Libri i Mormonit, që do të thotë "busull" apo "drejtues") botohet në anglisht, armenisht, bislamisht, bullgarisht, çekisht, danisht, estonisht, fihxisht, finlandisht, frëngjisht, greqisht, gjermanisht, hindisht, holandisht, hungarisht, indonezisht, islandisht, italisht, japonisht, kamboxhisht, kinezisht, kiribatisht, koreanisht, kroatisht, letonisht, lituanisht, malagasisht, marshallisht, mongolisht, norvegjisht, polonisht, portugalisht, rumanisht, rusisht, samoaisht, sebuanisht, sinhalaisht, sllovenisht, spanjisht, suedisht, shqip, tagalogisht, tahitisht, taisht, tamilisht, teleguisht, tongaisht, ukrainisht, urduisht dhe vietnamsisht. (Periodiciteti ndryshon sipas gjuhës.)

© 2010 nga Intellectual Reserve, Inc. I rezervohen të gjitha të drejtat. Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Lënda e shkruar dhe ajo figurative e *Liahonës* mund të kopjohet për ta përdorur me raste në kishë ose në shtëpi, jo për tregti. Lënda figurative nuk mund të kopjohet nëse ajo shoqërohet me kufizime të shënimit i meritave për punën artistike. Çështjet e së drejtës së autorit duhet të adresohen te: Intellectual Property Office, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150, USA; adresa elektronike: cor-intellectualproperty@ldschurch.org.

For Readers in the United States and Canada:

November 2010 Vol. 12 No. 4. LIAHONA (USPS 311-480) Albanian (ISSN 1521-4753), is published four times a year (April, May, October and November) by The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150. USA subscription price is \$3.00 per year; Canada, \$3.60 plus applicable taxes. Periodicals Postage Paid at Salt Lake City, Utah. Sixty days' notice required for change of address. Include address label from a recent issue; old and new address *must* be included. Send USA and Canadian subscriptions to Salt Lake Distribution Center at address below. Subscription help line: 1-800-537-5971. Credit card orders (Visa, MasterCard, American Express) may be taken by phone. (Canada Poste Information: Publication Agreement #40017431)

POSTMASTER: Send address changes to Salt Lake Distribution Center, Church Magazines, PO Box 26368, Salt Lake City, UT 84126-0368.



FOLËSIT SIPAS RENDIT
ALFABETIK

Ajring, Henri B., 23, 59, 70
Andersen, Nil L., 39
Arnold, Mervin B., 105
Ballard, M. Rasëll, 108
Bednar, Dejvid A., 94
Bek, Xhuli B., 112
Dancan, Kevin R., 34
Exhli, Riçard C., 31
Gong, Gerit W., 36
Hejls, Robert D., 24
Holland, Xhefri R., 6
Kiëron, Patrik, 50
Kosta, Klaudio R. M., 11
Kristoferson, D. Tod, 16
Kuk, Kuentin L., 27
Kuk, Meri N., 80
Lorens, Leri R., 98
Macagardi, Jairo, 103
Malm, Per G., 101
Mek-Konki, Dejvid M., 13
Monson, Tomas S., 4, 67, 87, 111, 122
Nelson, Rasëll M., 47
Ollred, Silvia H., 116
Ouks, Dallin H., 83
Paker, Bojd K., 74
Peri, L. Tom, 91
Skot, Riçard G., 43
Tompson, Barbara, 119
Uceda, Huan A., 53
Uhtdorf, Diter F., 19, 55
Uiksom, Rozmari M., 9
Xhensen, Xhei E., 77

TREGUES TEMATIK

Abuzimi me drogën, 108
Angazhimi, 67
Autoriteti, 83
Bazat e Ungjillit, 19
Bekimet, 87
Besëlidhjet, 36
Besimi, 6, 31, 34, 43, 80, 111, 116
Besnikëria, 39
Bindja, 11, 34, 43, 50, 70, 94, 98, 101, 105, 111
Cilësitë si të Krishtit, 53
Dashuria, 53
Dashuria hyjnore, 122
Dëshmia, 31, 77, 101
Dhembshuria, 119
Drejtesia, 91
Drita e Krishtit, 27
Familja, 19, 36, 98
Fatqeqësia, 116
Fëmijët, 9
Fryma e Shenjtë, 13, 59, 77, 94, 98
Fyerja, 39
Gjykimi, 122
Historia familjare, 36
Integriteti moral, 16, 27
Jezu Krishti, 31, 39, 87
Karakter, 43
Konferenca e përgjithshme, 4, 111
Konfirmimi, 94
Krenaria, 55
Kthimi në besim, 39
Kuraja, 98
Libri i Mormonit, 77
Liria e Zgjedhjes, 24, 27, 31, 67, 74, 103
Lutja, 9, 83
Mëkat, 103
Mësimdhënia, 9, 13

Mësimdhënia e vizitave, 119
Mësimi, 13
Mirëbesimi, 70
Mirënjohja, 6, 87
Moraliteti, 16, 27, 74, 80
Ndershmëria, 27
Paqja, 101
Pasojat, 67
Pendimi, 24, 50, 53, 74, 103
Përgjegjësia, 67
Përkushtimi, 16
Përlulësia, 55, 122
Pionierët, 34
Plani i shpëtimit, 9, 24, 116
Pornografia, 74, 103
Priftëria, 59, 91
Priftëria Aarone, 91
Prindërimi, 98
Profetët, 11, 34, 70
Puna, 16
Puna misionare, 4, 47
Sakrifica, 6
Shembulli, 9, 47, 80
Shërbesa e engjëjve, 91
Shërbimi, 6, 16, 55, 59, 91, 112, 119
Shërimi, 50
Shlyerja, 36, 108
Shoqata e Ndihmës, 112
Shoqërimi, 47
Standardet, 80
Studimi i shkrimit të shenjtë, 9, 13
Tempujt, 4, 36
Thjeshtësia, 19
Urdhërimet, 105
Varësia, 108
Zbulesa, 11, 77, 83, 94
Zelli, 19
Zgjedhja, 67



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Ndërsa Prapë Takohe mi së Bashku

Shërbimi misionar është një detyrë priftërie – një detyrim që Zoti e pret prej nesh, të cilëve na është dhënë kaq shumë.

Të dashur Vëllezërit dhe Motrat e mia, ne ju urojmë mirëseardhjen në konferencën e përgjithshme, që po dëgjohet e po shihet me mjete të ndryshme në mbarë botën. U shprehim falënderime të gjithëve që janë përfshirë në organizimin e kësaj konference të shkëlqyer.

Që nga prilli kur u takuam herën e fundit, puna e Kishës ka shkuar përpara e papenguar. Ka qenë privilegji im të përkushtoj katër tempuj të rinj. I shoqëruar nga këshilltarët e mi dhe Autoritete të tjera të Përgjithshme, kam shkuar në Gila-Velli të Arizonës, në Vankuver të Kolumbias Britanike,

Stokholm, Suedi



në Sebu të Filipineve dhe në Kiev të Ukrainës. Tempujt, në secilin prej këtyre vendeve, janë madhërisht të bukur. Secili po bekon jetën e anëtarëve tanë dhe është një ndikim pozitiv për ata që nuk janë të fesë sonë.

Mbrëmjen përpara përkushtimit të çdo tempulli, patëm privilegjin të shihnim një festim kulturor, ku morën pjesë njerëzit tanë të rinj dhe disa nga njerëzit tanë jo aq të rinj. Këto aktivitete u zhvilluan në përgjithësi në stadione të mëdhenj, ndonëse në Kiev u mbledhëm në një pallat të bukur. Vallëzimet, këngët, interpretimet



muzikore dhe shfaqjet qenë të shkëlqyera. Unë u shpreh lavdërimin dhe dashurinë time të gjithëve që u përfshinë.

Secili përkushtim tempulli që një festim shpirtëror. Ne ndiem Shpirtin e Zotit në secilin prej tyre.

Muajin e ardhshëm do të ripërkushtojmë Tempullin e Laies në Havai, një nga tempujt tanë më të vjetër, që i është nënshtruar riparimeve të gjera gjatë shumë muajve. E presim me padurim atë rast të shenjtë.

Ne vazhdojmë të ndërtojmë tempuj. Këtë mëngjes kam kënaqësinë të

njoftoj pesë tempuj të tjerë, për të cilët janë siguruar vendet e ndërtimit dhe të cilët, në muajt dhe vitet e ardhshme do të ndërtohen në vendet e mëposhtme: Lisbonë në Portugali, Indianapolis në Indiana, Urdaneta në Filipine, Hartford në Konetikat dhe Tihuana në Meksikë.

Ordinancat e kryera në tempujt tanë janë jetike për shpëtimin tonë dhe për shpëtimin e njerëzve tanë të dashur që kanë vdekur. Vazhdojmë me besnikëri që të shkojmë në tempuj, që po ndërtohen gjithnjë e më afër anëtarëve tanë.

Tani, përpara se të dëgjojmë folësit tanë këtë mëngjes, më lejoni të përmend një çështje që e kam për zemër dhe që meriton vëmendjen tonë serioze. Po flas për punën misionare.

Së pari, të rinjve të Priftërisë Aarone dhe ju të rinjve që po kaloni në detyrën e plakut: unë ju përsëris atë që kanë dhënë mësim prej kohësh profetët – që çdo i ri i denjë dhe i aftë duhet të përgatitet që të shërbejë në mision. Shërbimi misionar është një detyrë priftërie – një detyrim që Zoti e pret prej nesh, të

cilëve na është dhënë kaq shumë. Të rinj, ju këshilloj që të përgatiteni për shërbimin si misionar. Mbajeni veten të pastër, të dëlirë dhe të denjë për të përfaqësuar Zotin. Ruani shëndetin dhe forcën tuaj. Studioni shkrimet e shenjta. Atje ku mundësohen, merrni pjesë në seminar ose institut. Familjarizohuni me manualin misionar *Predikoni Ungjillin Tim*.

Një fjalë për ju motra të reja: ndonëse ju nuk keni të njëjtën përgjegjësi priftërore siç e kanë të rinjtë për të shërbyer mision kohëplota, ju gjithashtu jepni një kontribut të çmuar si misionare dhe ne e mirëpresim shërbimin tuaj.

Dhe tani për ju vëllezër e motra në moshë: ne kemi nevojë për shumë-shumë më tepër çifte në moshë. Për çiftet besnike që tani po shërbejnë ose që kanë shërbyer në të kaluarën, ne ju falënderojmë për besimin tuaj dhe përkushtimin ndaj ungjillit të Jezu Krishtit. Ju shërbeni me zell e mirë dhe përmbushni të mirë të madhe.

Për ata prej jush që nuk janë ende në atë stinë të jetës kur mund të shërbeni në një mision në çift, unë ju nxis të përgatiteni tani për ditën kur ju si bashkëshortë mund ta bëni këtë. Si ta lejojnë rrethanat tuaja, kur ju lind e drejta për të dalë në pension dhe si t'ju lejojë shëndeti, vihuni në dispozicion për të lënë shtëpinë e për të dhënë shërbim misionar kohëplotë. Janë pak ato kohë të jetës suaj kur do të shijoni shpirtin e ëmbël dhe kënaqësinë që vijnë nga dhënia e shërbimit kohëplotë së bashku në veprën e Mësuesit.

Tani, Vëllezërit dhe Motrat e mia, qofshi të harmonizuar me Shpirtin e Zotit ndërsa dëgjojmë shërbëtorët e Tij gjatë dy ditëve në vijim. Qoftë ky bekimi i secilit, lutem unë përlulesisht në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku Xhefri R. Holland,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Falë Besimit Tuaj

Falënderimet e mia të gjithëve juve anëtarë të mrekullueshëm të Kishës . . . që vërtetoni në çdo ditë të jetës suaj se dashuria e pastër e Krishtit “nuk ligështohet™ kurrë”.

Presidenti Monson, e gjithë anëtarësia e kësaj kisha kudo në botë bashkohet në atë himn të madh me këtë kor të mrekullueshëm dhe ne themi: “Ne të falënderojmë ty, o Perëndi, për një profet”. Faleminderit për jetën tënde, për shembullin tënd dhe për atë mesazh mirëseardhjeje një konference tjetër të përgjithshme të Kishës. Ne të duam ty, ne të admirojmë ty dhe ne të mbështesim ty. Vërtet, në këtë seancë të pasdites ne do të kemi një mundësi më formale për të ngritur dorën tonë në një votë mbështetjeje, jo vetëm për Presidentin Monson por gjithashtu për të gjithë zyrtarët e tjerë të përgjithshëm të Kishës. Ngaqë emri im do të përfshihet në atë listë, le të jem aq i guximshëm sa të flas për të gjithë duke ju falënderuar ju qysh përpara ato duar të ngritura. Asnjë nga ne nuk mund të shërbente pa lutjet tuaja dhe mbështetjen tuaj. Besnikëria juaj dhe dashuria juaj kanë domethënie më të madhe për ne nga sa do të mund ta shprehim ndonjëherë.

Në këtë frymë mesazhi im sot është për të thënë se *ne* ju mbështesim *juve*, që ne ju kthejmë *juve* po ato lutje të ndjera me zemër dhe po atë shprehje dashurie. Ne të gjithë e dimë se ka çelësa, besëlidhje dhe përgjegjësi që u jepen zyrtarëve kryesues të Kishës,

por ne dimë gjithashtu se Kisha merr një forcë të pakrahasueshme, një vitalitet vërtet unik, nga besnikëria dhe përkushtimi i *çdo* anëtari të kësaj Kisha, cilido që mund të jeni. Në çfarëdo vendi ku jetoni, sado i ri apo i papërshatru që ndiheni, apo sado të moshuar apo të kufizuar që e shihni veten si qenie, unë dëshmoj se ju jeni individualisht i dashur nga Perëndia, ju jeni kryesorë në domethënien e punës së Tij dhe ju jeni një njeri që e duan fort dhe për të cilin luten zyrtarët kryesues të Kishës së Tij. Vlera, mrekullia vetjake e çdo *njërit* nga ju, është vetë arsyeja që ka një plan shpëtimi dhe ekzaltimi. Në kundërshtim me të folurën e ditës, kjo është për *ju*. Jo, mos u kthe dhe të vështrosh fqinj tënd. Unë po të flas ty!

Unë jam përpjekur të gjej një mënyrë të përshtatshme për t'ju treguar sa të dashur jeni ju për Perëndinë dhe sa mirënjohës jemi ndaj jush ne në këtë presidium. Unë po përpiqem të jem zëri për çdo engjëll të qiellit që t'ju falënderoj juve për çdo gjë të mirë që keni bërë ndonjëherë, për çdo fjalë mirësie që keni thënë ndonjëherë, për çdo sakrificë që keni bërë ndonjëherë të drejtuar dikë – kushdo qoftë – te bukuria dhe te bekimet e ungjillit të Jezu Krishtit.

Unë jam mirënjohës për udhëheqëset e Të Rejave që shkojnë te kampi i vajzave dhe pa shampo, dushe apo ngjyra për fytyrën, i kthejnë mbledhjet e dëshmimeve të zjarrit me tym të kampit në diçka nga përjetimet më ngulitëse shpirtërore që ato vajza – apo ato udhëheqëse – do të përjetojnë gjatë gjithë jetës së tyre. Unë jam mirënjohës për të gjitha gratë e Kishës që gjatë jetës sime, kanë qenë aq të forta sa mali i Sinit dhe aq të mëshirshme sa shprehte predikimi i Jezusit në Malin e Bekimeve. Ne buzëqeshim ndonjëherë me historitë e motrave tona – ju e dini, xhelatinën me ngjyrë jeshile, dhe patatet e funeralit. Por familja ime ka qenë një marrëse mirënjohëse e secilit nga këto artikuj në një kohë apo një tjetër – dhe në një rast, të jorganit dhe patateve të funeralit në të njëjtën ditë. Ishte vetëm një jorgan i vogël – i imët, vërtet – për ta bërë udhëtimin e vëllait tim foshnjë përsëri në shtëpinë e tij në qiell, aq të ngrohtë dhe të rehatshëm, sa motrat e Shoqatës së Ndihmës dëshironin që ai të ishte. Ushqimi i siguruar për familjen tonë pas shërbesës, i dhënë vullnetarisht pa asnjë kërkesë nga ne, u prit me mirënjohje. Buzëqeshni, po të doni, mbi traditat tona por në një mënyrë gratë tepër shpesh të pavlerësuara në këtë kishë janë *gjithnjë* atje kur duar lëshohen dhe gjunjët dridhen.¹ Ato duket se e kuptojnë intuitivisht shenjtërinë në thënien e Krishtit: “Sa herë ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre . . . më të vegjël[ve], këtë ma bëtë mua.”²

Dhe jo më pak vëllezërit e priftërisë. Unë mendoj, për shembull, për udhëheqësit e të rinjve tanë, që, në vartësi nga klima dhe kontinenti, ose ndërmarrin marshime 80-kilometërshe në terrene të vështira apo gërmojnë – dhe në të vërtetë përpiqen të flenë në – guva akulli në netë të ftohta,



që duket të jenë nga më të gjatat në jetën e njeriut. Unë jam mirënjohës për kujtimet e grupit tim të priftërinjve të lartë, që disa vitet përpara, fjeti me turne për disa javë në një karrige përshatëse të vogël në dhomën e gjumit të një anëtari të kuorumit që po vdiste, që bashkëshortja e tij e moshuar dhe po aq delicate, të mund të flinte pak gjatë atyre javëve të fundit të jetës së të dashurit të saj. Unë jam mirënjohës për armatën e mësuesve të Kishës, zyrtarët, këshilltarët dhe nëpunësit, pa përmendur njerëzit që janë gjithnjë duke ngritur tavolina dhe duke hapur karriget. Unë jam mirënjohës për patriarkët e shuguruar, për muzikantët, për historianët e familjeve dhe për çiftet osteoporozë që me vështirësi shkojnë në tempull në 5:00 të mëngjesit me një valixhe të vogël thuajse më të madhe nga ata vetë. Unë jam mirënjohës për prindërit e qetë, vetmohues, që – ndoshta gjithë jetën – kujdesen për një fëmijë me paaftësi, ndonjëherë me më shumë se një problem, dhe ndonjëherë me më shumë se një fëmijë. Unë jam mirënjohës për fëmijët që shtrëngojnë radhët më vonë në jetë për t’ua kthyer prindërve të sëmurë apo të moshuar.

Dhe për motrën e moshuar thuajse të përsosur që gati duke kërkuar falje

pëshpëriti së fundi: “Unë nuk kam qenë kurrë udhëheqëse për ndonjë gjë në Kishë. Unë kam qenë vetëm një ndihmëse”, unë them: “E dashur motër, Perëndia të bekoftë ty dhe të gjithë ‘ndihmësit’ në mbretëri”. Disa nga ne që *jemi* udhëheqës shpresojmë që një ditë të kemi përpara Perëndisë pozitën që ju e keni arritur tashmë.

Tepër shpesh unë nuk e kam arritur ta shpreh mirënjohjen për besimin dhe mirësinë e njerëzve të tillë në jetën time. Presidenti Xhejms E. Faust qëndroi në këtë foltore trembëdhjetë vite përpara dhe tha: “si djalë i vogël . . . , unë kujtoj gjyshen time . . . duke gatuar ushqimet tona të shijshme në një sobë të nxehtë me dru. Kur arka prej druri ngjitur me sobën zbrazej, gjyshja qetësisht . . . dilte për ta mbushur përsëri nga stiva me dru kedri jashtë dhe sillte arkën e ngarkuar rëndë përsëri brenda në shtëpi. Unë isha kaq i pandjeshëm . . . [saqë] rrija ulur atje dhe e lija gjyshen time të dashur ta rimbushte [atë] arkë”. Atëherë, me zërin që i mbahej nga emocioni, ai tha: “Unë ndihem i turpëruar për veten dhe më ka ardhur keq për mosveprimin gjatë gjithë jetës time. Unë shpresoj që një ditë të kërkoj falje nga ajo.”³

Nëse një njeri aq i përsosur, siç ndieja se ishte Presidenti Faust, mund

të njohë pakujdesinë e tij rinore, unë mund të bëj jo më pak sesa një pranim të ngjashëm dhe të paguaj sot një borxh të vonuar gjatë.

Kur isha thirrur të shërbeja një mision dikur përpara se koha të lindte, nuk kishte barazim të kostove misionare. Secili duhej të përballonte shpenzimin e plotë të misionit ku ai apo ajo ishte dërguar. Disa misione ishin shumë të kushtueshme dhe, siç rezultoi, imi ishte një nga ato.

Siç i nxitim të bëjnë misionarët, unë pata kursyer para dhe shitur gjëra personale për të paguar rrugën time sa më mirë që mundesha. Unë *mendova* se kisha mjaft para, por nuk isha i sigurt si do të ishte në muajt e fundit të misionit tim. Me atë pyetje në mendje, unë gjithsesi e lashë familjen time me lumturi për përvojën më të madhe që kushdo mund të shpresojë të ketë. Unë e doja misionin tim siç jam i sigurt se, asnjë i ri nuk e ka dashur ndonjëherë më parë apo më pas.

Pastaj unë u ktheva në shtëpi pikërisht kur prindërit e mi ishin thirrur të shërbenin një mision të tyre. Çfarë do të bëj tani? Si vallë mund të paguaj për një arsimim në kolegji? Si mund vallë të paguaj për ushqimin dhe fjetjen? Dhe si mund ta kuptoj ëndrrën e madhe të zemrës sime, të martohem me të

përsosurën mahnitëse Patrisha Terri? Unë nuk e kam problem të pranoj se isha i shkurajuar dhe i trembur.

Me ngurrim shkova te banaku i lokalit dhe pyeta menaxherin, një mik i familjes, sa ishte llogaria ime. Ai pa i befusuar dhe tha: “Pse, Xhef, *gjithçka* është në llogarinë tënde. Nuk të treguan ata ty? Prindërit e tu donin të bënin sado pak që mundeshin për të të ndihmuar ty të filloje kur të ktheheshe në shtëpi. Ata nuk tërhoqën asnjë cent gjatë misionit tënd. Unë mendoja se ti e dije.”

Mirë, unë nuk e dija. Ajo që di unë është se babai im, një “mbajtës llogarie”, siç quheshin atëherë në qytetin tonë të vogël, autodidakt, me shumë pak klientë, ndoshta nuk veshi kurrë një kostum të ri apo një këmishë të re, apo një palë të këpucë të reja për dy vjet, në mënyrë që biri i tij të mund t’i kishte të gjitha për misionin e tij. Për më tepër, ajo që unë nuk e dija por që atëherë e mësova, ishte se mamaja ime, që kurrë nuk kishte punuar jashtë shtëpisë në jetën e saj bashkëshortore, filloi një punë në një market industrial që shpenzimet e misionit tim të mund të përballoheshin. Dhe as edhe një fjalë rreth kësaj nuk u përcoll kurrë tek unë në mision. Asnjë fjalë e vetme nuk u tha lidhur me çfarëdo gjëje për këtë. Sa baballarë në këtë Kishë kanë bërë saktësisht atë që babai im bëri? Dhe sa nëna, në këto kohë të vështira ekonomike, janë përsëri duke bërë atë që bëri mamaja ime?

Babai im ka 34 vite që është larguar nga jeta, kështu si Presidenti Faust mua do të më duhet të pres që ta falënderoj atë plotësisht në anën tjetër. Por nëna ime e dashur, që bëhet 95 javën tjetër, është duke ndjekur lumturisht këtë transmetim në shtëpinë e saj sot në Seint Xhorxh, kështu që nuk është tepër vonë për ta falënderuar atë. Ju, mama dhe baba, dhe të gjitha

nënat dhe etërit dhe familjet dhe njerëzit besnikë kudo, unë ju falënderoj që sakrifikoni për fëmijët tuaj (dhe për fëmijët e njerëzve të tjerë!), që doni aq shumë t’u jepni atyre favore që juve kurrë nuk i patët, që doni aq shumë t’u jepni atyre jetën më të lumtur që mund t’u siguroni.

Falënderimet e mia të gjithë juve anëtarë të mrekullueshëm të Kishës – dhe legjioneve të njerëzve të mirë jo të besimit tonë – që provoni në çdo ditë të jetës tuaj se dashuria e Krishtit “nuk ligështohet kurrë”.⁴ Asnjë nga ju nuk është i parëndësishëm, pjesërisht sepse ju zbatoni ungjillin e Jezu Krishtit që do të thotë – një kujtesë e gjallë e hirit dhe e mëshirës së Tij, një shfaqje vetjake por e fuqishme në fshatra të vegjël dhe në qytete të mëdha e së mirës që Ai bëri dhe i jetës që Ai dha, duke sjellë paqe dhe shpëtim për njerëzit e tjerë. Ne jemi të nderuar pa masë që llogaritemi të jemi një me ju në një kauzë të tillë të shenjtë.

Siç Jezusi u tha nefeëve, unë po them sot:

“Për shkak të besimit tuaj . . . , gëzimi im është i plotë.

“Dhe pasi tha këto fjalë, ai qau.”⁵

Vëllezër dhe motra, duke parë shembullin tuaj, unë premtoj përsëri vendsomërinë *time* për të qënë më i mirë, për të qënë më besnik – më i dashur dhe i përkushtuar, më bamirës dhe i vërtetë siç është Ati ynë në Qiell dhe aq shumë nga ju janë tashmë. Për këtë lutem në emër të Shembullit tonë të Madh në të gjitha gjërat – madje në emër të Zotit Jezu Krisht – amen. ■

SHËNIME

1. Shih Hebrejve 12:12; Doktrina e Besëlidhje 81:5.
2. Mateu 25:40.
3. James E. Faust, “The Weightier Matters of the Law: Judgment, Mercy, and Faith”, *Ensign*, nëntor 1997, 59.
4. 1 Korintasve 13:8; shih gjithashtu Moroni 7:46–47.
5. 3 Nefi 17:20–21.





Nga Rozmari M. Uiksom,
Presidente e Përgjithshme e Fillores

Qëndroni në Shteg

Kur kapemi me fëmijët tanë dhe ndjekim udhëheqjen e Shpëtimtarit, ne të gjithë do të kthehemi tek shtëpia jonë qiellore dhe do të jemi të sigurt në krahët e Atit tonë Qiellor.

Kohët e fundit vrojtova lindjen e Kejt Elizabetës së vogël. Pasi hyri në këtë botë dhe e vendosën në krahët e nënës së saj, Kejti u zgjat dhe kapi fort gishtin e nënës. Ishte sikur Kejti e vogël po thoshte: “Nëse do të kapem, a do të më ndihmoni të qëndroj në shteg për t’u kthyer tek Ati im Qiellor?”

Në moshën shtatëvjeçare, Jozef Smithi u sëmur me tifo dhe në këmbë iu bë një infeksion. Dr. Natan Smithi po studioje një mënyrë veprimi me anë të së cilës këmba e infektuar mund të shpëtohej. Pa anestezi, Dr. Smithit i duhej ta priste mishin e këmbës dhe faktikisht të hiqte pjesë të kockës së infektuar. Jozefi nuk e pranoi konjakun për të duruar dhembjen dhe refuzoi ta lidhnin, por tha: “Babai im do të ulet në shtrat dhe do të më mbajë në krahët e tij dhe pastaj, unë do të bëj gjithçka duhet”¹.

Për fëmijët në mbarë botën, ne themi: “Merre dorën time. Mbahu fort. Do të qëndrojmë në shteg së bashku për t’u kthyer tek Ati ynë Qiellor.”

Prindërit, gjyshërit, fqinjët, miqtë, udhëheqëset e Fillores – secili prej nesh mund të zgjatet për t’u kapur me fëmijët. Ne mund të ndalemi, të gjunjëzohemi e të shohim në sytë e tyre dhe të ndiejmë dëshirën e tyre

të lindur për të ndjekur Shpëtimtarin. Kapini duart e tyre. Ecni me ta. Është shansi ynë që t’i fiksojmë ata në shtegun e besimit.

Asnjë fëmijë nuk i duhet të ecë i vetëm në shteg për aq kohë sa t’u flasim lirisht fëmijëve tanë për planin e shpëtimit. Kuptimi i planit do t’i ndihmojë ata të kapen tek të vërtetat se ata janë fëmijë të Perëndisë dhe se Ai ka një plan për ta, se ata jetuan me Të në ekzistencën paratokësore, se ata lëshuan britma gëzimi për të ardhur në këtë tokë dhe se, nëpërmjet ndihmës së Shpëtimtarit, ne të gjithë mund të kthehemi në prani të Atit tonë Qiellor. Nëse e kuptojnë planin dhe se cilët janë, ata nuk do të kenë frikë.

Tek Alma 24 lexojmë: “Ai i do shpirtrat tanë [dhe i] do dhe fëmijët tanë; prandaj, . . . plani i shpëtimit të bëhet i njohur prej nesh, si edhe prej brezave të ardhshëm”².

Ne fillojmë t’ua bëjmë të njohur planin fëmijëve tanë kur ne vetë kapemi fort tek shufra e hekurt.

Kur kapemi fort tek shufra e hekurt, jemi në gjendje t’i vendosim duart tona mbi të tyret dhe të ecim së bashku në shtegun e ngushtë e të ngushtuar. Shembulli ynë lartësohet në sytë e tyre. Ata do ta ndjekin shembullin tonë kur të ndihen të sigurt në

veprimet tona. Nuk nevojitet të jemi të përsosur – thjesht të ndershëm e të singertë. Fëmijët dëshirojnë të ndihen një me ne. Kur një prind thotë: “Ne mund ta bëjmë këtë! Ne mund t’i lexojmë çdo ditë si familje shkrimet e shenjta!” fëmijët do të pasojnë.

Një familje e tillë me katër fëmijë të vegjël shkruan: “Ne vendosëm ta nisim me gjëra të vogla, për shkak të periudhës së shkurtër të vëmendjes së fëmijëve tanë. Fëmija jonë më e madhe ende nuk lexonte, por ajo mund të përsëriste fjalët tona, kështu që filluam ta lexojmë Librin e Mormonit, vetëm tre vargje çdo natë. Bashkëshorti im dhe unë do të lexonim nga një varg secili dhe pastaj Sidni do të përsëriste një varg. Ne përparuam në katër vargje dhe pastaj pesë vargje, kur djemtë filluan të përsërisin vargjet e tyre. Po, ishte e lodhshme, por ne vazhduam. U përpoqëm të përquendrohemi tek qëndrueshmëria në vend të shpejtësisë. Na u deshën tre vjet e gjysmë që ta mbaronim Librin e Mormonit. Qe një ndjesi e shkëlqyer arritjeje!”

Nëna vazhdon: “Leximi i përditshëm familjar i shkrimeve të shenjta është një zakon tani në familjen tonë. Fëmijët tanë ndihen rehat me gjuhën e shkrimeve të shenjta dhe bashkëshorti im dhe unë shfrytëzojmë mundësinë për të dhënë dëshmi për të vërtetat. Më e rëndësishmja, Shpirti është shtuar në shtëpinë tonë.”

A mësoni nga përvoja e kësaj familjeje çfarë mësoj unë? Kur qëllimi ynë është të kapemi fort tek fjala e Perëndisë, leximi ynë i shkrimeve të shenjta mund të jetë thjesht nga një varg çdo herë. Asnjëherë nuk është tepër vonë për të filluar. Ju mund ta filloni tani.

Bota do t’u japë mësim fëmijëve tanë, nëse nuk e bëjmë ne, dhe fëmijët janë të aftë të mësojnë gjithçka do t’u



mësojë bota, që në moshë shumë të vogël. Ajo çka duam që të dinë ata pas pesë vitesh, duhet të jetë pjesë e bashkëbisedimit tonë me ta sot. Jepuni mësim atyre në çdo rrethanë; bëni që çdo dilemë, çdo pasojë, çdo sprovë që mund të hasin ata, të japë një mundësi për t'u mësuar si të kapen tek të vërtetat e ungjillit.

Shenon, një nënë e re, nuk priste t'u mësonte fëmijëve të saj forcën e lutjes kur ata u rrasën në furgonin e tyre për t'u kthyer në shtëpi, vetëm 40 minuta larg. Nuk kishte stuhi kur u larguan nga shtëpia e gjyshes, por kur filluan të udhëtojnë nëpër kanione, bora e lehtë u shndërrua në stuhi. Furgoni filloi të rrëshkiste në sipërfaqen e udhës. Shpejt largësia e shikimit u bë thuajse zero. Dy fëmijët më të vegjël mund ta ndienin tensionin e situatës dhe filluan të qajnë. Shenoni u tha fëmijëve më të mëdhenj, Haidit dhe Tomasit, në moshë 8 dhe 6 vjeç: "Juve duhet të luteni. Na duhet ndihma e Atit Qiellor për të shkuar të sigurt në shtëpi. Lutuni që të mos ngecim dhe që të mos shkasim jashtë udhës." Duarte i dridheshin ndërsa drejtonte makinën, por mund të dëgjonte

pëshpëritjet e lutjeve të vogla, që vinin vazhdimisht nga ndenjëset e mbrapme. "Ati Qiellor, të lutem na ndihmo të kthehemi të sigurt në shtëpi; të lutem na ndihmo që të mos shkasim jashtë udhës."

Me kohë lutjet i qetësuan dy të vegjlit dhe pushuan së qari sapo mësuuan se një bllokim në rrugë i pengonte të udhëtonin më tej. Me kujdes, morën kthesë dhe gjetën një motel për atë natë. Kur shkuan në motel, u gjujnzuan dhe e falënderuan Atin Qiellor për sigurimin e tyre. Atë natë, një nënë u mësoi fëmijëve të saj fuqinë e qëndrimit të vërtetë ndaj lutjes.

Çfarë sprovash do të hasin fëmijët tanë? Ashtu si Jozef Smithi, fëmijët tanë mund të gjejnë kurajën të "bëj[në] gjithçka duhet". Kur ne jemi të qëllimshëm për t'i mbajtur ata dhe për t'u mësuar për planin e Atit Qiellor nëpërmjet lutjes dhe shkrimeve të shenjta, ata do ta dinë se nga kanë ardhur, *përse* janë këtu dhe *ku* po shkojnë.

Pranverën e kaluar, bashkëshorti im dhe unë morëm pjesë në një lojë futbollit të nipit tonë katërvjeçar. Mund të ndienit emocionet në fushë kur lojtarët

vraponin në çdo drejtim duke ndjekur topin e futbollit. Kur fishkëlleu bilbili i fundit, lojtarët nuk e dinin se cili fitoi e cili humbi. Ata thjesht kishin lozur lojën. Trajnerët i drejtuan lojtarët që të toknin duart me pjesëtarët e skuadrës kundërshtare. Atëherë vërejtja diçka shumë kuptimplote. Trajneri bëri thirrje për një tunel të fitores. Të gjithë prindërit, gjyshërit dhe spektatorët, që kishin ardhur për të parë ndeshjen, u ngritën në këmbë dhe formuan dy rreshta përballë njëri-tjetrit dhe, duke ngritur krahët, formuan një hark. Fëmijët thirrën ndërsa vrapuan mes të rriturve brohoritës dhe nëpër shtegun e formuar nga spektatorët. Shpejt fëmijët nga skuadra kundërshtare u bashkuan me zbatimjen ndërsa të gjithë lojtarët – fituesit dhe humbësit – morën brohoritje nga të rriturit, kur vrapuan në shtegun e tunelit të fitores.

Me sytë e mi të mendjes, pata një figurë tjetër. Pata ndjesinë se po i shihja fëmijët të jetonin planin, planin që Ati Qiellor ka krijuar për secilin fëmijë të veçantë. Ata po vraponin në shtegun e ngushtë e të ngushtuar mes krahëve të spektatorëve që i donin ata, duke ndier secili gëzimin e të qenit në shteg.

Jakobi tha: "O sa i madh plani i Perëndisë tonë!"³ Shpëtimtari "udhën neve na shënoi, andej përher' na prin"⁴. Unë dëshmoj se kur kapemi me fëmijët tanë dhe ndjekim udhëheqjen e Shpëtimtarit, ne të gjithë do të kthehemi tek shtëpia jonë qiellore dhe do të jemi të sigurt në krahët e Atit tonë Qiellor. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Lucy Mack Smith, *History of Joseph Smith by His Mother*, red. Preston Nibley (1958), f. 56–57.
2. Alma 24:14.
3. 2 Nefi 9:13.
4. "Oh, sa Urti dhe Dashuri", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 19.



Nga Plaku Claudio R. M. Costa,
i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

Bindja ndaj Profetëve

Çfarë bekimi i madh është të kemi profetë në kohën tonë!

Unë jam një i kthyer në besim në Kishë. Jam shumë mirënjohës që Perëndia iu përgjigj lutjes time dhe më dha dijeni e një dëshmi të fuqishme që Jozef Smithi është një profet i Perëndisë.

Përpara se të merrja vendimin që të pagëzohesha në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, studiova fragmentet nga historia e Jozef Smithit. U luta pasi lexova me kujdes çdo paragraf. Nëse do të dëshironi ta bëni ju vetë këtë, mund t'ju duhen 14 orë.

Pasi lexova, meditova dhe u luta, Zoti më dha sigurinë se Jozef Smithi qe profeti i Tij. Unë ju dëshmoj se Jozef Smithi është një profet dhe, meqë e kam marrë këtë përgjigje nga Zoti, e di se të gjithë pasuesit e tij janë gjithashtu profetë. Çfarë bekimi i madh është të kemi profetë në kohën tonë!

Përse është e rëndësishme të kemi profetë të gjallë që të udhëheqin Kishën e vërtetë të Jezu Krishtit dhe anëtarët e saj?

Tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, e gjejmë përkufizimin e fjalës *profet*: “Një njeri i cili thirret nga Perëndia dhe flet për Të. Si lajmëtar i Perëndisë, një profet merr urdhërime, profeci dhe zbulesa nga Perëndia” (“Prophet”, scriptures.lds.org; shih edhe Bible Dictionary, “Prophet”).

Është një bekim i madh të marrësh fjalën, urdhërimet dhe udhëheqjen e Zotit në këto ditë të vështira të tokës. Profeti mund të frymëzohet të shohë të ardhmen në përfitim të njerëzimit.

Neve na është thënë: “Sepse Zoti, Zoti, nuk bën asgjë, pa ua treguar sekretin e tij shërbëtorëve të tij, profetëve” (Amosi 3:7). Mësojmë nga ky shkrim i shenjtë se Zoti do t’u zbulojë profetëve të tij absolutisht çfarëdo gjë, që Ai ndjen se është e nevojshme të na komunikojë neve. Ai do të na zbulojë vullnetin e Tij për ne dhe do të na udhëzojë me anë të profetëve të Tij.

Zoti na ka premtuar që, nëse i besojmë profetët e shenjtë, ne do të kemi jetë të përjetshme (shih DeB 20:26). Në nenin e gjashtë të besimit, ne deklarojmë se besojmë tek profetët. Të besosh do të thotë të kesh besim e mirëbesim tek ata dhe t’i ndjekësh, dhe të bësh atë çfarë na kërkojnë të bëjmë profetët.

Në 1980-ën, kur Presidenti Ezra Taft Benson po shërbente si President i Këshillit të Dymbëdhjetë Apostujve, ai dha një mesazh të fuqishëm mbi bindjen ndaj profetëve në një mbrëmje shpirtërore të UBJ në Qendrën Mariot. Biseda e tij e shkëlqyer me titull “Fourteen Fundamentals in Following the Prophet” [“Katërmbëdhjetë Pika Themelore për Ndjekjen e Profetit”],

më preku zemrën. Më bëri të ndihe-she mirë që kisha marrë vendimin të ndiqja profetët për gjithë pjesën tjetër të jetës sime, kur pranova pagëzimin në Kishën e vërtetë të Zotit.

Do të doja të ndaja me ju disa nga parimet që dha mësim Presidenti Benson:

“Së pari: *Profeti është njeriu i vetëm që flet për Zotin në çdo gjë*” (1980 *Devotional Speeches of the Year* [1981], f. 26).

Në kohën tonë, profeti i Perëndisë na ka thënë të mbajmë urdhërimet, ta duam bashkënjëriun tonë, të shërbejmë, të kujdesemi për brezin e ri, të shpëtojmë joaktivët ose më pak aktivët – të bëjmë shumë gjëra, që i quajmë përparësi profetike. Na duhet të kuptojmë se këto përparësi janë përparësitë e Perëndisë dhe profeti është zëri i Tij që ia komunikon ato të gjithë Kishës dhe botës.

Neve na është këshilluar “[t’ua vëmë] veshin fjalëve dhe urdhërimeve të tij” (DeB 21:4). Ne mësojmë gjithashtu:

“Sepse fjalën e tij duhet ta merrni si nga goja ime, plot durim e besim.

Pasi duke i bërë këto gjëra, portat e ferrit nuk do të hapen kundër jush; po, dhe Zoti Perëndi do t’i shpërndajë fuqitë e errësirës përpara jush dhe do të bëjë që qiejt të dridhen për të mirën tuaj dhe për lavdinë e emrit të tij” (DeB 21:5–6).

Pika e dytë themelore: “*Profeti i gjallë është më jetik për ne sesa veprat standarde*” (“Fourteen Fundamentals”, f. 26).

Profeti i gjallë po merr zbulesa të posaçme për ne. Mund të kujtoj shumë herë kur kam qenë i prani-shëm për të dëgjuar një nga shërbëtorët e Zotit të flasë për një gjë të veçantë për një qytet apo vend. Më kujtohen të paktën tre nga profetët e gjallë, shikuesit dhe zbuluesit, që kanë



folur për vendin tim, Brazilin. Një nga këta shërbëtorë tha se Brazili do të bëhej një ekonomi e madhe në botë, e lirë nga inflacioni. Në atë kohë, ne kishim inflacion dyshifror çdo muaj. Për shumë njerëz, ishte e vështirë të besonin atë çfarë tha profeti, por unë e besova. Brazili ka pasur rreth 5 përqind inflacion në vit për shumë vite me radhë tani. Brazili është bërë i teti në ekonominë botërore dhe vendi po ecën shkëlqyeshëm!

Pika e tretë themelore: *“Profeti i gjallë është më i rëndësishëm për ne sesa një profet i vdekur”* (“Fourteen Fundamentals”, f. 27).

Ne mësojmë një mësim të madh për këtë nga shkrimet e shenjta. Në kohën e Noeut, ishte më e lehtë për njerëzit që të besonin tek profetët e vdekur, por që e vështirë për ta që të besonin tek Noeu. Ne e dimë se,

për shkak të mosbesimit të tyre, ata nuk i mbijetuan përmytjes (shih Zanafilla 6–7).

Pika e katërt themelore: *“Profeti nuk do ta udhëheqë kurrë Kishën në udhë të gabuar”* (“Fourteen Fundamentals”, f. 27).

Përsëri, ne mësojmë nga profetët e gjallë. Presidenti Uillford Udraf tha: “Zoti nuk do të më lejojë kurrë mua apo ndonjë burrë tjetër që qëndron si President i kësaj Kise për t’ju udhëhequr në udhë të gabuar. Nuk është në program. Nuk është në mendjen e Perëndisë. Në qoftë se unë do të përpiqesha për atë, Zoti do të më hiqte nga vendi im dhe kështu Ai do të bënte me këdo tjetër që do të përpiqet t’i drejtojë fëmijët e njerëzve në udhë të gabuar nga orakujt e Perëndisë dhe nga detyra e tyre” (Deklarata Zyrtare 1).

Pika e pestë themelore: *“Profetit nuk i kërkohet të ketë ndonjë trajnim apo kualifikime të veçanta tokësore për të folur mbi çfarëdo teme, apo për të vepruar për çfarëdo çështjeje në cilëndo kohë”* (“Fourteen Fundamentals”, f. 27).

Zoti thirri një të ri, Jozef Smithin, që të rivendoste Kishën e Tij. A mendoni se i riu Jozef Smith kishte titullin doktor në teologji apo shkencë? Ne e dimë se ai qe një i ri i përulur dhe pa arsimim akademik. Por ai u zgjodh nga Zoti dhe mori nga Zoti gjithçka që e nevojshme për ta nderuar dhe lartësuar thirrjen e një profeti të Rivendosjes.

Presidenti Benson vazhdoi:

“E gjashta: *Profetit nuk i duhet të thotë: ‘Kështu thotë Zoti’, që të na japë shkrim të shenjtë. . . .*

E shtata: *Profeti na tregon atë që na duhet të dimë, jo gjithmonë atë çfarë ne duam të dimë”* (“Fourteen Fundamentals”, f. 27, 28).

Dhe pastaj, Presidenti Benson citoi nga 1 Nefi 16:1, 3:

“Dhe tani ndodhi që pasi unë, Nefi, mbarova së foluri me vëllezërit e mi, vini re, ata më thanë: Ti na ke shpallur gjëra të rënda, më shumë sesa ne mund të durojmë. . . .

Dhe tani, vëllezërit e mi, në qoftë se ju do të ishit të drejtë dhe do të ishit të gatshëm të dëgjoni të vërtetën dhe t’ia vinit veshin asaj, që ju të mund të ecnit drejt përpara Perëndisë, atëherë ju nuk do të mërmëritnit për shkak të së vërtetës dhe të thonit: Ti flet gjëra të rënda kundër nesh.”

Pika e tetë themelore: *“Profeti nuk kufizohet nga arsyetimi i njerëzve. . . .*

. . . A duket e arsyeshme të mjekosh lebrën duke i thënë një njeriu të lahet shtatë herë në një lumë të veçantë? Megjithatë, kjo është pikërisht çfarë i tha të bënte një lebrozi profeti Eliseu

dhe ai u shërua. (Shih 2 Mbretërve 5.)” (“Fourteen Fundamentals”, f. 28).

Dhe Presidenti Benson vazhdoi të jepte parime të tjera mbi bindjen ndaj profetit. Do të lexoj gjashtë të fundit dhe ju ftoj që, në mbrëmjen tuaj të ardhshme familjare, t’i gjeni këto parime në fjalët dhe mësimet e profetëve, shikuesve dhe zbuluesve tanë të gjallë gjatë kësaj konference të përgjithshme.

“E nënta: *Profeti mund të marrë zbuluesë për çfarëdo çështje – materiale ose shpirtërore.* . . .

E dhjeta: *Profeti mund të përfshihet në çështje qytetare.* . . .

E njëmbëdhjeta: *Dy grupet që kanë vështrësitë më të mëdha për të ndjekur profetin janë krenarët që janë të mësuar, dhe krenarët që janë të pasur.* . . .

E dymbëdhjeta: *Profeti jo domosdoshmërisht do të jetë popullor për botën apo materialistët.* . . .

E trembëdhjeta: *Profeti dhe këshilltarët e tij përbëjnë Presidencën e Parë – kuorumi më i lartë në Kishë.* . . .

E katërbëdhjeta: *Profeti dhe presidenca – profeti i gjallë dhe Presidenca e Parë – ndiqini ata dhe do të bekoheni; refuzojini ata dhe vuani*” (“Fourteen Fundamentals”, f. 29).

Ne kemi privilegjin të kemi fjalët e e profetëve, shikuesve dhe zbuluesve tanë të gjallë gjatë kësaj konference të përgjithshme të mrekullueshme. Ata do të shprehin vullnetin e Zotit për ne, popullin e Tij. Ata do të transmetojnë fjalën e Perëndisë dhe këshillën e Tij për ne. Vëruani veshin dhe ndiqini udhëzimin e sugjerimet e tyre dhe unë ju dëshmoj se jeta juaj do të jetë plotësisht e bekuar.

Jezusi është Krishti, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë. Tomas S. Monsoni është profeti i gjallë i Perëndisë dhe Presidenca e Parë e Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve, janë profetë, shikues e zbulues. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Dejvid M. Mek-Konki,

Këshilltar i Parë në Presidencën e Përgjithshme të Shkollës të së Dieles

Mësimi dhe Mësimdhënia e Ungjillit

Ajo që ka më shumë rëndësi është qëndrimi apo shpirti me anë të së cilit mësuesi jep mësim.

Si anëtar i presidencës së përgjithshme të Shkollës të së Dieles, e ndiej se duhet t’i filloj fjalët e mia këtë mëngjes duke thënë: “Mirëmëngjes, klasa”.

Mesazhi im sot ju drejtohet të gjithëve ju që jeni thirrur për të dhënë mësim, në cilëndo organizatë të jeni duke shërbyer dhe qoftë nëse jeni një i sapokthyer në besim në Kishë, apo një mësues me vite përvojë.

Nuk do të flas mbi mënyrat e mësimdhënies por përkundrazi, mbi mënyrat e mësimin. Mund të ketë një ndryshim të madh mes asaj që një mësues thotë dhe asaj që dëgjojnë ose mësojnë ata që janë në klasë.

Mendoni për një çast për një mësues, që vërtet solli ndryshim në jetën

tuaj. Çfarë kishte ai apo ajo që ju bëri ta kujtoni atë që u dha mësim, të dëshironi ta zbuloni të vërtetën për vete, ta ushtroni lirinë tuaj të zgjedhjes dhe të veproni e jo të detyrohemi të veproni – me fjalë të tjera, që të mësoni? Çfarë kishte ai apo ajo mësues/e, që e dallonte nga pjesa tjetër?

Një mësues dhe autor i suksesshëm tha: “Ajo çfarë ka më shumë rëndësi në të mësuar është qëndrimi. Qëndrimi i mësuesit.”¹

Vini re se ajo që ka rëndësi më shumë në të mësuarin, nuk është numri i viteve që një mësues ka qenë anëtar i Kishës, apo sa shumë përvojë mësimdhënieje ka një person, apo madje njohuria e ungjillit e mësuesit ose teknikat e mësimdhënies. Ajo që





ka më shumë rëndësi, është qëndrimi apo shpirti me anë të së cilit mësuesi jep mësim.

Në një mbledhje mbarëbotërore për trajnimin e udhëheqjes, Plaku Xhefri R. Holland tregoi këtë ndodhje: “Prej shumë vitesh, më ka pëlqyer ndodhja që Presidenti Paker ka treguar mbi mësuesin e Shkollës të së Dieles në djalërinë e Uilliam E. Berretit. Një Vëllai i moshuar danez u thirr t’i jepte mësim një klase djemsh të potershëm. . . . Ai nuk e fliste shumë mirë gjuhën; ende kishte një theks të fortë danez; ishte shumë më i moshuar, kishte duar të mëdha fermeri. Përsëri, ai duhej t’u jepte mësim këtyre 15-vjeçarëve të rinj, të rrëmujshëm. Me gjithë qëllimin e mirë, kjo nuk dukej si një përshtatje shumë e mirë. Por Vëllai Berret thoshte – dhe kjo është pjesa që citon Presidenti Paker – se ky burrë u dha mësim atyre në njëfarë mënyre; se me gjithë ato pengesa, me gjithë ato kufizime, ky burrë hyri në zemrat e atyre çunakëve 15-vjeçarë të potershëm dhe u ndryshoi jetën. Dhe dëshmia e Vëllai Berret qe: ‘Ne do të mund të kishim ngrohur duart me zjarrin e besimit të tij.’”²

Mësuesit e suksesshëm të ungjillit e duan ungjillin. Ata emocionohen për

atë. Dhe sepse i duan nxënësit e tyre, duan që dhe nxënësit të ndiejnë siç ndiejnë ata dhe të përjetojnë atë që kanë përjetuar ata. Të japësh mësim ungjillin është të ndash dashurinë tënde për ungjillin.

Vëllezër dhe Motra, qëndrimi i mësuesit nuk mësohet, ai kapet.³

Atëherë, si e zhvillojmë qëndrimin e nevojshëm për të qenë një mësues i suksesshëm? Do të doja të diskutoja katër parime bazë të mësimdhënies së ungjillit.

Së pari, zhytuni ju vetë në shkrimet e shenjtja. Nuk mund ta duam atë që nuk e njohim. Zhvilloni një zakon të studimit të përditshëm të shkrimit të shenjtë, të ndarë e veçmas përgatitjes tuaj për mësim. Përpara se të mund ta japim mësim ungjillin, ne duhet ta njohim ungjillin.

Presidenti Tomas S. Monson i ruan ende si thesar kujtimet për mësuesen e Shkollës të së Dieles të djalërisë së tij. Ai tha: “Përvoja ime si djalë i vogël ishte të bija nën ndikimin e mësueses më efektive e të frymëzuar, që na dëgjoi dhe na desh. Emri i saj qe Lusi Gertsh. Në klasën tonë të Shkollës të së Dieles, ajo na mësoi në lidhje me Krijimin e botës, Rënie

e Adamit dhe sakrificën shlyese të Jezusit. Ajo solli në klasën e saj si të ftuar nderi Moisiun, Jozueun, Pjetrin, Thomanë, Palin dhe, sigurisht, Krishtin. Edhe pse ne nuk i pamë, ne mësuam t’i duam, t’i nderojmë dhe t’i kemi shembull ata.”⁴

Lusi Gertsh qe në gjendje t’i fronte në klasën e saj këta miq të nderuar, sepse ajo i njihnte ata. Ata qenë miqtë e saj të dashur. Për shkak të kësaj, klasa e saj gjithashtu mësoi t’i “donte, nderonte dhe t’i kishte shembull ata”.

Zoti i tha Hajrëm Smithit: “Mos kërko të shpallësh fjalën time, por së pari ta fitosh fjalën time”⁵. Kjo këshillë zbatohet për secilin prej nesh.

Zoti na ka urdhëruar t’i hetojmë shkrimet e shenjtja⁶, të ushqehemi me bollëk me to⁷ dhe t’i mbledhim si thesar⁸. Kur shqyrtojmë dhe meditojmë me zell fjalën e Zotit, do ta kemi me vete Shpirtin e Tij. Ne do të njihemi me zërin e Tij.⁹

Pak kohë pasi u thirra për të qenë president kunji, presidenca e kunjit tonë mori trajnim nga një I Shtatëdhjetë Zonal. Gjatë trajnimit, unë bëra një pyetje, së cilës ai u përgjigj: “Kjo është një pyetje e mirë. Le t’i drejtohem *Church Handbook of Instructions* [Manualit të Udhëzimeve për Kishën] për përgjigjen.” Atëherë ne iu drejtua manualit dhe atje qe përgjigja për pyetjen time. Pak më vonë në trajnimin tonë, unë bëra një pyetje tjetër. Edhe një herë, ai u përgjigj: “Pyetje e mirë. Le t’i drejtohem manualit.” Nuk kuturisa më të bëja ndonjë pyetje tjetër. Mendova se qe më mirë të lexoja manualin.

Që atëherë kam menduar se Zoti mund t’i jepte një përgjigje të ngjashme secilit prej nesh kur i drejtohem Atij me shqetësime apo pyetje. Ai mund të thoshte: “Kjo është një pyetje e mirë. Nëse shqyrtoni Almën kapitulli 5, ose Doktrinën e Besëlidhjet seksioni

76, do ta kujtoni se ju kam folur tashmë për këtë.”

Vëllezër dhe Motra, është në kundërshtim me mënyrën e funksionimit të qiellit që Zoti të përsërisë për secilin prej nesh veçan, atë që Ai tashmë na e ka zbuluar bashkërisht. Shkrimet e shenjta përmbajnë fjalët e Krishtit. Ato janë zëri i Zotit. Studimi i shkrimeve të shenjta na stërvit për të dëgjuar zërin e Zotit.

Së dyti, zbatohet në jetën tuaj gjërat që mësoni. Kur Hajrëm Smithi dëshiroi të ishte pjesë e kësaj pune të shkëlqyer të ditëve të mëvonshme, Zoti i tha atij: “Vër re, kjo është puna jote, të zbatosh urdhërimet e mia, po, me gjithë fuqinë, mendjen dhe forcën tënde”¹⁰. Si mësues, puna jonë, e para dhe më e rëndësishmja, është të mbajmë urdhërimet me gjithë fuqinë, mendjen dhe forcën tonë.

Së treti, kërkon ndihmën e qiellit. Lutuni Zotit për Shpirtin e Tij, me gjithë fuqinë e zemrës suaj. Shkrimi i shenjtë shpall: “Nëse nuk e merrni Shpirtin, ju s’duhet të jepni mësim”¹¹. Kjo do të thotë se, edhe nëse përdorni të gjitha teknikat e drejta të mësimdhënies dhe ajo që po jepni mësim është e vërtetë, pa Shpirtin mësimi i vërtetë nuk do të ndodhë.

Roli i mësuesit është “të ndihmojë individët të marrin përgjegjësinë për të mësuar ungjillin – të zgjojë në ta dëshirën për ta studiuar, kuptuar dhe jetuar ungjillin”¹². Kjo do të thotë që, si mësues ne nuk duhet të përqendrohemi aq shumë në paraqitjen tonë sesa në atë se si t’i ndihmojmë të tjerët ta mësojnë dhe ta jetojnë ungjillin¹³.

Kur ka qenë hera e fundit kur ju u gjunjëzuat në lutje dhe i kërkuat Zotit jo thjesht t’ju ndihmojë për mësimin tuaj, por gjithashtu t’ju ndihmojë të njihni dhe të plotësoni nevojat e çdo nxënësi në klasën tuaj? Asnjë klasë nuk është kaq e madhe sa të mos

mund të lutemi për frymëzim se si ta ndihmojmë çdo student.

Është e natyrshme që mësuesit të kenë ndjenja pamjaftueshmërie. Ju duhet ta kuptoni se “mosha dhe pjekuria, dhe trajnimi intelektual nuk janë të nevojshëm në asnjë mënyrë ose në asnjë shkallë për të komunikuar me Zotin dhe Shpirtin e Tij”¹⁴.

Premtimet e Zotit janë të sigurta. Nëse shqyrtoni me zell shkrimet e shenjta dhe mblidhni vazhdimisht si thesar në mendjet tuaja fjalët e jetës, nëse i mbani urdhërimet me të gjithë zemrën tuaj dhe luteni për secilin nxënësi, ju do të gëzoni shoqërimin e Frymës së Shenjtë dhe ju do të merrni zbulesë¹⁵.

Së katërti, Vëllezër e Motra, ka rëndësi maksimale që ne ta ushtrojmë lirinë tonë të zgjedhjes dhe të veprimit, pa vonesë, në përputhje me nxitjet shpirtërore që marrim.

Presidenti Tomas S. Monson dha mësim: “Ne vëzhgojmë. Ne presim. Ne dëgjojmë për atë zë të qetë, të vogël. Kur ai flet, burrat dhe gratë e mençura binden. Nxitjet e Shpirtit nuk duhet të lihen për më vonë.”¹⁶

Ju nuk duhet të keni frikë ta ushtroni lirinë tuaj të zgjedhjes dhe të veproni sipas mendimeve dhe

San-Paulo, Brazil



përshtypjeve që Shpirti i Zotit vë në zemrën tuaj. Ju mund të ndiheni të ngathët në fillim, por ju premtoj se përvojat më të ëmbla dhe më përmbushëse që do të keni si mësues, do të jenë kur t’i nënshtrohni vullnetit të Zotit dhe të ndiqni nxitjet që merrni nga Fryma e Shenjtë. Përvojat do ta forcojnë besimin tuaj dhe do t’ju japin kurajë më të madhe për të vepruar në të ardhmen.

Mësues të dashur, ju jeni një nga mrekullitë e mëdha të kësaj Kishe. Ju keni një mirëbesim të shenjtë. Ne ju duam dhe kemi mirëbesim tek ju. E di që, nëse do t’i shqyrtojmë shkrimet e shenjta dhe do të jetojmë në atë mënyrë që të jemi të denjë që të kemi shoqërimin e Frymës së Shenjtë, Zoti do të na lartësojë në thirrjet dhe përgjegjësitë tona që të mund të përmbushim detyrën tonë nga Zoti. Që ne të gjithë të mund të bëjmë kështu është lutja ime, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. David McCullough, “Teach Them What You Love” (fjalim mbajtur në Salt Lake Tabernacle, Salt Lake City, Utah, 9 maj 2009).
2. Jeffrey R. Holland, “Teaching and Learning in the Church”, *Liahona*, qershor 2007, f. 72.
3. Shih McCullough, “Teach Them What You Love”.
4. Thomas S. Monson, “Examples of Great Teachers”, *Liahona*, qershor 2007, f. 76.
5. Doktrina e Besëlidhje 11:21.
6. Shih Gjoni 5:39.
7. Shih 2 Nefi 32:3.
8. Shih Joseph Smith – Mateu 1:37.
9. Shih Doktrina e Besëlidhje 18:36; 84:52.
10. Doktrina e Besëlidhje 11:20.
11. Doktrina e Besëlidhje 42:14.
12. *Teaching, No Greater Call: A Resource Guide for Gospel Teaching* (1999), f. 61.
13. Shih *Teaching, No Greater Call*, f. 60–62.
14. J. Reuben Clark Jr., *The Charted Course of the Church in Education* (fjalim mbajtur udhëheqësve të seminarit dhe institutit në Aspen Grove, Utah, 8 gusht 1938), f. 6.
15. Shih *Teachings of Presidents of the Church: Joseph Smith* (2007), f. 132.
16. Thomas S. Monson, “The Spirit Giveth Life”, *Liahona*, qershor 1997, f. 4.



Nga Plaku D. Tod Kristoferson,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Mendime mbi një Jetë të Përkushtuar

Suksesi i vërtetë në këtë jetë vjen në përkushtimin e jetës tonë – që do të thotë, kohën dhe zgjedhjet tona – qëllimeve të Perëndisë.

Kur isha i ri, unë vizitova Panairin Botëror të vitit 1964 në Nju-Jork-Siti. Një nga ndalesat e mia të parapëlqyera ishte pavioni i Kishës së SHDM me maketet mbresëlënëse të shigjetave të Tempullit të Solt-Lejkut. Atje për herë të parë pashë filmin *Man's Search for Happiness* [Kërkimi i Njeriut për Lumturi]. Përshkrimi në film i planit të shpëtimit, dhënë nga Plaku Riçard L. Evans, pati një efekt të madh te shumë vizitorë, përfshirë mua. Midis gjërash të tjerash Plaku Evans tha:

“Jeta ju ofron juve dy gjëra të çmuara – njëra është koha, tjetra, liria e zgjedhjes, liria për të bërë me kohën tuaj atë që ju doni. Ju jeni të lirë të shkëmbeni ndarjen tuaj të kohës për teka. Ju mund ta përdorni atë për dëshira të pavlera. Ju mund ta investoni atë në lakmi. . . .

Juaja është liria për të zgjedhur. Por këto nuk janë të mira, sepse në to ju nuk gjeni asnjë kënaqësi të përhershme.

Për çdo ditë, çdo orë, çdo minutë të hapësirës së viteve tuaja të vdekshmërisë dikur duhet të jepet llogari. Dhe është në *këtë* jetë që ju ecni me besim

dhe e provoni veten të aftë të zgjidhni të mirën ndaj të keqes, të drejtën ndaj të gabuarës, lumturinë e qëndrueshme ndaj thjesht argëtimit. Dhe shpërblimi juaj i përjetshëm do të jetë sipas zgjedhjes tuaj.

Një profet i Perëndisë ka thënë: ‘Njerëzit janë që ata të mund të kenë gëzim’ – një gëzim që përfshin një plotësi të jetës, një jetë të përkushtuar shërbimit, dashurisë dhe harmonisë në shtëpi, dhe frytet e punës së ndershme – një pranim i Ungjillit të Jezu Krishtit – i kërkesave dhe urdhërimeve të tij.

Vetëm në këto ju do të gjeni lumturinë e vërtetë, lumturinë që nuk zhduket bashkë me dritat e muzikën dhe me turmat”.¹

Këto deklarata shprehin realitetin që jeta jonë në tokë është një administrim i kohës dhe i zgjedhjeve dhuruar nga Krijuesi ynë. Fjala *kujdestari* të sjell në mendje ligjin e Zotit për përkushtimin (shih, për shembull, DeB 42:32, 53), që ka një rol ekonomik, por më shumë se kjo, është një zbatim i ligjit qiellor të jetës këtu dhe tani (shih DeB 105:5). Të përkushtosh është të veçosh apo ta kushtosh diçka si të shenjtë, kushtuar qëllimeve të

shenjtë. Suksesi i vërtetë në këtë jetë vjen në përkushtimin e jetës tonë, që do të thotë kohën dhe zgjedhjet tona, qëllimeve të Perëndisë (shih Gjoni 17:1, 4 dhe DeB 19:19). Duke bërë kështu, ne e lejojmë Atë të na ngrejë në destinacionin tonë më të lartë.

Unë do të doja të shqyrtoja me ju pesë nga elementet e një jete të përkushtuar: Pastërtinë, punën, respektin për trupin e vet fizik, shërbimin dhe integritetin moral.

Siç e tregoi Shpëtimtari, jeta e përkushtuar është një jetë e pastër. Ndërsa Jezusi është i vetmi që ka ndjekur një jetë pa mëkate, ata që vijnë tek Ai dhe marrin mbi vete zgjedhjen e Tij, kërkojnë prej hirit të Tij, që do t'i bëjë ata ashtu siç është Ai, pa mëkate dhe pa njolla. Me dashuri të thellë Zoti na nxit neve me këto fjalë: “Pendohuni, të gjitha ju skajet e tokës dhe ejani tek unë dhe pagëzohuni në emrin tim, që të shenjtëroheni nëpërmjet marrjes së Frymës së Shenjtë, që të mund të qëndroni pa njollë para meje, në ditën e fundit” (3 Nefi 27:20).

Prandaj përkushtim do të thotë pendesë. Kokëfortësia, rebelimi dhe racionalizmi duhet të braktisen dhe të zëvendësohen me përlulje, një dëshirë për korrigjim dhe pranim të të gjitha gjërave që Zoti mund të kërkojë. Kjo është ajo që mbreti Benjamin e quajti zhveshje të njeriut të natyrshëm, nënshtrim ndaj nxitjeve të Frymës së Shenjtë dhe të bërit “një shenjtor nëpërmjet shlyerjes së Krishtit Zot” (Mosia 3:19). Një njeriu të tillë i është premtuar prania e përhershme e Frymës së Shenjtë, një premtim i kujtuar dhe i ripërtërirë sa herë që shpirti i penduar merr pjesë në sakramentin e darkës së Zotit (shih DeB 20:77, 79).

Plaku B. H. Roberts e shprehu një herë procesin me këto fjalë: “Njeriu që ecën në dritë dhe urtësi, dhe fuqi të

Perëndisë, në fund të fundit, me vetë forcën e shoqërimit, do ta bëjë dritën dhe urtësinë, dhe forcën e Perëndisë të tijën – duke thurur me ato rreze drite një zinxhir hyjnor, që lidh veten përgjithmonë me Perëndinë dhe Perëndinë me veten. Ky [është] thelbi i fjalëve mistike të Mesias: “Ti Atë në mua dhe unë në ty” – përtej kësaj madhështia njerëzore nuk mund të shkojë”.²

Një jetë e përkushtuar është një jetë pune. Qysh herët në jetën e Tij, Jezusi u lidh me punën e Atit të Tij (shih Lluka 2:48–49). Vetë Perëndia është përlëvdur nga puna e Tij për të bërë që të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e fëmijëve të Tij (shih Moisiu 1:39). Ne natyrisht duam të marrim pjesë me Të në punën e Tij dhe, duke bërë kështu, ne duhet të njohim se e gjithë puna e ndershme është puna e Perëndisë. Me fjalët e Tomas Karilit: “E gjithë Puna e vërtetë është e shenjtë; në gjithë Punën e vërtetë, qoftë edhe thjesht punë e vërtetë dore, ka diçka hyjnore. Puna, e çfarëdo lloji dhe kudo në Botë, çon dhe shpërblehet në Qiell.”³

Perëndia e ka projektuar këtë ekzistencë të vdekshme për të kërkuar thaujse një tendosje të përhershme. Unë kujtoj deklaratën e thjeshtë të Profetit Jozef Smith: “Me punë të vazhdueshme [ne] patëm mundësi të arrijmë një jetë komode” (Jozef Smith – Historia 1:55). Me punë ne mbajmë dhe pasurojmë jetën. Ajo na bën të aftë t’u mbijetojmë zhgënjimeve dhe tragjedi të përvojës vdekësore. Arritja e fituar me vështirësi sjell ndjesi respekti për veten. Puna ngre dhe përsos karakterin, krijon bukuri dhe është instrumenti i shërbimit tonë për një tjetër dhe për Perëndinë. Një jetë e shenjtë është e mbushur me punë, ndonjëherë e përsëritur, ndonjëherë pastruese, ndonjëherë e pavarësuar, por gjithmonë punë që përmirëson,



rregullon, mban, ngre, shërben, dëshiron.

Pasi kam folur për të vlerësuar punën, unë duhet të shtoj gjithashtu diçka për kohën e lirë. Ashtu si rraskapitja e ndershme i jep pushimit ëmbël-sinë e tij, çlodhja e shëndetshme është miku dhe shoqëruesi i vazhdueshëm i punës. Muzika, letërsia, arti, vallëzimi, teatri, sporti – të gjitha mund të sigurojnë argëtim për të pasuruar jetën e njeriut dhe për ta shenjtëruar më tej atë. Njëkohësisht, vështirë se nevojitet të thuhet që shumë nga ajo që merret si argëtim sot është e rëndomtë, degraduese, e dhunshme, mendje-topitëse dhe humbje kohe. Për ironi, ndonjëherë kërkohet punë e rëndë për të gjetur kohë të lirë të shëndetshme. Kur argëtimi kthehet nga virtyt në ves, ai bëhet shkatërrues i jetës së përkushtuar. “Prandaj, kini kujdes, . . . të mos gjykoni atë që është e ligë të jetë e Perëndisë” (Moroni 7:14).

Një jetë e shenjtëruar respekton dhuratën e pakrahasueshme të një trupi fizik, një krijim hyjnor në vetë shëmbëlltyrën e Perëndisë. Një qëllim qendror i përvojës vdekësore është që secili shpirt duhet të marrë një trup të tillë dhe të mësojë të ushtrojë lirinë morale të zgjedhjes në një tabernakull prej mishi. Një trup fizik është gjithashtu thelbësor për ekzaltimin, që vjen vetëm në një ndërthurje të përsosur të fizikes dhe shpirtërores, siç ne e shohim në Zotin tonë të dashur të ringjallur. Në këtë botë të rënë, disa jetë do të jenë dhimbshëm të shkurtra, disa trupa do të keqformohen, thyhen apo thjesht do jenë të pamjaftueshëm për të mbajtur jetë, përsëri jeta do të jetë mjaftueshëm

e gjatë për çdo shpirt dhe çdo trup do të kualifikohet për ringjallje.

Ata që besojnë se trupat tanë nuk janë më shumë sesa një rezultat i rastit evolucionar, nuk do të ndiejnë asnjë përgjegjësi ndaj Perëndisë apo kujtdo tjetri për atë që bëjnë me apo për trupin e tyre. Ne që kemi një dëshmi për realitetin më të gjerë të përjetësisë paratokësore, tokësore dhe pastokësore, sidoqoftë, duhet të njohim se kemi një detyrë ndaj Perëndisë lidhur me këtë arritje kurorëzuese të Tij të krijimit fizik. Me fjalët e Palit:

“A nuk e dini se trupi juaj është tempulli i Frymës së Shenjtë që është në ju, të cilin e keni nga Perëndia, dhe se nuk i përkitni vetvetes?”

Sepse u bletë me një çmim! Përlëvdoni Perëndinë, pra, në trupin tuaj dhe në frymën tuaj, që i përkasin Perëndisë” (1 Korintasve 6:19–20).

Duke njohur këto të vërteta dhe drejtimin nga Presidenti Tomas S. Monson në konferencën e përgjithshme të prillit të kaluar, ne me siguri nuk do ta prishim trupin tonë, si me tatuazhe, apo ta dobësojmë, si me drogë, apo ta ndotim, si me mëkate, tradhëti bashkëshortore, apo pacipësi.⁴ Duke qenë se trupi ynë është një instrument i shpirtit tonë, është jetike që ne të kujdesemi për të me sa mundemi. Ne duhet të përkushtojmë forcat e tij për t’i shërbyer punës së Krishtit dhe për ta çuar më tej atë. Pali tha: “Po ju bëj thirrje, nëpërmjet dhembshurisë së Perëndisë, ta paraqisni trupin tuaj si fli të gjallë, të shenjtëruar, të pëlqyer te Perëndia” (Romakëve 12:1).

Jezusi demonstroi se një jetë e përkushtuar është një jetë shërbimi. Orë

përpara se të fillonte agonia e Shlyerjes së Tij, Zoti përulësisht lau këmbët e dishepujve të Tij, duke u thënë:

“Në qoftë se unë, Zoti dhe Mësuesi, ju kam larë këmbët, edhe ju duhet t'i lani këmbët njëri-tjetrit.

Unë, në fakt, ju kam dhënë shëmbullin që ashtu siç kam bërë unë, bëni edhe ju.

Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: Shërbëtori nuk është më i madh se padroni i tij, as i dërguari më i madh se ai që e ka dërguar” (Gjoni 13:14–16).

Ata që qetësisht dhe plot kujdes synojnë të bëjnë mirë, japin një model përkushtimi. Askush në kohën tonë nuk e mishëron në mënyrë më të përsosur këtë veçori në jetën e përditshme sesa Presidenti Tomas S. Monson. Ai ka formuar një vesh të vëmendshëm që mund të dallojë edhe pëshpërimën më të dobët të Shpirtit, që sinjalizon për nevojën e dikujt, të cilit ai mund t'i drejtohet dhe ta ndihmojë. Shpesh ai përgjigjet me veprime e thjeshta, ku vërtetohet dashuri dhe dije hyjnore, por gjithmonë Tomas Monsoni përgjigjet.

Unë gjej në jetën e gjyshit dhe të gjyshes time Aleksandër DeVit dhe Luizë Vikeri Kristoferson, një shembull përkushtimi të tillë. Gjyshi ishte një burrë i fortë dhe ishte i mirë në qethjen e deleve në ditët përpara qethëseve elektrike. Ai fitoi shumë, ai tha: “Në një ditë qetha 287 dele dhe mund të kisha qethur mbi 300, por delet na u mbaruan”. Gjatë vitit 1919, ai qethi mbi 12.000 dele, duke fituar rreth 2.000 dollarë. Të hollat mund ta kishin zgjeruar në masë të konsiderueshme fermën e tij dhe ta modernizonin shtëpinë e tij, por një thirrje për të shërbyer në Misionin e Shteteve të Jugut erdhi nga Vëllezërit dhe, me mbështetjen e plotë të Luizës, ai pranoi. Ai e la bashkëshkorten (atëherë shtatëzënë me birin e tyre të parë, babanë tim) dhe tri vajzat e tyre me paratë nga qethja e



deleve. Për kthimin e tij të gëzueshëm dy vite më pas, ai vërejt: “Kursimet tona na mbajtën gjatë dy viteve dhe neve na kishin mbetur 29 dollarë”.

Një jetë e përkushtuar është një jetë e ndershme. Ne e shohim atë të bashkëshorti dhe bashkëshortja “të cilët i nderojnë me besnikëri të plotë besëlidhjet e martesës”⁵. Ne e shohim atë të babai dhe nëna përparësia e parë e shfaqur e të cilëve është të ushqejnë martesën e tyre dhe të sigurojnë mirëqenien fizike dhe shpirtërore të fëmijëve të tyre. Ne e shohim atë tek ata që janë të ndershëm.

Vite përpara, unë u njoha me dy familje në procesin e shkrirjes së një ndërmarrjeje tregtare në bashkëpronësi. Pronarët kryesorë, dy burra që ishin miq dhe anëtarë në të njëjtin komunitet të krishterë, kishin formuar një firmë vite përpara. Ata kishin në përgjithësi një marrëdhënie miqësore si partnerë biznesi, por ndërsa po moshoheshin dhe brezi tjetër filloi të merrte pjesë në biznes, konfliktet filluan. Përfundimisht, të gjitha palët vendosën se do të ishte më e mira të ndanin pasuritë dhe të ndiqnin rrugët e tyre të ndara. Një nga dy ortakët

filleshtarë sajoi një strategji me juristët e tij për të siguruar për vete një epërsi të rëndësishme financiare prej shkrirjes në dem të ortakut tjetër dhe të bijve të tij. Në një takim të palëve, një nga bijtë u ankua për këtë trajtim të padrejtë dhe iu drejtua nderit dhe besimeve të krishtera të ortakut të parë. “Ju e dini se kjo nuk është e drejtë”, tha ai. “Si mund të fitoni epërsi ndaj dikujt me këtë mënyrë, veçanërisht një vëllai në të njëjtën kishë?” Juristi i ortakut të parë ia priti: “Oh, rritu një herë! Si mund të jesh kaq naiv?”

Ndershmëria nuk është naivitete. Ajo që është naive është të mendosh se ne nuk jemi përgjegjës përpara Perëndisë. Shpëtimtari ka thënë: “Dhe, Ati im më dërgoi që të mund të ngrihesha në kryq; dhe pasi u ngrita në kryq, që t'i tërheq të gjithë njerëzit tek unë, që ashtu si unë u ngrita nga njerëzit, ashtu dhe njerëzit të ngrihen nga Ati, që të qëndrojnë para meje për t'u gjykuar për veprat e tyre, qofshin ato të mira ose qofshin ato të liga” (3 Nefi 27:14). Ai që jeton një jetë të përkushtuar nuk përpiqet të fitojë epërsi ndaj një tjetri, por nëse ka diçka, do t'i kthejë faqen tjetër dhe, nëse

i kërkohet të japë xhakët të japë edhe pallton gjithashtu (shih Mateu 5:39–40). Qortimet më të ashpra të Shpëtimtarit ishin ndaj hipokritëve. Hipokrizia është tmerrësisht shkatërrimtare, jo vetëm për hipokritin, por për të gjithë ata që e vënë re apo e dinë sjelljen e tij apo të saj, veçanërisht fëmijët. Ajo është besim-shkatërruese, ndërsa ndershmëria është toka e pasur ku fara e besimit lulëzon.

Një jetë e përkushtuar është një gjë e mrekullueshme. Forca dhe kthjelltësia e saj janë “si një pemë shumë frytdhënëse, e cila mbillet në një tokë të mirë, pranë një rrekeje të pastër, e cila prodhon shumë fruta të çmuar” (DeB 97:9). Me rëndësi të veçantë është ndikimi i një burri apo gruaje të përkushtuar ndaj të tjerëve, veçanërisht atyre më të afërt dhe më të dashur. Përkushtimi i shumë njerëzve që janë larguar përpara nesh, dhe i të tjerëve që jetojnë midis nesh, ka ndihmuar të hidhet themeli për lumturinë tonë. Në mënyrë të ngjashme, brezat e ardhshëm do të marrin kurajë nga jeta juaj e përkushtuar, duke njohur borxhin e tyre ndaj jush për pasjen e gjithçkaje që vërtet vlen. E përkushtofshim jetën tonë si bij dhe bija të Perëndisë, “që kur ai të shfaqet, ne të jemi si ai, pasi ne do ta shohim atë ashtu sikurse është; që të mund të kemi këtë shpresë” (Moroni 7:48; shih gjithashtu 1 Gjoni 3:2), unë lutem në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. *Man's Search for Happiness* (pamflet, 1969), f. 4–5.
2. B. H. Roberts, “Brigham Young: A Character Study”, *Improvement Era*, qershor 1903, f. 574.
3. Thomas Carlyle, *Past and Present* (1843), f. 251.
4. Shih Tomas S. Monson, “Përgatitja Sjell Bekime”, *Liahona dhe Ensign*, maj 2010, f. 64–67.
5. “Familja: Një Proklamim Drejtuar Botës”, *Liahona*, tetor 2004, f. 49; *Ensign*, nëntor 1995, f. 102.



Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Për Gjërat që Kanë më Shumë Rëndësi

Nëse jeta dhe ritmi i saj i ngutshëm, dhe streset e shumta e kanë bërë të vështirë që ju të ndieni gëzim, atëherë ndoshta tani është koha e duhur për t'u ripërqendruar në atë që ka më shumë rëndësi.

Është e habitshme se sa shumë mund të mësojmë për jetën duke studiuar natyrën. Për shembull, shkencëtarët mund të shohin rrathët e pemëve dhe të bëjnë pandehma shkencore mbi klimën dhe kushtet e rritjes qindra dhe madje mijëra vite më parë. Një nga gjërat që mësoni nga studimi i rritjes së pemëve, është që, gjatë stinëve kur kushtet janë ideale, pemët rriten me ritëm normal. Megjithatë, gjatë stinëve kur kushtet e rritjes nuk janë ideale, pemët e ngadalësojnë rritjen dhe ia kushtojnë energjinë e tyre elementeve bazë të domosdoshme për mbijetesë.

Në këtë pikë ju mund të jeni duke menduar: “E gjitha kjo është shumë e këndshme dhe e mirë, por çfarë lidhje ka me fluturimin e një aeroplani?” Epo, më lejoni t'ua tregoj.

A keni qenë ndonjëherë në aeroplan dhe të keni përjetuar turbulencë? Shkaku më i zakonshëm i turbulencës është një ndryshim i papritur në lëvizjen e ajrit, që e bën aeroplanin të lëkundet lart-poshtë, majtas-djathtas dhe të kthehet përmbys. Ndërkohë që

aeroplanët janë ndërtuar që t'i rezistojnë një turbulencë shumë më të madhe nga çfarëdo që do të hasnit në një fluturim të rregullt, përsëri ajo mund të jetë shqetësuese për pasagjerët.

Si mendoni ju, çfarë bëjnë pilotët kur hasin turbulencë? Një student për pilot mund të mendojë se rritja e shpejtësisë është një strategji e mirë, sepse do t'i bëjë ta kalojnë më shpejt turbulencën. Por kjo mund të jetë gjëja e gabuar. Pilotët profesionistë e kuptojnë se ka një shpejtësi ideale për të depërtuar nëpër turbulencë, që do t'i zvogëlojë pasojat negative të saj. Dhe në shumicën e rasteve kjo do të thotë ta zvogëlosh shpejtësinë. I njëjti parim zbatohet gjithashtu tek gungat e shpejtësisë nëpër rrugë.

Prandaj, është një këshillë e mirë të ngadalësosh pak, ta bësh kursin më të njëtrajshëm dhe të përqendrohesh në gjërat thelbësore, kur përjeton kushte të pafavorshme.

Ritmi i Jefs Moderne

Ky është një mësim për t'u mësuar, i thjeshtë por vendimtar. Mund të



duket logjike kur shprehet në termat e pemëve ose turbulencave, por është e çuditshme sa e lehtë është ta shpërfillesh këtë mësim kur vjen fjala për t'i zbatuar këto parime në vetë jetën tonë të përditshme. Kur rritet niveli i stresit, kur shfaqet ankthi, kur tragjedia godet, tepër shpesh ne përpiqemi të mbajmë të njëjtin ritëm të furishëm, ose madje të shpejtojmë, duke menduar disi se sa më i ngutshëm të jetë ritmi ynë, aq më mirë do të jemi.

Një nga karakteristikat e jetës moderne duket se është që ne po lëvizim me një ritëm gjithnjë e më të madh, parvësisht nga turbulencat ose pengesat.

Le të jemi të ndershëm, është disi e lehtë të jesh i zënë. Të gjithë mund të mendojmë për një listë detyrash që do ta stërbushnin programin tonë. Disa madje mund të mendojnë se vlera e tyre varet nga gjatësia e listës së gjërave për të bërë. Ata i përmbysin pjesët e lira të kohës së tyre me lista takimesh dhe gjërash të vockla – madje dhe gjatë kohës së stresit dhe lodhjes së madhe. Për shkak se e ndërlikojnë jetën e tyre në mënyrë të panevojshme, shpesh ata ndiejnë irritim të shtuar, gëzim të zvogëluar dhe tepër pak ndjesi kuptimi në jetën e tyre.

Thuhet se çdo virtyt, kur çohet në skaj, mund të shndërrohet në ves. Mbi programimi i ditëve tona sigurisht që do të kualifikohej për këtë. Vjen një pikë ku synimet mund të bëhen si gurë mulliri dhe ambiciet, si mokra që na varen në qafë.

Cila Është Zgjidhja?

Të mençurit i kuptojnë dhe i zbatojnë mësimet e rrathëve të pemëve

dhe të turbulencave të ajrit. Ata i rezistojnë tundimit që të përfshihen në nxitimin e furishëm të jetës së përditshme. Ata ndjekin këshillën: “Jeta është më tepër sesa t'i rritësh shpejtësinë”¹. Shkurt, ata përqendrohen tek gjërat që kanë më shumë rëndësi.

Plaku Dallin H. Ouks, në një konferencë të përgjithshme të kohëve të fundit, dha mësim: “Duhet të heqim dorë nga disa gjëra të mira, që të mund të zgjedhim të tjera që janë më të mira ose më të mirat, sepse zhvillojnë besim tek Zoti Jezu Krisht dhe forcojnë familjet tona”².

Kërkimi për më të mirat, pashmangshmërisht të çon tek parimet themelore të ungjillit të Jezu Krishtit – të vërtetat e thjeshta dhe të bukura, që na janë zbuluar nga një Atë në Qiell përkujudesës, i përjetshëm dhe i gjithëditur. Këto doktrina e parime thelbësore, edhe pse mjaft të thjeshta sa t'i kuptojë një fëmijë, japin përgjigjet për çështjet më të ndërlikuara të jetës.

Ka një bukuri dhe qartësi që vjen nga thjeshtësia, që nganjëherë ne nuk e vlerësojmë në etjen tonë për zgjidhje të ndërlikuara.

Për shembull, jo shumë kohë pasi atronautët dhe kozmonautët fluturuan në orbitë rreth tokës, ata kuptuan se stilolapsat nuk funksiononin në hapësirë. Dhe kështu, disa njerëz shumë të zgjuar shkuan ta zgjidhnin problemin. U deshën mijëra orë dhe miliona dollarë por, në fund, ata krijuan një stilolaps që do të mund të shkruante kudo, në çfarëdo temperature dhe thuajse në çfarëdo sipërfaqe. Por si ja bënë astronautët dhe kozmonautët

derisa u zgjidh problemi? Ata thjesht përdorën laps.

Citohet që Leonardo da Vinci të ketë thënë se “thjeshtësia është stërholli më i fundit”³. Kur shohim parimet themelore të planit të lumturisë, planit të shpëtimit, ne mund të dallojmë e vlerësojmë në qartësinë dhe thjeshtësinë e tij, elegancën dhe bukurinë e urtësisë së Atit Qjellor. Atëherë, veprimi sipas urdhërimeve të Tij është fillimi i urtësisë sonë.

Fuqia e Gjërave Bazë

Tregohet historia se si trajneri legjendar i futbollit amerikan, Vinse Lombardi, kishte një ritual që e kryente ditën e parë të stërvitjes. Ai do të merrte një top futboll, do t'ua tregonte atë sportistëve, që kishin vite që e luanin atë sport, dhe do të thoshte: “Zotërinj, . . . ky është një top futboll!” Ai fliste mbi përmasat dhe formën e tij, se si mund ta shkëlmosh, ta mbash, ose ta pasosh. Ai e nxirrte skuadrën në fushën e zbrazët dhe thoshte: “Kjo është një fushë futboll”. Ai i çonte rreth saj, duke përshkruar përmasat, formën, rregullat dhe se si luhet loja⁴.

Ky trajner e dinte se edhe këta lojtarë me përvojë, dhe vërtet skuadra, mund të bëheshin të mëdhenj vetëm duke zotëruar gjërat bazë. Ata mund të kalonin kohë duke praktikuar lojëra me marifete të ndërlikuara, por derisa të zotëronin gjërat themelore të lojës, ata nuk do të mund të bëheshin kurrë një skuadër kampione.

Mendoj se shumica prej nesh e kuptojnë me intuitë se sa të rëndësishme janë gjërat themelore. Ne nganjëherë thjesht hutohemi nga kaq shumë gjëra, që duken më joshëse.

Materiale të shtypura, burime të shumëllojshme mediatike, mjete dhe pajisje elektronike – të gjitha të dobishme nëse përdoren siç duhen – mund të shndërrohen në devijime

të dëmshme, ose dhoma izolimi të pashpirta.

Përsëri, mes morisë së zërave dhe zgjedhjeve, Burri i përlurur nga Galilea qëndron me duar të shtrira, duke prituri. Mesazhi i Tij është i thjeshtë: “Eja, e më ndiq”⁵. Dhe Ai nuk flet me një altoparlant të fuqishëm, por me një zë të vogël e të qetë⁶. Është kaq e lehtë që mesazhi bazë i ungjillit të humbasë mes vërshimit të informacionit, i cili na godet nga të gjitha anët.

Shkrimet e Shenjta dhe fjala e folur nga profetët e gjallë u vënë theksin parimeve dhe doktrinave themelore të ungjillit. Arsyeja pse kthehemi tek këto parime themelore, tek doktrinën e pastra, është sepse ato janë porta drejt të vërtetave me kuptim të thellë. Ato janë dyer drejt përvojave me rëndësi lartësuese që përndryshe, do të ishin përtej aftësisë sonë për t'i kuptuar. Këto parime të thjeshta, bazë, janë çelësi për të jetuar në harmoni me Perëndinë dhe njeriun. Ato janë çelësat për të hapur pragjet e qiellit. Ato na udhëheqin tek paqja, gëzimi dhe kuptueshmëria që Ati Qiellor u ka premtuar fëmijëve të Tij, të cilët e dëgjojnë dhe i binden Atij.

Vëllezërit e Motrat e mia të dashura, do të bënim mirë të ngadalësojmë pak, të vazhdojmë me shpejtësinë më të favorshme për rrethanat tona, të përqendrohemi tek thelbësorja, të ngremë sytë lart dhe të shohim vërtet gjërat që janë më të rëndësishme. Le të jemi të ndërgjegjshëm për normat themelore, që Ati ynë Qiellor u ka dhënë fëmijëve të Tij, të cilat do të krijojnë bazat e një jete të pasur e të frytshme në vdekshmëri, me premtimet e lumturisë së përjetshme. Ato na mësojnë të bëjmë “të gjitha këto gjëra . . . në urtësi dhe rregull; pasi nuk është e nevojshme që [ne] duhet të vrapojmë më shpejt sesa [kemi] fuqi. [Por] është e domosdoshme që

[ne] duhet të jemi të zellshëm [dhe] kështu . . . të fitojmë çmimin.”⁷

Vëllezër e Motra, bëra me zell e gjërave që kanë më shumë rëndësi, do të na udhëheqë tek Shpëtimtari i botës. Kjo është pse “ne flasim për Krishtin, ne gëzohemi në Krishtin, ne predikojmë për Krishtin, ne profetizojmë mbi Krishtin . . . , që [ne] të mund të dimë se cilit burim t'i drejtohejmë për heqjen e mëkateve [tona]”⁸. Në ndërlikimin, përshtjellimin dhe ngutën e jetesës moderne, kjo është “udh[a] shumë më [e] lartë”⁹.

Atëherë, Cilat Janë Bazat?

Kur i referohemi Atit tonë Qiellor dhe kërkojmë urtësinë e Tij në lidhje me gjërat që kanë më shumë rëndësi, mësojmë sërish e sërish rëndësinë e katër marrëdhënieve kyç: me Perëndinë tonë, me familjet tona, me bashkënjerezit tanë dhe me veten. Kur vlerësojmë vetë jetën tonë me një mendje të gatshme, do të shohim se ku jemi shmangur nga udha më e shkëlqyer. Sytë e të kuptuarit tonë do të hapen dhe ne do ta dallojmë atë që duhet bërë për ta pastruar zemrën

tonë dhe për ta ripërqendruar jetën tonë.

Së pari, marrëdhënia jonë me Perëndinë është më e shenjtja dhe më jetësorja. Ne jemi fëmijët e Tij shpirtërorë. Ai është Ati ynë. Ai dëshiron lumturinë tonë. Kur e kërkojmë Atë, kur mësojmë për Birin e Tij, Jezu Krishtin, kur i hapim zemrën ndikimit të Frymës së Shenjtë, jeta jonë do të bëhet më e qëndrueshme dhe më e sigurt. Ne përjetojmë paqe, gëzim dhe pëmbushje më të madhe kur japim më të mirën tonë për të jetuar sipas planit të përjetshëm të Perëndisë dhe për të mbajtur urdhërimet e Tij.

Ne e përmirësojmë marrëdhënien tonë me Atin tonë Qiellor duke mësuar prej Tij; duke komunikuar me Të, duke u penduar për mëkatet tona dhe duke e ndjekur aktivisht Jezu Krishtin; sepse “askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet [Krishtit]”¹⁰. Që ta forcojmë marrëdhënien tonë me Perëndinë, na duhet një kohë kuptimplotë vetëm me Të. Përqendrimi i qetë në lutjen vetjake dhe studimin e shkrimeve të shenjtja përditë, duke synuar gjithmonë për të qenë të denjë për një rekomandim aktual tempulli – këto do të jenë disa investime të urta të kohës dhe përpjekjeve tona për t'u afruar Atit tonë Qiellor. Le t'ia vëmë veshin ftesës së psalmistit: “Ndaluni dhe pranoni që jam Perëndi”¹¹.

Marrëdhënia jonë e dytë kyç është me familjet tona. Meqë “asnjë sukses tjetër nuk mund të na dëmshpërblejë për dështimin”¹² atje, duhet t'u japim përparësi të lartë familjeve tona. Ne ndërtojmë marrëdhënie të thella dhe të dashura familjare duke bërë gjëra të thjeshta së bashku, si vakti familjar e mbrëmja familjare, dhe thjesht duke u zbatuar së bashku. Në marrëdhëniet familjare *dashuria* vërtet shprehet nga *koha*, koha që kalojmë me familjen. Kalimi i kohës me njëri-tjetrin është



kyçi për harmoni në shtëpi. Ne flasim me njëri-tjetrin dhe jo për njëri-tjetrin. Ne mësojmë nga njëri-tjetri dhe i vlerësojmë ndryshimet tona po ashtu si dhe tiparet e përbashkëta. Ne krijojmë një lidhje hyjnore me njëri-tjetrin, ndërsa i qasemi Perëndisë së bashku përmes lutjes familjare, studimit të ungjillit dhe adhurimit të dielën.

Marrëdhënia e tretë kyç që kemi, është me bashkënjëzërit tanë. Ne e ndërtojmë këtë marrëdhënie me njëri-tjetrin nga një – duke qenë të ndjeshëm ndaj nevojave të të tjerëve, duke u shërbyer atyre dhe duke dhënë nga koha dhe talentet tona. Më ka bërë përshtypje një Motër që qe e ngarkuar nga sfidat e moshës dhe të sëmundjes, por që vendosi që edhe pse nuk mund të bënte shumë, ajo mund të dëgjonte. Dhe kështu çdo javë ajo shihte për njëri-tjetrin që dukeshin të shqetësuar ose të shkurajuar, dhe kalonte kohë me ta, duke i dëgjuar. Çfarë bekimi ishte ajo në jetën e kaq shumë njëri-tjetri!

Marrëdhënia e katërt kyç është me veten tonë. Mund të duket e çuditshme të kemi marrëdhënie me veten, por e kemi. Disa njëri-tjetri nuk mundën ta pëlqejnë veten. Ata e kritikojnë dhe e nënvleftësojnë veten gjithë ditën, derisa fillojnë ta urrejnë. Më lejoni të sugjeroj që ta zvogëloni ngutin dhe të harxhoni pak kohë shtesë për ta njohur veten më mirë. Shëtisni në natyrë, vështroni lindjen e diellit, gëzoni krijesat e Perëndisë, meditoni të vërtetat e ungjillit të rivendosur dhe zbuloni se çfarë kuptimi kanë ato për ju personalisht. Mësoni ta shihni vetveten ashtu si ju sheh Ati Qiellor – si bija ose biri i Tij i çmuar me potencial hyjnor.

Gëzohuni në Ungjillin e Pastër

Vëllezër dhe Motra, le të jemi të mençur. Le të drejtohem tek ujërat e pastra doktrinale të ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit. Le të marrim



Dublin, Irlandë

me gëzim prej tyre në thjeshtësinë dhe qartësinë e tyre. Qiejt janë hapur përsëri. Ungjilli i Jezu Krishtit është në tokë edhe një herë dhe të vërtetat e tij të thjeshta janë një burim i bollshëm gëzimi!

Vëllezër dhe Motra, ne vërtet kemi arsye të madhe që të gëzojmë. Nëse jeta dhe ritmi i saj i ngutshëm, dhe streset e shumta e kanë bërë të vështirë që ju të ndieni gëzim, atëherë ndoshta tani është koha e duhur për t'u ripërqendruar në atë që ka më shumë rëndësi.

Forca nuk vjen nga aktiviteti i furishëm, por nga qenia të vendosur mbi një themel të qëndrueshëm të vërtete dhe drite. Ajo vjen nga vendosja e vëmendjes dhe përpjekjeve tona mbi bazat e ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit. Ajo vjen nga kushtimi i vëmendjes gjërave hyjnore, që kanë më shumë rëndësi.

Le ta thjeshtojmë pak jetën tonë. Le të bëjmë ndryshimet e nevojshme për

ta ripërqendruar jetën tonë në bukurinë kulmore të shtegut të thjeshtë e të përlulur të dishepullit të krishterë – shtegu që udhëheq gjithmonë drejt një jete me kuptim, kënaqësi dhe paqe. Për këtë lutem unë ndërsa ju lë bekimin tim, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Mahatma Gandhi, në Larry Chang, *Wisdom for the Soul* (2006), f. 356.
2. Dallin H. Ouks, "Mirë, Më Mirë, Më e Mira", *Liahona*, nëntor 2007, f. 107.
3. Leonardo da Vinci, në John Cook, përmb., *The Book of Positive Quotations*, bot. 2-të (1993), f. 262.
4. Vince Lombardi, në Donald T. Phillips, *Run to Win: Vince Lombardi on Coaching and Leadership* (2001), f. 92.
5. Lluca 18:22.
6. Shih 1 Mbretërve 19:12.
7. Mosia 4:27.
8. 2 Nefi 25:26.
9. 1 Korintasve 12:31; Ethëri 12:11.
10. Gjoni 14:6.
11. Psalmeve 46:10.
12. J. E. McCulloch, *Home: The Savior of Civilization* (1924), 42; shih edhe Conference Report, prill 1935, f. 116.



Paraqitur nga Presidenti Henri B. Ajring
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Mbështetja e Drejtuesve të Kishës

Propozohet që ne të mbështesim Tomas Spenser Monson, si profet, shikues dhe zbulues, si dhe si President të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme; Henri Benion Ajring, si Këshilltar të Parë në Presidencën e Parë; dhe Diter Fridrih Uhtdorf, si Këshilltar të Dytë në Presidencën e Parë.

Ata që janë dakord, ta tregojnë.

Ata që janë kundër, nëse ka, mund ta tregojnë.

Propozohet që ne të mbështesim Bojd Kenet Paker, si President të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ata që vijojnë si anëtarë të atij

kuorumi: Bojd K. Paker, L. Tom Peri, Rasëll M. Nelson, Dallin H. Ouks, M. Rasëll Ballard, Riçard G. Skot, Robert D. Hejls, Xhefri R. Holland, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson dhe Nil L. Andersen.

Ata që janë dakord, ju lutem ta tregojnë.

Ndonjë kundër mund ta tregojë këtë.

Propozohet që ne të mbështesim këshilltarët në Presidencën e Parë dhe Dymbëdhjetë Apostujt si profetë, shikues e zbulues.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem

tregojeni atë.

Kundër, në qoftë se ka, me të njëjtën shenjë.

Propozohet që ne të lirojmë nga detyra Pleqtë Spenser J. Kondi, Brus C. Hejfen, Kenet Xhonsen, Glen L. Pejs dhe Lejnc B. Vikmen si anëtarë të Kuorumit të Parë të Të Shtatëdhjetëve dhe i zgjedhim ata si Autoritete të Përgjithshme nderi.

Propozohet gjithashtu që ne të lirojmë nga detyra Pleqtë Spenser V. Xhons dhe Wolfgang H. Paul, si anëtarë të Kuorumit të Dytë të Të Shtatëdhjetëve.

Ata që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur mirënjohje këtyre Vëllezërve për shërbimin e tyre të shkëlqyer, ju lutem ta tregojnë.

Propozohet që të lirojmë nga detyra Fernando Maluenda dhe Hoze L. Torres si Të Shtatëdhjetë Zonalë.

Ata që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur mirënjohjen tonë për shërbimin e tyre të shkëlqyer, ju lutem ta tregojnë.

Propozohet që të mbështesim Venceslao H. Svec si një Të Shtatëdhjetë Zonal.

Të gjithë që janë dakord, ju lutemi tregojeni.

Ndonjë kundër.

Propozohet që ne të mbështesim Autoritetet e tjera të Përgjithshme, Të Shtatëdhjetët Zonalë dhe presidentat e përgjithshme të organizatave ndihmëse me përbërjen e tyre të tanishme.

Ata që janë dakord, ju lutemi ta tregojnë.

Ndonjë kundër mund ta tregojë po ashtu.

Presidenti Monson, për aq sa kam mundur të vërej, votimi në Qendrën e Konferencave ka qenë unanimit.

Faleminderit, Vëllezër dhe Motra, për votimin tuaj mbështetës, besimin, përkushtimin dhe lutjet tuaja. ■





Nga Plaku Robert D. Hejls,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Liria e Zgjedhjes: Thelbësore për Planin e Jetës

Kurdoherë që zgjedhim të vijmë te Krishti, të marrim mbi vete emrin e Tij dhe të ndjekim shërbëtorët e Tij, ne përparojmë përgjatë shtegut drejt jetës së përjetshme.

Kohët e fundit, mora një letër nga një mik prej më shumë se 50 vitesh, i cili nuk është anëtar i Kishës. I kisha dërguar disa materiale leximi që lidhen me ungjillin, të cilave ai iu përgjigj: “Fillimisht, qe e vështirë për mua të ndiqja kuptimin e zhangronit tipik mormon, të tillë si *liri e zgjedhjes*. Ndoshta një faqe e shkurtër fjalori do të ishte e dobishme.”

U çudita që ai nuk e kuptonte se çfarë duam të themi me fjalët *liri e zgjedhjes*. Shkova tek një fjalor në internet. Nga 10 përkufizime dhe përdorime të fjalës *liri e zgjedhjes*, asnjëri nuk shprehte idenë e bërjes së zgjedhjeve për të vepruar. Ne japim mësim se liria e zgjedhjes është aftësia dhe privilegji që Perëndia na jep për të zgjedhur dhe që të “veproj[m]ë për veten [tonë] dhe të mos detyrohe[m] të veprojmë”¹. Liria e zgjedhjes është të veprojmë me përgjegjshmëri dhe përgjegjësi për veprimet tona. Liria jonë e zgjedhjes është thelbësore për planin e shpëtimit. Me atë, ne jemi

“të lirë të zgjedhi[m] lirinë dhe jetën e përjetshme, nëpërmjet Ndërmjetësit të madh të të gjithë njerëzve, ose të zgjedhi[m] robërinë dhe vdekjen, sipas robërisë dhe fuqisë së djallit”².

Fjalët e një himni të njohur na mësojnë shumë qartë këtë parim:

*Dijeni këtë, që çdo shpirt është i lirë
Të zgjedhë jetën e tij dhe çfarë do të jetë;*

Sepse na është dhënë kjo e vërtetë e përjetshme:

*Perëndia nuk do të detyrojë asnjë njeri për në qiell.*³

Për t’iu përgjigjur pyetjes së mikut tim dhe pyetjeve të burrave e grave të mira kudo, më lejoni të ndaj me ju më shumë nga ajo që dimë për këtë kuptim të lirisë së zgjedhjes.

Përpara se të vinim në këtë tokë, Ati Qiellor paraqiti planin e Tij të shpëtimit – një plan për të ardhur në tokë e për të marrë një trup, për të zgjedhur midis të mirës e të ligës dhe

për të përparuar e për t’u bërë si Ai e për të jetuar me Të përgjithmonë.

Liria jonë e zgjedhjes – aftësia jonë për të zgjedhur e për të vepruar për veten – ishte një pjesë thelbësore e këtij plani. Pa lirinë e zgjedhjes, ne nuk do të ishim në gjendje të bënim zgjedhje të drejta e të përparonim. Përsëri, me lirinë e zgjedhjes, ne mund të bënim zgjedhje të gabuara, të kryenim mëkat dhe ta humbisnim mundësinë për të qenë përsëri me Atin Qiellor. Për këtë arsye, një Shpëtimtar do të na sigurohej, që të vuante për mëkatet tona dhe të na shëlbonte, nëse ne do të pendoheshim. Me anë të Shlyerjes së Tij të pafundme, Ai do të bënte “të realizohel] plani i mëshirës, për të plotësuar kërkesat e drejtësisë”⁴.

Pasi Ati Qiellor e paraqiti planin e Tij, Luciferi doli përpara duke thënë: “Dërgomë mua . . . dhe do ta shëlbej gjithë njerëzimin, që asnjë shpirt të mos humbasë, . . . si rrjedhim, ma jep mua lavdinë tënde”⁵. Ky plan nuk u pranua nga Ati ynë, sepse na mohonte neve lirinë tonë të zgjedhjes. Vërtet, ai ishte një plan rebelimi.

Atëherë Jezu Krishti, Biri “i Dashuri dhe i Zgjedhuri . . . që nga fillimi” i Atit Qiellor, e ushtroi lirinë e Tij të zgjedhjes për të thënë: “Atë, vullneti yt u bëftë dhe lavdia qoftë e jotja përgjithmonë”⁶. Ai do të ishte Shpëtimtari ynë – Shpëtimtari i Botës.

Për shkak të rebelimit të Luciferit, rezultoi një konflikt i madh shpirtëror. Secili prej fëmijëve të Atit Qiellor pati mundësinë të ushtronte lirinë e zgjedhjes që Ati Qiellor u kishte dhënë atyre. Ne zgjedhëm të kemi besim tek Shpëtimtari Jezu Krisht – të vijmë tek Ai, ta ndjekim Atë dhe ta pranojmë planin që Ati Qiellor paraqiti për hirin tonë. Por një e treta e fëmijëve të Atit tonë Qiellor nuk pati besim të ndiqte Shpëtimtarin dhe zgjedhi të ndiqte Luciferin, ose Satanin në vend të kësaj.⁷

Dhe Perëndia tha: “Si rrjedhim, ngaqë ai Satan ngriti krye kundër meje dhe kërkoi të shkatërronte lirinë e njeriut për të zgjedhur, të cilën, unë, Zoti Perëndi, ia kisha dhënë atij, . . . unë bëra që ai të flakej tutje”⁸. Ata që ndoqën Satanin, e humbën mundësinë për të marrë një trup të vdekshëm, për të jetuar në tokë dhe për të përparuar. Për shkak të mënyrës se si e përdorën lirinë e tyre të zgjedhjes, ata e humbën lirinë e tyre të zgjedhjes.

Sot, e vetmja fuqi që kanë Satani dhe pasuesit e tij, është fuqia që të na tundojë dhe provojë ne. Gëzimi i tyre i vetëm është të na bëjë “të mjeruar sikurse [ata vetë]”⁹. Lumturia e tyre e vetme vjen kur jemi të pabindur ndaj urdhërimeve të Zotit.

Por mendoni për këtë: në gjendjen tonë para lindjes, ne zgjodhëm të ndjekim Shpëtimtarin, Jezu Krishtin! Dhe sepse e bëmë, ne u lejuam të vijmë në tokë. Unë dëshmoj se, duke bërë të njëjtën zgjedhje që ta ndjekim Shpëtimtarin tani, ndërsa jemi këtu në tokë, ne do të sigurojmë një bekim edhe më të madh në përjetësira. Por, le të dihet: ne duhet të vazhdojmë të zgjedhim Shpëtimtarin. Përjetësia rrezikohet dhe përdorimi ynë i mençur i lirisë sonë të zgjedhjes e veprimet tona janë thelbësore që të mund të kemi jetë të përjetshme.

Gjatë gjithë jetës së Tij, Shpëtimtari ynë na tregoi se si ta përdorim lirinë tonë të zgjedhjes. Kur qe djalosh në Jeruzalem, Ai zgjodhi me qëllim “të merref] me punët e Atit [të Tij]”¹⁰. Në shërbesën e Tij, Ai zgjodhi pa lëkundje “të bë[n]te vullnetin e Atit [të Tij]”¹¹. Në Gjetsemani, Ai zgjodhi të vuante të gjitha gjërat, duke thënë: “Mos u bëftë vullneti im, por i yti”. Atëherë iu shfaq një engjëll nga qielli për t’i dhënë forcë”¹². Mbi kryq, Ai zgjodhi t’i donte armiqtë e Tij, duke u lutur: “O Atë, fali ata sepse nuk dinë ç’bëjnë”¹³. Dhe



atëherë, që së fundi të mund të tregonte se po zgjidhte për veten, Ai u la i vetëm. “[Atë,] përse më ke braktisur?” pyeti Ai.¹⁴ Së fundi, Ai ushtroi lirinë e Tij të zgjedhjes për të vepruar, duke duruar deri në fund, derisa të mund të thoshte: “U krye!”¹⁵

Edhe pse Ai “u tundua në të gjitha ashtu si ne”¹⁶, me secilën zgjedhje dhe me secilin veprim, Ai ushtroi lirinë e zgjedhjes për të qenë Shpëtimtari ynë – për të këputur zinxhirët e mëkatit dhe të vdekjes për ne. Dhe me anë të jetës së Tij të përsosur, Ai na mësoi se, kur zgjedhim të bëjmë vullnetin e Atit tonë Qiellor, liria jonë e zgjedhjes ruhet, mundësitë tona shtohen dhe ne përparojmë.

Prova e kësaj të vërtete gjendet kudo në shkrimet e shenjta. Jobi humbi gjithçka kishte, por përsëri zgjodhi të mbetej besnik dhe mori bekimet e përjetshme të Perëndisë. Maria dhe Jozefi zgjodhën të ndiqnin paralajmërimin e një engjëlli e të iknin në Egjipt dhe jeta e Shpëtimtarit u ruajt. Jozef Smithi zgjodhi të ndiqte udhëzimet e Moronit dhe Rivendosja u shpaloj siç u profetizua. Kurdoherë që zgjedhim të vijmë te Krishti, të marrim mbi vete emrin e Tij dhe të ndjekim shërbëtorët e Tij, ne përparojmë përgjatë shtegut

drejt jetës së përjetshme.

Në udhëtimin tonë në vdekshmëri, është e dobishme të kujtojmë se edhe e kundërta është gjithashtu e vërtetë: kur nuk i mbajmë urdhërimet apo nuk i ndjekim nxitjet e Frymës së Shenjtë, mundësitë tona zvogëlohen, aftësitë tona për të vepruar dhe përparuar, pakësohen. Kur Kaini mori jetën e të vëllait, sepse e donte Satanin më shumë se Perëndinë, përparimi i tij shpirtëror ndaloi.

Në rininë time mora një mësim të rëndësishëm mbi atë se si veprimet tona mund ta kufizojnë lirinë tonë. Një ditë, babai im më la detyrën të lustroja një dysheme druri. Bëra zgjedhjen që ta filloja tek dera dhe të vazhdoja punën *brenda* dhomës. Kur thuajse kisha përfunduar, e kuptova se nuk i kisha lënë vetes rrugë për të dalë jashtë. Nuk kishte derë ose dritare në anën tjetër. Me të vërtetë e kisha mbërthyer veten në një cep. Nuk kisha vend ku të shkoja. Kisha ngecur.

Kurdoherë që nuk bindemi, ne shpirtërisht e ngecim veten në një cep dhe jemi robër të zgjedhjeve tona. Edhe pse jemi shpirtërisht të ngecur, ka gjithmonë një rrugë kthimi. Ashtu si pendimi, të kthehesh e të ecësh përmes një dyshemeje druri

të sapolustruar, do të thotë punë – shumë rikruajtje me rërë dhe rilëmim. Të kthehesh tek Zoti nuk është e lehtë, por ia vlen.

Ndërsa e kuptojmë sfidën e pendimit, ne i vlerësojmë bekimet e Frymës së Shenjtë, që të na udhëheqë për lirinë tonë të zgjedhjes, dhe të Atit Qiellor, që na jep urdhërime dhe na forcon, dhe na mbështet për t'i mbajtur ato. Ne e kuptojmë gjithashtu se si bindja ndaj urdhërimeve në fund të fundit, e mbron lirinë tonë të zgjedhjes.

Për shembull, kur ia vëmë veshin Fjalës së Urtësisë, ne i shpëtojmë robërisë së shëndetit të keq dhe të varësisë ndaj substancave që me të vërtetë na e grabisin aftësinë tonë për të zgjedhur vetë.

Kur i bindemi këshillës për ta shmangur dhe për të dalë nga borxhi tani, ne e përdorim lirinë tonë të zgjedhjes dhe fitojmë lirinë që ta përdorim të ardhurën tonë të disponueshme, për të ndihmuar dhe bekuar të tjerët.



Kur e ndjekim këshillën e profetëve që të kemi mbremje familjare, lutje familjare dhe studim familjar të shkri-meve të shenjta, shtëpitë tona bëhen një inkubator për rritjen shpirtërore të fëmijëve tanë. Atje ne u mësojmë atyre ungjillin, japim dëshmitë tona, shprehim dashurinë tonë dhe dëgjojmë kur ata ndajnë ndjenjat dhe përvojat e tyre. Me anë të zgjedhjeve dhe veprimeve tona të drejta, ne i çlirojmë ata nga errësira duke e rritur aftësinë e tyre për të ecur në dritë.

Bota na mëson shumë pavërtetë-sira rreth lirisë së zgjedhjes. Shumë mendojnë se ne duhet “[të hamë, të pimë e të dëfremë]; . . . dhe në qoftë se jemi fajtorë, Perëndia do të na qëllojë pak me kamxhik dhe në fund ne do të shpëtohem në mbretërinë e Perëndisë”¹⁷. Të tjerë përqafojnë laicizmin dhe e mohojnë Perëndinë. Ata e bindin veten se nuk ka “një kundërshtim në të gjitha gjërat”¹⁸ dhe, si rrjedhim, “çdo gjë që një njeri [bën] nuk [është] krim”¹⁹. Kjo “[shkatërron] urtësinë e Perëndisë dhe synimet e tij të përjetshme”²⁰.

Në kundërshtim me mësimet laike të botës, shkrimet e shenjta na mësojnë se ne vërtet kemi liri zgjedhjeje dhe ushtrimi i drejtë i lirisë së zgjedhjes gjithmonë sjell ndryshim në mundësitë që kemi dhe në aftësinë tonë për të vepruar mbi to e për të përparuar përjetësisht.

Për shembull, me anë të Profetit Samuel, Zoti i dha një urdhërim të qartë Mbretit Saul:

“Zoti më ka dërguar që të të vajos mbret . . . tani dëgjo fjalët e Zotit. . . . Shko, godit Amalekun dhe cakto shfarosjen e të gjitha gjërave që ai ka”²¹.

Por Sauli nuk e ndoqi urdhërimin e Zotit. Ai praktikoi atë që unë e quaj “bindje me përzgjedhje”. Duke u mbështetur në urtësinë e vet, ai ia kurseu jetën Mbretit Agag dhe mori

me vete më të mirat nga delet, qetë dhe kafshët e tjera.

Zoti ia zbuloi këtë Profetit Samuel dhe e dërgoi atë ta hiqte Saulin nga qenia mbret. Kur mbërriti Profeti, Sauli tha: “Unë e kam zbatuar urdhrin e Zotit”²². Por Profeti e dinte ndryshe dhe tha: “Ç’është kjo blegërimë dhensh që më vjen në vesh dhe kjo pëllitje lopësh që po dëgjoj?”²³

Sauli u shfajësua duke fajësuar të tjerë, duke thënë se njerëzit i kishin mbajtur kafshët për të bërë sakrifica për Zotin. Përgjigjja e profetit ishte e qartë: “Ndoshta i pëlqejnë Zotit olokaustet dhe flijimet si bindje ndaj zërit të Zotit? Ja, bindja është më e mirë se flijimi; dhe të dëgjosh me kujdes është më mirë se dhjami i deshve”²⁴.

Së fundi, Sauli u rrëfye, duke thënë: “Kam mëkatuar sepse kam shkelur urdhrin e Zotit dhe fjalët e tua, dhe kjo sepse kisha frikë nga populli dhe dëgjova zërin e tij”²⁵. Meqë Sauli nuk dëgjoi me saktësi – meqë ai zgjodhi të bindej me përzgjedhje – ai e humbi mundësinë dhe lirinë e zgjedhjes për të qenë mbret.

Vëllezërit dhe Motrat e mia, a po e dëgjojmë me saktësi zërin e Zotit dhe të profetëve të Tij? Apo, ashtu si Sauli, po praktikojmë bindje me përzgjedhje dhe po i trembemi gjykimit të njerëzve?

Unë e pranoj se të gjithë ne bëjmë gabime. Shkrimet e shenjta na mësojnë: “Të gjithë mëkatua[m] dhe u privua[m] nga lavdia e Perëndisë”²⁶. Për ata që e gjejnë veten robër të zgjedhjeve të kaluara, jo të drejta, të ngecur në cep, pa të gjitha bekimet e disponueshme nga ushtrimi i drejtë i lirisë së zgjedhjes, ne ju duam. Kthehuni! Dilni nga cepi i errët për në dritë. Edhe nëse do t’ju duhet të ecni përmes një dyshemeje të sapolustruar, ia vlen. Besoni se “nëpërmjet shlyerjes së Krishtit, i gjithë njerëzimi [përfshirë ju] mund të shpëtohet, me anë të

bindjes ndaj ligjeve dhe ordinancave të Ungjillit”²⁷.

Kur ora e Shlyerjes po afrohej, Shpëtimtari ofroi Lutjen e Tij të madhërishtme Ndërmjetësuese dhe foli për secilin prej nesh, duke thënë: “O Atë, unë dua që atje ku jam unë, të jenë me mua edhe ata që më ke dhënë, që ta shohin lavdinë time që ti më ke dhënë”²⁸. “Dhe kjo është jeta e përjetshme, të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar”²⁹.

Unë jap dëshminë time të veçantë se Ata jetojnë. Kur e ushtrojmë lirinë tonë të zgjedhjes në drejtësi, ne arrijmë t’i njohim Ata, të bëhemi më shumë si Ata dhe të përgatitemi për atë ditë kur “çdo gju do të gjuhëzohet dhe çdo gjuhë do të pohojë” se Jezusi është Shpëtimtari ynë³⁰. Vazhdojmë ta ndjekim Atë dhe Atin tonë të Përjetshëm, siç bëmë në fillim, lutem unë, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. 2 Nefi 2:26.
2. 2 Nefi 2:27.
3. “Know This, That Every Soul Is Free”, *Hymns*, nr. 240.
4. Alma 42:15.
5. Moisiu 4:1.
6. Moisiu 4:2.
7. Shih Doktrina e Besëlidhje 29:36.
8. Moisiu 4:3.
9. 2 Nefi 2:27; shih edhe 2 Nefi 9:9.
10. Lluka 2:49.
11. 3 Nefi 27:13.
12. Lluka 22:42–43.
13. Lluka 23:34.
14. Mateu 27:46; Marku 15:34.
15. Gjoni 19:30.
16. Hebrenjve 4:15.
17. 2 Nefi 28:8.
18. 2 Nefi 2:11.
19. Alma 30:17.
20. 2 Nefi 2:12.
21. 1 Samuelit 15:1, 3.
22. 1 Samuelit 15:13.
23. 1 Samuelit 15:14.
24. 1 Samuelit 15:22.
25. 1 Samuelit 15:24.
26. Romakëve 3:23.
27. Nenet e Besimit 1:3.
28. Gjoni 17:24.
29. Gjoni 17:3.
30. Mosia 27:31.



Nga Plaku Kuentin L. Kuk,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Pastë Dritë!

Në botën tonë gjithnjë e më të padrejtë, është thelbësore që vlerat e bazuara në besimin fetar të jenë pjesë e diskutimit publik.

Festova ditëlindjen muajin e kaluar. Për dhuratë ditëlindjeje, bashkëshortja ime, Meri, më dha një disk që përmban këngë shprese dhe besimi të interpretuara nga një këngëtare e njohur britanike e quajtur Vera Lin, e cila i frymëzonte dëgjuesit e saj gjatë ditëve të errëta të Luftës së Dytë Botërore.

Ka një arsye përse bashkëshortja ime do të më bënte këtë dhuratë. Bombardimi i Londrës në shtator të 1940-ës filloi një ditë para lindjes sime¹. Nëna ime, duke dëgjuar në radio te dhoma e saj e spitalit përshkrimin e Sulmit Rrufe mbi Londër, vendosi të më vinte emrin e folësit të radios, i cili quhej Kuentin.

Këngëtarja, Vera Lin, tani është 93 vjeçe. Vitin e kaluar, disa nga këngët e saj të kohës së luftës u nxorën rishtas në shitje dhe menjëherë arritën në krye të listave muzikore në Britani. Kush prej jush është ca i moshuar, do t’i kujtojë disa këngë si “Shkrepi i Bardhë i Duvërit”.

Një këngë, e titulluar “Kur Dritat të Ndizen Sërish (Anëmbanë Botës)”, më preku thellësisht. Kjo këngë më solli në mendje dy mendime – së pari, fjalët profetike të një britaniku, burrë shteti: “Llambat po shuhen gjithkund në Evropë. Ne nuk do t’i shohim të ndriçojnë sërish në kohën tonë”²; dhe, së dyti, sulmet bombarduese të drejtuara

mbi qytetet britanike si Londra. Për t’ua vështirësuar bombarduesve gjetjen e objektivit, nisi të vendosej fikja e dritave. Dritat ndërpriteshin dhe dritaret mbulohehin.

Kënga pasqyrore shpresën optimiste se liria dhe drita do të rivendosehin. Për ata prej nesh që e kuptojnë rolin e Shpëtimtarit dhe të Dritës së Krishtit³ në përplasjen e vazhdueshme midis së mirës dhe së keqes, është e qartë ngjashmëria ndërmjet asaj lufte botërore dhe përplasjes së sotme morale. Pikërisht Drita e Krishtit është ajo me të cilën i gjithë njerëzimi “mund të [njohë] të mirën nga e keqja”⁴.

Liria dhe drita nuk kanë qenë kurrë të lehta të arrihen apo të mbahen. Që nga Lufta në Qiell, forcat e së keqes kanë përdorur çdo mjet të mundshëm që të asgjësojnë lirinë e zgjedhjes dhe të largojnë dritën. Sulmi ndaj parimeve morale dhe lirisë fetare nuk ka qenë kurrë më i fuqishëm.

Si shenjtore të ditëve të mëvonshme, nevojitet të bëjmë më të mirën për ruajtjen e dritës dhe mbrojtjen e familjeve e komuniteteve tona nga ky sulm ndaj moralit dhe lirisë fetare.

Mbrojtja e Familjes

Një rrezik gjithnjë i pranishëm ndaj familjes është sulmi i furishëm



i forcave të liga, që duket se vjen nga çdo drejtim. Ndërsa përpjekja jonë parësore duhet të jetë kërkimi i dritës e i së vërtetës, ne duhet të jemi të mençur t'i mbrojmë shtëpitë tona nga bombat vdekjeprurëse që shkatërrojnë zhvillimin dhe rritjen shpirtërore. Pornografia, në veçanti, është një armë e shkatërrimit moral në masë. Efekti i saj është ballor në gërryerjen e vlerave morale. Disa programe të televizionit dhe faqe të internetit janë të po atij lloji vdekjeprurës. Këto forca të liga largojnë nga bota dritën dhe shpresën. Niveli i degjenerimit po përshpejtohet⁵. Nëse nuk ua presim të ligën shtëpive dhe jetëve tona, mos u befasoni në rast se shpërthimet morale shkretuese thërrmojnë paqen që është shpërblimi për jetesë të drejtë. Përgjegjësia jonë

është të jemi në botë, por të mos jemi të botës.

Veç kësaj, nevojitet të shtojmë së tepërmi zbatimin e fesë sonë në shtëpi. Mbrëmja familjare e përjavshme dhe lutja e studimi i përditshëm familjar i shkrimit të shenjtë janë thelbësore. Ne duhet që të paraqesim në shtëpitë tona përmbajtje që është "[e] virtutshme, [e] dashur ose me famë të mirë"⁶. Nëse i bëjmë shtëpitë tona vende të shenjta që na strehojnë nga e liga, ne do të jemi të mbrojtur nga pasojat armiqësore që shkrimet e shenjta i kanë parathënë.

Mbrojtja e Komunitetit

Përveç mbrojtjes së vetë familjeve tona, ne duhet të jemi burim drite në mbrojtje të komuniteteve tona. Shpëtimtari tha: "Ashtu le të shndritë drita

juaj para njerëzve, që të shohin veprat tuaja të mira dhe ta lëvdojnë Atin tuaj që është në qiej"⁷.

Ditët tona janë përshkruar si "kohë bollëku dhe epokë dyshimi"⁸. Besimi bazë te fuqia dhe autoriteti i Perëndisë jo vetëm që vihet në dyshim, por edhe përgojohet. Nën këto rrethana, si mundemi të kontribuojmë për nxitjen e vlerave me një mënyrë që do të gjejë mbështetje nga jobesimtarët dhe apatikët e do të ndihmojë të pakësohet zbritja e përshpejtuar drejt dhunës dhe së ligës?

Kjo pyetje është e një rëndësie madhështore. Mendoni profetin Mormon dhe dhimbjen e tij, kur ai shpalli: "Si mundët të hidhni poshtë atë Jezus që qëndroi krahëhapur për t'ju pranuar juve?"⁹ Dhimbja e Mormonit u konsiderua e drejtë dhe biri i tij, Moroni, u la të jetojë për të përshkruar "historinë e trishtueshme të shkatërrimit të popullit [të tij]"¹⁰.

Përvoja ime vetjake e të jetuarit dhe e bashkëveprimit me njerëz anembanë botës, ka bërë që të jem optimist. Unë besoj që në kohën tonë drita dhe e vërteta do të ruhen. Në të gjitha kombet janë të shumtë ata që adhurojnë Perëndinë dhe ndihen të përgjegjshëm para Tij për sjelljen e tyre. Disa vëzhgues besojnë se, në të vërtetë, ka një rigjallërim botëror të besimit¹¹. Si udhëheqës të Kishës ne jemi takuar me udhëheqës të besimeve të tjera dhe kemi gjetur se ka një themel moral të përbashkët që i kapërcen dallimet teologjike dhe na bashkon në aspiratat tona për një shoqëri më të mirë.

Po ashtu, gjejmë se shumica e njerëzve kanë ende respekt për vlerat morale themelore. Por të mos gabohemi: ka gjithashtu njerëz të cilët janë të vendosur si për shkatërrimin e besimit, ashtu dhe për përjashtimin e ndikimit fetar në shoqëri. Njerëz të tjerë të ligj shfrytëzojnë, manipulojnë dhe rrënojnë

shoqërinë me droga, pornografi, shfrytëzim seksual, trafikim njerëzor, grabitje dhe praktika të pandershme biznesi. Fuqia dhe ndikimi i këtyre njerëzve është shumë i madh, edhe nëse janë krahasimisht të paktë në numër.

Gjithnjë ka ekzistuar një betejë e vazhdueshme ndërmjet njerëzve të besimit dhe atyre të cilët do ta spastronin fenë dhe Perëndinë nga jeta publike¹². Shumë opinionistë sot përjashtojnë pikëpamje morale të botës të bazuara mbi vlera judaiko-kristiane. Për pikëpamjen e tyre, nuk ka asnjë rregull moral objektiv¹³. Ata besojnë se nuk duhet t'u jepen parapëlqime synimeve morale¹⁴.

Megjithatë, pjesa më e madhe e njerëzve dëshirojnë të jenë të mirë e të nderuar. Drita e Krishtit, që dallon prej Frymës së Shenjtë, informon ndërgjegjen e tyre. Nga shkrimet e shenjta dimë se Drita e Krishtit është "Shpirti [i cili] i jep dritë çdo njeriu që vjen në botë"¹⁵. Kjo dritë jepet "për hir të të gjithë botës"¹⁶. Presidenti Bojd K. Paker ka mësuar që ajo është një "burim frymëzimi të cilin secili prej nesh e ka njësoj si të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes njerëzore"¹⁷. Kjo është arsyeja që shumëkush do t'i pranojë vlerat morale edhe kur ato bazohen në bindje fetare që ata vetë nuk i mbështesin. Sikurse lexojmë tek Mosia në Librin e Mormonit: "Nuk është e zakonshme që zëri i popullit të dëshirojë diçka që është kundër asaj që është e drejtë; por është e zakonshme për pakicën e popullit të dëshirojë atë që nuk është e drejtë". Mosia më pas paralajmëron: "Në qoftë se vjen koha që zëri i popullit zgjedh paudhësinë, atëherë është koha që gjykimet e Perëndisë të [vijjnë]"¹⁸.

Në botën tonë gjithnjë e më të padrejtë, është thelbësore që vlerat e bazuara në besimin fetar të jenë pjesë e diskutimit publik. Duhet që

pikëpamjeve morale që ndikohen nga një ndërgjegje fetare, t'u jepet një e drejtë e barabartë për diskutim publik. Sipas kushtetutave të shumicës së vendeve, ndërgjegjes fetare mund të mos i jepet parapëlqimi, por ajo as nuk duhet shpërfillur¹⁹.

Besimi fetar është një burim drite, njohurie dhe urtësie dhe i sjell dobi shoqërisë në mënyrë të jashtëzakonshme, kur pasuesit angazhohen me sjelljen morale ngaqë ndihen të përgjegjshëm para Perëndisë²⁰.

Dy parime fetare do ta ilustrojnë këtë çështje.

Sjellja e Ndershme e Motivuar nga Përgjegjshmëria ndaj Perëndisë

Neni i trembëdhjetë i besimit nis me fjalët "Ne besojmë në të qenit të ndershëm". Ndershmëria është një parim i themeluar mbi besimin fetar dhe është një nga ligjet bazë të Perëndisë.

Shumë vjet më parë, kur po ushtrroja profesionin e juristit në Kaliforni, një mik dhe klient që nuk ishte i besimit tonë, erdhi të më takonte dhe me entuziazëm të madh më tregoi një letër që kishte marrë nga një peshkop SHDM i një lagjeje atje pranë. Peshkopi shkruante se një anëtar i klientit tim, kishte marrë materiale nga vendi i punës së klientit tim dhe kishte arsyetuar se ato ishin tepricë. Por, pasi që bërë një shenjtor i ditëve të mëvonshme i zotuar dhe po përpiquej të ndiqte Jezu Krishtin, ky i punësuar kuptoi se ajo që kishte bërë ishte e pandershme. Bashkë me letrën ishte një shumë parash prej atij burri, e cila përfshinte jo vetëm çmimin e materialeve, por edhe interesin. Klientit tim i kishte bërë përshtypje që Kisha, nëpërmjet udhëheqjes nga njerëz të zakonshëm, e ndihmonte këtë burrë në përpjekjen e tij për pajtim me Perëndinë.

Mendoni dritën dhe të vërtetën që

ka vlera e përbashkët e ndershmërisë në botën judaiko-kristiane. Mendoni ndikimin mbi shoqërinë sikur të rinjtë të mos mashtronin në shkollë, sikur të rriturit të ishin të ndershëm në punë dhe besnikë ndaj betimeve martesore. Për ne koncepti themelor i ndershmërisë bazohet në jetën dhe mësimet e Shpëtimtarit. Ndershmëria gjithashtu është cilësi e vlerësuar në shumë besime të tjera e në literaturën historike. Poeti Robert Bërn tha: "Njeriu i ndershëm është vepra më fisnike e Perëndisë"²¹. Pothuajse në çdo rast, njerëzit e besimit ndihen të përgjegjshëm ndaj Perëndisë për të qenë të ndershëm. Kjo është arsyeja që ai burrë nga Kalifornia po pendohej për aktin e tij të mëparshëm të pandershmërisë.

Në fjalën e ceremonisë së diplomimit vitin e shkuar, Klejton Kristensen, një profesor i Harvardit dhe udhëheqës i Kishës, tregoi një ngjarje të vërtetë për një koleg në profesion nga një vend tjetër, i cili kishte studiuar demokracinë. Ky mik ishte i befasuar nga rëndësia aq kritike e besimit fetar për demokracinë. Ai vuri në dukje se në shoqëritë ku qytetarëve u mësohet qysh në moshë të re të ndihen të përgjegjshëm ndaj Perëndisë për ndershmëri dhe integritet, ata do të veprojnë në përputhje me rregulla dhe praktika që, ndonëse nuk janë të imponuara, kontribuojnë për nxitjen e idealeve demokratike. Në shoqëritë ku nuk ndodh kjo gjë, nuk do të mjaftonin policët për të imponuar sjelljen e ndershme²².

Qartazi, vlerat morale të ndershmërisë mund të luajnë rol kuptimplotë në përf forcimin e dritës dhe të vërtetës e në përmirësimin e shoqërisë dhe duhet të çmohen nga ata që nuk kanë besim.

Trajtimi si Vëllezër e Motra i të Gjithë Fëmijëve të Perëndisë

Një shembull i dytë se si besimi fetar i sjell dobi shoqërisë dhe i ofron



dritë botës, është roli i besimit fetar në trajtimin si vëllezër e motra i të gjithë fëmijëve të Perëndisë.

Shumë institucione me themel besimi, në dy shekujt e fundit kanë qenë vija e parë në përpjekjet e ndihmës dhe në shpëtimin e të ekspozuarve ndaj faktorëve mizorë, për arsye se anëtarët e tyre besojnë që të gjithë njerëzit janë bërë në shëmbëlltyrën dhe ngjasimin e Perëndisë²³. Uiliam Uilbërfors, britaniku burrë i madh shteti që ishte instrument për të nxjerrë jashtë ligjit tregtinë e skllëvërve në Britaninë e Madhe, është një shembull i shkëlqyer²⁴. “Hir Mahnitës”, himni prekës dhe filmi frymëzues me të njëjtin titull, pushtojnë vetëdijen e viteve të hershme të 1800-ave dhe përshkruajnë ngjarjen e përpjekjes së tij heroike. Përpjekjet e palodhura të Uilbërforsit qenë ndër hapat e parë në eliminimin e asaj praktike të tmerrshme, shtypëse, mizore dhe korruptive. Si pjesë e asaj përpjekjeje, së bashku me udhëheqës të tjerë, ai paraqiti ide për të ndrequr moralin publik. Ai besonte që arsimit dhe qeverisja duhej të bazoheshin tek e moralshmja²⁵. “Largpamësia . . . e tij për pasurimin moral dhe shpirtëror, ishte gjëja për të cilën ai jetoi, qoftë duke mbrojtur institucionin e martesës, duke sulmuar praktikën e tregtisë së skllëvërve apo duke mbrojtur

prerazi ditën e Shabatit”²⁶. Me energji të madhe ai ndihmoi që të viheshin në lëvizje udhëheqësit moralë dhe shoqërorë të vendit, në një përpjekje mbarëkombëtare kundër shthurjes²⁷.

Në historinë tonë të hershme të Kishës, shumica dërrmuese e anëtarëve tanë ishin kundër skllavërisë²⁸. Kjo që një arsye e rëndësishme, tok me besimet e tyre fetare, për armiqtësinë dhe dhunën e bandave që ata përjetuan, të cilat kulmuan me urdhrin e shfarosjes të lëshuar prej Guvernatorit Bogs në Misuri.²⁹ Më 1833 Jozef Smithi mori një zbulim që shpallte: “Nuk është e drejtë që ndonjë njeri të jetë nën skllavërinë e një tjetri”³⁰. Zotimi ynë ndaj lirisë së besimit dhe trajtimit të të gjithë njerëzve si bij e bija të Perëndisë është në qendër të doktrinës sonë.

Këta janë vetëm dy shembuj se në ç’mënyrë i mbështesin vlerat me baza besimi parimet që e bekojnë shumë shoqërinë. Ka shumë më tepër. Duhet që edhe të marrim pjesë vetë, edhe të mbështesim njerëzit me karakter e integritet, që të ndihmojmë të rirforcohen vlerat morale që do të bekojnë mbarë komunitetin.

Lejomëni të jem i qartë se të gjitha zërat duhet të dëgjohen në diskutimin publik. As zërat fetarë, as ata laikë nuk duhet të heshtin. Veç kësaj, ne nuk duhet të presim që, meqenëse disa nga pikëpamjet tona burojnë nga parime

fetare, ato do të pranohen vetvetiu ose do t’u jepet parapëlqimi. Por është gjithashtu e qartë se pikëpamje dhe vlera të tilla kanë të drejtë të shqyrtohen mbi meritat e tyre.

Themeli moral i doktrinës sonë mund të jetë fanar drite për botën e mund të jetë një forcë bashkuese qoftë për moralin, qoftë për besimin te Jezu Krishti. Nevojitet që t’i mbrojmë familjet tona e të jemi në ballë së bashku me të gjithë njerëzit vullnetmirë, duke bërë gjithçka që mundim për të ruajtur dritën, shpresën dhe moralin në komunitetet tona.

Nëse i jetojmë e gjithashtu i shpallim këto parime, do të jemi duke ndjekur Jezu Krishtin, i cili është Drita e vërtetë e Botës. Ne mund të jemi një forcë për të drejtën, në përgatitje për Ardhjen e Dytë të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Ne e presim atë ditë të bukur, kur “zemrat e lira do të këndojnë në kohën kur dritat të ndizen sërish anembanë botës”³¹. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Richard Hough dhe Denis Richards, *The Battle of Britain: The Greatest Air Battle of World War II* (1989), f. 264.
2. Kushuar Sir Edward Grey. Shih “When the Lights Go On Again (All over the World)”, wikipedia.org.
3. Shih Doktrina e Besëlidhjet 88:11–13. Drita e Krishtit është “dritë e cila është në gjithçka, që i jep jetë gjithçkaje, që është ligji me anë të të cilit gjithë gjërat qeverisen” (vargu 13). Për kuptim tërësor të Dritës së Krishtit dhe ndryshimit ndërmjet Dritës së Krishtit dhe Frymës së Shenjtë, shih Boyd K. Paker, “Drita e Krishtit”, *Liahona*, prill 2005, f. 8–14.
4. Moroni 7:19.
5. Shih Jacques Barzun, *From Dawn to Decadence: 500 Years of Western Cultural Life* (2000), f. 798.
6. Nenet e Besimit 1:13.
7. Mateu 5:16.
8. Roger B. Porter, “Seek Ye First the Kingdom of God” (fjalim i mbajtur në Lagjen e Universitetit të Kembrixhit, Kunji i Kembrixhit në Masaçusets, 13 shtator 2009).

9. Mormoni 6:17.
10. Mormoni 8:3.
11. Shih John Micklethwait dhe Adrian Wooldridge, *God Is Back: How the Global Revival of Faith Is Changing the World* (2009).
12. Shih Diana Butler Bass, "Peace, Love and Understanding" (recension i *God Is Back*, nga John Micklethwait dhe Adrian Wooldridge), *Botim Kombëtar i Përjaushëm i "Washington Post"*, 27 korrik–2 gusht 2009, f. 39.
13. Shih David D. Kirkpatrick, "The Right Hand of the Fathers", *Revista "The New York Times"*, 20 dhjetor 2009, f. 27.
14. Shih Kirkpatrick, "The Right Hand of the Fathers", f. 27. Robert P. George mëson që ne ose kemi arsye morale dhe zgjedhje të lirë, ose kemi imoralitet dhe determinizëm.
15. Doktrina e Besëlidhje 84:46.
16. Doktrina e Besëlidhje 84:48.
17. Bojd K. Paker, *Liahona*, prill 2005, f. 8.
18. Mosia 29:26–27.
19. Shih Margaret Somerville, "Should Religion Influence Policy?" www.themarknews.com/articles/1535-should-religion-influence-policy.
20. Shih Zhao Xiao, "Market Economies with Churches and Market Economies without Churches", 2002, www.danwei.org/business/churches_and_the_market_econom.php. Ky ekonomist i qeverisë kineze argumenton se është i nevojshëm përforcimi moral për të penguar njerëzit që të gënjejnë e të dëmtojnë të tjerët.
21. "The Cotter's Saturday Night", në *Poems by Robert Burns* (1811), f. 191.
22. Shih Clayton M. Christensen, "The Importance of Asking the Right Questions" (fjala e ceremonisë së diplomimit në Universitetin e Nju-Hempshajërit Jugor, Manchester i N.H., 16 maj 2009).
23. Shih Zanafilla 1:26.
24. Shih William Hague, *William Wilberforce: The Life of the Great Anti-Slave Trade Campaigner* (2007), f. 352–356.
25. Shih Hague, *William Wilberforce*, f. 104–105.
26. Hague, *William Wilberforce*, f. 513.
27. Shih Hague, *William Wilberforce*, f. 107–108.
28. Shih James B. Allen dhe Glen M. Leonard, *The Story of the Latter-day Saints*, bot. 2-të (1992), f. 93, 120, 202.
29. Shih Leonard J. Arrington dhe Davis Bitton, *The Mormon Experience: A History of the Latter-day Saints*, bot. 2-të (1992), f. 48–51; shih edhe Clyde A. Milner dhe të tjerë, *The Oxford History of the American West* (1994), f. 362: "Kolonët dhe politikanët pro skllavërisë i përndoqën ata pa mëshirë".
30. Doktrina e Besëlidhje 101:79.
31. Rreshti i fundit i këngës "When the Lights Go On Again (All over the World)".



Nga Peshkopi Riçard C. Exhli,
Këshilltar i Parë në Peshkopatën Kryesuese

Besim – Zgjedhja Është e Juaja

Zgjidhni besimin në vend të dyshimit, zgjidhni besimin në vend të frikës, zgjidhni besimin në vend të së panjohurës e të padallueshmes dhe zgjidhni besimin në vend të pesimizmit.

Jetojmë në njërin nga periudhat Jungjillore më të shkëlqyera të të gjitha kohërave – një kohë që profetët e mëparshëm mezi e prisnin, e profetizuan dhe, unë besoj, e dëshiruan me mall. Mirëpo, me gjithë bekimet qiellore që na janë dhuruar, Satani, gjithnjë aq real, është përherë mjaft aktiv dhe mesazhet kontraktore vazhdimisht po na bombardojnë të gjithëve. Engjëlli Moroni paralajmëroi Profetin Jozef Smith se emri i tij do të mbahej për mirë e për keq anembanë botës (shih Joseph Smith – Historia 1:33), dhe kurrë më i faktuar nuk ka qenë plotësimi i një profecie. Profeti dha jetën për dëshminë e tij dhe sot sulmet vazhdojnë kundër Kishës dhe Vetë Shpëtimtarit madje. E vërteta për Shpëtimtarin, sakrificën e Tij shlyese dhe zbatimin e përgjithshëm që ajo ka për të gjithë ne, kundërshtohet dhe shpesh mënjanohet si një mit apo shpresë e pabazë e mendjes së dobët e të paarsimuar. Për më tepër, të vërtetën e Rivendosjes së ungjillit në këto ditë të mëvonshme vazhdojnë ta kundërshtojnë. Bombardimi i vazhdueshëm prej mesazhesh të tilla mund të shkaktojë ngatërresë, dyshim

dhe pesimizëm, secili në mësymje të të vërtetave themelore në të cilat ne besojmë, të besimit tek Perëndia dhe të shpresës sonë tek e ardhmja.

Kjo mund të jetë e vërteta e botës sonë, por ne ende mund të zgjedhim si të reagojmë ndaj saj. Kur doktrinat dhe besimet tona të shenjtja i kundërshtojnë, është mundësia jonë që të njihemi me Perëndinë në mënyrën më personale e më të afërt. Kjo është mundësi që ne të zgjedhim.

Për arsye të kundërshtimeve dhe sfidave me të cilat përballemi në botën e sotme, unë dëshiroj të këshilloj një zgjedhje të vetme – një zgjedhje paqeje dhe mbrojtjeje dhe një zgjedhje e përshtashme për të gjithë. Ajo zgjedhje është besimi. Kini parasysh që besimi nuk është dhuratë falas që jepet pa treguar vëmendje, dëshirë apo përpjekje. Nuk vjen si vesa që bie nga qielli. Shpëtimtari tha: "Ejani tek unë" (Mateu 11:28) dhe "Trokitni dhe do t'ju [jepet]" (Mateu 7:7). Këto janë folje veprimi – *ejani, trokitni*. Ato janë zgjedhje. Prandaj them: zgjidhni besimin. Zgjidhni besimin në vend të dyshimit, zgjidhni besimin në vend të frikës, zgjidhni besimin në vend të së panjohurës e të

padallueshmes dhe zgjidhni besimin në vend të pesimizmit.

Diskutimi klasik i Almës mbi besimin, sikurse shënohet në kapitullin e 32-të të Almës në Librin e Mormonit, është një seri zgjedhjesh për të garantuar zhvillimin dhe ruajtjen e besimit tonë. Alma na dha një udhëzim për të zgjedhur. Ishin të tijat fjalët e veprimit që fillon me zgjedhjen. Ai përdori fjalët *zgjohuni, vini në veprim, vini në provë, ushtroni, dëshironi, veproni* dhe *mbillni*. Më pas Alma shpjegoi se, në rast se i bëjmë këto zgjedhje dhe nuk e hedhim farën tej me mosbesim, atëherë “ajo do të fillojë të fryhet në kraharorin [tonë]” (Alma 32:28).

Po, besimi është zgjedhje dhe duhet të kërkohet e të zhvillohet. Kësisoj, ne jemi përgjegjes për besimin tonë vetjak. Jemi gjithashtu përgjegjës për mungesën e besimit tonë. Zgjedhja është e juaja.

Janë të shumta ato që unë nuk di. Nuk di hollësitë e organizimit të lëndës për një botë të mrekullueshme ku ne jetojmë. Nuk kuptoj ndërlikimet e Shlyerjes, mënyrën se si arrin sakrifica e Shpëtimtari t'i pastrojë të gjithë njerëzit e penduar apo mënyrën si mund të vuante Shpëtimtari “dhemljen e gjithë njerëzve” (DeB 18:11). Nuk di se ku ishte qyteti i Zarahemlës, siç është përmendur në Librin e Mormonit. Nuk e di përse ato që besoj, nganjëherë bien ndesh me njohurinë e pranuar shkencore apo laike. Ndoshta këto janë çështje të cilat Ati ynë Qieullor i cilësoi si “misteret . . . [e] qiellit” (DeB 107:19) që do të zbulohen në një kohë të mëvonshme.

Por, ndonëse nuk di gjithçka, unë di të rëndësishmen. Di të vërtetat e qarta e të thjeshta të ungjillit që çojnë drejt shpëtimit dhe ekzaltimit. Di që Shpëtimtari vuajti dhembjen e gjithë njerëzve dhe që të gjithë njerëzit e penduar mund të pastrohen nga

mëkati. Dhe, për ato që nuk di ose nuk kuptoj plotësisht, me ndihmën e fuqishme të besimit tim, i vë hendekut urën dhe vazhdoj përpara, duke marrë premtimet dhe bekimet e ungjillit. Dhe atëherë, siç mësonte Alma, besimi ynë na sjell te një njohuri e përsosur (shih Alma 32:34). Duke shkuar përpara drejt së panjohurës, të armatosur vetëm me shpresë e dëshirë, ne shfaqim treguesin e besimit dhe të besnikërisë sonë ndaj Zotit.

Dhe prandaj, duke ndjekur formulën e Almës, le të zgjedhim. Le të zgjedhim besimin.

- Nëse hutimi dhe mungesa e shpresës rëndojnë në mendjen tuaj, zgjidhni të “zgjoheni dhe . . . të vini në veprim aftësitë tuaja” (Alma 32:27). Afrimi i përlulur te Zoti, me një zemër të thyer dhe një shpirt të penduar, është shtegu drejt së vërtetës dhe rruga e Zotit drejt dritës, njohurisë dhe paqes.
- Nëse dëshmia juaj është e pazhvilluar, e paprovuar dhe e pasigurt, zgjidhni të “ushtroni [madje] një pjesëz të besimit”; zgjidhni të “bëni një provë mbi fjalët e [Tij]” (Alma 32:27). Shpëtimtari shpjegoi: “Në



goftë se dikush don të dijë vullnetin e tij, do ta njohë nëse kjo doktrinë vjen nga Perëndia apo unë flas nga vetja ime” (Gjoni 7:17).

- Kur logjika, arsyeja ose intelektu vetjak bien ndesh me mësimet dhe doktrinën e shenjtë ose kur mesazhet kontradiktore i sulmojnë besimet tuaja si shigjetat e zjarra që përshkruhen nga Apostulli Pal (shih Efesianëve 6:16), zgjidhni të mos e dëboni farën nga zemra juaj prej mosbesimit. Mbani mend, ne nuk marrim dëshmi deri pas provës së besimit tonë (shih Ethëri 12:6).
- Nëse besimi juaj është provuar dhe pjekur, zgjidhni ta ushqeni “me kujdes të madh” (Alma 32:37). Aq sa është i fortë besimi ynë, me të gjitha mesazhet e trazuar që e sulmojnë atë, mund të bëhet shumë i brishtë. Atij i nevojitet ushqim i pandërprerë përmes studimit të shkrimit të shenjtë, lutjes dhe zbatimit të fjalës së Tij në vazhdimësi.

Kur dishepujt e pyetën Jezusin se përse nuk mundën të dëbonin një djall sikurse sapo kishin dëshmuar se Shpëtimtari e bëri këtë, Jezusi u përgjigj: “Po të keni besim sa një kokërr sinapi, do t’i thoni këtij mali: ‘Zhvendosu nga këtu atje’, dhe ai do të zhvendoset” (Mateu 17:20). Unë nuk kam dëshmuar ndonjëherë zhvendosjen e një mali të vërtetë. Por, për shkak të besimit, kam parë male dyshimi e dëshpërimi të zhvendosen dhe të zëvendësohen me shpresë dhe optimizëm. Për shkak të besimit, kam dëshmuar personalisht që një mal mëkati zëvendësohet me pendim dhe falje. Dhe, për shkak të besimit, kam dëshmuar personalisht që një mal dhimbjeje zëvendësohet me paqe, shpresë dhe mirënjohje. Po, kam parë të zhvendosen male.



- Për shkak të besimit tim kam vënë në lëvizje fuqinë e priftërisë që unë mbaj dhe kam qenë pjesëmarrës i ëmbëlsisë së ungjillit, dhe kam zgjedhur ordinancat shpëtuese.
- Për shkak të besimit tim punoj me paqe e siguri përmes mundimeve e vështirësive të jetës.
- Për shkak të besimit tim kam qenë në gjendje që pyetje, dhe madje dyshime, t’i shndërroja në siguri e kuptim.
- Për shkak të besimit tim i qasem me siguri të plotë së panjohurës, së padukshmes e së pashpjegueshmes.
- Dhe për shkak të besimit tim – madje në kohët në dukje më të këqija – pranoj me paqe e mirënjohje se aty është, në të vërtetë, koha më e mirë.

E kur ne zgjedhim besimin e më pas e ushqejmë atë besim drejt një njohurie të përsosur të gjërave të Zotit, atëherë ne përdorim fjalët “unë dëshmoj” ose “unë e di”. Unë personalisht e kam mbjellur farën në zemër dhe gjatë jetës sime jam përpjekur ta ushqej atë farë drejt një njohurie të përsosur. Dhe sot, ndërsa qëndroj pas kësaj foltoreje, unë dëshmoj që Jezusi është Krishti, Shëlbuesi i botës. Dëshmoj më tej që Jozef Smithi ishte profet i Perëndisë dhe instrumenti i gjallë që përdori Zoti për t’i risjellë tokës ungjillin e plotë dhe të vërtetë të Jezu Krishtit. Dëshmoj që Presidenti të Jezu Krishtit. Dëshmoj që Presidenti Tomas S. Monson është profeti i Zotit sot. E po ashtu, zgjedhja e besimit është e juaja, është e imja. Le të zgjedhim besim. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku Kevin R. Dankan,
i Të Shtatëdhjetëve

Pikërisht Mbijetesa Jonë

Paçim urtësinë që të mirëbesojmë e të ndjekim këshillën e profetëve e të apostujve të gjallë.

Dimri i 1848-ës ishte i vështirë dhe sfidues për kolonët pionierë në Luginën e Solt-Lejkut. Gjatë verës së 1847-ës Brigam Jangu pati deklaruar se shenjtorët më në fund kishin prekur vendmbërritjen e tyre. “Ky është vendi i duhur”¹, tha Brigam Jangu, të cilit në vegim i qe shfaqur se ku do të vendoseshin shenjtorët. Anëtarët e hershëm të Kishës kishin duruar fatkeqësi të pamasa kur Rivendosja e ungjillit shpalosej. Ata qenë përzënë nga shtëpitë e tyre, përndjekur dhe gjurmuar pa pushim. Kishin vuajtur mundime të patreguara, ndërsa kapërcenin rrafshinat. Por tashmë ata ndodheshin më në fund në “vandin e duhur”.

E, sidoqoftë, dimri i vitit 1848 kishte qenë jashtëzakonisht i ashpër. Dimri kish qenë kaq i ftohtë, sa këmbët e disa njerëzve patën ngrirë keqas. Një shpirt parehatie filloi të zbriste mbi shenjtorët. Disa anëtarë të Kishës u shprehën se nuk do t'i ndërtonin shtëpitë e veta në luginë. Ata donin të rrinin në karrocet e tyre, sepse ishin të sigurt që udhëheqja e Kishës do t'u printe më tej në ndonjë vend më të mirë. Ata patën sjellë farëra dhe bimë frutore, por nuk guxonin t'i humbisnin duke i mbjellë në djerrinën e shkretëtirës shterpë. Xhim Brixher, një eksplores i mirënjohur i kohës, i tha Brigam

Jangut se do të jepte një mijë dollarë për të parën sasi misri të rritur në Luginën e Solt-Lejkut, sepse ai thoshte që kjo nuk mund të bëhej.²

Për t'i ndërlikuar gjërat, sapo ishte zbuluar ar në Kaliforni. Disa anëtarë të Kishës përfytyruan se jeta do të qe më e thjeshtë e më e begatë nëse do të lëviznin drejt Kalifornisë në kërkim të pasurive dhe të një klime më të mirë.

Nën këtë re të pakënaqësisë, Brigam Jangu iu drejtua anëtarëve të Kishës. Ai bëri të ditur:

“[Kjo luginë] është vendi që Perëndia i ka caktuar popullit të Tij.

Ne na kanë hedhur nga tigani në zjarr, nga zjarri në mes të dyshemesë dhe ne ja ku jemi dhe këtu do të qëndrojmë. Perëndia më ka treguar që

ky është vendi për të vendosur popullin e Tij dhe pikërisht këtu ata do të përparojnë; Ai do t'i zbusë elementet për të mirën e shenjtorëve të Tij; Ai do ta qortojë acarin dhe shterpësinë e truallit dhe vendi do të bëhet i frytshëm. Vëllezër, shkoni, që tani, dhe mbillni . . . farërat që keni.”

Përveç premtimit të këtyre beki-meve, Presidenti Brigam Jang shpalli se Lujina e Solt-Lejkut do të bëhej e njohur si një rrugë drejt kombeve. Mbretërit dhe perandorët do të vizitonin vendin. Më e mira e të gjithave, tempulli i Zotit do të ngrihej³.

Këto ishin premtime të jashtëzakonshme. Shumë anëtarë të Kishës patën besim tek profecitë e Brigam Jangut, kurse të tjerë mbetën skeptikë dhe ikën për atë që e mendonin se do të ishte jetë më e mirë. Tashmë historia ka treguar se çdo profeci që Brigam Jangu shpalli ka ndodhur. Lujina lulëzoi dhe prodhoi. Shenjtorët u begatuan. Dimri i vitit 1848 ishte për Zotin një katalizator i madh që t'i mësonte popullit të Tij një mësim të çmuar. Mësuan – siç duhet të mësojmë të gjithë – se e vetmja rrugë e sigurt dhe e garantuar drejt mbrojtjes në këtë jetë, vjen nëpërmjet mirëbesimit dhe bindjes ndaj këshillës së ardhur nga profetët e Perëndisë.



Sigurisht që një nga bekimet kuro-rëzuese të anëtarësimit në këtë Kishë, është bekimi që të udhëhiqemi nga profetë të gjallë të Perëndisë. Zoti ka shpallur: “Kurrë nuk ka përveçse një njeri mbi tokë gjatë një kohe, mbi të cilin kjo fuqi dhe çelësat e kësaj priftë-rie jepen”⁴. Profeti dhe Presidenti i Kishës sot, Tomas S. Monson, merr fjalën e Perëndisë për të gjithë anëtarësinë e Kishës dhe për botën. Veç kësaj, ne mbështesim si profetë, shikues dhe zbulues këshilltarët në Presidencinë e Parë dhe anëtarët e Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve.

Me këmbët e ngrira dhe tokën shterpë, atyre shenjtorëve sigurisht u nevojitej besim për të mirëbesuar te profeti i tyre. Pikërisht mbijetesa dhe jeta e tyre ishte në fije të perit. Megjithatë, Zoti e shpërbleu bindjen e tyre dhe i bekoi e i begatoi ata që e ndoqën gojën e Tij.

Dhe Zoti bën sot të njëjtën gjë për ju dhe mua. Kjo botë është përplot me kaq shumë libra për vetëndihmë, kaq shumë ekspertë të vetëshpallur, kaq shumë teoricienë, mësues dhe filozofë që kanë të japin rekomandime dhe këshilla për çfarëdo e gjithçka. Me teknologjinë e sotme mund të merret informacion mbi një mori çështjesh me një të rënë të tastës. Është lehtë që të biesh në grackën e kërkimit të këshillës të “krahu i mishtë”⁵, për gjithçka, nga mënyra e rritjes së fëmijëve deri te mënyra e gjetjes së lumturisë. Ndërkohë që disa informacione kanë vlerë, ne, si anëtarë të Kishës, mund të marrim tek burimi i së vërtetës së pastër, madje tek Perëndia Vetë. Do të bënim mirë t’i kërkonim përgjigjet e problemeve dhe pyetjeve tona duke hetuar atë që na ka zbuluar Zoti përmes profetëve të Tij. Me po atë teknologji të sotme, ne arrijmë që thjesht me gishtërinjtë tanë të gjejmë fjalët e profetëve thujse për çdo temë.



Stokholm, Suedi

Çfarë na ka mësuar Perëndia nëpërmjet profetëve të Tij mbi martesën dhe familjen? Çfarë na ka mësuar përmes profetëve të Tij mbi arsimimin dhe jetesën me maturi? Çfarë na ka mësuar përmes profetëve të Tij mbi lumturinë dhe ndjenjën e plotësimit vetjak?

Ajo që na mësojnë profetët, disave mund t’u duket e vjetëruar, jopopullore ose madje e pamundur. Por Perëndia është Perëndi i rregullit dhe ka vendosur një sistem përmes të cilit mund të dimë vullnetin e Tij. “Sepse Zoti, Zoti, nuk bën asgjë, pa ua treguar sekretin e tij shërbëtorëve të tij, profetëve”⁶. Në çeljen e kësaj periudhe, periudhës ungujlore të plotësisë së kohëve, Zoti ripohoi që do të komunikonte me ne përmes profetëve të Tij. Ai shpalli: “Fjala ime . . . do të përmbushet e gjitha, qoftë nëpërmjet zërit tim apo nëpërmjet zërit të shërbëtorëve të mi është njësoj”⁷.

Të mirëbesosh e të ndjekësh profetët, është më shumë se bekim e privilegj. Presidenti Ezra Taft Benson bëri të ditur se “[pikërisht] shpëtimi ynë varet” te ndjekja e profetit. Ai ka cilësuar ato që i quajti “Katërmbëdhjetë Pikat Themelore në Ndjekjen e Profetit”. Në sesionin e këtij mëngjesi,

Plaku Klaudio Kosta, i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve, na udhëzoi në mënyrë aq shprehëse lidhur me këto 14 pika themelore. Meqenëse janë të një rëndësie aq të madhe për vetë shpëtimin tonë, do t’i përsëris ato rishtas.

“E para: Profeti është i vetmi njeri i cili flet për Zotin, në gjithçka.

E dyta: Profeti i gjallë është më jetik për ne, sesa veprat standarde.

E treta: Profeti i gjallë është më i rëndësishëm për ne, se një profet i vdekur.

E katërta: Profeti nuk do ta udhëheqë kurrë Kishën shtrembër.

E pesta: Nuk kërkohet që profeti të ketë ndonjë formim apo certifikim të veçantë tokësor për të folur mbi çfarëdo tematike ose të veprojë në lidhje me ndonjë çështje në çdo kohë.

E gjashta: Profeti nuk do të duhet të thotë “Kështu thotë Zoti”, për të na dhënë shkrime të shenjta.

E shtata: Profeti na thotë atë që na nevojitet të dimë, jo gjithnjë atë që dëshirojmë të dimë.

E teta: Profeti nuk kufizohet nga arsytimi i njerëzve.

E nënta: Profeti mund të marrë zbuluesë mbi çdo çështje, materiale ose shpirtërore.

E dhjeta: Profeti mund të përfshihet në çështje qytetare.

E njëmbëdhjeta: Dy grupet që kanë vështirësinë më të lartë në ndjekjen e profetit, janë kryelartët që janë të mësuar dhe kryelartët që janë të pasur.

E dymbëdhjeta: Profeti nuk do të jetë doemos popullor me botën apo me të botës.

E trembëdhjeta: Profeti dhe këshilltarët e tij përbëjnë Presidencën e Parë – kuorumin më të lartë në Kishë.

E katërbëdhjeta: [Ndiqni] . . . profetin e gjallë dhe Presidencën e Parë . . . e bekohuni; refuzojini ata e vuani”⁸.

Vëllezër dhe motra, ashtu si shenjtorët e 1848-ës, ne mund të zgjedhim që të ndjekim profetin ose mund të mbështetemi te krahu i mishtë. Paçim urtësinë që të mirëbesojmë e të ndjekim këshillën e profetëve e të apostujve të gjallë. Unë jam dëshmitar i mirësisë së tyre. Dëshmoj që janë thirrur nga Perëndia. Dëshmoj gjithashtu se për t’iu qasur jetës, për të gjetur përgjigje për problemet tona, për të fituar lumturi në këtë botë dhe për të mbrojtur pikërisht shpëtimin tonë, nuk ka mënyrë më të sigurt, sesa duke iu bindur fjalëve të tyre. E jap këtë dëshmi në emrin e shenjtit të Zotit Jezu Krishti, amen. ■

SHËNIME

1. Brigham Young, sikurse citohet nga Wilford Woodruff, në *The Utah Pioneers* (1880), f. 23.
2. Shih Bryant S. Hinckley, *The Faith of our Pioneer Fathers* (1956), f. 9–15; shih edhe Gordon B. Hinckley, “Remarks at Pioneer Day Commemoration Concert”, *Ensign*, tetor 2001, f. 70–72.
3. Shih Hinckley, *The Faith of our Pioneer Fathers*, f. 11–12; shih edhe *Ensign*, tetor 2001, f. 71.
4. Doktrina e Besëlidhje 132:7.
5. Doktrina e Besëlidhje 1:19.
6. Amosi 3:7.
7. Doktrina e Besëlidhje 1:38.
8. Ezra Taft Benson, “Fourteen Fundamentals in Following the Prophet”, në *1980 Devotional Speeches of the Year* (1981), f. 29–30.



Nga Plaku Gerrit W. Gong,
i Të Shtatëdhjetëve

Pasqyra Tempulli të Përjetësisë: Një Dëshmi për Familjen

Një këndvështrim përjetësie i kthimit në ungjill dhe besëlidhjet e tempullit, mund të na ndihmojë të shohim bekimet e pasura në çdo brez të familjeve tona të përhershme.

Të dashur vëllezër dhe motra, kur djali ynë ishte në Qendrën Trajnuese Misionare në Provo, Motra Gong i postoi bukë të sapo pjekur atij dhe shokëve të tij misionarë. Këtu janë disa nga shënimet falënderuese që mori Motra Gong: “Motra Gong, ajo bukë ishte një shije e shtëpisë.” “Motra Gong, gjithë ç’mund të them është mrekulli. Ajo bukë është gjëja më e mirë që kam futur në gojë qysh nga ençiladat e nënës time.” Por kjo është e parapëlqyera ime: “Motra Gong, buka ishte e mrekullueshme”. Ai vazhonte pastaj me shaka: “Më kujtoni mua nëse gjërat nuk shkojnë mirë mes jush dhe Z. Gong.”

Ne i duam misionarët tanë – çdo motër, plak, çift të rriturish. Ne i jemi të gjithë mirënjohës përjetësisht atij misionari të veçantë që solli i pari ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit në familjen tonë. Unë dëshmoj me mirënjohje se një këndvështrim përjetësie i kthimit në ungjill dhe besëlidhjet e tempullit mund të na ndihmojnë të

shohim bekimet e pasura në çdo brez të familjeve tona të përhershme.

E kthyerja e parë në familjen tonë të Gong-ëve në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, është nëna jonë Xhin Gong. Si e re adoleshente në Honolulu, Havai, ajo dëgjonte; ajo dinte; ajo u pagëzua dhe u konfirmua; ajo po vazhdon në besim. Anëtarët besnikë të Kishës e ndihmuan nënën time që ajo të kishte miq të ungjillit, thirrje të Kishës dhe ushqim të vazhdueshëm nga fjala e mirë e Perëndisë. Në të folurën e sotme, çdo i kthyer i ri, i ri beqar në moshë madhore, ata që riktheheshin në aktivitetin e Kishës dhe të tjerë, bekojnë breza kur bëhen shokë shenjtorë në shtëpinë e Perëndisë.¹

Një familje që e ushqeun nënën time, ishte ajo e Gerrit de Jong i Riu. Një gjuhëtar që e donte gjuhën e zemrës dhe të Shpirtit, gjysh de Jong-u e ngacmonte imagjinatën time prej djali të vogël me porosi si: “Manaferrat kur janë të kuqe janë jeshil”. Sot, duke

folur për pajisjet elektronike të dorës, unë u them miqve të mi të rinj: “Ma-naferrat që lexohen në kishë i bëjnë peshkopët jeshilë të nxihen.”

Prindërit e mi, Uollteri dhe Xhin Gong-u u martuan tri herë: një ceremoni kineze për familjen, një ceremoni amerikane për miqtë dhe një ceremoni të shenjtë në shtëpinë e Zotit për kohën dhe përjetësinë.

Fëmijët tanë të Fillores këndojnë: “Unë dua tempullin ta shoh. Do t’shkoj një ditë atje”.² Të rinjtë tanë zotohen që “të marrin ordinancat e tempullit”.³

Unë isha kohët e fundit në një Shtëpi të Zotit me një çift të denjë për të marrë bekime nga besëlidhja. Unë i ftova ata të bënin që, muaji i tyre i parë të mjaltit të zgjaste 50 vite, pastaj pas 50 vitesh të fillonin muajin e tyre të dytë të mjaltit.

Unë e gjeta veten duke parë me këtë çift të mrekullueshëm në pasqyrat e tempullit – një pasqyrë në këtë anë, një në atë anë. Së bashku pasqyrat në tempull reflektojnë pamje përpara dhe prapa që shtrihen si në përjetësi.

Pasqyrat e përjetësisë në tempull na kujtojnë se, çdo qenie njerëzore ka “një natyrë dhe destinacion hyjnor”; që “ordinancat dhe besëlidhjet e shenjta që janë në dispozicion në tempujt e shenjtë, bëjnë të mundur që individët të kthehen në praninë e Perëndisë dhe që familjet të bashkohen përjetësisht”;⁴ dhe që duke u rritur në dashuri dhe besnikëri ndaj njeri-tjetrit dhe Perëndisë, ne të mund t’u japim fëmijëve rrënjë dhe krahë.

Në pasqyrat e përjetësisë në tempull unë mendova për Dragon Gongun e Parë, lindur më 837 të erës sonë (ish dinastia Tang) në Kinën Jugore dhe arrita brezat pasardhës të familjes Gong deri te babai im, brezi i 32-të i regjistruar i familjes sonë. Vëllai, motra ime dhe unë jemi në familjen tonë brezi i 33-të; katër bijtë e mi të

mrekullueshëm dhe kushërinjtë e tyre, brezi i 34-t; nipi ynë, brezi i 35-të i regjistruar i familjes Gong. Në pasqyrat e përjetësisë në tempull, unë nuk mund të shihja fillim apo fund brezash.

Pastaj unë përfytyrova jo vetëm një vazhdimësi brezash, por gjithashtu, një vazhdimësi të marrëdhënieve familjare. Në një drejtim unë pashë veten time si bir, nip, stërnip, prapa deri te Dragon Gongu i Parë. Në pasqyrat nga drejtimi tjetër, unë e pashë veten si baba, gjysh, stërgjysh. Unë mund

ta shoh gruan time, Sjuzën, si bijë, mbesë, stërmbesë dhe, në drejtimin tjetër, si nënë, gjyshe, stërgjyshe.

Në pasqyrat e përjetësisë në tempull, unë fillova t’i kuptoj bashkëshorten time dhe veten njëkohësisht si fëmijë të prindërve tanë dhe prindër të fëmijëve tanë, si nipër të gjyshërve tanë dhe si gjyshër të nipërve tanë. Mësimet e mëdha të vdekshmërisë përvetësohen gradualisht në shpirtat tanë ndërsa mësojmë dhe japim mësim në rolet tona të përjetshme,





ndajë nga dashuria e Perëndisë që është në Jezu Krishtin, Zotin tonë”.¹⁷

Përlësisht unë dëshmoj: Perëndia jeton. Ai “do të thajë çdo lot nga sytë [tanë]”¹⁸ – përveç lotëve të gëzimit kur ne shohim nëpërmjet pasqyrave të përjetësisë në tempull dhe shohim veten në shtëpi, të dëlirë e të pastër, brezat e familjes sonë të vulosur nga autoriteti i priftërisë në dashuri, për të thirrur hosana, hosana, hosana.” Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Efesianëve 2:19.
2. “I Love to See the Temple,” *Children's Songbook*, f. 95.
3. “Young Women Theme,” *Young Women Personal Progress: Standing as a Witness of God* (broshurë, 2009), f. 3.
4. “Familja: Një Proklamatë Drejtuar Botës”, *Liahona*, tetor 2004, f. 49.
5. Shih Mosia 15:2.
6. Shih Alma 7:11–12.
7. Doktrina e Besëlidhje 88:6; shih gjithashtu Doktrina e Besëlidhje 122:5–8.
8. Isaia 53:5.
9. Mateu 10:39.
10. Shih Alma 34:14.
11. Shih Doktrina e Besëlidhje 20:74, 79.
12. Mosia 18:9.
13. Doktrina e Besëlidhje 121:44.
14. “How Great the Wisdom and the Love,” *Hymns*, no. 195.
15. Shih Doktrina e Besëlidhje 45:26; 88:91.
16. Doktrina e Besëlidhje 1:30.
17. Romakëve 8:38–39.
18. Zbulesa 21:4.

përfshirë fëmijë dhe prind, prind dhe fëmijë.

Shkrimet e shenja e përshkruajnë Shpëtimtarin tonë si “Ati dhe Biri”.⁵ Meqenëse jetoi në mish duke ia nënshtruar mishin vullnetit të Atit, Shpëtimtari ynë di si të na shpëtojë ne, njerëzit e Tij, në dhembjet, hidhërimet, tundimet, sëmundjet, madje në vdekjen tonë.⁶ Duke “zbritur nën gjithçka”,⁷ Shpëtimtari ynë mund të durojë brengat tona dhe të mbajë pikëllimet tona. “Ai u tejpua për shkak të shkeljeve tona, u shtyp për paudhësitë tona . . . ; për shkak të vurratave [të Shpëtimtarit tonë] . . . ne jemi të shëruar”.⁸

Qysh nga koha e këshillave në qiell, Shpëtimtari ynë kërkoi vetëm të plotësonte vullnetin e Atit të Tij. Ky model i Atit dhe Birit mund të ndihmojë të shpjegohet paradoksi “Ai që do të humbasë jetën e vet për hirin tim, do ta gjejë përsëri”.⁹ Bota ndjek e ndriçuar interesin e vet. Përsëri, fuqia nuk është te ne për të shpëtuar vetë. Por ajo është tek Ai. E pafund dhe e përjetshme¹⁰, vetëm Shlyerja e Shpëtimtarit përpin vdekjen, kohën, hapësirën, zemërimin, hidhërimin, padrejtësinë, vetminë dhe zemërthyerjen.

Ndonjëherë gjërat shkojnë keq madje edhe pse ne kemi bërë më të mirën tonë. Një Qengj i pafajshëm dhe i pastër, Shpëtimtari qan me dhe


për ne. Kur ne e kujtojmë gjithmonë Atë,¹¹ Ai mund të qëndrojë me ne “në të gjitha kohërat dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet që [ne] të gjende[m]”.¹² “Besnikëria [e Tij] është më e fortë se zinxhirët e vdekjes”.¹³ Duke na tërhequr ne drejt Vetes, Shpëtimtari ynë na çon ne tek Ati ynë në Qiell. Ndërsa disa gjëra janë të papërsosura në tokë, ne mund të besojmë tek Ati Qiu për të plotësuar “planin e madh të shëlbimit, ku drejtësia, dashuria dhe mëshira bashkohen në harmoni hyjnore!”¹⁴

Një mrekulli e pamjeve që ne shquajmë në pasqyrat e përjetësisë në tempull, është se ato – ne – mund të ndryshojmë. Kur Xhini dhe Uollter Gongu u futën në një besëlidhje të re të përherëshme, ata hapën rrugën për paraardhës (të tillë si Dragon Gongu i Parë) për t’u vulosur dhe për pasardhësit që të lindin në besëlidhje. Ju lutem mbani mend: ndërsa ndihmojmë secilën motër apo vëlla, ne bekojmë breza.

Bota është në trazirë,¹⁵ por në “të vetmen kishë të vërtetë dhe të gjallë” të Tij,¹⁶ ka besim dhe jo frikë. Me fjalët e Apostullit Pal, unë gjithashtu dëshmoj:

“Sepse unë jam i bindur se as vdekja, as jeta, . . .

as lartësitë, as thellësitë, as ndonjë jetër krijesë, nuk do të mund të na





Nga Plaku Nil L. Andersen,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Kurrë Mos e Lini Atë

Ndërsa zgjidhni të mos fyheni ose turpëroheni, ju do ta ndieni dashurinë dhe miratimin e Tij. Ju do ta dini se ju po bëheni më shumë si Ai.

Të dashur Vëllezërit dhe Motrat e mia nëpër botë, unë shpreh admirimin tim të thellë për besimin dhe kurajën që shoh në jetën tuaj. Ne jetojmë në një kohë shumë të shquar – por në një kohë sfiduese.

Zoti na Paralajmëron për Rreziqet që Janë Përpara

Zoti nuk na ka lënë vetëm në kërkimin tonë për t'u kthyer tek Ai. Dëgjoini fjalët e Tij, të cilat na paralajmërojnë për rreziqet që janë përpara: “Tregoni kujdes, rrini zgjuar dhe lutuni”¹. “Ruhuni që të mos mashtroheni.”² “Të jeni të vëmendshëm dhe të kujdesshëm.”³ “Ruajuni se mos ligështoheni në qëndresën tuaj.”⁴

Asnjë nga ne nuk është i imunizuar nga ndikimet e botës. Këshilla e Zotit na mban vigjilentë.

Juve do t’ju kujtohet përvoja e Jezusit në Kapernaum, kur dishepujt, që e kishin ndjekur Shpëtimtarin, nuk do ta pranonin se Ai qe Biri i Perëndisë. Shkrimi i shenjtë shkruan: “Që nga ai moment shumë nga dishepujt e vet . . . nuk shkuan më me të”⁵.

Jezusi atëherë u kthye nga Të Dymbëdhjetët dhe i pyeti: “A doni edhe ju të largoheni?”⁶

A Doni Edhe Ju të Largoheni?

Në vetë mendjen time, i jam përgjigjur asaj pyetjeje shumë herë: “Absolutisht jo! Jo unë! Unë kurrë nuk do ta lë Atë! Unë jam këtu përgjithmonë!” E di se ju jeni përgjigjur në të njëjtën mënyrë.

Por pyetja: “A doni edhe ju të largoheni?” na bën të mendojmë për vetë dobësinë tonë. Jeta nuk është piknik shpirtëror. Fjalët e Apostujve, nga një rrethanë tjetër, na vijnë qetë në mendje: “Mos jam unë; Zot?”⁷

Ne hymë në ujërat e pagëzimit me gëzim dhe padurim. Shpëtimtari na bën me shenjë “[e]ani! tek unë”⁸ dhe ne përgjigjemi, duke marrë mbi vete emrin e Tij. Asnjë prej nesh nuk dëshiron që udhëtimi ynë të jetë një flirtim i shkurtër me shpirtshmërinë, as edhe një kapitull i shquar, por i kufizuar. Rruga e të qenit dishepull nuk është për ligështimin shpirtëror të zemrës. Jezusi i tha: “Duaje Zotin Perëndinë tënde me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde”⁹. “Kushdo që don të vijë pas meje, të mohojë vetveten, të marrë kryqin e vet dhe të më ndjekë.”¹⁰

Ndërsa e ndjekim Shpëtimtarin, pa dyshim do të ketë sfida, që do të na dalin përballë. Nëse u qasemi me besim, këto përvoja pastruese sjellin një

kthim në besim më të thellë për realitetin e Shpëtimtarit. Nëse u qasemi në mënyrën e botës, po këto përvoja e turbullojnë vështrimin tonë dhe e dobësojnë vendosmërinë tonë. Disa, që i duam dhe i admirojmë, shkasin nga shtegu i ngushtë dhe i ngushtuar dhe “nuk shk[ojnë] më me të”.

Si Mbetemi të Vërtetë?

Si i mbetemi të vërtetë Shpëtimtarit, ungjillit të Tij dhe ordinancave të priftërisë së Tij? Si e zhvillojmë besimin dhe forcën që të mos e lëmë kurrë Atë?

Jezusi tha: “Në qoftë se nuk ktheheni dhe nuk bëheni si fëmijët e vegjël, ju nuk do të hyni fare në mbretërinë e qiejve”¹¹. Na nevojitet zemra besuese e një fëmije.

Nëpërmjet fuqisë së Shlyerjes së Tij, ne duhet të bëhemi “si një fëmijë, [të] nënshtuar, [të] bindur, [të] përu-lur, [të] duruar, plot me dashuri, [të] gatshëm t’u nënshtrohe[mi] të gjitha gjërave që Zoti i sheh të përshtatshme të shkaktojë mbi [ne], madje sikurse një fëmijë i nënshtrohet atit të tij”¹². Ky është ndryshimi i madh i zemrës.¹³

Shpejt ne e shohim pse është i nevojshëm një ndryshim i zemrës. Dy fjalë sinjalizojnë rrezik përpara: fjalët janë *i fyer* dhe *i turpëruar*.

Zgjidhni të Mos Turpëroheni

Ata që shqetësoheshin nga karakteri hyjnor i Shpëtimtarit, Jezusi i pyeti: “Kjo ju skandalizon?”¹⁴ Në shëmbëlltyrën e mbjellësit, Jezusi paralajmëroi: “[Ai duron] për pak kohë; [por] kur vijnë mundimi ose përndjekja për shkak të fjalës, skandalizohet menjëherë”¹⁵.

Fyerja vjen në shumë forma dhe vazhdimisht përpiqet të na hyjë në mendje. Njerëz tek të cilët besojmë, na zhgënjëjnë. Ne kemi vështirësi që nuk i prisnim. Jeta jonë nuk del pikërisht ashtu si e prisnim. Ne bëjmë gabime,



mbushur me njerëz, . . . pleq dhe të rinj, . . . meshkuj dhe femra dhe . . . veshj[a e tyre] ishte jashtëzakonisht e mirë; dhe ata ishin duke u tallur dhe duke treguar me gisht [me përqeshje] drejt atyre që . . . po hanin frutin”²³. Engjëlli shpjegoi se tallja, përqeshja, gishtat e përqeshjes përfaqësonin krenarinë dhe urtësinë e botës²⁴.

Nefi deklaroi qartë: “Ne nuk ua vumë veshin”²⁵.

Trishtueshëm, pati të tjerë kuraja e të cilëve u lëkund. Shkrimi i shenjtë thotë: “Dhe *pasi* ata kishin shijuar nga fruti, *u turpëruan* për shkak të atyre që po i përqeshnin; dhe ata u larguan nëpër shtigje të ndaluara dhe humbën”²⁶.

Si dishepuj të Krishtit, ne qëndrojmë veçmas botës. Mund të ketë momente kur ne ndihemi në siklet, ndërsa gishtat e përqeshjes tallin dhe largojnë atë që është e shenjtë për ne²⁷. Presidenti Monson na këshilloi: “Po qe se rrënjët e dëshmisë tuaj nuk janë mbjellë me vendosmëri, do të jetë e vështirë për ju të përballonit talljet e atyre që vënë në dyshim besimin tuaj”²⁸. Nefi tha: “[Mos ua vini]



ndihemi të padenjë dhe shqetësohemi për të qenë të falur. Vrasim mendjen për një çështje doktrinale. Mësojmë për diçka të thënë në një katedër në Kishë 150 vite më parë, që na shqetëson. Fëmijët tanë trajtohen padrejtësisht. Neve na shpërfillin ose na nënvlerësojnë. Mund të jenë njëqind gjëra, secila shumë e vërtetë për ne në atë kohë.¹⁶

Në çastet tona të dobësisë, kundërshtari përpiket të vjedhë premtimet tona shpirtërore. Nëse nuk jemi syçelë, shpirti ynë i fyer, si një fëmijë, do të tërhiqet në guackën e ftohtë e të errët të unit tonë të mëparshëm të kapardisur, duke lënë pas dritën e ngrohtë e shëruese të Shpëtimtarit.

Kur Parli P. Prat, në 1835-ën, u gjykua padrejtësisht, duke i sjellë siklet dhe turp atij dhe familjes së tij, Profeti Jozef Smith këshilloi: “Parli, . . . mos u jep rëndësi gjërave të tilla . . . [dhe] Perëndia i Plotfuqishëm do të jetë me ty”¹⁷.

Një shembull tjetër: Në 1830, Frederik G. Uilliams, një mjek i mirënjohur, u pagëzua. Ai menjëherë ia dha Kishës talentet dhe begatinë e tij. Ai u bë një udhëheqës në Kishë. Ai dhuroi pronë për Tempullin e Kirtlandit. Në 1837-ën, i mbërthyer në vështirësitë e kohës, Frederik G. Uilliams bëri gabime serioze. Zoti deklaroi në një zbulësë se “si pasojë e shkeljeve të [tij], pozita e [tij] e mëparshme [në udhëheqjen e Kishës] i ishte hequr [atij]”¹⁸.

Mësimi i bukur që mësojmë nga Frederik G. Uilliams, është se “cilado qenë dobësitë e tij, ai pati forcën e karakterit që ta [përtërinte] besnikërinë e tij ndaj [Zotit], Profetit dhe . . . Kishës, kur do të kishte qenë kaq e lehtë ta linte veten të binte në hidhësi”¹⁹. Në pranverën e 1840-ës, ai u paraqit në një konferencë të përgjithshme, duke kërkuar falje përulësisht për sjelljen e tij të kaluar dhe duke shprehur vendosmërinë për të bërë vullnetin e Perëndisë në të ardhmen. Çështja e tij u paraqit nga Hajrëm Smithi dhe ai u fal lirisht. Ai vdiq si anëtar besnik i Kishës.

Kohët e fundit u takova me presidentin e Tempullit të Resifes në Brazil, emri i të cilit është Frederik G. Uilliams. Ai rrëfeu se si vendimi me karakter i stërstërgjyshit të tij, kishte bekuar familjen dhe qindra pasardhës të tij.

Zgjidhni të Mos Turpëroheni

Të qenit *i fyer* ka një shok gërryes që quhet të qenit *i turpëruar*.

Në Librin e Mormonit, ne mësojmë për vegimin e Lehit të pemës së jetës. Vegimi flet për ata shpirtira fisnikë që “shkuan përpara përmes mjegullës së errësirës, duke u mbajtur fort pas shufrës së hekurit”, derisa arritën dhe “hëngrën nga fruti i pemës”²⁰.

Nefi e përshkroi pemën si “dashuria e Perëndisë”²¹, që kishte fryt, i cili “mbushi shpirtin . . . me një gëzim jashtëzakonisht të madh”²².

Pasi provoi frutin, Lehi pa “një ndërtesë të gjerë dhe të madhe . . .



veshin”²⁹. Pali këshilloi: “Perëndia nuk na ka dhënë frymë frike, . . . Mos ki turp, . . . të dëshmosh Zotin tonë”³⁰. Ne kurrë nuk e lëmë Atë.

Kur po shoqëroja Presidentin Diter F. Uhtdorf në Europën Lindore vitin e kaluar, u mahnita me besimin dhe kurajën e shenjtoreve. Një udhëheqës priftërie në Ukrainë na tregoi se u thirr në presidencën e degës në pranverën e 1994-it, vetëm gjashtë muaj pas pagëzimit të tij. Kjo do të kërkonte ta bënte të njohur besimin e tij dhe të ndihmonte për regjistrimin e Kishës në qytetin e Dnipropetrovskit. Ishte një kohë pasigurie në Ukrainë dhe paraqitja hapur e besimit në Krisht dhe në ungjillin e rivendosur mund të nënkuptonte vështirësi, përfshirë mundësinë e humbjes së punës së tij si pilot.

Udhëheqësi i priftërisë na tha: “Unë u luta dhe u luta. Kisha një dëshmi dhe kisha bërë një besëlidhje. E dija se çfarë donte Zoti që të bëja.”³¹ Me kurajë, ai dhe bashkëshortja e tij shkuan përpara në besim, të paturpëruar për ungjillin e Jezu Krishtit.

Aty Ku Shumë Është Dhënë, Shumë Kërkohet

Disa pyesin: “A duhet të jem kaq i ndryshëm nga të tjerët?” “A nuk

mund të jem një dishepull i Krishtit pa menduar kaq shumë për sjelljen time?” “A nuk mund ta dua Krishtin pa mbajtur ligjin e dëlirësisë?” “A nuk mund ta dua Atë dhe të bëj çfarë dua të dielën?” Jezusi dha një përgjigje të thjeshtë: “Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia”³².

Disa pyesin: “A nuk ka shumë nga besimet e tjera që e duan Krishtin?” Sigurisht që ka! Megjithatë, si anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtoreve të Ditëve të Mëvonshme, duke pasur dëshmi për realitetin e Tij, jo vetëm nga Bibla, por gjithashtu nga Libri i Mormonit; duke e ditur se priftëria e Tij është rivendosur në tokë; pasi kemi bërë besëlidhje të shenjta që ta ndjekim Atë dhe kemi marrë dhuratën e Frymës së Shenjtë; pasi jemi pajisur me forcë në tempullin e Tij të shenjtë dhe duke qenë pjesë e përgatitjes për kthimin e Tij të lavdishëm në tokë; ne nuk mund të krahasojmë atë që duhet të jemi me ata që nuk i kanë marrë ende këto të vërteta. “Atij që shumë i është dhënë, shumë i kërkohet.”³³

Zoti ka thënë: “Ti mund të zgjedhësh vetë”³⁴.

Unë ju premtoj, ndërsa zgjidhni të mos fyheni ose turpëroheni, ju do

ta ndieni dashurinë dhe miratimin e Tij. Ju do ta dini se ju po bëheni më shumë si Ai.³⁵

A do të kuptojmë gjithçka? Natyrisht që jo. Do t’i lëmë disa çështje mënjanë, që t’i kuptojmë në një kohë të mëvonshme.

A do të jetë gjithçka e drejtë? Nuk do të jetë. Do t’i pranojmë disa gjëra që nuk mund t’i rregullojmë, dhe t’i falim të tjerët kur lëndohemi.

A do të ndihemi me raste të ndarë nga ata që janë rreth nesh? Absolutisht.

A do të habitemi nganjëherë kur shohim zemërimin që disa ndiejnë ndaj Kishës së Zotit dhe orvatjet e tyre për të shkatërruar besimin në përpjekje të të dobtëve?³⁶ Po. Por kjo nuk do ta frenojë rritjen ose fatin e Kishës, as nuk duhet të pengojë përparimin shpirtëror të secilit prej nesh si dishepull të Zotit, Jezu Krishtit.

Kurrë Mos e Lini Atë

Më pëlqejnë shumë fjalët e një himni të preferuar:

*Shpirtin që te Jezusi kërkon të pushoj’
armique në duar un’ kurr’ s’ua lëshoj’.
Megjith’së skëterra k’të shpirt t’mund
do doj’,
un’ kurrë, jo kurrë, un’kurrë, jo kurrë,
un’ kurrë, jo kurrë, jo kurrë s’e
harroj!*³⁷

Përsosja nuk vjen në këtë jetë, por ne ushtrojmë besim tek Zoti Jezu Krisht dhe i mbajmë besëlidhjet tona. Presidenti Monson ka premtuar: “Dëshmia juaj, kur ushqehet vazhdimisht, do t’ju mbajë të siguruar”³⁸. Ne i shtyjmë thellë rrënjët tona shpirtërore, duke u ushqyer me bollëk me fjalët e Krishtit në shkrimet e shenjta. Ne mirëbesojmë në fjalët e profetëve të gjallë, vendosur para nesh për të na treguar udhën. Ne lutemi e lutemi dhe dëgjojmë zërin e qetë të Frymës

së Shenjtë, që na udhëheq më tej dhe që i flet paqe shpirtit tonë. Çfarëdo sfidash të dalin, ne kurrë, kurrë nuk e lëmë Atë.

Shpëtimtari i pyeti Apostujt e Tij: “A doni edhe ju të largoheni?”³⁹

Pjetri u përgjigj:

“Zot, te kush të shkojmë? Ti ke fjalë jete të përjetshme.

. . . Ne kemi besuar dhe kemi njohur se ti je Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë”⁴⁰.

Unë gjithashtu e kam atë dëshmi. Unë dëshmoj kështu në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Marku 13:33.
2. Doktrina e Besëlidhje 46:8.
3. Doktrina e Besëlidhje 42:76.
4. 2 Pjetrit 3:17.
5. Gjoni 6:66.
6. Gjoni 6:67.
7. Mateu 26:22.
8. 3 Nefi 9:14.

9. Mateu 22:37.
10. Marku 8:34.
11. Mateu 18:3; shih edhe Marku 10:15; Lluka 18:17; 3 Nefi 9:22; 11:37–38.
12. Mosia 3:19.
13. Shih Alma 5:14.
14. Gjoni 6:61.
15. Mateu 13:21.
16. Shih David A. Bednar, “And Nothing Shall Offend Them”, *Liahona*, nëntor 2006, f. 89–92.
17. Joseph Smith, në *Autobiography of Parley P. Pratt*, red. Parley P. Pratt Jr. (1938), f. 118.
18. Në *History of the Church*, 3:46, poshtëshënim.
19. Frederick G. Williams, “Frederick Granger Williams of the First Presidency of the Church”, *BYU Studies*, vëll. 12, nr. 3 (1972):261.
20. 1 Nefi 8:24.
21. 1 Nefi 11:25.
22. 1 Nefi 8:12.
23. 1 Nefi 8:26–27; shih edhe vargun 33.
24. Shih 1 Nefi 11:35–36; 12:18–19.
25. 1 Nefi 8:33.
26. 1 Nefi 8:28; theksimi i shtuar.
27. Presidenti Bojd K. Paker tha: “Kryesisht

për shkak të televizionit [dhe të internetit], në vend që të shohim tek ajo ndërtesë e madhe, ne, në fakt, po jetojmë brenda saj” (“Finding Ourselves in Lehi’s Dream”, *Liahona*, gusht 2010, f. 29).

28. Në të njëjtën bisedë, Presidenti Tomas S. Monson tha: “Ndërtesa e gjerë dhe e madhe në vegimin e Lehit përfaqëson ata njerëz në botë që përqeshin fjalën e Perëndisë dhe që tallen me ata që e përqafojnë atë, dhe që e duan Shpëtimtarin, dhe jetojnë urdhërimet” (“Paçi Kurajë”, *Liahona*, maj 2009, f. 126).
29. 1 Nefi 8:33.
30. 2 Timoteut 1:7–8.
31. Nga bashkëbisedim personal dhe nga fragment i përkthyer nga një histori gojore nga Alexander Davydov, regjistruar më 16 korrik 2010.
32. Gjoni 14:15.
33. Doktrina e Besëlidhje 82:3.
34. Moisiu 3:17.
35. Shih 1 Nefi 19:9.
36. Shih 2 Nefi 28:20.
37. “Sa i Fortë Një Themel”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 6.
38. Tomas S. Monson, *Liahona*, maj 2009, f. 126.
39. Gjoni 6:67.
40. Gjoni 6:68–69.





Nga Plaku Riçard G. Skot,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Fuqia Shndërruese e Besimit dhe Karakteri

Një jetë e qëndrueshme dhe e drejtë prodhon një forcë dhe një fuqi të brendshme që mund të jenë përherë të qëndrueshme ndaj ndikimit gërryes të mëkatit dhe shkeljes.

Kur besimi kuptohet dhe përdoret siç duhet, ai ka efekte jashtëzakonisht të gjera. Një besim i tillë mund ta shndërrojë jetën e një individi nga aktivitete të përditshme, të zakonshme e sentimentalisht të cekëta në një simfoni gëzimi dhe lumturie. Ushtrimi i besimit është jetik për planin e lumturisë të Atit në Qiell. Por besimi i vërtetë, besimi tek shpëtimi, përqendrohet tek Zoti Jezu Krisht, besimi tek doktrinat dhe mësimet e Tij, besimi në udhëheqjen profetike të të vajosurit të Zotit, besimi në aftësinë për të zbuluar karakteristika dhe tipare të fshehura të vetes, që mund ta shndërrojë jetën. Vërtet, besimi tek Shpëtimtari është një parim veprimi dhe fuqie.

Besimi është një element themelor ndërtimi për krijimin. Kam besim se Shpëtimtari Jezu Krisht e përdor besimin në rolin e Tij për të vepruar nën drejtimin e Atit në Qiell. Mësuesi e përdori atë për të krijuar galaktikat më të largëta, po ashtu si për të krijuar kuarket, elementet më të vogla të materies, që njohim sot. Megjithatë, unë kam besim se ka elemente ndërtimi edhe më të vogla në mrekuillinë e krijimit.

Besimi në të ardhmen shfaqet nga një çift i vulosur në tempull. Ata e kuptojnë se duke iu bindur mësimëve të Jezu Krishtit dhe planit të lumturisë të Atit tonë në Qiell, mund të kenë një jetë të gëzueshme së bashku. Ata e kuptojnë se kur vijnë sfidat, që kanë për qëllim të jenë mundësi për rritje, ata do të gjejnë mënyra të frytshme dhe karakterformuese, siç nxiten nga Fryma e Shenjtë, për t'i kapërcyer ato.

Besimi dhe karakteri janë të lidhur ngushtë. Besimi në fuqinë e bindjes ndaj urdhërimeve të Perëndisë, do të farkëtojë forcën e karakterit të disponueshme për ju në kohët e nevojave urgjente. Një karakter i tillë nuk zhvillohet në momentet e sfidave dhe tundimeve të mëdha. Në ato momente ai synohet të përdoret. Ushtrimi prej jush i besimit në parimet e vërteta e ndërton karakterin; karakteri i forcuar e zgjeron aftësinë tuaj për të ushtruar më shumë besim. Si rezultat, aftësia dhe besimi juaj tek vetja për të kapërcyer sprovat e jetës, rriten. Sa më shumë forcohet karakteri juaj, aq më shumë aftësoheni ju për të përfituar nga ushtrimi i fuqisë së besimit. Ju do të zbuloni se si besimi dhe karakteri

ndërveprojnë për të forcuar njëri-tjetrin. Karakteri endet me durim nga fijet e parimeve, doktrinave dhe bindjes të zbatuara në jetë.

Presidenti Hug B. Braun ka thënë: “Kurdoherë në jetë që vlera të mëdha shpirtërore presin që njeriu t’i përvetësojë, vetëm besimi mund t’i përvetësojë ato. Njeriu nuk mund të jetojë pa besim, sepse në aventurën e jetës, problemi qendror është formimi i karakterit – që nuk është prodhim i logjikës, por i besimit në ideale dhe përkushtimit me flijim ndaj tyre” (në Conference Report, tetor 1969, f. 105). Ne e ushtrojmë besimin duke vepruar. Jozef Smithi tha se “besimi [është] parimi i veprimit dhe i fuqisë” (*Lectures on Faith* [1985], f. 72).

Ne *bëhemi* ajo çfarë dëshirojmë të *jemi*, duke *qenë* vazhdimisht ajo çfarë duam të *bëhemi* çdo ditë. Karakteri i drejtë është një shfaqje e çmuar e asaj që po bëheni. Karakteri i drejtë është më me vlerë se çfarëdo objekti material që zotëroni, çfarëdo njohurie që keni fituar nëpërmjet studimit, ose çfarëdo synimi që keni arritur, pavarësisht se sa lëvdohet nga njerëzimi. Në jetën tjetër, karakteri juaj i drejtë do të vlerësohet për të çmuar se sa mirë e keni përdorur privilegjin e vdekshmërisë.

As Satani as ndonjë fuqi tjetër nuk mund të dobësojë ose shkatërrojë karakterin tuaj në rritje. Vetëm ju mund ta bëni këtë me anë të mosbindjes. Një karakter i shkëlqyer kthehet në hi pa vlerë kur gërryhet nga mashtrimi ose shkelja.

Karakter i fortë moral vjen nga zgjedhjet e vazhdueshme të drejta në sprovat dhe provat e jetës. Zgjedhjet të tilla bëhen me besim në gjërat që besohen dhe që vërtetohen, kur vepron mbi to.

Cilat janë disa nga parimet fuqizuese mbi të cilat bazohet besimi?



- Mirëbesim në Perëndi dhe në gatishmërinë e Tij për të siguruar ndihmë kur është e nevojshme, pa varësisht sa sfiduese mund të jenë rrethanat.
- Bindje ndaj urdhërimeve të Tij dhe një jetë që tregon se Ai mund t'ju mirëbesojë juve.
- Ndjeshmëri ndaj nxitjes së qetë të Shpirtit.
- Zbatim me kurajë i asaj nxitjeje.
- Durim dhe kuptueshmëri kur Perëndia ju lë të mundoheni për t'u rritur dhe përgjigjet vijnë pak nga pak gjatë një periudhe të gjatë kohe.

“Besimi qëndron në gjërat që shpresohen dhe nuk shihen; prandaj mos dyshoni, sepse nuk shihni, pasi ju nuk do të merrni asnjë dëshmi, deri pas provës së besimit tuaj” (Ethëri 12:6). Kështu, çdo herë që ju provoni besimin tuaj – që domethënë, të veproni me denjësi sipas një përshtypjeje – ju do të merrni provën vërtetuese të Shpirtit. Kur veproni sipas kuptimit

më të mirë prej jush të gjërave, por ende jeni të pasigurt për atë që duhet të bëni, nëse ushtroni besim, do të drejtoheni të gjeni zgjidhje që nuk do të mund t'i kishit gjetur në asnjë mënyrë tjetër. Madje dhe me besimin tuaj më të fortë, Perëndia nuk do t'ju shpërblejë gjithmonë ju menjëherë sipas dëshirave tuaja. Përkundrazi, Perëndia do të përgjigjet me atë çfarë është më e mira për ju në planin e Tij të përjetshëm, kur të japë dobinë më të madhe. Jini mirënjohës që nga njëherë Perëndia ju lë të mundoheni për një kohë të gjatë përpara se ajo përgjigje të vijë. Kjo bën që besimi juaj të shtohet dhe karakteri juaj të rritet.

Themeli i karakterit është ndershmëria. Karakteri i denjë do ta forcojë aftësinë tuaj për të njohur drejtimin e Shpirtit dhe për të qenë i bindur ndaj tij. Ushtrimi juaj i vazhdueshëm i besimit ndërton karakter të fortë. Një themel i sigurt për karakterin tuaj në rritje hidhet duke i bërë Jezu Krishtin dhe mësimet e Tij, qendrën e jetës suaj.

Lumturia juaj në tokë, ashtu si dhe shpëtimi juaj i përjetshëm, kërkojnë shumë vendime të sakta, asnjëri prej të cilëve nuk është i vështirë për t'u marrë. Së bashku ato vendime do të farkëtojnë një karakter të qëndrueshëm ndaj ndikimeve gërryese të mëkatit dhe shkeljes. Karakteri fisnik është si një porcelan i çmuar, i përgatitur prej lëndëve të para të përzgjedhura, i formuar me besim, i punuar me kujdes nga veprime të drejta të vazhdueshme dhe i pjekur në furrën e përvojës lartësuese. Ai është një objekt me bukuri të madhe dhe vlerë tepër të çmuar. Përsëri, mund të dëmtohet në një çast me anë të shkeljes, duke kërkuar përpjekje të dhimbshme e të zgjatur që të rindërtohet. Kur mbrohet nga vetëkontrolli, karakteri i drejtë do të durojë në përjetësi.

Sendet materiale nuk prodhojnë në vetvete lumturi, kënaqësi dhe gëzimin e arritjes në tokë. As nuk na udhëheqin drejt ekzaltimit. Është fisnikëria e karakterit, ajo pëlhurë e forcës dhe e bindjes së brendshme, e endur nga vendime të drejta të panumërta, që i jep jetës drejtimin e saj. Një jetë e qëndrueshme dhe e drejtë prodhon një forcë dhe një fuqi të brendshme, që mund të jenë përherë të qëndrueshme ndaj ndikimit gërryës të mëkatit dhe shkeljes. Besimi juaj tek Jezu Krishti dhe bindja ndaj urdhërimeve të Tij do ta forcojnë karakterin tuaj. Karakteri juaj është një masë e asaj se çfarë po bëheni. Është treguesi se sa mirë po e përdorni ju kohën tuaj në tokë në këtë periudhë të provës në vdekshmëri.

Një aksiomë që e kuptojmë të gjithë, është që ju merrni atë për të cilën paguani. Kjo është e vërtetë edhe për çështjet shpirtërore. Ju do të merrni çfarë paguani me bindjen, me besimin në Jezu Krisht, me vënien në jetë me zell të të vërtetave që mësoni. Ajo çfarë merrni është formimi i karakterit,

rritja në aftësi dhe përmbushja me sukses e qëllimit tuaj në vdekshmëri që të provoheni dhe të keni gëzim.

Ju nuk mund të jeni pasivë në jetë, përndryshe, njeriu i natyrshëm do të minojë përpjekjet tuaja për të jetuar denjësisht. Ju bëheni ajo çfarë bëni dhe çfarë mendoni. Mungesa e karakterit e çon dikë që është nën tryzni të kënaqë orekset ose të kërkojë fitim personal. Nuk mund ta mbështesësh me sukses një karakter të dobët me mantelin e shtirjes.

Përfundimisht, dikush që merr vendime mbështetur tek rrethanat është pothuajse i sigurt që do të kryejë shkelje serioze. Nuk ka shufër hekuri të së vërtetës që ta mbajë atë person në udhën e drejtë. Ai ose ajo vazhdimisht do të përballet me shumë tundime delikate për të bërë shmangie nga urdhërimet. Ato zgjedhje justifikohen duke

argumentuar se nuk janë aq të këqia, se janë më të pranueshme shoqërisht dhe se sigurojnë një bazë më të gjerë miqsh. Një individ i mençur, pa parime themelore, nganjëherë mund të sigurojë arritje të përkohshme, mbresëlënëse. Përsëri, ajo arritje është si një kështjellë prej rëre. Kur vjen prova e karakterit, ajo thërrmohet, shpesh duke marrë arritje të tjera me vete. Pavarësisht se me sa kujdes një shkelës mundohet ta mbajë të fshehur dhunimin e urdhërimeve, me kohë, thujse gjithmonë ato bëhen të njohura publikisht. Satani vetë kujdeset për atë. Ai dhe puthadorasit e tij janë të vendosur t'i shkaktojnë dëmtimin më të madh të mundshëm secilit prej fëmijëve të Atit në Qiell. Një veprim serioz mosbindjeje ose dhunimi të mirëbesimit gjithmonë ngre pyetje nëse ka dhe të tjerë të tillë. Besimi

dhe mirëbesimi i njerëzve të tjerë tek karakteri i atij individi dëmtohet.

Kjo jetë në vdekshmëri është një vend testimi. Mënyra se sa mirë i përmbushni sfidat e saj përcakton se sa i fortë do të jetë karakteri juaj. Besimi juaj tek Jezu Krishti dhe mësimet e Tij e forcon karakterin tuaj.

E kam vërtetuar personalisht se koncepte të tilla si besim, lutje, dashuri dhe përlësi nuk përmbajnë domethënie të madhe dhe nuk prodhojnë mrekulli derisa të bëhen një pjesë e gjallë e jona përmes vetë përvojës sonë, ndihmuar nga nxitjet e ëmbla të Shpirtit të Shenjtë. Në fillim të jetës sime zbulova se mund t'i mësoja mendërisht mësimet e ungjillit, dhe, përmes fuqisë së arsyes dhe analizës, ta pranoja se ato kishin vlerë thelbësore. Por fuqia dhe aftësia e tyre e pamasë për të më shtrirë përtej kufijve të përfytyrimit dhe aftësisë sime nuk u bë realitet derisa praktika e vazhdueshme me durim të lejonte Shpirtin e Shenjtë ta pikonte dhe ta zgjeronte kuptimin e tyre në zemrën time. Zbulova se, ndërsa po u shërbeja sinqerisht të tjerëve, Perëndia farkëtoi karakterin tim personal. Ai shkaktoi një aftësi në rritje për të njohur drejtimin e Shpirtit. Gjenia e planit të ungjillit është se duke bërë ato gjëra që Zoti na këshillon të bëjmë, neve na jepet çdo kuptueshmëri dhe çdo aftësi e nevojshme për të siguruar paqe dhe përmbushje të pasur në këtë jetë. Po ashtu, ne fitojmë përgatitjen e nevojshme për lumturinë e përrjetshme në praninë e Zotit.

Një dëshmi forcohet me anë të mbresave shpirtërore që vërtetojnë vlefshmërinë e një mësimi, e një veprimi të drejtë. Shpesh një drejtim i tillë shoqërohet nga emocione të fuqishme që sjellin lot në sy dhe e vështirësojnë të folurin. Por dëshmia nuk është emocion. Është vetë thelbi i karakterit endur nga fije që prodhohen



nga vendime të sakta e të panumërta. Këto zgjedhje bëhen me mirëbesim në gjërat që besohen dhe, të paktën fillimisht, nuk shihen. Një dëshmi e fuqishme jep paqe, ngushëllim dhe sigurim. Ajo lind bindjen se, kur u bindemi vazhdimisht mësimëve të Shpëtimtarit, jeta do të jetë e bukur, e ardhmja e sigurt dhe do të kemi aftësinë për të kapërcyer sfidat që kryqëzohen me shtegun tonë. Një dëshmi rritet ngaqë kuptohet e vërteta, që vjen ngadalë prej lutjes dhe meditimit të doktrinës së shkrimeve të shenjta. Ajo ushqehet duke i jetuar ato të vërteta me besim të ankoruar në sigurinë se rezultatet e premtuara do të merren.

Dëshmia juaj do të bëhet e fortë nëpërmjet bindjes me gatishmëri ndaj ligjit të së dhjetës e duke dhënë oferta agjërimit dhe Zoti do t'ju bekojë me bollëk për atë. Ndërsa dëshmia juaj forcohet, Satani do të përpiqet më fort që t'ju tundojë. Rezistojini përpjekjeve të tij. Ju do të bëheni më i fortë dhe ndikimi i tij mbi ju, më i dobët.

Ndikimi në rritje i Satanit në botë lejohet që të sigurojë një mjedis në të cilin ta provojmë veten. Ndërsa ai sot shkakton rrënim, fati përfundimtar i Satanit u përcaktua nga Jezu Krishti nëpërmjet Shlyerjes dhe Ringjalljes së Tij. Djalli nuk do të triumfojë. Madje tani ai duhet të veprojë brenda kufijve të vendosur nga Zoti. Ai nuk mund ta marrë ndonjë bekim që është fituar. Ai nuk mund ta ndryshojë karakterin që është endur nga vendime të drejta. Ai nuk ka fuqi të shkatërrojë lidhjet e përjetshme të farkëtuara në një tempull të shenjtë midis një bashkëshorti, bashkëshortes dhe fëmijëve. Ai nuk mund ta shuajë besimin e vërtetë. Ai nuk mund ta marrë dëshminë tuaj. Po, këtë gjëra mund të humbasin prej dorëzimit ndaj tundimeve të tij. Por ai nuk ka fuqi në vetvete dhe prej vetvetes t'i shkatërrojë ato.



Dublin, Irlandë

Për ta përmbledhur:

- Perëndia përdor besimin tuaj për të formuar karakterin tuaj.
- Karakteri është manifestimi i asaj çfarë po bëheni.
- Karakteri i fortë rezulton nga zgjedhje të sakta të vazhdueshme.
- Themeli i karakterit është ndershmëria.
- Sa më shumë forcohet karakteri juaj, aq më shumë aftësoheni ju për të ushtruar fuqinë e besimit.


Përlësia është ajo cilësi që na lejon të marrim mësim nga lart nëpërmjet Shpirtit, ose të marrim mësim prej burimeve, origjina e të cilëve qe frymëzimi nga Zoti, të tilla si shkrimet e shenjta dhe komentet e profetëve. Përlësia është toka e çmuar, pjellore e karakterit të drejtë. Në të mbijnë farat e rritjes personale. Kur kultivohen nëpërmjet ushtrimit të besimit, krasiten me anë të pendimit dhe përforcohen me anë të bindjes dhe veprave të mira, fara të tilla prodhojnë frutin e dëshiruar të drejtimit shpirtëror. Fuqi dhe frymëzim hyjnor rezultojnë atëherë – frymëzim për të ditur vullnetin e Zotit, fuqi për të dhënë aftësinë që ta përmbushim atë vullnet të frymëzuar.

A më lejoni të ndaj katër parime që kanë sjellë ndjenjat më të thella të paqes dhe lumturisë në jetën time? Zoti ka vendosur këta gurë themeli në

planin e Tij të përjetshëm dhe secili është thelbësor. Të gjithë funksionojnë së bashku në harmoni dhe e përforcojnë njëri-tjetrin. Kur zbatohen me zell dhe vazhdimësi, ata prodhojnë forcë karakteri, aftësi në rritje për t'i shndërruar sfidat e jetës në mjete përparimi për lumturinë, tani dhe përgjithmonë. Ata janë:

- Besim tek Zoti Jezu Krisht dhe programi i Tij që të fitojmë fuqinë për të realizuar.
- Pendim për të korrigjuar pasojat e gabimeve prej moskryerjes ose kryerjes.
- Bindje ndaj urdhërimeve të Zotit për të siguruar forcë dhe drejtim në jetën tonë.
- Shërbim vetëmohues për të pasuruar jetën e të tjerëve.

Nëse keni vendosur të jetoni drejtësisht, mos u shkurajoni. Jeta mund të duket e vështirë tani, por mbahuni fort tek ajo shufër prej hekuri e së vërtetës. Ju po bëni përparim më të mirë nga sa e kuptoni. Betejat tuaja po përcaktojnë karakterin, disiplinën dhe mirëbesimin në premtimet e Atit tuaj në Qiell dhe të Shpëtimtarit, kur ju u bindeni vazhdimisht urdhërimeve të Tyre. Fryma e Shenjtë ju nxistë që të merrni vazhdimisht vendime, të cilat e forcojnë karakterin tuaj dhe prodhojnë shumë gëzim e lumturi. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku Rasëll M. Nelson,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Bëhu Shembull për Besimtarët

Qoftë nëse jemi misionarë kohëplotë apo anëtarë, ne të gjithë duhet të bëhemi shembuj të mirë të besimtarëve tek Jezu Krishti.

Vëllezërit e mi të dashur, këtë mbrëmje jemi mbledhur në shumë vende në mbarë botën. Misionarë të mrekullueshëm kohëplotë janë mes nesh. Do të dëshiroja t'i ftoja të gjithë misionarët kohëplotë që të ngriheshin në këmbë. Kudo që të jeni, pleq dhe presidenca misioni, ju lutem ngrihuni në këmbë. Ne jemi mirënjohës për secilin prej jush! Ne ju falënderojmë! Ne ju duam! Mund të uleni.

Herë pas here, na duhet t'i kujtojmë vetes se përse kemi misionarë. Kjo është për shkak të një urdhërimi nga Zoti, që tha:

“Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë,

dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar. Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës.”¹

Ky urdhërim është një prej të shumëve, që janë ripërtëritur për shkak se ungjilli i Jezu Krishtit është rivendosur në plotësinë e tij. Misionarët shërbejnë

tani njëjloj siç bënë në kohën e Dhia-tës së Re. Libri i Veprave të Apostujve përshkruan punët e hershme misionare të Apostujve dhe dishepujve të tjerë në vijim të shërbesës së Zotit në vdekshmëri. Atje lexojmë për kthimin e shquar në besim dhe pagëzimin e Saulit nga Tarsi², që më parë kishte qenë “duke shfryrë akoma kërcënime dhe kërdi kundër dishepujve të Zotit”³ dhe duke përndjekur anëtarë të një kishe të sapokrijuar. Nga fillime të tilla, Sauli u bë Pali i kthyer në besim, një nga misionarët më të mëdhenj të Zotit.

Okland, Zelanda e Re



15 kapitujt e fundit të librit të Veprave të Apostujve raportojnë veprat misionare të Palit dhe shokëve të tij.

Në një letër drejtuar njërit prej shokëve të tij më të besuar, Pali i shkroi Timoteut të ri: “Askush të mos e shpërfillë moshën tënde të re, por *bëhu shembull për besimtarët* në fjalë, në sjellje, në dashuri, në Frymë, në besim dhe dëlirësi”⁴. Kjo këshillë është po aq e vlefshme për ne tani sa qe atëherë. Ajo zbatohet për misionarët tanë kohëplotë; ajo zbatohet njëjloj për secilin anëtar të Kishës. Qoftë nëse jemi misionarë kohëplotë apo anëtarë, ne të gjithë duhet të bëhemi shembuj të mirë të besimtarëve tek Jezu Krishti.

Misionarët Kohëplotë

Misionarë kohëplotë, rreth 52.000 e më tepër, shërbejnë në 340 misione në mbarë botën. Ata janë besimtarë dhe shërbëtorë të përkushtuar të Zotit. Qëllimi i tyre është të “ftojnë të tjerët të vijnë tek Krishti duke i ndihmuar të marrin ungjillin e rivendosur me anë të besimit tek Jezu Krishti dhe Shlyerja e Tij, pendimit, pagëzimit, marrjes së dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe durimit deri në fund”⁵.

Ashtu si Timoteu, shumica e misionarëve kohëplotë janë të rinj. Disa janë motra, disa janë misionarë në moshë. Ne e duam secilin prej tyre!

Misionarët shërbejnë për ta bërë më të mirë jetën për fëmijët e Perëndisë. Ati Qiellor e do secilin prej fëmijëve të Tij. Sepse sigurisht, Ai është Ati i tyre. Ai dëshiron t'i bekojë ata me dhuratën e Tij më të madhe, atë të jetës së përjetshme⁶. Misionarët japin mësim kështu kudo që shërbejnë. Ata i ndihmojnë njerëzit të krijojnë besim në Zotin, të pendohen, të pagëzohen, të marrin Frymën e Shenjtë, të marrin ordinancat e tempullit dhe të durojnë besnikërisht deri në fund. Puna dhe lavdia e Perëndisë – “të bëj[ë] të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut”⁷ – është gjithashtu puna dhe lavdia e shenjtë e çdo misionari.

Ne na duhen më shumë misionarë – më shumë misionarë të denjë. Gjatë shërbesës së Tij tokësore, Zoti u tha dishepujve të Tij: “E korra është e madhe, kurse punëtorë janë pak; lutni Zotin e të korrës që të çojë punëtorë në të korrën e vet”⁸.

Në sesionin e këtij mëngjesi të konferencës së përgjithshme, Presidenti ynë i dashur, Tomas S. Monson, bëri një kërkesë të flaktë për çdo të ri të kësaj Kishe, që të përgatitet për shërbim misionar. Shpresoj që të gjithë këtij mesazhi, t’ia vënë veshin në çdo shtëpi të Kishës.

Këshillës së urtë të Presidentit Monson unë i shtoj dëshminë time. Në familjen time, kam vërejtur bekimet që i vijnë çdo misionari. Deri tani, numri i fëmijëve, nipërve e mbesave tona dhe bashkëshortëve e bashkëshorteve të tyre, të thirrur për të shërbyer si misionarë kohëplotë është 49 dhe ai numër do të vazhdojë të rritet. Në çdo rast, kam parë rritjen në urtësi, maturimin në gjykim dhe lulëzimin e besimit, që u zhvilluan tek secili misionar. Ata, ashtu si shumë breza përpara tyre, u nisën në shërbim të Perëndisë që “t’i shërbelj[në] atij me gjithë zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën [e tyre]”⁹.

Shërbimi misionar ka ndihmuar për t’i dhënë formë fatit të tyre hyjnor.

Misionarët Anëtarë

Këshilla e Palit: “Bëhu shembull për besimtarët”, zbatohet njëloj për anëtarët. Shumica nuk kanë qenë dhe ndoshta nuk do të jenë kurrë misionarë kohëplotë. Por të gjithë mund të jenë anëtarë misionarë. Ajo deklaratë më kujton tregimin për një ngjarje humoristike. Në një fushë të madhe loje në një qendër trajnimit misionar, u vendos një tabelë. Aty shkruhej: “Vetëm për misionarët!” Njerëzit, që gjithashtu dëshironin të luanin në atë fushë, vendosën një tabelë të re të tyre. Tabela e tyre shkruante: “Çdo Anëtar një Misionar!”

Çdo anëtar mund të jetë një shembull për besimtarët. Vëllezër, si pasues të Jezu Krishtit, secili prej jush mund të jetojë në përputhje me mësimet e Tij. Ju mund të keni “një zemër të kulluar dhe . . . duar të pastra”; ju mund të keni “shëmbëlltyrën e Perëndisë të gdhendur mbi pamjen tuaj”¹⁰. Veprat tuaja të mira do të jenë të dukshme për të tjerët¹¹. Drita e Zotit mund të ndriçojë në sytë tuaj¹². Me atë rrezatim, bëni mirë të përgatiteni se do t’ju bëjnë pyetje. Apostulli Pjetër këshilloi kështu: “Jini gjithnjë gati për t’u përgjigjur në mbrojtjen tuaj kujt do që ju kërkon shpjegime për shpresën që është në ju”¹³.

Përgjigjja juaj le të jetë e ngrohtë dhe e gëzueshme. Dhe përgjigjja juaj le të jetë e përshtatshme për atë individ. Kujtoni, ai ose ajo është gjithashtu një fëmijë e Perëndisë, e po atij Perëndie që dëshiron fort që ai person të kualifikohet për jetën e përjetshme dhe të kthehet tek Ai një ditë. Ju mund të jeni pikërisht ai, i cili do t’i hapë derën shpëtimit dhe kuptuesmërisë së doktrinës së Krishtit¹⁴ prej tij ose asaj.

Pas përgjigjes tuaj fillestare, bëhuni gati të ndërmerreni hapin tjetër. Ju mund ta ftoni mikun tuaj të vijë në kishë me ju. Shumë nga miqtë tanë nuk e dinë se janë të mirëpritur në ndërtesat tona kishtare. “Eja dhe shiko” qe ftesa e Shpëtimtarit drejtuar atyre që dëshironin të mësonin më shumë për Të¹⁵. Një ftesë për të marrë pjesë në një mbledhje të diele me ju, ose për të marrë pjesë në një aktivitet shoqëror ose shërbimi të Kishës, do të ndihmojë të davaritë mitet e gabuara dhe t’i bëjë vizitorët të ndihen më rehat mes nesh.

Si anëtar i Kishës, drejtoju atyre që nuk i njihni, dhe përshëndetini ngrohtësisht. Çdo të diel zgjatini një dorë shoqërimi të paktën një personi që nuk e njihnit më parë. Çdo ditë të jetës suaj, përpikuni fort ta zgjeroni vetë rrethin tuaj të miqësisë.

Ju mund ta ftoni një mik që të lexojë Librin e Mormonit. Shpjegoni se nuk është një roman apo libër historie. Ai është një dëshmi tjetër e Jezu Krishtit. Vetë qëllimi i tij është “për bindjen e Judenjve dhe Johebrenjve se Jezusi është Krishti, Perëndia i Amshuar, që ua shfaqti veten të gjitha kombeve”¹⁶. Ka një fuqi në këtë libër, e cila mund të prekë zemrën dhe të lartësojë jetën e kërkuesve të ndershëm të së vërtetës. Ftojani mikun tuaj ta lexojë librin plot lutje.

Profeti Jozef Smith tha “se Libri i Mormonit ishte më i sakti nga ndonjë libër mbi tokë dhe gurthemeli i besimit tonë, dhe se një njeri do t’i afrohet më shumë Perëndisë duke iu bindur porosive të tij, se nga ndonjë libër tjetër”¹⁷. Libri i Mormonit na mëson për Shlyerjen e Jezu Krishtit dhe është mjete me anë të së cilit Perëndia do të përmbushë premtimin e Tij të lashtë për të mbledhur Izraelin e shpërndarë në këto ditë të mëvonshme¹⁸.



Dublin, Irlandë

Shumë vite më parë, dy kolegë të mitë – një infermiere dhe bashkëshorti i saj mjek – më pyetën se përse jetoja ashtu si jetoja. U përgjigja: “Sepse e di që Libri i Mormonit është i vërtetë”. U dhashë hua kopjen time të librit, duke i ftuar që ta lexonin. Një javë më vonë, ata ma kthyen librin me një “shumë faleminderit” të sjellshme.

U përgjigja: “Çfarë do të thotë shumë faleminderit? Kjo është një përgjigje plotësisht e pavend për dikë që e ka lexuar këtë libër. Ju nuk e keni lexuar atë, apo jo! Ju lutem, merreni dhe lexojeni; atëherë ma ktheni përsëri.”

Duke pranuar se thjesht e kishin shfletuar, ata e pranuan ftesën time. Kur u kthyen, thanë plot lot: “Ne e kemi lexuar Librin e Mormonit. E dimë se është i vërtetë! Duam të dimë më shumë.” Ata mësuam më shumë dhe që privilegji im t’i pagëzoja që të dy ata.

Një tjetër mënyrë se si ju mund të ndani ungjillin, është të ftoni miqtë të takohen me misionarë kohëplotë në shtëpinë tuaj. Ata misionarë janë thirrur dhe përgatitur që të japin mësim ungjillin. Miqtë tuaj, në rehatinë e shtëpisë suaj dhe me sigurimin tuaj të vazhdueshëm, mund të fillojnë udhëtimin e tyre drejt shpëtimit dhe ekzaltimit. Zoti tha: “Ju jeni thirrur që të bëni të ndodhë mbledhja e të zgjedhurve të mi; sepse të zgjedhurit e mi e dëgjojnë zërin tim dhe nuk i ngurtësojnë zemrat e tyre”¹⁹.

Shkrimi i shenjtë na thotë se “ka shumë vetë akoma mbi tokë . . . të

cilët mbahen larg nga e vërteta vetëm ngaqë nuk dinë se ku ta gjejnë atë”²⁰. A nuk është kjo mundësia juaj? Ju mund të bëheni vetë dishepulli i tyre i zbulimit!

Tani në këtë kohë të internetit, ka mënyra të reja dhe emocionuese se si ju mund të bëni punë misionare. Ju mund të ftoni miq dhe fqinj që të vizitojnë faqen e re të internetit mormon.org. Nëse keni blogs [ditare në rrjet] dhe rrjete shoqërore në internet, ju mund t’i lidhni faqet tuaja me mormon.org. Dhe atje mund të krijoni vetë profilin tuaj personal. Çdo profil përfshin një shprehje të besimit, një përvojë dhe një dëshmi. Meqë është një mjet i ri, shumica e profileve janë të disponueshëm në anglisht. Profile në gjuhë të tjera do të vijnë.

Këto profile mund të kenë një ndikim të thellë për mirë. Dy muaj më parë, një i ri që quhej Zak – student i vitit të parë në fakultet – pa një reklamë për mormon.org në televizor në Baton-Ruzh të Luizianës. Ai u lidh me këndin në internet dhe u bë kureshtar nga profilet e anëtarëve të Kishës. Në faqen tonë gjeti hallkën lidhëse, që e informoi se ku mund të shkonte në kishë. Të dielën e ardhshme, i veshur me këmbë të bardha dhe kollare, ai mori pjesë në kishë, iu paraqit anëtarëve të lagjes dhe i shijoi të tri orët e mbledhjeve. Atë e ftuan në shtëpinë e një anëtarë për drekë, pasuar nga mësimi i tij i parë prej

misionarëve. Në më pak se dy javë, ai u pagëzua dhe u konfirmua si anëtar i Kishës²¹. Mirëseerdhe Zak! (Ai po dëgjon.)

Çdo ndjekës shembullor i Jezu Krishtit mund të bëhet një anëtar misionar efikas. Anëtarët dhe misionarët kohëplotë mund të punojnë krah për krah për t’ua sjellë bekimet e ungjillit miqve dhe fqinjëve të dashur. Shumë prej tyre janë të Izraelit, që tani po mbledhet siç është premtuar. E gjitha kjo është pjesë e përgatitjes për Ardhjen e Dytë të Zotit²². Ai dëshiron që secili prej nesh të jetë vërtetë një shembull për besimtarët.

Unë e di që Perëndia jeton. Jezusi është Krishti. Kjo është Kisha e Tij. Libri i Mormonit është i vërtetë. Jozef Smithi është përkthyesi i tij dhe profeti i kësaj periudhe ungjillore të fundit. Presidenti Tomas S. Monson është profeti i Perëndisë sot. Unë dëshmoj kështu, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Mateu 28:19–20.
2. Shih Veprat e Apostujve 9:3–18.
3. Veprat e Apostujve 9:1.
4. 1 Timoteut 4:12; theksimi i shtuar.
5. *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2004), f. 1.
6. Shih Doktrina e Besëlidhje 14:7.
7. Moisiu 1:39.
8. Lluca 10:2.
9. Doktrina e Besëlidhje 4:2.
10. Alma 5:19.
11. Shih Mateu 5:16; Alma 7:24.
12. Shih Doktrina e Besëlidhje 88:11.
13. 1 Pjetrit 3:15.
14. (Shih 2 Nefi 31:2, 21).
15. Gjon 1:39. Për këtë model, shih edhe Zbulesa 6:1, 3, 5, 7.
16. Faqja e titullit e Librit të Mormonit.
17. Parathënia për Librin e Mormonit.
18. Shih 3 Nefi 21:1–7. Vini re se këto shtatë vargje përbëjnë një fjali.
19. Doktrina e Besëlidhje 29:7.
20. Doktrina e Besëlidhje 123:12.
21. Komunikim personal nga William G. Woods, President i Louisiana Baton Rouge Mission.
22. Shih Malakia 4:5; 3 Nefi 25:5; Doktrina e Besëlidhje 2:1; 110:14–16; 128:17; 138:46; Joseph Smith – Historia 1:38.



Nga Plaku Patrik Kiëron,
i Të Shtatëdhjetëve

“Ejani tek Unë me Qëllim të Plotë të Zemrës, dhe Unë Do t’Ju Shërojmë”

Shpëtimtari ynë është Princi i Paqes, Shëruesi i Madh, i Vetmi që mund të na pastrojë vërtet nga thumbi i mëkatit.

Sonte dëshiroj të ndaj një mesazh ngushëllimi dhe shërimi me këdo prej jush që ndihet i vetmuar a i braktisur, që ka humbur paqen e mendjes a të zemrës ose që ndihet sikur ka hedhur tej mundësinë e tij të fundit. Shërimi i plotë dhe paqja mund të gjenden te këmbët e Shpëtimtarit.

Kur isha një djalë shtatëvjeçar e jetoja në Gadishullin Arabik, prindërit më thonin rregullisht t’i vishja gjithnjë këpucët, dhe unë e kuptoja përse. E dija që këpucët do të më mbronin këmbët nga kërcënimet e shumta që gjendeshin në shkretëtirë, si gjarpërinj, akrepa dhe gjemba. Një mëngjes, pas një kampimi nate në shkretëtirë, doja të dilja për eksplorim, por nuk doja të bezdisesha duke veshur këpucët. Arsyetova që po shkoja vetëm për pak shëtitje dhe do të qëndroja afër kampit. Kështu, në vend të këpucëve veshja pantofla. Thoja me vete se pantoflat këpucë

ishin – njëfarësoj. E çfarë do të mund të ndodhte vallë?

Ndërsa ecja nëpër rërën e freskët – me pantofla – ndjeva diçka si gjemb që u fut në harkun e shputës sime. Vështrova poshtë dhe pashë jo një gjemb, por një akrep. Ndërsa mendja ime fiksonte akrepin dhe unë kuptova atë që sapo kishte ndodhur, dhimbja e thumbimit nisi të ngjitej nga shputa deri lart këmbës. Shtrengova pjesën e sipërme të këmbës në përpjekje për të ndalur përhapjen e dhimbjes dhe thirra fort për ndihmë. Prindërit e mi erdhën nga kampi duke vrapuar.

Teksa babai goditi me një lopatë akrepin, një mik që po kamonte me ne, u përpoq heroikisht të thithte helmin nga këmba ime. Në atë çast mendova se unë do të vdisja. Rënkoja ndërsa prindërit më hipën në makinë e u lëshuan me shpejtësi të lartë nëpër shkretëtirë drejt spitalit më të afërt, i cili ishte mbi dy orë larg. Dhimbja

në gjithë gjatësinë e këmbës ishte torturuese dhe, gjatë gjithë asaj udhe, mendoja se unë po vdisja.

Kur më në fund mbërritëm në spital, doktori, megjithatë, mundi të na siguronte se vetëm fëmijët e vegjël dhe njerëzit fare të kequshqyer kërcënohen nga pickimi i atij lloj akrepi. Ai përdori një anesteziq, i cili e mpiu këmbën dhe ma largoi ndjesinë e dhimbjes. Brenda 24 orëve nuk pata më ndonjë ndikim nga thumbi i akrepit. Por kisha mësuar një mësim të fuqishëm.

E kuptova që, kur prindërit më thonin të vishja këpucë, nuk e kishin fjalën për pantofla; isha aq i rritur sa të dija se pantoflat nuk sigurojnë të njëjtën mbrojtje si këpucët. Por atë mëngjes në shkretëtirë, nuk mora parasysh atë që e dija se ishte e drejtë. Nuk mora parasysh atë që prindërit më kishin mësuar vazhdimisht. U tregova edhe përtac, edhe paksa rebel, dhe pagova një çmim për këtë.

Ndërsa ju flas ju të rinjve guximtarë, etërve, mësuesve dhe miqve tuaj, i shpreh respektin gjithkujt që po përpiqet me zell që të bëhet ashtu siç i nevojiteni e siç ju dëshiron Zoti. Por dëshmoj nga vetë përvoja ime e djalërisë dhe si burrë se mospërfillja e asaj që ne dimë se është e drejtë, qoftë nga përtacia apo mosbindja, sjell gjithmonë pasoja të padëshirueshme dhe shpirtërisht dëmtuese. Jo, tek e fundit, akrepi nuk e kërcënoi jetën time, por shkaktoi dhimbje e ankth të jashtëzakonshëm si për mua, edhe për prindërit e mi. Kur vjen puna tek mënyra se si e jetojmë ne ungjillin, nuk duhet të reagojmë me dembelizëm ose me mosbindje.

Si anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit e si mbajtës të priftërisë ne i dimë urdhërimet dhe standardet për të cilat kemi besëlidhur t’i përkrahim. Kur ne zgjedhim shteg tjetër nga ai që dimë se është i drejtë, siç na e mësojnë

prindërit dhe udhëheqësit tanë dhe siç na pohohet nga Fryma e Shenjtë në zemrën tonë, është si të shkelësh rërën e shkretëtirës me pantofla në vend të këpucëve. Atëherë, kërkojmë të shfaqësojmë sjelljen tonë përtaçe ose rebele. I themi vetes se vërtet nuk po bëjmë asgjë aq të gabuar, se kjo nuk ka shumë rëndësi dhe se askurrgjë aq e keqe nuk do të rrjedhë duke u larguar vetëm për pak nga shufra e hekurt. Ndoshta ngushëllojmë veten me mendimin se kushdo tjetër po vepron ashtu – ose po vepron më keq – dhe neve gjithsesi nuk do të na prekë negativisht. E bindim disi veten që ne bëjmë përjashtim nga rregulli dhe, prandaj, jemi të paprekshëm nga pasojat e thyerjes së tij. Ne refuzojmë, ndonjëherë qëllimisht, të jemi “përpikërisht të bindur”¹ – siç thuhet te libri *Predikoni Ungjillin Tim* – dhe një pjesë të zemrës sonë nuk ia japim Zotit. Dhe atëherë thumbohemi.

Shkrimet e shenjta na mësojnë se “Zoti *kërkon zemrën*”² dhe ne urdhërohem ta duam Zotin e t’i shërbejmë me “*gjithë zemrën [tonë]*”³. Premtimi është që ne “[mund të qëndrojmë] të pafaj përpara Perëndisë në ditën e fundit” e të rikthehemi në praninë e Tij⁴.

Anti-Nefi-Lehitët, te Libri i Mormonit, i gpropoën armët e tyre të luftës thellë në tokë, duke besëlidhur që të mos i merrnin më kurrë armët kundër vëllezërve të tyre. Por bënë më shumë se kaq. “Ata u bënë një popull i drejtë”, sepse “ata ulën armët e *rebelimit* të tyre dhe nuk luftuan më kundër Perëndisë”⁵. Kthimi i tyre në besim që aq i plotë e aq i thellë, sa që ata “nuk hoqën dorë kurrë nga besimi i tyre”⁶.

Por, përpara kthimit të tyre në besim, kujtoni gjendjen e tyre: ata jetonin në atë që shkrimet e shenjta e quajnë “rebelim të hapur kundër Perëndisë”⁷. Zemrat e tyre rebele i kishin dënuar të jetonin “në një gjendje të kundërt nga

natyra e lumturisë”, ngaqë ata kishin “vajtur në udhën e kundërt nga ajo e natyrës së Perëndisë”⁸.

Kur ulën armët e tyre të *rebelimit*, ata u bënë të pranueshëm për shërimin dhe paqen e Zotit, e ashtu mundim dhe ne. Shpëtimtari garanton: “Nëse ata nuk i ngurtësojnë zemrat e tyre dhe nuk i forcojnë kokat e tyre kundër meje, ata do të kthehen në besim dhe *unë do t’i shëroj*”⁹. Ju dhe unë mund ta pranojmë ftesën e Tij: të “[ktheheni e pendoheni dhe të vini] tek unë me qëllim të plotë të zemrës, dhe unë do [t’ju] shëroj”¹⁰.

Krahasojeni këtë shërim të mrekullueshëm me atë që ndodh “kur

përpiqemi t’i mbulojmë mëkatet tona ose të kënaqim krenarinë tonë [apo] ambicien tonë të kotë. . . . Qiejt tërhiqen; Shpirti i Zotit hidhërohet”; dhe ne lihemi të vetëm “për të goditur me shkelm gjembat . . . dhe për të luftuar kundër Perëndisë”¹¹.

Vëllezër, ne gjejmë shërim dhe lehtësim vetëm kur sjellim vetveten te këmbët e Mjekut të Madh, Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Duhet të ulim armët e rebelimit (e secili nga ne e di se cilat janë ato). Duhet të braktisim mëkatin, kotësinë dhe krenarinë tonë. Duhet të heqim dorë nga dëshirat e ndjekjes së botës dhe të respektojeve e lëvdatave nga bota. Duhet të





pushojmë së luftuari kundër Perëndisë dhe, në vend të kësaj, t'ia japim Atij të gjithë zemrën, pa i mbajtur asgjë. Atëherë Ai mundet të na shërojë. Atëherë Ai mundet të na pastrojë nga thumbi helmues i mëkatit.

“Sepse Perëndia nuk e dërgoi Birin e vet në botë që ta dënojë botën, por që bota të shpëtohet prej tij”¹².

Presidenti Xhejms E. Faust na mësoi:

“Kur bindja bëhet qëllimi ynë, ajo nuk është më një ngacmim; në vend të një guri pengese, ajo bëhet gur ndërtimi. . . .

. . . Bindja çon drejt lirisë së vërtetë. Sa më shumë t'i bindemi së vërtetës së zbuluar, aq më të çliruar bëhemi”¹³.

Javën e kaluar u takova me një burrë 92-vjeçar i cili kishte marrë pjesë në shumë nga fushatat më të mëdha të Luftës së Dytë Botërore. Ai u pati mbijetuar tre plagosjeve, një nga të cilat qe nga shpërthimi i një mine tokësore ndaj makinës me të cilën po udhëtonte, i cili vrau shoferin. *Ai mësoi se, që të mbijetosh në fushën e minuar, duhen ndjekur me përpikëri gjurmët e lëna nga makina që shkon para jush.* Çdo shmangie djathtas apo majtas mundet – dhe, në fakt, arriti – të rezultojë fatale.

Profetët dhe apostujt tanë, udhëheqësit dhe prindërit vazhdimisht vënë në dukje udhën që duhet të

ndjekim, nëse duam të shmangnim një shpërthim shkatërrues për shpirtin tonë. Ata e dinë shtegun që ka qenë spastruar i sigurt nga minat (apo, në të vërtetë, nga akrepat) dhe pa u lodhur na ftojnë që të ecim pas tyre. Ka aq shumë gracka shkatërrimtare për të na tërhequr ne nga udha. Endja pas drogave, alkoolit, pornografisë ose sjelljes imorale në internet apo në lojërë elektronike, do të na prijë drejt-përdrejt në një shpërthim. Shmangia në të djathtë a në të majtë të udhës së sigurt para nesh, qoftë për shkak të përtacisë ose të mosbindjes, mund të rezultojë fatale për jetën tonë shpirtërore. Nuk ka përjashtime ndaj këtij rregulli.

Nëse jemi shmangur nga udha, ne mund të ndryshojmë, ne mund të rikthehemi e mund të rimarrim gëzimin tonë dhe paqen tonë të brendshme. Do të zbulojmë se rikthimi tek udha së cilës i janë hequr minat tokësore, sjell lehtësim të pamasë.

Asnjë nuk mund të gjejë paqe në një fushë të minuar.


Shpëtimtari ynë është Princi i Paqes, Shëruesi i Madh, i Vetmi që mund të na pastrojë vërtet nga thumbi i mëkatit dhe helmi i krenarisë e ta kthejë zemrën tonë të pabindur në zemër besëlidhjeje e të kthyer në besim. Shlyerja e Tij është e pafundme dhe na përfshin të gjithëve.

Ftesa që iu bë neftëve, kur Ai kreu shërbesë për ta si Krishti i ringjallur, është ende në fuqi për ju dhe për mua: “A ka mes jush ndonjë që është i sëmurë? Silleni këtu. A ka ndonjë që është i çalë ose i verbër, ose i gjymtë, ose sakat, ose i lebrësuar, ose i deformuar, ose i shurdhër, ose i prekur në ndonjë mënyrë? I sillni këtu *dhe unë do t'i shëroj ata*”¹⁴.

Asnjë prej jush nuk e ka hedhur tej mundësinë e tij të fundit. Ju mund të ndryshoni, ju mund të ktheheni, ju mund të pretendoni mëshirë. Ejani tek i Vetmi i cili mund të shërojë dhe ju do të gjeni paqe. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2004), ana e brendshme e kapakut të prapmë.
2. Doktrina e Besëlidhjet 64:34; kursivet janë theksime.
3. Doktrina e Besëlidhjet 4:2; 59:5; kursivet janë theksime.
4. Doktrina e Besëlidhje 4:2.
5. Alma 23:7; kursivet janë theksime.
6. Alma 23:6.
7. Mosia 2:37; Alma 3:18; shih edhe Mormoni 2:15.
8. Alma 41:11.
9. Doktrina e Besëlidhjet 112:13; kursivet janë theksime.
10. 3 Nefi 18:32.
11. Doktrina e Besëlidhje 121:37, 38.
12. Gjoni 3:17
13. James E. Faust, “Obedience: The Path to Freedom”, *Liahona*, korrik 1999, f. 55, 53; *Ensign*, maj 1999, f. 47, 45.
14. 3 Nefi 17:7; kursivet janë theksime.



Nga Plaku Huan A. Uceda,
i Të Shtatëdhjetëve

Ai Na Mëson ta Zhveshim Njeriun e Natyrshëm

*Unë jap dëshmi të realitetit dhe fuqisë së Shlyerjes së
Shpëtimtarit për të na pastruar, kthjelluar dhe për të na
bërë të shenjtë ne dhe shtëpitë tona.*

Një mëngjes, një familje u mblodh të studioje shkrimet e shenjta si zakonisht. Kur u mblodhën, babai ndjeu një atmosferë negative: disa anëtarë të familjes nuk dukeshin shumë të emocionuar për të marrë pjesë. Ata bënë lutjen familjare dhe, kur filluan të lexonin shkrimet e shenjta, babai vuri re se një nga fëmijët nuk e kishte kompletin e saj personal të shkrimeve të shenjta me vete. Ai e ftoi atë të shkonte në dhomën e saj dhe të sillte shkrimet e shenjta. Ajo e bëri këtë pa dëshirë dhe pas një copë here që u duk si përjetësi, ajo u kthye, u ul dhe tha: “A na duhet vërtet ta bëjmë këtë tani?”

Babai mendoi me vete se armiku i të gjithë drejtësisë dëshironte të krijonte probleme kështu që ata të mos studionin shkrimet e shenjta. Babai, duke u përpjekur të qëndronte i qetë, tha: “Po, ne duhet ta bëjmë këtë tani; sepse kjo është ajo që do Zoti që të bëjmë”.

Ajo u përgjigj: “Unë vërtet nuk dëshiroj ta bëj këtë tani!”

Atëherë babai e humbi durimin, ngriti zërin dhe tha: “Kjo është shtëpia ime dhe ne gjithmonë do t'i lexojmë shkrimet e shenjta në shtëpinë time!”

Toni dhe lartësia e zërit të tij e lënduan të bijën dhe, me shkrimet e saj në dorë, ajo u largua nga rrethi familjar, vrapoi për në dhomën e saj të gjumit dhe përplasi derën. Kjo i dha fund studimit familjar të shkrimit të shenjtë – nuk kishte harmoni dhe pak dashuri po ndihej në shtëpi.

Babai e dinte se kishte vepruar gabim, kështu që ai shkoi në dhomën e vet të gjumit dhe u gjuhëzua për t'u lutur. Ai iu përgjërta Zotit për ndihmë, duke e ditur se kishte fyer një nga fëmijët e Tij, një bijë që ai e donte vërtet. Ai iu lut fort Zotit që të përtërinte shpirtin e dashurisë dhe harmonisë në shtëpi dhe t'u jepte mundësi që të ishin të aftë të vazhdonin studimin e shkrimeve të shenjta si familje. Ndërsa po lutej, një ide i erdhi në mendje:

“Shko dhe thuaj: ‘Më vjen keq.’” Ai vazhdoi të lutej me zell, duke kërkuar që Shpirti i Zotit të kthehej në shtëpinë e tij. Edhe një herë i erdhi ideja: “Shko dhe thuaj: ‘Më vjen keq.’”

Ai vërtet dëshironte të ishte një baba i mirë dhe të bënte gjënë e duhur, kështu që u ngrit dhe shkoi në dhomën e gjumit të së bijës. Butësisht, trokiti disa herë në derë dhe nuk pati përgjigje. Kështu, e hapi ngadalë derën dhe e gjeti vajzën duke dënesur e duke qarë në shtrat. Ai u gjuhëzua pranë saj dhe tha me një zë të butë e të ëmbël: “Më vjen keq. Kërkoj falje për atë që bëra.” Ai përsëriti: “Më vjen keq, unë të dua dhe nuk dua të të lëndoj”. Dhe atëherë, nga goja e një fëmije doli mësimi që Zoti donte t'i mësonte atij.

Ajo pushoi së qari dhe, pas një heshtjeje të shkurtër, mori në duar shkrimet e saj të shenjta dhe filloi të kërkonte disa vargje. Babai vështroi ndërsa ato duar të dëlira dhe delikate kthyen faqet e shkrimeve të shenjta, faqe pas faqeje. Ajo arriti tek vargjet që po kërkonte, dhe filloi të lexonte shumë ngadalë, me një zë të butë: “Pasi njeriu i natyrshëm është një armik ndaj Perëndisë dhe ka qenë që nga rënia e Adamit dhe do të jetë gjithmonë e përgjithmonë, nëse ai nuk dëgjon thirrjet e Frymës së Shenjtë dhe nuk zhvesh njeriun e natyrshëm dhe nuk bëhet një shenjtor nëpërmjet shlyerjes së Krishtit Zot, dhe nuk bëhet si një fëmijë, i nënshtruar, i bindur, i përlulur, i duruar, plot me dashuri, i gatshëm t'u nënshtrohet të gjitha gjërave që Zoti i sheh të përshtatshme të shkaktojë mbi të, madje sikurse një fëmijë i nënshtrohet atit të tij”¹.

Ndërsa qe ende i gjuhëzuar pranë shtratit të saj, ai u ndie plot përlulësi ndërsa mendoi me vete: “Ai shkrim i shenjtë ishte shkruar për mua. Ajo më dha një mësim të shkëlqyer”.



Atëherë ajo i ktheu sytë nga ai dhe tha: “Më vjen keq. Më vjen keq, Babi”.

Pikërisht në atë çast babai e kuptoi se ajo nuk e lexoi atë varg për ta zbatuar shkrimin e shenjtë për të, por e lexoi duke e zbatuar për veten. Ai hapi krahët dhe e përqafoi. Dashuria dhe harmonia u rivendosën në atë çast të ëmbël pajtimi, që erdhi nga fjala e Perëndisë dhe Fryma e Shenjtë. Ai shkrim i shenjtë, që bija e tij e mbante mend nga studimi i vet personal i shkrimit të shenjtë, e kishte prekur zemrën e tij me zjarrin e Frymës së Shenjtë.

Vëllezërit e mi të dashur, shtëpitë tona duhet të jetë vende ku Shpirti i Shenjtë të mund të banojë. “Vetëm shtëpia mund të krahasohet me tempullin në shenjtëri.”² Nuk ka vend për njeriun e natyrshëm në shtëpitë tona. Njeriu i natyrshëm është i prirur që “t’i mbulojë [e] mëkatet [e tij] ose të kënaq [e] krenarinë [e tij], ambicien [e tij] të kotë ose të ushtroj [e] kontroll apo sundim, apo detyrim mbi shpirtat e fëmijëve të njerëzve [dhe kur ai vepron] në çfarëdo shkallë padrejtësie, vini re, qiejt tërhiqen; Shpirti i Zotit hidhërohet; dhe kur ai tërhiqet, Amen

priftërisë ose autoritetit të atij njeriu”³.

Ne, që mbajmë priftërinë Aarone ose Melkizedeke duhet ta kujtojmë gjithmonë se “asnjë fuqi apo ndikim nuk mund ose nuk duhet të mbahet me anë të priftërisë, veçse nëpërmjet bindjes, nëpërmjet durimit, nëpërmjet mirësjelljes e zemërbutësisë dhe nëpërmjet dashurisë së pashtirur; nëpërmjet mirësisë dhe diturisë së pastër, të cilat do ta zgjerojnë shumë shpirtin, pa hipokrizi dhe pa mashtrim”⁴.

Grindja largohet nga shtëpitë dhe jeta jonë kur përpiqemi fort t’i jetojmë këto tipare si të Krishtit. “Dhe ju duhet t’ia falni shkeljet njëri-tjetrit; pasi në të vërtetë unë ju them juve, ai që nuk i fal shkeljet e fqinjit të tij, kur ai thotë se pendohet, po ai vetë ka çuar veten e tij në dënim.”⁵ “Më vjen keq. Më vjen keq, Babi.”

Zoti Jezu Krisht, që është Princi i Paqes, na mëson se si të vendosim paqe në shtëpitë tona.

Ai na mëson të jemi të nënshtruar, ose me fjalë të tjera, t’i jepemi vullnetit ose fuqisë së Zotit. “Shko dhe thuaj: ‘Më vjen keq.’”

Ai na mëson të jemi të bindur, ose me fjalë të tjera, të jemi “të butë nga

karakteri; pa acarim; të ëmbël; që nuk provokohemi ose nxehemi lehtë; të epueshëm; të dhënë pas vetëpërmbytjes para padrejtësive”⁶.

Ai na mëson të jemi të përlur, ose me fjalë të tjera “të përlur, të thjeshtë; të bindur; të nënshtruar; e kundërta e *krenarisë, kryelartësisë, arrogancës, ose krekosjes*”⁷.

“Më vjen keq. Kërkoj falje për atë që bëra.”

Ai na mëson të jemi të duruar, ose me fjalë të tjera, “të kemi cilësinë e durimit të të ligave pa murmuritur ose pa grindje” ose “të qetë kur durojmë padrejtësi apo fyerje”⁸.

Ai na mëson të jemi plot me dashuri. “Unë të dua dhe nuk dua të të lëndoj.”

Po, Vëllezërit e mi të dashur, Ai na mëson ta zhveshim njeriun e natyrshëm, ashtu si babai në këtë ndodhi, që iu përgjyera Zotit për ndihmë. Po, tamam ashtu si babai e përqafoi të bijën në krahët e dashurisë së tij, po ashtu Shpëtimtari i shtrin krahët që të na përqafojë ne gjatë kohës së pëndimit tonë të vërtetë.

Ai na mëson të bëhemi “shenjtore nëpërmjet shlyerjes së Krishtit Zot”.

Dhe atëherë ne do të pajtohemi me Perëndinë dhe do të bëhemi miq të Perëndisë. Unë jap dëshmi të realitetit dhe fuqisë së Shlyerjes së Shpëtimtarit për të na pastruar, kthjelluar dhe për të na bërë të shenjtë ne dhe shtëpitë tona, kur përpiqemi fort ta zhveshim njeriun e natyrshëm dhe ta ndjekim Atë.

Ai është “Qengji i Perëndisë”⁹, Ai është i “Shenjtë, [i] Drejtë”¹⁰ “dhe do të quhet Këshilltar i admirueshëm, Perëndi i fuqishëm, Atë i përjetshëm, Princ i paqes”¹¹. Në emrin e Zotit Jezu Krisht, amen. ■

SHËNIME

1. Mosia 3:19.
2. Bible Dictionary, “Temple”.
3. Doktrina e Besëlidhje 121:37.
4. Doktrina e Besëlidhje 121:41–42.
5. Mosia 26:31.
6. *Noah Webster's First Edition of an American Dictionary of the English Language*, bot. 9-të (1996), “meek”.
7. *Noah Webster's First Edition*, “humble”.
8. *Noah Webster's First Edition*, “patient”.
9. Gjoni 1:29.
10. Veprat e Apostujve 3:14, Version i Ri Ndërkombëtar.
11. Isaia 9:6.



Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf

Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Krenaria dhe Priftëria

Krenaria është një çelës që e largon fuqinë e priftërisë. Përrulësia është një çelës që e sjell atë.

Të dashur vëllezër të mi, ju falemi-nderit që jeni mbledhur nga gjithë bota për këtë seancë të priftërisë në konferencën e përgjithshme. Prania juaj tregon angazhimin tuaj që të qëndroni, kudo që jeni, me vëllezërit tuaj që mbajnë priftërinë e shenjtë, dhe të shërbeni, dhe të nderoni Zotin e Shëlbuesin tuaj, Jezu Krishtin.

Shpesh ne e masim jetën tonë me ngjarje që lënë gjurmë në mendjen dhe në zemrën tonë. Ka shumë ngjarje të tilla në jetën time, një nga të cilat ndodhi në 1989 kur unë dëgjova një predikim të rëndësishëm për çdo kohë nga Presidenti Ezra Taft Benson: “Kujdes nga Krenaria”. Te hyrja shënohej se kjo çështje pati rënduar shumë në shpirtin e Presidentit Benson për një kohë të gjatë¹.

Unë kam ndier një barrë të ngjashme gjatë muajve të fundit. Nxitjet e Shpirtit të Shenjtë më kanë nxitur të shtoj zërin tim si një dëshmitar tjetër i mesazhit të Presidentit Benson dhënë 21 vite më parë.

Çdo i vdekshëm ka njëfarë përvoje me mëkatën e krenarisë. Askush nuk e ka mënjanuar atë; pak njerëz e kanë mposhtur. Kur i tregova bashkëshortes time se kjo do të ishte tema e bisedës, ajo buzëqeshi dhe tha: “Është aq mirë që do të flasësh mbi gjëra për të cilat ti di aq shumë”.

Kuptime të Tjera të Krenarisë


Unë gjithashtu kujtoj një efekt anësor interesant të bisedës shumë ndikuese të Presidentit Benson. Për njëfarë kohe thuajse u bë tabu midis anëtarëve të Kishës të thoshin se ata ishin “krenarë” për fëmijët e tyre apo vendin e tyre apo se ndienin “krenari” nga puna e tyre. Vetë fjala *krenari* dukej të ish bërë përjashtim nga fjalori ynë.

Në shkrimet e shenjta ne gjejmë mjaft shembuj njerëzish të mirë dhe të drejtë që gëzohen në drejtësi dhe në të njëjtën kohë krenohen në mirësinë e Perëndisë. Ati ynë Qiellor Vetë e paraqiti Birin e Tij të Dashur me fjalët: “Në të cilin unë jam shumë i kënaqur”².

Alma u krenua me mendimin se ai mund të “[jetë] një mjet në duart e Perëndisë”³. Apostulli Pal u krenua me besnikërinë e anëtarëve të Kishës.⁴ Misionari i madh Amoni u krenua me suksesin që ai dhe vëllezërit e tij përjetuan si misionarë.⁵

Unë besoj se ka një ndryshim midis të qenit krenar për disa gjëra dhe të qenit krenar. Unë jam krenar për shumë gjëra. Unë jam krenar për bashkëshorten time. Unë jam krenar për fëmijët dhe nipërit e mbesat tona.

Unë jam krenar për rininë e Kishës dhe unë kënaqem nga mirësia e tyre.



Unë jam krenar për ju, vëllezërit e mi të dashur e besnikë. Unë jam krenar të qëndroj krah për krah me ju si mbajtës i priftërisë së shenjtë të Perëndisë.

Krenaria Është Mëkati i Vetëvlerësimit

Pra, cili është ndryshimi midis kësaj lloj krenarie dhe asaj që Presidenti Benson e quajti: “mëkati i përgjithshëm”?⁶ Krenaria është mëkat, siç Presidenti Benson na mësoi në mënyrë aq mbresëlënëse, sepse ajo krijon urrejtje apo armiqësi dhe na vendos në kundërshtim me Perëndinë dhe me njerëzit tanë. Në thelbin e vet, krenaria është një mëkat krahasimi, sepse edhe pse zakonisht fillon me: “Shih sa i mrekullueshëm jam dhe çfarë gjëra madhështore kam bërë”, ajo gjithnjë duket se mbaron me: “Prandaj, unë jam më i mirë se ty”.

Kur zemrat tona janë mbushur me krenari, ne bëjmë një mëkat të rëndë, sepse ne shkelim dy urdhërimet e mëdha.⁷ Në vend që të adhurojmë Perëndinë dhe të duam fqinjin tonë, ne zbulojmë objektin e vërtetë të adhurimit dhe të dashurisë sonë – shëmbëlltërinë që ne shohim te pasqyra.

Krenaria është mëkati i madh i vetëvlerësimit. Ajo është për aq shumë njerëz një Rameumpton, një podium i shenjtë që justifikon zilinë, lakminë dhe kotësinë.⁸ Në një kuptim, krenaria

është mëkati fillestar, sepse përpara krijimit të kësaj toke, krenaria rrëzoi Luciferin, një bir i mëngjesit “që ishte në autoritet në praninë e Perëndisë”.⁹ Nëse krenaria mund të korruptojë dikë aq të aftë dhe premtues sa ky, a nuk duhet t’i kontrollojmë ne shpirtrat tanë gjithashtu?

Krenaria Ka Shumë Pamje

Krenaria është një kancer vdekjeprurës. Ajo është një mëkat që të bën bartës dobësisht të tjera njerëzore. Në fakt, mund të thuhet se çdo mëkat tjetër është, në thelb, një manifestim krenarie.

Ky mëkat ka shumë fytyra. Ai i bën disa njerëz që t’i gëzohen perceptimit vetjak të vlerës, arritjeve, talenteve, pasurisë apo pozitës së vetë. Ata i numërojnë këto bekime si fakte të të qenit “i zgjedhur”, “superior” apo “më i drejtë” se të tjerët. Ky është mëkati: “Falë Zotit unë jam më i veçantë se ju”. Si thelb i tij është dëshira për të qenë i admiruar apo i lakmueshëm. Ai është mëkati i vetëlavdërimit.

Për të tjerë, krenaria kthehet në zili: ata shohin hidhësisht ata që kanë pozita më të mira, më shumë talente apo kamje më të mëdha sesa ata. Ata kërkojnë të dëmtojnë, të zvogëlojnë dhe të shembin të tjerët në një përpjekje të gabuar dhe pa vlerë për ngritjen e vetes. Kur njerëzit që ata kanë zili pengohen apo vuajnë, ata fshehtazi ngazëllehën.

Laboratori i Sporteve

Ndoshta nuk ka laborator më të mirë për të vëzhguar mëkatin e krenarisë sesa bota e sporteve. Unë gjithnjë kam pëlqyer të marr pjesë në ngjarje sportive dhe t’i ndjek ato. Por unë pranoj ka raste kur mungesa e mirësjelljes në sporte është sikletosëse. Si ndodh që qenie njerëzore normalisht të sjellshme dhe të dhembshme

mund të jenë kaq intolerante dhe të mbushura me urrejtje ndaj skuadrës kundërshtarë dhe tifozëve të saj?

Unë kam vërejtur tifozë sporti të shpifin kundër rivalëve të tyre dhe t’i demonizojnë. Ata kërkojnë ndonjë cen dhe e zmadhojnë atë. Ata e justifikojnë urrejtjen e tyre me përgjithësime të gjera dhe ua veshin ato cilitdo që lidhet me njërin apo tjetrin skuadër. Kur fati i keq pikëllon rivalin e tyre, ata gëzohen.

Vëllezër, fatkeqësisht ne shohim sot tepër shpesh të njëjtin lloj qëndrimi dhe sjellje përhapur në fjalime publike të politikës, të etnicitetit dhe të fesë.

Vëllezër të mi të dashur të priftërisë, shokë të mi dishepuj të dashur të Krishtit të mirë, a nuk duhet ta mbajmë ne veten në një standard më të lartë? Si mbajtës të priftërisë, ne duhet të kuptojmë se të gjithë fëmijët e Perëndisë mbajnë ngjyrat e së njëjtës skuadër. Skuadra jonë është vëllazëria e njeriut. Kjo jetë e vdekshme është fusha jonë e lojës. Objektivi ynë është të mësojmë të duam Perëndinë dhe ta shtrijmë të njëjtën dashuri ndaj bashkënjërvëzëve tanë. Ne jemi këtu për të jetuar sipas ligjit të Tij dhe të krijojmë mbretërinë e Perëndisë. Ne jemi këtu të ndërtojmë, të ngremë, të trajtojmë drejtësisht dhe të nxisim të gjithë fëmijët e Atit Qiellor.

Ne Nuk Duhet të Gëlltisim

Kur u thirra si Autoritet i Përgjithshëm, unë u bekova të jem nën kujdestarinë e shumë prej Vëllezërve në Kishë. Një ditë unë pata rastin ta çoj Presidentin Xhejms E. Faust me makinë në një konferencë kunji. Gjatë orëve që kaluam në makinë, Presidenti Faust përfitoi nga koha të më mësonite disa parime të rëndësishme mbi emërimin tim. Ai shpjegoi gjithashtu sa bujarë janë anëtarët e Kishës, veçanërisht ndaj Autoriteteve të Përgjithshme.

Ai tha: “Ata do të të trajtojnë ty shumë njerëzisht. Ata do të thonë gjëra të këndshme rreth jush”. Ai qeshi pak dhe pastaj tha: “Diter, ji mirënjohës për këtë. Por mos e gëlltit kurrë”.

Ai është një mësim i mirë për të gjithë ne, vëllezër, në çfarëdo thirrje apo situatë në jetë. Ne mund të jemi mirënjohës për shëndetin, bollëkun, kamjen, apo pozitën tonë, por kur ne fillojmë ta gëlltisim atë – kur ne bëhemi të pushtuar nga gjendja jonë; kur ne përqendrohemi në rëndësinë, pushtetin apo famën tonë; kur ne rrojmë me atë që mendojnë të tjerët për ne, dhe besojmë në atë që thonë të tjerët për ne, – ky është çasti kur shqetësimi fillon; ky është çasti kur krenaria fillon të korruptojë.

Ka plot paralajmërime mbi krenarinë në shkrimet e shenjta: “Nga krenaria rrjedhin vetëm grindjet, por dituria është me ata që u kushtojnë kujdes këshillave”¹⁰.

Apostulli Pjetër paralajmëroi që “Perëndia i kundërshton krenarët, por u jep hir të përlurur”¹¹. Mormoni shpjegoi: “Askush nuk pranohet para Perëndisë, në qoftë se nuk është i bindur dhe i përlurur në zemër”¹². Me qëllim Zoti zgjedh “gjërat e dobëta të botës për të turpëruar të fortët”¹³. Zoti e bën këtë për të treguar se dora e Tij është në punën e Tij, që ne të mos “besojmë në krahun e mishit”¹⁴.

Ne jemi shërbëtorë të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Neve nuk na është dhënë priftëria për të marrë nderime dhe për t’u ngrohur nga lëvdatat. Ne jemi këtu që të përveshim mëngët dhe të shkojmë në punë. Ne jemi renditur në një detyrë aspak të rëndomtë. Ne jemi thirrur të përgatisim botën për ardhjen e Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Ne nuk kërkojmë nderim vetjak por ia japim lavdërimin dhe lavdinë Perëndisë. Ne e dimë se kontributi që mund të japim



nga vetja, është i vogël; gjithsesi, kur ushtrojmë fuqinë e priftërisë në drejtësi, Perëndia mund të bëjë që një punë e madhe dhe e mrekullueshme të vijë nga përpjekjet tona. Ne duhet të mësojmë, siç bëri Moisiu, që “njeriu është një hiç”¹⁵ nga vetja e tij por që “për Perëndinë çdo gjë është e mundur”¹⁶.

Jezu Krishti Është Shembulli i Përkryer i Shërbimit

Këtu, si në çdo gjë, Jezu Krishti është shembulli ynë i përsosur. Ndërsa Luciferi u përpoq të ndryshonte planin e Atit për shpëtimin dhe të fitonte nderim për veten, Shpëtimtari tha: “Atë, vullneti yt u bëftë dhe lavdia qoftë e jotja përgjithmonë”¹⁷. Megjithë aftësitë dhe arritjet e Tij të mrekullueshme,

Shpëtimtari ishte gjithmonë i butë dhe i përlurur.

Vëllezër, ne mbajmë “Priftëri[në] e Shenjtë, sipas Urdhërit të Birit të Perëndisë”¹⁸. Ajo është fuqia që Perëndia u ka dhënë burrave mbi tokë për të vepruar për Të. Me qëllim që të ushtrojmë fuqinë e Tij, ne duhet të përpiqemi të jemi si Shpëtimtari. Kjo do të thotë që në të gjitha gjërat ne përpiqemi të bëjmë vullnetin e Atit, pikërisht si Shpëtimtari.¹⁹ Kjo do të thotë se ne ia japim të gjithë lavdinë Atit, pikërisht si Shpëtimtari.²⁰ Kjo do të thotë se ne e humbasim veten në shërbim të të tjerëve, pikërisht si Shpëtimtari.

Krenaria është një çelës që e largon fuqinë e priftërisë.²¹ Përlësia është një çelës që e sjell atë.

Ji i Përlurur dhe Plot Dashuri

Pra, si e mposhtim ne këtë mëkat të krenarisë që është kaq mbizotërues dhe kaq i dëmshëm? Si bëhemi më të përlurur?


Është thujse e pamundur të ngrihemi në krenari kur zemrat tona janë të mbushura me dashuri. “Dhe askush s’mund të ndihmojë në këtë punë, nëse nuk do të jetë i përlurur dhe plot dashuri.”²² Kur e shohim botën përreth nesh nën ndikimin e dashurisë së pastër të Krishtit, ne fillojmë të kuptojmë përlësinë.

Disa supozojnë se përlësia është të ndihemi fajtorë. Përlësia nuk do të thotë të bindim veten se jemi fajtorë, të pakuptimtë, apo me vlerë të paktë. As do të thotë që të mohojmë apo të fshehim talentet që Perëndia na ka dhënë neve. Ne nuk tregojmë përlësi duke menduar keq për vetveten; ne tregojmë përlësi duke menduar pak për vetveten. Kjo ndodh kur ne e kryejmë punën tonë me një qëndrim shërbimi ndaj Perëndisë dhe bashkë-njerëzve tanë.

Përlësia na e drejton vëmendjen dhe dashurinë te të tjerët dhe te qëllimet e Atit Qiellor. Krenaria bën të kundërtën. Krenaria e merr energjinë dhe forcën e saj nga burimet e thella të egoizmit. Në çastin kur ne pushojmë së marruri me vetveten dhe e humbasim atë në shërbim, krenaria jonë pakësohet dhe fillon të mbarojë.

Të dashur vëllezër të mi, ka aq shumë njerëz në nevojë për të cilët ne mund të mendojmë në vend të vetvetes. Dhe ju lutem mos harroni kurrë familjen tuaj, bashkëshorten tuaj. Ka aq shumë mënyra që ne mund të gjendemi në shërbim. Ne nuk kemi kohë të bëhemi të humbur në vetvete.

Unë pata dikur një penë që më pëlqente ta përdorja gjatë karrierës



sime si një kapiten aeroplani pasagjerësh. Thjesht duke kthyer boshtin, unë mund të zgjidhja një nga katër ngjyrat. Pena nuk ankohej kur unë doja të përdorja bojën e kuqe në vend të blusë. Ajo nuk më tha asnjëherë: “Unë më mirë nuk do të shkruaj pas orës 10:00 pasdite, në mjegull të dendur apo në lartësi të mëdha”. Pena nuk tha: “Më përdor vetëm për dokumenta të rëndësishme, jo për detyra të përditshme të rëndomta”. Me besueshmërinë më të madhe ajo kreu çdo detyrë që pata nevojë, pavarësisht sa e rëndësishme apo e parëndësishme. Ajo ishte gjithnjë gati të shërbente.

Në një mënyrë të ngjashme ne jemi vegla në duart e Perëndisë. Kur zemra jonë është në vendin e duhur, ne nuk ankohemi se detyra që na është caktuar është e padenjë për aftësitë tona. Ne shërbejmë me gëzim kudo që na kërkohet. Kur e bëjmë këtë, Zoti mund të na përdorë neve në mënyra që e kapërcejnë kuptimin tonë për të përmbushur punën e Tij.

Më lejoni të përfundoj me fjalët e mesazhit të frymëzuar të Presidentit Ezra Taft Benson të 21 viteve përpara:

“Krenaria është blloku i madh pengues për në Sion.

Ne duhet ta fillojmë me veten duke mposhtur krenarinë.” . . .²³

“Ne duhet të dëgjojmë ‘thirrjet e Frymës së Shenjtë’, të largojmë ‘njeriun e natyrshëm’, të bëhemi ‘një shenjtor nëpërmjet shlyerjes së Krishtit Zot’, dhe të bëhemi ‘si një fëmijë, i nënshtruar, i bindur, i përlurur’. . . .²⁴

Perëndia dëshiron të ketë një popull të përlurur . . . ‘Të bekuar janë ata që e përlulin veten pa qenë të detyruar të përlulen.’ . . .²⁵

Le të zgjedhim të jemi të përlurur. Ne mund ta bëjmë këtë. Unë e di që ne mundemi.”²⁶

Të dashur vëllezër të mi, le të ndjekim shembullin e Shpëtimtarit tonë dhe të shkojmë të shërbejmë më mirë se të kërkojmë lavdërim dhe nderim nga njerëzit. Kjo është lutja ime, që ne do të njohim dhe çrrënjosisim krenarinë e padrejtë nga zemrat tona dhe që ne do ta zëvendësojmë atë me “drejtësinë, perëndishmërinë, besimin, dashurinë, zemërgjerësinë dhe zemërbutësinë”²⁷. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Ezra Taft Benson, “Beware of Pride”, *Ensign*, maj 1989, f. 4.
2. 3 Nefi 11:7.
3. Alma 29:9.
4. Shih 2 Thesalonikasve 1:4.
5. Shih Alma 26.
6. Ezra Taft Benson, *Ensign*, maj 1989, f. 6.
7. Shih Mateu 22:36–40.
8. Shih Alma 31:21.
9. Doktrina e Besëlidhje 76:25.
10. Fjalët e Urta 13:10.
11. 1 Pjetrit 5:5.
12. Moroni 7:44.
13. (1 Korintasve 1:27.
14. Doktrina e Besëlidhje 1:19.
15. Moisiu 1:10.
16. Mateu 19:26.
17. Shih Moisiu 4:1–2.
18. Doktrina e Besëlidhje 107:1.
19. Shih Gjoni 8:28–29.
20. Shih Gjoni 17:4.
21. Shih Doktrina e Besëlidhje 121:34–37.
22. Doktrina e Besëlidhje 12:8.
23. Shih Alma 6:2–4; Mateu 23:25–26.
24. Mosia 3:19; shih gjithashtu Alma 13:28.
25. Alma 32:16.
26. Ezra Taft Benson, *Ensign*, maj 1989, f. 6–7.
27. 1 Timoteut 6:11.



Nga Presidenti Henri B. Ajring
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Shërbeni me Shpirtin

Le të bëjmë çfarëdo gjë që kërkohet, që të cilësohemi për Frymën e Shenjtë si shoqëruesin tonë.

Jam mirënjohës për këtë mundësi që të jem bashkë me ju, që jeni nderuar nga Perëndia të mbani priftërinë. Ne jemi thirrur të përdorim fuqi hyjnore për t'u shërbyer fëmijëve të Atit tonë Qiellor. Mënyra se sa mirë do ta plotësojmë atë detyrim, do të ketë pasoja të përjetshme për ata që jemi thirrur t'u shërbejmë, për ne dhe për brezat, që nuk kanë lindur ende.

I kujtoj me nderim të madh dy mbajtës priftërie, të cilët ishin kualifikuar që Shpirti i Perëndisë të shkonte me ta, në misionin ku Zoti i kishte thirrur. Ata vetë e kishin gjetur ungjillin e rivendosur në Amerikë. Ata qenë shërbëtorët e Zotit që u folën së pari për atë ungjill, dy prej paraardhësve të mi evropianë.

Një prej atyre paraardhësve qe një vajzë e re, që jetonte në një fermë të vogël në Zvicër. Një tjetër qe një i ri, jetim dhe emigrant në Shtetet e Bashkuara nga Gjermania, që jetonte në Sent-Luis të Misurit.

Që të dy ata dëgjuan nga një mbajtës priftërie të dëshmonte për ungjillin e rivendosur – për vajzën pranë vatrës së shtëpisë së saj të vogël në Zvicër dhe për djalin duke ndenjur në ballkonin e një salle të marrë me qira në Amerikë. Që të dy ata e dinin me anë të Shpirtit se mesazhi që ata misionarë u sollën atyre, qe i vërtetë.

Djali dhe vajza zgjodhën të pagëzoheshin. Të dy ata u takuan për herë të parë në shtegun plot pluhur vite më vonë, duke përshkuar qindra kilometra për tek malet e Amerikës Perëndimore. Ata biseduan ndërsa ecnin së bashku. Ajo për çfarë biseduan ata ishte bekimi i mrekullueshëm që, mes të gjithë botës, shërbëtorët e Perëndisë i kishin gjetur ata dhe, ende më e mrekullueshme, që ata e dinin se mesazhi i tyre ishte i vërtetë.

Ata ranë në dashuri dhe u martuan. Dhe për shkak të dëshmisë së Shpirtit, që filloi kur dëgjuan fjalët e mbajtësve të priftërisë në ndikimin e Frymës së Shenjtë, ata u vulosën për përjetësinë nga fuqia e priftërisë. Unë jam një prej dhjetëra mijëra pasardhësve të atij djali dhe asaj vajze, të cilët bekojnë emrat e dy mbajtësve të priftërisë, që i sollën me vete shërbesat e Shpirtit të Perëndisë, kur ngjitën kodrën në Zvicër e u ngritën të flisnin në atë mbledhje në Sent-Luis.

Ajo ndodhi e lumtur, dhe miliona të tjera si ajo, janë përsëritur dhe do të përsëriten në mbarë botën nëpër breza. Për disa do të jetë ndodhia e një mësuesi shtëpie të ri, që tha fjalë të cilat ngjallën një dëshirë tek gjyshi juaj që të kthehej në Kishë. Për disa do të jenë fjalët e ngushëllimit dhe bekimit nga një patriark, që i dhanë

kurajë nënës tuaj kur tragjedia thajse e tronditi atë.

Do të ketë një temë të përbashkët në të gjitha ato ndodhi. Ajo do të jetë e fuqisë së priftërisë në një mbajtës, fuqia e të cilit për të shërbyer u lartësua nga Fryma e Shenjtë.

Dhe kështu, mesazhi im për ne sonte është: le të bëjmë çfarëdo gjë që kërkohet që të cilësohemi për Frymën e Shenjtë si shoqëruesin tonë dhe le të shkojmë përpara pa frikë, kështu që të na jepen fuqitë për të bërë çfarëdo gjë që Zoti na thërret të bëjmë. Ajo rritje në fuqinë për të shërbyer mund të vijë ngadalë, mund të vijë me hapa të vegjël, që është e vështirë t'i shihni, por do të vijë.

Sonte, do të bëj disa sugjerime mbi kualifikimin për të marrë Frymën e Shenjtë si shoqërues në shërbimin tuaj të priftërisë. Pastaj, do të jap disa shembuj të shërbimit të priftërisë, në të cilat ju mund të prisni që të shihni fuqitë tuaja për të shërbyer të forcuara nga ndikimi i Shpirtit.

Tani, ne të gjithë e dimë se konfirmimi në Kishë na dha dhuratën e Frymës së Shenjtë. Por shoqërimi i Frymës së Shenjtë, shfaqjet e saj në jetën dhe shërbimin tonë, kërkojnë që të jetojmë denjësisht që të kualifikohemi.

Ne kultivojmë dhunti frymore duke mbajtur urdhërimet dhe duke u përpjekur të jetojmë një jetë të pamëkatë. Kjo kërkon besim tek Jezu Krishti për t'u penduar dhe për t'u pastruar nëpërmjet Shlyerjes së Tij. Kështu, si mbajtës të priftërisë, ne asnjëherë nuk duhet të humbasim një mundësi për të marrë pjesë me gjithë zemrën tonë, në premtimin e ofruar në çdo mbledhje sakramenti për anëtarët e Kishës së rivendosur që "të marrin mbi vete emrin e Birit [të Perëndisë] dhe gjithmonë ta kujtojnë atë e të zbatojnë urdhërimet që ai u ka dhënë atyre, që të mund të kenë gjithmonë Shpirtin e tij me ta"¹.



Dublin, Irlandë

Pikërisht siç duhet të pastrohemi nga mëkati që ta kemi Shpirtin me ne, duhet të përulemi aq shumë përpara Perëndisë sa të kuptojmë nevojën tonë për të. Dishepujt e Shpëtimtarit të ringjallur e shfaqën atë përlësi, siç shënohet në Librin e Mormonit.

Shpëtimtari po i përgatiste për shërbesën e tyre. Ata u gjunjëzuan në tokë që të luteshin. Këtu është rrëfimi: “Dhe ata u lutën për atë gjë që dëshironin më shumë; dhe ata dëshironin që t’u jepej Fryma e Shenjtë”². Ata u pagëzuan ashtu si dhe ju. Dhe rrëfimi thotë se, në përgjigje të përgjërimit të tyre, ata u mbushën me Frymën e Shenjtë dhe me zjarr.

Shpëtimtari u lut me zë të lartë për të falënderuar Atin e Tij, që ua dha Frymën e Shenjtë atyre, të cilët Ai i kishte zgjedhur për shkak të besimit të tyre tek Ai. Dhe pastaj Shpëtimtari u lut për një bekim shpirtëror mbi njerëzit, të cilëve ata po u shërbenin. Zoti iu përgjërua Atit të Tij: “Të lutem që t’u japësh Frymën e Shenjtë të gjithë atyre që besojnë në fjalët e tyre”³.

Si shërbëtorët e përlur të Shpëtimtarit, ne duhet të lutemi që shfaqjet e Frymës së Shenjtë të na vijnë neve në shërbimin tonë dhe atyre që u shërbejmë. Lutja e përlur për Atin tonë Qiellor, me besim të thellë tek Jezu Krishti, është thelbësore për të na kualifikuar për shoqërimin e Frymës së Shenjtë.

Përlësia jonë dhe besimi ynë, që ftojnë dhuratat shpirtërore, rriten me

anë të leximit, studimit dhe përsiatjes të shkrimeve të shenjta. Ne të gjithë i kemi dëgjuar këto fjalë. Prapëseprapë, ne mund të lexojmë pak rreshta ose faqe të shkrimit të shenjtë çdo ditë dhe shpresojmë se kjo do të mjaftojë.

Por leximi, studimi dhe përsiatja nuk janë e njëjta gjë. Ne lexojmë fjalë dhe mund të marrim ide. Ne studiojmë dhe mund të zbulojmë modele ose lidhje në shkrimin e shenjtë. Por kur përsiatemi, ne ftojmë zbulësia nga Shpirti. Përsiatja, për mua, është mendimi dhe lutja që bëj, pasi i lexoj e i studioj me kujdes shkrimet e shenjta.

Për mua, Presidenti Jozef F. Smith dha një shembull se si përsiatja mund të ftojë dritën nga Perëndia. Ai tregohet në seksionin e 138-të të Doktrinës e Besëlidhjeve. Ai kishte qenë duke lexuar e studiuar shumë shkrime të shenjta, duke u përpjekur të kuptonte se si pasojat e Shlyerjes së Shpëtimtarit do të ndihmonin ata që kishin vdekur pa e dëgjuar kurrë mesazhin e Tij. Këtu është tregimi se si erdhi zbulësia: “Ndërsa përsiatja për këto gjëra që janë shkruar, sytë e të kuptuarit tim u hapën dhe Shpirti i Zotit pushoi në mua e unë pashë ushtritë e të vdekurve, si të mëdhenj, edhe të vegjël”⁴.

Pendimi, lutja dhe përsiatja mbi shkrimet e shenjta janë pjesë thelbësore e kualifikimit tonë për dhuratat e Shpirtit në shërbimin tonë të priftërisë. Lartësimi i mëtejshëm i fuqisë sonë për të shërbyer, do të vijë kur ne përgjigjemi me besim për të shkuar

përpara në thirrjet tona, me Frymën e Shenjtë që të na ndihmojë.

Presidenti Tomas S. Monson e shprehu kështu për ne: “Çfarë do të thotë të lartësosh thirrjen [tënde]? Do të thotë t’ia ngresh dinjitetin . . . ta zgjerosh e ta forcosh atë, që të lejosh dritën e qiellit të shkëlqejë përmes saj, që ta shohin njerëzit e tjerë. Dhe si e lartëson dikush një thirrje? Thjesht duke kryer shërbimin që i përket asaj.”⁵

Do të sugjeroj dy shërbime në të cilat jemi thirrur të gjithë. Duke i kryer nën ndikimin e Shpirtit, ju dhe të tjerët do ta shihni fuqinë tuaj për të shërbyer të forcohet dhe të lartësohet.

I pari është që, si veprues të Tij, t’u japim mësim dhe t’u dëshmojmë të tjerëve për Të. Zoti përfshiu më të rinjtë dhe më pak të sprovuarit nga mbajtësit e priftërisë Aarone për të shërbyer në atë thirrje. Pasi përshkroi detyrat e mbajtësve të priftërisë Aarone, Ai tha:

“Por as mësuesit, as dhjakët nuk kanë autoritet të pagëzojnë, të administrojnë sakramentin apo të vënë duart;

Ata, megjithatë, duhet të paralajmërojnë, të sqarojnë, të këshillojnë e të japin mësim dhe t’i ftojnë të gjithë të vijnë te Krishti.”⁶

Diku në botë këtë javë, do të ketë një dhjak, të cilit presidenti i kuorumit të tij do t’i kërkojë të ftojë një anëtar të kuorumit të tyre në një mbledhje, ku atë nuk e kanë parë kurrë të marrë pjesë. Presidenti 13-vjeçar nuk ka gjasa t’i përdorë fjalët “[paralajmëro, këshillo e jep] mësim” por kjo është çfarë pret Zoti nga dhjaku i caktuar që të shkojë për shpëtim.

Dhjaku që merr thirrjen për të shkuar tek anëtar i kuorumit të tij, unë do t’i bëj tre premtime. Së pari, kur luteni për ndihmë, Shpirti do ta qetësojë frikën tuaj. Së dyti, ju do të habiteni që do të dini se çfarë të thoni kur të shkoni në shtëpinë e tij

dhe gjatë rrugës bashkë me të për t'u kthyer në kishë. Ajo çfarë thoni mund t'ju duket absurde. Por do ta ndieni se fjalët ju janë dhënë juve në çastin kur ju duheshin. Dhe, së treti, ju do të ndieni miratimin e Zotit që ju thirri, nëpërmjet presidentit tuaj, pavarësisht nga rezultati.

Nuk mund të premtoj se çfarë suksesi do të vijë, përderisa çdo person është i lirë të zgjedhë se si ai ose ajo do t'i përgjigjet një shërbëtori të Perëndisë. Por dhjaku, të cilit i flisni në emër të Zotit, do ta kujtojë se erdhët tek ai. Njoh një djalosh, tashmë një burrë, ende tepër larg të qenit aktiv në Kishë, tek i cili u dërgua një dhjak që ta gjente dhe i cili i tregoi gjyshit të tij për atë vizitë njëzet vite më parë. Dukej se nuk pati efekt dhe përsëri, ai madje përmendi emrin e dhjakut që erdhi. Gjyshi më kërkoi ta gjeja dhe falënderoja dhjakun që u thirr të paralajmërojë, të këshillojë dhe të japë

mësim. Ishte vetëm një ditë në jetën e një djaloshi, por një gjysh dhe Zoti i kujtojnë fjalët që djali u frymëzua të thoshte dhe emrin e djalit.

Unë i nxis të gjithë ne, të rinj e të moshuar, që jemi thirrur të flasim në një mbledhje në emrin e Zotit, t'i largojmë ndjenjat tona të dyshimit tek vetja dhe të pamjaftueshmërisë. Nuk na duhet të përdorim fjalor të ngritur apo të përçojmë kuptime të thella. Fjalë të thjeshta dëshmie do të mjaftojnë. Shpirti do t'ju japë fjalët që të thoni, dhe do t'i çojë ato në zemrat e njerëzve të përulur, që kërkojnë të vërtetën nga Perëndia. Nëse do të vazhdojmë të përpiqemi të flasim për Zotin, do të çuditemi një ditë kur të mësojmë se ne kemi paralajmëruar, këshilluar, dhënë mësim dhe ftuar me ndihmën e Shpirtit për të bekuar jetë, me shumë më tepër rezultat se nga çfarëdo fuqi vetëm e jona.

Përveç thirrjes për të dhënë mësim, të gjithë ne do të dërgohemi nga Zoti për të ndihmuar ata në nevojë. Ai është një tjetër shërbim priftërie në të cilin ne do të ndiejmë ndikimin e Shpirtit të rrisë fuqinë tonë për të shërbyer. Ju do ta gjeni veten më të aftë për të dalluar dhimbjen dhe shqetësimin në fytyrën e njerëzve. Emra ose fytyra të njerëzve në kuorumin tuaj, do t'ju vijnë në mendje me përshtypjen se ata janë në nevojë.

Peshkopëve u vjen ajo ndjenjë gjatë natës dhe çdo herë që ulen në panel, duke vështruar anëtarët e lagjes së tyre ose duke menduar për ata që nuk janë aty. Mund t'ju ndodhë kur e gjejnë veten pranë një spitali ose qendre për kujdesjeje. Më tepër se një herë i kam dëgjuar fjalët kur kam hyrë në derën e një spitali: "Oh, e dija se do të vije".

Nuk duhet të shqetësohemi që të dimë gjënë e saktë për të thënë ose bërë, kur të jemi atje. Dashuria e





Anëtarë në Romë të Italisë përkthejnë biseda të konferencës së përgjithshme.

Perëndisë dhe Shpirti i Shenjtë mund të jenë të mjaftueshme. Kur isha i ri kisha frikë se nuk do të dija çfarë të bëja ose t'u thosha njerëzve në nevojë të madhe.

Dikur qeshë pranë shtratit të spitalit të babait tim, kur ai dukej pranë vdekjes. Dëgjova një trazirë mes infermiereve në korridor. Befas, Presidenti Spenser W. Kimball hyri në dhomë dhe u ul në një karrige nga ana e kundërt e shtratit që isha unë. Mendova me vete: "Tani, ja ku është rasti im të vështroj e dëgjoj një mjeshtër, që shkon tek ata që janë në dhembje dhe vuajtje".

Presidenti Kimball tha disa fjalë përshëndetjeje, e pyeti babanë tim nëse kishte marrë një bekim priftërie, dhe pastaj, kur Babi u përgjigj se e kishte marrë, profeti u rehatua në karrigen e tij.

Prita një shfaqje të aftësive ngushëlluese, që ndieja se më mungonin dhe që më duheshin kaq shumë. Pas ndoshta pesë minutash, që i vështroja të dy ata thjesht duke i buzëqeshur në heshtje njëri-tjetrit, e pashë Presidentin Kimball të ngrihej e të thoshte: "Henri, mendoj të shkoj përpara se të të lodhim".

Mendova se e kisha humbur mësimin, por ai erdhi më vonë. Në një çast të qetë me Babin, pasi u shërua

mjaftueshëm sa të shkonte në shtëpi, biseda jonë shkoi tek vizita e Presidentit Kimball. Babi tha qetë: "Nga të gjitha vizitat që kam pasur, vizita që pata prej tij më ngriti më shumë shpirtërisht".

Presidenti Kimball nuk tha shumë fjalë qetësimi, të paktën që unë të mund t'i dëgjoja, por ai shkoi me Shpirtin e Zotit si shoqëruesi për të dhënë qetësimin. E kuptoj tani se ai po shfaqte mësimin që na dha Presidenti Monson: "Si e lartëson dikush një thirrje? Thjesht duke kryer shërbimin që i përket asaj."

Kjo është e vërtetë, qoftë nëse jemi thirrur të japim mësim ungjillin me anë të Shpirtit, ose të shkojmë me Frymën e Shenjtë tek ata me gjuhë të këputur dhe duar që varen poshtë⁷. Shërbimi ynë i priftërisë do të forcohet, njerëzit do të bekohen dhe drita e qiellit do të jetë atje. Drita e qiellit do të jetë atje për ne si dhe për ata të cilëve u shërbejmë. Ne mund të jemi të lodhur. Telashet tona dhe të familjes sonë mund të na shqetësojnë. Por ka një bekim nxitjeje për ata që shërbejnë nën ndikimin e Shpirtit.

Presidenti Xhorxh Q. Kenon pati shumë hidhërim, kundërshtim dhe sprova në vitet e tij të shërbimit të priftërisë. Ai pati gjithashtu përvojë

me Frymën e Shenjtë si shoqëruesin e tij në kohë të vështira dhe shërbim të zorshëm. Ky është sigurimi për ne në shërbimin tonë të priftërisë, në Kishë dhe në familjet tona. Për mua premtimi ka qenë i vërtetë kur kam ndier Shpirtin në shërbimin tim të priftërisë. "Kurdoherë që errësira mbush mendjen tonë, mund ta dimë se nuk jemi të pushtuar nga Shpirti i Perëndisë.

... Kur jemi të mbushur me shpirtin e Perëndisë, ne jemi të mbushur me gëzim, me paqe dhe me lumturi, pavarësisht se cilat mund të jenë rrethanat tona; sepse është një shpirt gazi dhe lumturie. Zoti na ka dhënë dhuratën e Frymës së Shenjtë. Është privilegji ynë ta kemi atë Frymë të Shenjtë të mbretërojnë brenda nesh, kështu që nga mëngjesi deri në darkë dhe nga darka deri në mëngjes, ne do të kemi gëzimin, dritën dhe zbulesën e tij."⁸

Ne mund ta presim të vijë atë bekim të lumturisë dhe gëzimit kur të na duhet, gjatë kohëve të vështira në shërbimin tonë besnik të priftërisë.

Unë dëshmoj se ne jemi thirrur nga Perëndia me anë të profecisë. Kjo është Kisha e vërtetë e Jezu Krishtit, e rivendosur nëpërmjet Profetit Jozef Smith. Perëndia jeton dhe e dëgjon secilën nga lutjet tona. Jezusi është Krishti i ringjallur dhe Shpëtimtari ynë. Ju mund ta dini se këto gjëra janë të vërteta nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, që do të vijë tek ju në shërbimin tuaj. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 20:77.
2. 3 Nefi 19:9.
3. 3 Nefi 19:21.
4. Doktrina e Besëlidhje 138:11.
5. Thomas S. Monson, "Priesthood Power", *Liahona*, janar 2000, f. 60.
6. Doktrina e Besëlidhje 20:58-59.
7. Shih Doktrina e Besëlidhje 81:5.
8. George Q. Cannon, në Brian H. Stuy, përmb., *Collected Discourses Delivered by President Wilford Woodruff, His Two Counselors, the Twelve Apostles, and Others*, 5 vëll. (1987-1992), 4:137.



Autoritetet e Përgjithshme të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Tetor 2010

PRESIDENCA E PARË



Henri B. Airing,
Këshilltar i Parë



Tomas S. Monson,
President



Dieter F. Uchtdorf,
Këshilltar i Dytë

KUORUMI I DYMËDHJETË APOSTUJVE



Boyd K. Packer



L. Tom Peri



Rasëll M. Nelson



Dallin H. Oaks



M. Rasëll Ballard



Rïçard G. Skot



Robert D. Hejls



Xhefri R. Holland



Dejvid A. Bednar



Kuentin L. Kuk



D. Tod Kristoferson



Nil L. Andersen

PRESIDENCA E TË SHATËDHJETËVE



Ronald A. Rasband



Klaudio R. M. Kosta



Shiven E. Snuu



Uolter F. Gonzales



L. Urti Klejton



Xheri E. Xhensen



Donald L. Hallstrom

KUORUMI I PARË TË SHITATËDHJETËVE



Markos A. Aidikaris



Karios H. Amado



Mervin B. Arnold



Deyvid S. Bakster



Shein M. Bowen



Zherald Kosë



Jun Huan Çai



Benjamin De Hoops



Xhon B. Dikson



Kevin R. Domkan



Deyvid F. Evans



Enrike R. Falibala



Eduardo Gornet



Karlos A. Gocobi



Xhejms J. Hornula



Keith K. Hibbig



Ricard G. Hinkli



Marlin K. Xhensen



Daniel L. Xhinson



Pol V. Xhanson



Parik Kieran



Ricard J. Meinis



Markus B. Nash



Brent H. Nilson



Alan F. Parker



Kevin W. Pison



Entoni D. Parkins



Pol B. Palper




Dej G. Renhard



Matjell T. Ringud



Lin G. Robins



Sesi O. Samuelson i Riu



Xhozef W. Strati



Ulises Suresh



Geri E. Siverson



Huan A. Urcido



Fransko J. Vings



Uilliam R. Uolker



F. Matjell Utison



Hoge F. Zebalos



Klaudio D. Zvic



W. Kreig Zuk

KUORUMI I DYTË I TË SHITATËDHJETËVE



Ulfhard W. Andersen



Kaçi Aqogji



Ted R. Kellster



Kraig A. Kardon



Bus A. Karlson



Dan R. Klank



Keith R. Edwards



Stenli G. Elis



Bredli D. Foster



Leni W. Gibons



Von Jong Ko



Leni R. Lorens



Per G. Malm



Xhejms B. Marfino



Jaro Macagari



Kent F. Ricards



Gregori A. Shicer



Louell M. Snou



Pol K. Sibrowski



Kent D. Utison



Lorens E. Korhixh



Geri J. Koleman



Erik W. Kopishke



Karl B. Pror



Oktaviano Tenorio



Gerit W. Gong



Pol E. Kollker



Brus D. Porter



Zhazë A. Teisheru



Rafnel E. Pino



Joshihko Kikuçi



Matjell Xhon U. Teh



H. David Barton
Peshkop i Kryesues



Ricard C. Exhij
Këshilltar i Parë



Keith B. Meksullin
Këshilltar i Dytë

PESHKOPATA KRYESUESE




Ricard C. Exhij
Këshilltar i Parë



H. David Barton
Peshkop i Kryesues



Keith B. Meksullin
Këshilltar i Dytë



Shenjtore të ditëve të mëvonshme mbliidhen për Konferencën e Përgjithshme Gjysmëvjetore të 180-të të Kishës. Paraqiten në fotografi, sipas drejtimit të akrepave të orës nga skaji i sipërm majtas, anëtarë të Kishës në San-Paulo të Brazilit, në Okland të Zelandës së Re, në Formoza të Argjentinës, në Kejptaun të Afrikës së Jugut, në Stokholm të Suedisë, në Dublin të Irlandës dhe në Montevideo të Uruguait.





Nga Presidenti Tomas S. Monson

Tre Parimet e Zgjedhjes

Secili prej nesh ka ardhur në këtë tokë me të gjitha mjetet e nevojshme për të bërë zgjedhje të sakta.

Vëllezër të mi të dashur të priftërisë, lutja ime e sinqertë sot është që të mund të gëzoj ndihmën e Atit tonë Qiellor në shprehjen me fjalë të atyre gjërave që ndihem i frymëzuar të ndaj me ju.

Kohët e fundit kam menduar rreth zgjedhjeve dhe rrjedhojave të tyre. Rrallë kalon një orë e ditës pa na u kërkuar të bëjmë zgjedhje të një lloji apo tjetri. Disa janë të parëndësishme, disa me ndikim më të gjerë. Disa nuk do të bëjnë ndryshim në skemën e përvetshme të gjërave; dhe të tjera do të bëjnë ndryshim tërësor.

Ndërsa kam medituuar mbi aspektet e ndryshme të zgjedhjes, i kam ndarë ato në tre kategori: së pari, *e drejta* e zgjedhjes; së dyti, *përgjegjësia* e zgjedhjes; dhe së treti, *pasojat* e zgjedhjes. Këto i quaj tre Parimet e zgjedhjes.

Përmend së pari *të drejtën* e zgjedhjes. I jam kaq mirënjohës një Ati të dashur Qiellor për dhuratën e tij të lirisë së zgjedhjes, ose të drejtën për të zgjedhur. Presidenti Dejvid O. Mek-Kei, Presidenti i nëntë i Kishës, tha: “Pas dhuratës së vetë jetës, e drejta për ta drejtuar atë jetë është dhurata më e madhe e Perëndisë për ne.”¹

Ne e dimë se e kishim lirinë tonë të zgjedhjes përpara se kjo botë të krijohet dhe se Luciferi u përpoq të na e merrte. Ai nuk kishte fare besim

në parimin e lirisë së zgjedhjes apo në ne dhe argumentoi për shpëtimin me detyrim. Ai nguli këmbë që me planin e tij, asnjë nuk do të humbiste, por duket se nuk pranonte – ose ndoshta nuk shqetësohej – që, përveç kësaj, askush nuk do ishte më i mençur, më i fortë, më i dhembshur apo diçka më mirënjohës, nëse do të ndiqej plani i tij.

Ne që zgjodhëm planin e Shpëtimtarit e dinim se do të nisnim një udhëtim, që do të na ndante nga Ati ynë, të rrezikshëm e të vështirë, sepse ne ecim në rrugët e botës dhe mëkatit dhe pengohemi. Por i Parëlinduri në Shpirt e ofroi Vetën si një sakrificë për të shlyer mëkatet e të gjithëve. Përmes vuajtjes së papërkrahshme Ai u bë Shëlbuesi i madh, Shpëtimtari i gjithë njerëzimit, duke bërë të mundur kështu kthimin tonë të suksesshëm tek Ati ynë.

Profeti Lehi na thotë: “Kështu që, njerëzit janë të lirë sipas mishit; dhe të gjitha gjërat u janë dhënë atyre të cilat janë të nevojshme për njeriun. Dhe ata janë të lirë të zgjedhin lirinë dhe jetën e përvetshme, nëpërmjet Ndërmjetësit të madh të të gjithë njerëzve, ose të zgjedhin robërinë dhe vdekjen, sipas robërisë dhe fuqisë së djallit; pasi ai kërkon që të gjithë njerëzit të jenë të mjeruar sikurse është ai vetë.”²

Vëllezër, brenda kufijve të çfarëdo situatë në të cilën gjendemi, ne gjithmonë do të kemi *të drejtën* për të zgjedhur.

Pastaj, me *të drejtën* e zgjedhjes vjen *përgjegjësia* e zgjedhjes. Ne nuk mund të jemi asnjëherë, nuk ka pozitë të ndërmjetme. Zoti e di këtë; Luciferi e di këtë. Për aq sa jetojmë mbi këtë tokë, Luciferi dhe shërbëtorët e tij nuk do ta braktisin kurrë shpresën për të marrë shpirtat tanë.

Ati ynë Qiellor nuk na dërgoi në udhëtimin tonë të përvetshëm pa siguruar mjetet nëpërmjet të cilave të mund të merrnim prej Tij drejtim të perëndishëm për të ndihmuar në kthimin tonë të sigurt në fund të jetës së vdekshme. E kam fjalën për lutjen. Gjithashtu, e kam fjalën për pëshpërimat prej atij zëri të qetë, të ulët brenda secilit prej nesh; dhe nuk i lë pa përmendur shkrimet e shenjta, të shkruara nga marinarë që i lundruan me sukses detet që ne gjithashtu duhet t'i kalojmë.

Secili prej nesh ka ardhur në këtë tokë me të gjitha mjetet e nevojshme për të bërë zgjedhje të sakta. Profeti Mormoni na thotë: “Shpirti i Krishti i jepet çdo njeriu, që ai të dallojë të mirën nga e keqja.”³

Ne jemi rrethuar – madje nganjëherë bombarduar – prej mesazheve të kundërshtarit. Dëgjoni disa prej tyre; ato pa dyshim janë të njohura për ju: “Vetëm një herë s’ka rëndësi.” “Mos ki merak; askush nuk do e marrë vesh.” “Mund ta ndërpresësh duhanpirjen ose pirjen e alkoolit, ose marrjen e drogave kur të duash.” “Të gjithë po e bëjnë, kështu që s’duhet të jetë dhe aq e keqe.” Gënjeshtrat janë pa fund.

Megjithëse në udhëtimin tonë do të hasim degëzime e kthesa në rrugëtim, ne thjesht nuk mund t’ia lejojmë vetes luksin e rrugëve të tërthorta prej të



cilave mund të mos kthehemi kurrë. Luciferi, ai fyelltar laraman, i bie melodisë së tij gazmore dhe tërheq njerëzit e joshur larg sigurisë së shtegut të tyre të zgjedhur, larg këshillës së prindërve të dashur, larg mbrojtjes së mësimëve të Perëndisë. Ai kërkon jo vetëm të ashtuquajturit plehrat e njerëzimit, ai kërkon të gjithë ne, përfshirë vetë të zgjedhurit e Perëndisë. Mbreti David ia vuri veshin, u lëkund dhe pastaj e ndoqi dhe ra. Po kështu bëri Kaini në një epokë më të hershme dhe Juda Iskarioti në një më të vonshme. Metodat e Luciferit janë mashtruese, viktimat e tij të shumta.

Ne lexojmë për të tek 2 Nefi: “Të tjerë ai do t’i paqësojë dhe do t’i përkundë në siguri trupore.”⁴ “Të tjerët ai i lajkaton dhe u thotë se nuk ka ferr . . . derisa i kap ata me zinxhirët e tij të tmerrshëm.”⁵ “Dhe kështu djalli gënjen shpirtrat e tyre dhe ai i çon me kujdes poshtë në ferr.”⁶

Kur përballemi me zgjedhje të rëndësishme, si e marrim vendimin? A i jepemi premtimit të kënaqësisë së çastit? Nxitjeve dhe pasioneve tona? Presionit të shokëve tanë?

Le të mos jemi po aq të pavendosiur sa Liza në veprën e përkryer artistike të Luis Keroll “*Aventurat e Lizës në Botën e Çudirave*”. Ju e mbani mend që ajo vjen në një udhëkryq me dy shtigje përpara vetes, secili shtrihej përpara, por në drejtime të kundërta. Asaj i del përpara macja Qeshirë (Buzëqeshëse), të cilën Liza e pyet: “Cilin shteg të ndjek?”

Macja i përgjigjet: “Kjo varet se ku dëshiron të shkosh. Nëse nuk e di se ku dëshiron të shkosh, nuk ka rëndësi se cilin shteg ndjek.”⁷

Ndryshe nga Liza, ne të gjithë e dimë se ku dëshirojmë të shkojmë, dhe ka rëndësi se në cilën rrugë shkojmë, sepse duke zgjedhur shtegun tonë, ne zgjedhim destinacionin tonë.

Vendimet janë vazhdimisht para nesh. Për t’i marr ato me mençuri, duhet kurajë – kurajë për të thënë jo; kurajë për të thënë po. Vendimet vërtet përcaktojnë fatin.

Unë ju lutem që, pikërisht këtu, pikërisht tani, të merrni një vendim për të mos u shmangur nga shtegu që do të na çojë tek qëllimi ynë: jeta e përjetshme me Atin tonë në Qiell. Gjatë atij shtegu të drejtë e të vërtetë ka qëllime të tjera: shërbimi misionar, martesë në tempull, veprimtaria në Kishë, studimi i shkrimeve të shenjta, lutja, puna në tempull. Ka qëllime të denja, të panumërta për t’u arritur ndërsa udhëtojmë përmes jetës. I domosdoshëm është zotimi ynë për t’i arritur ato.

Së fundmi, vëllezër, flas për *pasojat* e zgjedhjes. Të gjitha zgjedhjet tona kanë pasoja, disa prej të cilave kanë pak ose aspak të bëjnë me shpëtimin tonë të përjetshëm, kurse të tjerat kanë të bëjnë *drejtpërdrejt* me të.

Nëse vishni një këmishë të gjelbër apo blu nuk sjell ndonjë ndryshim afatgjatë. Mirëpo, nëse vendosni të shtypni një buton në kompjuterin tuaj, që do t’ju çojë drejt pornografisë, mund të sjellë ndryshim *tërësor* në jetën tuaj. Ju do të keni hedhur thjesht një hap jashtë shtegut të drejtë e të sigurt. Nëse një shok ju shtyn për të pirë alkool apo për të provuar droga dhe ju i jepeni presionit, ju keni marrë një rrugë të tërthortë nga e cila ju mund të mos ktheheni. Vëllezër, qoftë nëse jemi dhjakë 12-vjeçarë apo priftërinj të lartë të mençur, ne jemi të tundueshëm. I mbajtshim sytë tanë, zemrat tona dhe vendosmërinë tonë të përqendruar tek ai qëllim që është i përjetshëm dhe i vlefshëm sa çfarëdo çmimi që mund të na duhet të paguajmë, pavarësisht sakrificës që duhet të bëjmë për ta arritur atë.

Asnjë tundim, asnjë presion, asnjë nxitje nuk mund të na mposhtë,

përveç nëse e lejojmë këtë. Nëse bëjmë zgjedhjen e gabuar, nuk kemi askënd për të fajësuar përveç vetvetes. Presidenti Brigam Jang e shprehu njëherë këtë të vërtetë duke e krahasuar me veten. Ai tha: “Nëse vëllai Brigam merr udhë të gabuar dhe lihet jashtë mbretërisë së qiejve, asnjë njeri nuk do të fajësohet përveç vëllait Brigam. Unë jam e vetmja qenie në qiell, tokë apo ferr që mund të fajësohet.” Ai vijoi: “Kjo do të zbatohet njësoj për çdo shenjtor të ditëve të mëvonshme. Shpëtimi varet nga veprimtaria personale.”⁸

Apostulli Pal na ka siguruar: “Asnjë tundim nuk ju ka gjetur juve, përveç tundimit njerëzor; por Perëndia është besnik dhe nuk do të lejojë që t’ju tundojnë përtej fuqive tuaja, por me tundimin do t’ju japë dhe rrugë dalje, që ju të mund ta përballoni.”⁹

Ne të gjithë kemi bërë zgjedhje të gabuara. Nëse nuk i kemi korrigjuar tashmë këto zgjedhje, unë ju siguroj se ka një mënyrë për ta bërë këtë. Procesi quhet pendim. Unë lutem që t’i korrigjoni gabimet tuaja. Shpëtimtari ynë vdiq për t’ju siguruar juve dhe mua atë dhuratë të bekuar. Megjithëse shtegu nuk është i lehtë, premtimi është i vërtetë: “Edhe sikur mëkatet tuaja të ishin të kuqe flakë, do të bëhen të bardha si bora.”¹⁰ “Dhe unë, Zoti, nuk i kujtoj më ato.”¹¹ Mos e vini në rrezik jetën tuaj të përjetshme. Nëse keni mëkatuar, sa më shpejt të filloni rrugën e kthimit, aq më shpejt ju do të gjeni paqen dhe gëzimin e ëmbël që vijnë me mrekullinë e faljes.

Vëllezër, ju jeni nga një trashëgimi fisnike. Jeta e përjetshme në mbretërinë e Atit tonë është qëllimi juaj. Një qëllim i tillë nuk arrihet me një përpjekje të lavdishme, por është rezultat i një jete të drejtë, i një grumbulli zgjedhjesh të mençura, madje i një besnikërie të qëllimit. Ashtu si me çdo



gjë që vërtet vlen, shpërblimi i jetës së përjetshme kërkon përpjekje.

Shkrimet e shenja janë të qarta:

“Kini . . . kujdes të bëni atë që Zoti, Perëndia juaj, ju ka urdhëruar; mos u shmangni as djathtas, as majtas;

ecni të tërë në rrugën që Zoti, Perëndia juaj, ju ka caktuar.”¹²

Në mbyllje më lejoni të ndaj me ju një shembull të dikujt që vendosi herët në jetë se cilat do të ishin qëllimet tij. E kam fjalën për vëllain Klejton M. Kristensen, një anëtar i Kishës që është profesor i administrimit të biznesit në shkollën e biznesit të Universitetit të Harvardit.

Kur ishte 16 vjeç, vëllai Kristensen vendosi, ndërmjet të tjerave, që nuk do luante ndeshje të dielën. Vite më vonë, kur frekuentoi Universitetin e Oksfordit në Angli, ai luajti si lojtar i qendrës në skuadrën e basketbollit. Atë vit, ata patën një sezon pa humbje dhe arritën deri tek ekuivalentja britanike e asaj që në Shtetet e Bashkuara do të ishte kampionati NCAA i basketbollit.

Ata i fituan lojërat e tyre mjaft lehtësisht në kampionat, duke arritur si një prej katër finalistëve. Ndodhi atëherë që vëllai Kristensen shikoi programin dhe për tmerrin e tij të plotë pa se ndeshja finale e basketbollit ishte programuar që të luhej të dielën. Ai dhe skuadra e tij kishte punuar kaq fort për të arritur aty ku ishin dhe ai

ishte lojtari qendror që fillonte lojën. Me dilemën e tij, ai shkoi tek trajneri. Trajneri i tij qe mospërfillës dhe i tha vëllait Kristensen se priste që ai të luante në ndeshje.

Gjithsesi, përpara ndeshjes finale, kishte një ndeshje gjysmëfinale. Fatkeqësisht, lojtari qendror rezervë nxori nga vendi shpatullën, gjë që e rriti presionin mbi vëllain Kristensen për të luajtur në ndeshjen finale. Ai shkoi në dhomën e tij të hotelit. Ai u gjunjëzua. Ai i kërkoi Atit të tij Qielor në qoftë se do të ishte e drejtë, vetëm këtë herë, po të luante atë ndeshje të dielën. Ai tha se që përpara se të mbaronte së luturi, ai e mori përgjigjen: “Klejton, përse po më pyet së koti për këtë? Ti e di përgjigjen.”

Ai vajti tek trajneri i tij, duke i thënë se sa keq i vinte që nuk do të luante në ndeshjen finale. Pastaj vajti në mbledhjet e së dielës në lagjen vendore ndërsa skuadra tij luante pa të. Ai u lut fuqishëm për fitoren e tyre. Ata vërtet fituan.

Ai vendim fatpërcaktues e i vështirë u mor mbi 30 vjet më parë. Vëllai Kristensen ka thënë se, ndërsa koha ka kaluar, ai e quan atë një prej vendimeve më të rëndësishme që ka marrë ndonjëherë. Do të kishte qenë shumë e lehtë të kishte thënë: “Ti e merr me mend, në përgjithësi, mbajtja e shenjtë e ditës së Shabatit është urdhërimi i duhur, por në rrethanën time posaçërisht



Nga Presidenti Henri B. Ajring
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

të veçantë, është në rregull nëse, vetëm këtë herë, nuk e mbaj.” Megjithatë, ai thotë se e gjithë jeta e tij doli se ishte një rrjedhë e pafundme rrethanash të veçanta, dhe po ta kishte kaluar kufirin vetëm atë herë, atëherë herës tjetër diçka dilte që ishte aq e nevojshme dhe kritike, sa do të ishte shumë më e lehtë ta shkelte kufirin përsëri. Mësimi që mori është se është më e lehtë t'i mbash urdhërimet 100 përqind të kohës sesa 98 përqind të kohës.¹³

Vëllezër të mi të dashur, qofshim të mbushur me mirënjohje për të drejtën e zgjedhjes, pranoni përgjegjësinë e zgjedhjes dhe jini përherë të ndër-gjegjshëm për pasojat e zgjedhjes. Si mbajtës të priftërisë, të gjithë ne, të bashkuar në një, mund të cilësohemi të përshtatshëm për frymëzimin udhë-heqës të Atit tonë Qiellor kur zgjedhim me kujdes dhe drejt. Ne jemi përfshirë në veprën e Zotit Jezu Krishti. Ne, sikurse ata të kohërave të lashta, i jemi përgjigjur thirrjes së Tij. Ne jemi duke bërë punën e Tij. Ne do të kemi sukses në porosinë solemne: “Pastrohuni, ju që mbani vazot e Zotit.”¹⁴ Qoftë e mundur që kjo të ndodhë, është lutja ime solemne dhe e përlurur, në emrin e Jezu Krishtit, Zotit tonë, amen. ■

SHËNIME

1. *Teachings of Presidents of the Church: David O. McKay* (2003), f. 208.
2. 2 Nefi 2:27.
3. Moroni 7:16.
4. 2 Nefi 28:21.
5. 2 Nefi 28:22.
6. 2 Nefi 28:21.
7. Përshtatur nga Lewis Carroll, *Aventurat e Lizës në Botën e Çudirave* (1898), f. 89.
8. *Teachings of Presidents of the Church: Brigham Young* (1997), f. 294.
9. 1 Korintasve 10:13.
10. Isaia 1:18.
11. Doktrina e Besëlidhje 58:42.
12. Ligji i Përtërirë 5:32–33.
13. Shih Clayton M. Christensen, “Decisions for Which I’ve Been Grateful” (takim shpirtëror i Univeritetit “Brigam Jang” – Idaho, 8 qershor 2004), www.byui.edu/presentations.
14. Isaia 52:11.

Mirëbeso tek Perëndia, Pastaj Shko dhe Bëj

Ju e tregoni mirëbesimin tek Ai kur dëgjoni me qëllimin për të mësuar e për t’u penduar dhe, pastaj, shkoni e bëni çfarëdo që Ai kërkon.

Vëllezërit dhe Motrat e mia të dashura, është një nder t’ju drejtohem juve në këtë ditë Shabati. Ndihem i përlurur nga detyra për t’u folur miliona shenjtoreve të ditëve të mëvonshme dhe miqve tanë nëpër botë. Në përgatitje për këtë mundësi të shenjtë, unë u luta dhe meditova për të mësuar mbi nevojat tuaja personale dhe se çfarë mesazhi donte Zoti që të jepja.

Nevojat tuaja janë të mëdha e të larmishme. Secili prej jush është një fëmijë unik i Perëndisë. Perëndia ju njeh individualisht. Ai dërgon mesazhe nxitjeje, korrigjimi dhe drejtimi, të përshtatshme për ju dhe nevojat tuaja.

Për të zbuluar se çfarë dëshironte Perëndia që të shtoja në këtë konferencë, unë lexova mesazhet e shërbëtorëve të Tij në shkrimin e shenjtë dhe në konferencat e shkuara. Mora një përgjigje për lutjen time kur lexova fjalët e Almës, një shërbëtori të shkëlqyer të Zotit, në Librin e Mormonit:

“O sikur të isha një engjëll dhe të mund të plotësoja dëshirën e zemrës

sime, që të mund të shkoja dhe të njoftoja me borinë e Perëndisë, me një zë që tund tokën dhe të thërrisja pendim në çdo popull!

Po, unë do t’i shpallja çdo shpirti si me zërin e rrufesë, pendimin dhe planin e shëlbimit, që ata duhet të pendohen dhe të vijnë te Perëndia ynë, kështu që të mos ketë më pikëllim mbi të gjithë faqen e dheut.

Por vini re, unë jam një njeri dhe mëkatoj në dëshirën time; pasi duhet të isha i kënaqur me gjërat që më ka dhënë Zoti.”¹

Dhe pastaj unë gjeta në mendimet e Almës, drejtimin për të cilin isha lutur: “Pasi vini re, Zoti në urtësi u jep të gjitha kombeve, nga kombi dhe gjuha e tyre, për të mësuar fjalën e tij, po, në dituri gjithçka që ai e shikon të përshtatshme se ata duhet ta kenë, prandaj ne shohim se Zoti këshillon me urtësi, sipas asaj që është e drejtë dhe e vërtetë”².

Kur lexova atë mesazh nga një shërbëtor i Perëndisë, detyra ime për sot u bë e qartë. Perëndia u dërgon mesazhe dhe lajmëtarë të autorizuar

fëmijëve të Tij. Unë duhet të ndërtoj mirëbesim tek Perëndia dhe shërbëtorët e Tij, aq sa ne të shkojmë dhe t'i bindemi këshillës së Tij. Ai e dëshiron atë sepse Ai na do dhe dëshiron lumturinë tonë. Dhe Ai e di se si mungesa e mirëbesimit tek Ai sjell trishtim.

Mungesa e mirëbesimit u solli hidhërim fëmijëve të Atit Qiellor që përpara se bota të krijohej. Ne e dimë nëpërmjet zbulesave të Perëndisë drejtuar Profetit Jozef Smith, se shumë nga vëllezërit e motrat tona në botën shpirtërore e refuzuan planin për jetën tonë në vdekshmëri të paraqitur nga Ati ynë Qiellor dhe Biri i Tij më i madh, Jehovahi.³

Ne nuk i dimë të gjitha arsyet e suksesit të tmerrshëm të Luciferit për ta ndërsyer atë rebelim. Megjithatë, një arsye është e qartë. Atyre, që e humbën bekimin e ardhjes në vdekshmëri, u mungonte mirëbesimi i mjaftueshëm tek Perëndia, sa të shmangnin mjerimin e përrjetshëm.

Modeli i trishtuar i mungesës së mirëbesimit tek Perëndia ka vazhduar që nga krijimi. Do të jem i kujdesshëm në dhënien e shembujve nga jeta e fëmijëve të Perëndisë, meqë nuk i di të gjitha arsyet e mungesës së besimit të mjaftueshëm të tyre për t'i mirëbesuar Atij. Shumë prej jush i keni studiuar çastet e krizës në jetën e tyre.

Jona, për shembull, jo vetëm që nuk e pranoi mesazhin nga Zoti që të shkonte në Ninive, por shkoi në anën e kundërt. Naamani nuk mund t'i mirëbesonte udhëzimit të profetit të Zotit që të lahej në një lumë, për ta lejuar Zotin t'i shëronte lebrën, duke e ndier se detyra e thjeshtë nuk ishte dinjitoze për të.

Shpëtimtari e ftoi Pjetrin ta linte sigurinë e barkës që të ecte me Të mbi ujë. Ne ndiejmë dhembjen e tij dhe shohim vetë nevojën tonë për

mirëbesim më të madh tek Perëndia, kur dëgjojmë rrëfimin:

“Në rojën e katërt të natës, Jezusi shkoi drejt tyre, duke ecur mbi det.

Dishepujt duke parë atë që po ecte mbi det, u trembën dhe thanë: ‘Është një fantazmë!’ Dhe filluan të bërtasin nga frika;

por menjëherë Jezusi u foli atyre duke thënë: ‘Qetësohuni; jam unë, mos kini frikë!’

Dhe Pjetri, duke u përgjigjur tha: ‘Zot, nëse je ti, më urdhëro të vij te ti mbi ujëra.’

Ai tha: ‘Eja!’ Dhe Pjetri zbriti nga barka dhe eci mbi ujëra, për të shkuar te Jezusi.



Por, duke parë erën e fortë, kishte frikë, dhe duke filluar të fundosej, bërtiti duke thënë: ‘O Zot, shpëtomë!’

Dhe Jezusi ia zgjati menjëherë dorën, e zuri dhe i tha: ‘O njeri besimpak, pse dyshove?’⁴

Ne mund të marrim kurajë nga fakti se Pjetri arriti t'i mirëbesonte Zotit, aq sa të qëndronte besnik në shërbimin e Tij gjithë kohës, deri në martirizimin e vet.

Djaloshi Nefi në Librin e Mormonit frymëzon tek ne një dëshirë për të zhvilluar mirëbesim tek Zoti dhe për t'iu bindur urdhërimeve të Tij, pavarësisht se sa të vështira të na duken. Nefi u përball me rrezik dhe vdekje të mundshme kur tha këto fjalë mirëbesimi, që ne mund dhe duhet t'i ndiejmë vazhdueshëm në zemrën tonë: “Unë do të shkoj dhe do të bëj gjërat që Zoti ka urdhëruar, pasi e di se Zoti nuk u jep urdhërime fëmijëve të njerëzve pa përgatitur një udhë për ta, që ata të mund të plotësojnë gjënë, që ai i urdhëron”⁵.

Ai mirëbesim vjen nga njohja e Perëndisë. Më shumë se çdo popull në botë ne, nëpërmjet ngjarjeve të lavdishme të rivendosjes së ungjillit, kemi ndier paqen që Zoti i ofroi popullit të Tij me fjalët: “Ndaluni dhe pranoni që jam Perëndi”⁶. Zemra ime është e mbushur me mirënjohje për atë që Perëndia ka zbuluar për Vetën, që ne të mund t'i mirëbesojmë Atij.

Për mua ajo filloi në 1820-ën, me një djalosh në një korië pemësh, në një fermë, në shtetin e Nju-Jorkut. Djaloshi, Jozef Smith i Riu, shkoi mes pemëve deri tek një vend i veçantë. Ai u gjunjëzua të lutej me mirëbesim të plotë se Perëndia do t'i përgjigjej përgjërimit të tij, që të dinte se çfarë duhej të bënte, që të pastrohej dhe të shpëtohej përmes Shlyerjes së Jezu Krishtit.⁷

Çdo herë që e lexoj rrëfimin e tij, mirëbesimi im, tek Perëndia dhe shërbëtorët e Tij, rritet:

“Unë pashë një shtyllë drite tamam mbi kokën time, më e shkëlqyeshme se dielli, e cila zbriti gradualisht derisa ra mbi mua.

Sapo u shfaq ajo, unë e gjeta veten time të çliruar nga armiku që më mbante të mbërthyer. Kur drita pushoi mbi mua, unë pashë dy Personazhe, shkëlqimi dhe lavdia e të cilëve i kapërcejnë të gjitha përshekrimet, duke qëndruar mbi mua në ajër. Një prej tyre më foli, duke më thirrur në emër dhe tha, duke treguar tjetrin: *Ky është Biri Im i Dashur. Dëgjoje Atë!*”⁸

Ati na e zbuloi neve se Ai jeton, se Jezu Krishti është Biri i Tij i Dashur dhe se Ai na deshi aq shumë, sa ta dërgonte atë Bir për të na shpëtuar ne, që jemi fëmijët e Tij. Dhe sepse unë kam një dëshmi se Ai e thirri atë djalosh të paarsimuar si një Apostull dhe Profet, unë u mirëbesoj Apostujve dhe Profetëve të Tij sot dhe atyre që ata thërrasin për t'i shërbyer Perëndisë.

Ai mirëbesim e ka bekuar jetën time dhe jetën e familjes sime. Vite më parë, unë dëgjova Presidentin Ezra Taft Benson të fliste në një konferencë si kjo. Ai na këshilloi të bënim gjithçka mundeshim që të liroheshim nga borxhet dhe të qëndronim pa borxh. Ai përmendi hipotekimin e shtëpive. Ai tha se mbase nuk do të ishte e mundur, por më e mira do të ishte nëse do të mund ta shlyenim të gjithë borxhin e hipotekimit.⁹

Iu drejtova gruas sime pas mbledhjes dhe e pyeta: “A mendon se ka ndonjë mënyrë që të mund ta bëjmë këtë?” Në fillim nuk mundëm. Dhe pastaj, nga mbrëmja, mendova për një pronë që e kishim në një shtet tjetër. Për vite ishim përpjekur ta shitnim pa sukses.



Por, meqë ne e mirëbesonim Perëndinë dhe fjalët prej mesazhit të shërbëtorit të Tij, ne i bëmë një telefonatë të hënën në mëngjes njeriut në San-Francisko, që e kishte në listën për shitje pronën tonë. I kisha telefonuar disa javë më parë dhe atëherë ai kishte thënë: “Ka vite që s’kemi pasur ndonjë njeri që të shfaqë interes për pronën tuaj”.

Por të hënën pas konferencës, dëgjova një përgjigje që deri më sot e forcon mirëbesimin tim tek Perëndia dhe shërbëtorët e Tij.

Burri në telefon tha: “Po çuditëm nga telefonata jote. Sot erdhi një burrë që pyeti nëse mund ta blinte pronën

tuaj.” Me habi e pyeta: “Sa ka ofruar të paguajë?” Ishte pak dollarë më shumë sesa shuma e hipotekimit tonë.

Dikush mund të thotë se ishte vetëm një rastësi. Por hipotekimi ynë u shlye. Dhe familja jonë ende dëgjon për çfarëdo fjale në një mesazh profeti, e cila mund të dërgohet për të na treguar se çfarë duhet të bëjmë për të gjetur sigurinë dhe paqen, që Perëndia dëshiron për ne.

Një mirëbesim i tillë tek Perëndia mund të bekojë komunitetet si dhe familjet. Unë u rrita në një qytezë të vogël në Nju-Xhersi. Dega jonë e Kishës kishte më pak se 20 anëtarë që merrnin pjesë rregullisht.

Mes tyre qe një grua – një e kthyer në besim në Kishë, e moshuar dhe shumë e përlurur. Ajo ishte emigrante, që fliste me një theks të rëndë norvegjez. Ajo ishte e vetmja anëtare e Kishës në familjen e saj dhe e vetmja anëtare e Kishës në qytetin ku jetonte.

Me anë të babait tim, që qe presidenti i degës, Zoti e thirri atë si presidente të Shoqatës së Ndihmës të degës. Ajo nuk kishte manual që t'i tregonte se çfarë të bënte. Asnjë anëtar tjetër i Kishës nuk jetonte pranë saj. Ajo dinte vetëm se Zoti kujdeset për ata në nevojë dhe të paktat fjalë në moton e Shoqatës së Ndihmës: “Dashuria hyjnore nuk ligështohet kurrë”.

Qe në mes të asaj që ne tani e quajmë Depresioni i Madh. Mijëra vetë qenë pa punë dhe pa shtëpi. Kështu, duke ndier se e kishte marrë këtë detyrë nga Zoti, ajo u kërkoi fqinjëve rroba të vjetra. Ajo i lau rrobat, i hekurosi dhe i vendosi në kuti kartoni në verandën pas shtëpisë. Kur njerëzit pa para kishin nevojë për veshje dhe u kërkonin ndihmë fqinjëve, ata do të thoshin: “Shko tek shtëpia poshtë në rrugë. Atje jeton një zonjë mormone që do t’ju japë atë që ju duhet.”

Zoti nuk e drejtoi qytetin, por Ai ndryshoi për më mirë një pjesë të tij. Ai thirri një grua të imët – të vetme – e cila i mirëbesoi aq shumë Atij sa të zbulonte se çfarë donte Ai që të bënte ajo dhe pastaj e bëri atë. Për shkak të mirëbesimit të saj tek Zoti, ajo qe në gjendje të ndihmonte në atë qytet, qindra nga fëmijët e Atit Qiellor në nevojë.

Po ai mirëbesim tek Perëndia mund të bekojë kombet. Kam arritur ta di se mund t’i mirëbesojmë Perëndisë që do të përmbushë premtimin e Almës: “Vini re, Zoti në urtësi u jep të gjitha kombeve, nga kombi dhe gjuha e tyre, për të mësuar fjalën e tij, po, në dituri gjithçka që ai e shikon të

përshtatshme se ata duhet ta kenë”¹⁰.

Perëndia nuk sundon në kombe, por Ai kujtohet për ta. Ai mund dhe vendos njerëz në poste ndikuese, që dëshirojnë çfarë është më e mira për njerëzit dhe që i mirëbesojnë Zotit.¹¹

E kam parë këtë në udhëtimet e mia nëpër botë. Në një qytet me më shumë se 10 milionë banorë, unë u fola shenjtorëve të ditëve të mëvonshme, që ishin mbledhur me mijëra në konferencë. Ajo u zhvillua në një stadium të madh sportiv.

Përpara se të fillonte mbledhja, vura re një të ri të pashëm që ishte ulur në radhën e parë. Ai qe i rrethuar nga të tjerë të cilët, ashtu si ai, ishin të veshur më mirë se shumica e atyre që ishin rreth tyre. E pyeta Autoritetin e Përgjithshëm të Kishës pranë meje se cilët ishin ata burra. Ai pëshpëriti se qe kryetari i bashkisë së qytetit dhe punonjësit e tij.

Kur po shkoja tek makina ime pas mbledhjes, u çudita kur pashë kryetarin e bashkisë, që po priste të më përshëndeste, bashkë me punonjësit e tij. Ai eci përpara, më zgjati dorën dhe tha: “Ju falënderoj që erdhët në qytetin tonë dhe në vendin tonë. Ju jemi mirënjohës për atë që bëni për të lartësuar njerëzit tanë. Me njerëz të tillë dhe familje të tilla, ne mund të krijojmë harmoninë dhe begatinë që dëshirojmë për njerëzit tanë.”

E pashë në atë çast se ai qe një nga të ndershmit në zemër, që qe vendosur nga Perëndia në pushtet mes fëmijëve të Tij. Ne jemi një pakicë e vogël mes qytetarëve të atij qyteti dhe kombi të madh. Kryetari i bashkisë dinte pak mbi doktrinën tonë dhe njihnte pak nga njerëzit tanë. Përsëri Perëndia i kishte dërguar atij mesazhin se shenjtorët e ditëve të mëvonshme, nën besëlidhjen për të mirëbesuar Perëndinë dhe shërbëtorët e autorizuar të Tij, do të ishin një dritë për njerëzit e tij.

I njoh shërbëtorët e Perëndisë, që do t’ju flasin gjatë kësaj konference. Ata janë thirrur nga Perëndia për t’u dhënë mesazhe fëmijëve të Tij. Zoti ka thënë për ta: “Atë që unë, Zoti, kam thënë, e kam thënë dhe nuk justifikohem, dhe ndonëse qiejt dhe toka do të kalojnë, fjala ime nuk do të kalojë, por do të përmbushet e gjitha, qoftë nëpërmjet zërit tim apo nëpërmjet zërit të shërbëtorëve të mi është njësoj”¹².

Ju e tregoni mirëbesimin tuaj tek Ai kur dëgjoni me qëllimin për të mësuar e për t’u penduar dhe, pastaj, shkoni e bëni çfarëdo që Ai kërkon. Nëse i mirëbesoni Perëndisë sa të dëgjoni për mesazhin e Tij në çdo predikim, këngë dhe lutje në këtë konferencë, ju do ta gjeni atë. Dhe nëse shkoni e bëni atë çfarë Ai do që ju të bëni, fuqia juaj për t’i mirëbesuar Atij do të rritet dhe me kohë ju do të pushtoheni nga mirënjohja se e kuptoni që Ai ka arritur t’ju mirëbesojë juve.

Unë dëshmoj se Perëndia flet sot nëpërmjet shërbëtorëve të Tij të zgjedhur në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Tomas S. Monsoni është profeti i Perëndisë. Ati ynë Qiellor dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, jetojnë dhe na duan. Unë dëshmoj kështu në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Alma 29:1–3.
2. Alma 29:8.
3. Shih Doktrina e Besëlidhje 29:36–37; Abrahami 3:27–28.
4. Mateu 14:25–31.
5. 1 Nefi 3:7.
6. Psalmi 46:10.
7. Shih *Teachings of Presidents of the Church: Joseph Smith* (2007), f. 28.
8. Joseph Smith – Historia 1:16–17.
9. Shih për shembull, Ezra Taft Benson, “Prepare for the Days of Tribulation”, *Ensign*, nëntor 1980, f. 33.
10. Alma 29:8.
11. Shih 2 Kronikave 36:22–23; Ezra 1:1–3; Isaia 45:1, 13.
12. Doktrina e Besëlidhje 1:38.



Nga Presidenti Bojd K. Paker
President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Pastrimi i Brendësisë së Enës

Askund nuk shfaqen më shumë bujaria e mirësia dhe mëshira e Perëndisë, sesa në pendim.

Kjo konferencë e përgjithshme u mbledh në një kohë kur kaq shumë pësjtjellim e rrezik, saqë të rinjtë tanë vështirë se e dinë se çfarë rruge duhet të ndjekin. Duke qenë të paralajmëruar nga zbulesat që do të ishte kështu, profetëve dhe apostujve u është treguar gjithmonë se çfarë të bëjnë.

Zoti i zbuloi Profetit Jozef Smith “që çdo njeri të mund të flasë në emër të Perëndisë, Zotit, madje Shpëtimtarit të botës.”¹ Kur u rivendosën çelësat, ata siguruan që autoriteti i priftërisë të ishte i pranishëm në çdo shtëpi, nga gjyshërit, etërit dhe bijtë.

Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve nxorën proklamatin “Familja: Një Proklamatin Drejtuar Botës”, e pesta në historinë e Kishës. Është një udhëzues që anëtarët e Kishës do bënin mirë ta lexonin e ta zbatonin.

Pjesërisht ajo shpall: “Ne, Presidencia e Parë dhe Këshilli i të Dymbëdhjetë Apostujve të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, solemnisht shpallim se martesë midis një burri dhe një gruaje shugurohet nga Perëndia dhe se familja është thelbësore në planin e Krijuesit për destinacionin e përjetshëm të fëmijëve të Tij”.²

“Perënditë zbritën për të organizuar njeriun sipas shëmbëlltyrës së tyre, në shëmbëlltyrën e Perëndive për ta formuar atë, mashkull dhe femër për t’i formuar ata.

Dhe Perënditë thanë: Ne do t’i bekojmë. Dhe . . . ne do t’i bëjmë të jenë të frytshëm dhe të shumëzohen e të mbushin tokën, dhe ta nënshtrojnë atë.”³

Ky urdhërim kurrë nuk është shfuqizuar.

“Dhe ne do t’i provojmë me këtë, për të parë nëse ata do t’i bëjnë të gjitha gjërat që Zoti, Perëndia i tyre, do t’i urdhërojë.”⁴

Është paracaktuar që ne të jemi të lumtur, sepse “njerëzit janë, që ata të mund të kenë gëzim.”⁵

Lehi la mësim që njerëzit janë të lirë dhe duhet të jenë “të lirë . . . të veprojnë për veten e tyre dhe të mos detyrohen të veprojnë me përjashtim të ndëshkimit nga ligji, në ditën e madhe dhe të fundit”.⁶

Thënia e lashtë: “Zoti voton pro meje dhe Luciferi voton kundër meje, por rëndësi ka vota ime”, përshkruan një siguri doktrinale që liria jonë e zgjedhjes është më e fuqishme se dëshira e kundërshtarit. Liria e zgjedhjes

është e çmuar. Ne, pa mend e verbërisht, mund ta falim, por ajo nuk mund të na merret me forcë.

Gjithashtu ka një shfajësim të lashtë: “Djali më detyroi ta bëja”. Nuk është ashtu! Ai mund t’ju mashtrorë dhe udhëheqë gabim, por ai nuk ka fuqi t’ju detyrojë juve apo këdo tjetër drejt shkeljes apo t’ju mbajë në shkelje.

Mirëbesimi me fuqinë për të krijuar jetë mbart me vete gëzimet më të mëdha dhe tundimet më të rrezikshme. Dhurata e jetës tokësore dhe aftësia për të krijuar jetë të tjera është një bekim hyjnor. Nëpërmjet ushtrimit të drejtë të kësaj fuqie, si në asgjë tjetër, ne mund t’i afrohemi Atit tonë në Qiell dhe të përjetojmë një plotësi të gëzimit. Kjo fuqi nuk është pjesë e rastësishme e planit të lumturisë. Ajo është çelësi – çelësi i vetëm.

Qoftë nëse e përdorim këtë fuqi siç urdhërojnë ligjet e përjetshme, qoftë nëse refuzojmë qëllimin e saj hyjnor; kjo do të ndikojë përgjithmonë se kush ne do të bëhemi. “A nuk e dini ju se jeni tempulli i Perëndisë dhe se Fryma e Perëndisë banon në ju?”⁷

Ka diçka tepër çliruese kur një individ vendos me vetë vullnetin e lirë të tij apo të saj që të jetë i bindur ndaj Atit tonë e Perëndisë tonë dhe ia shpreh atë gatishmëri Atij në lutje.

Kur bindemi, ne mund t’i gëzojmë këto fuqi në besëlidhjen e martesës. Prej burimeve tona të jetës do të vijnë fëmijët tanë, familja jonë. Dashuria midis bashkëshortit dhe bashkëshortes mund të jetë e vazhdueshme e të sjellë përmbushje dhe kënaqësi tërë ditë e jetës sonë.

Nëse dikujt i janë mohuar këto bekime në vdekshmëri, premtimi është se atyre do t’u jepet në botën që do të vijë.

Dashuria e pastër nënkupton që vetëm pas një zotimi për besnikëri të

përjetshme, një ceremonie juridike dhe të ligishme, dhe idealisht pas ordinancës së vulosjes në tempull, ato fuqi jetëkrijuese lihen për shprehjen e plotë të dashurisë. Duhet të ndahen veçanërisht dhe vetëm mes burrit dhe gruas, bashkëshortit dhe bashkëshortes, me atë që është shoku apo shoqja jonë e përjetshme. Ungjilli është shumë i qartë në këtë.

Ne jemi të lirë të mos i pranojmë urdhërimet, por, kur zbulosat flasin me terma kaq të qartë, si “nuk do të”, më mirë t’i kushtojmë vëmendje.

Kundërshtari është ziliqar ndaj gjithkujt që ka fuqi për të sjellë jetë. Satani nuk mund të sjellë jetë; ai është i pafuqishëm. “Ai kërkon që të gjithë njerëzit të jenë të mjeruar sikurse është ai vetë.”⁸ Ai kërkon të pakësojë përdorimin e drejtë të fuqive jetëkrijuese duke ju tunduar në marrëdhënie të pamoralshme.

Zoti përdori shprehjen “i ngjan”, për të krijuar një ngjashmëri që pasuesit e Tij të mund ta kuptonin, si:

“Mbretëria e qiejve i ngjan një tregtari.”⁹

“Mbretëria e qiejve i ngjan një thesari të fshehur në një arë.”¹⁰

Në ditët tona, ndikimi i tmerrshëm i pornografisë i ngjan një murtaje që përfshin tejpertej botën, duke infektuar një këtu e një aty, duke u përpjekur në mënyrë të pamëshirshme të pushtojë çdo shtëpi, më shpesh nëpërmjet bashkëshortit e babait. Ndikimi i kësaj murtaje mund të jetë, fatkeqësisht, shpesh është, shpirtërisht shkatërrimtar. Luciferi kërkon të përçajë “planin e madh të shëlbimit”¹¹, “planin e madh të lumturisë”.¹²

Pornografia gjithmonë do të zbrapsë Shpirtin e Krishtit dhe do të ndërpresë komunikimet midis Atit tonë Qiellor e fëmijëve të Tij dhe do të përçajë marrëdhënien e butë midis bashkëshortit dhe bashkëshortes.

Priftëria mban fuqinë më të lartë. Ajo mund t’ju mbrojë nga murtaja e pornografisë – dhe ajo është murtajë – nëse po i jepeni ndikimit të saj. Nëse një njeri është i bindur, priftëria mund t’i tregojë sesi të ndërpresë një zakon dhe madje fshijë një varësi. Mbajtësit e priftërisë e kanë atë autoritet dhe duhet ta përdorin atë për të luftuar ndikimet e liga.

Ne ngremë një alarm dhe i paralajmërojmë anëtarët e Kishës që të zgohen e të kuptojnë se çfarë po ndodh. Prindër jini vigilentë, përherë syhapur se mos kjo ligësi kërcënon rrethin tuaj familjar.

Ne japim për mësim një standard të sjelljes morale që do të na mbrojë nga shumë prej zëvendësuesëve apo sajësavëve të Satanit për martesën. Ne duhet të kuptojmë që, cilado përpjekje për t’ju bindur të hyni në ndonjë marrëdhënie që nuk është në harmoni me parimet e ungjillit, duhet të jetë e



gabuar. Nga Libri i Mormonit mësojmë se “ligësia kurrë nuk ka qenë lumturi”.¹³

Disa mendojnë që ata kanë qenë të paracaktuar dhe nuk mund t’i kapërcejnë ato që ata ndiejnë se janë tundime të lindura drejt shthurjes dhe kundër natyrës. Nuk është ashtu! Kujtoni, Perëndia është *Ati* ynë Qiellor.

Pali premtoi se: “Perëndia . . . nuk do të lejojë që t’ju tundojnë përtej fuqive tuaja, por me tundimin do t’ju japë dhe rrugë dalje, që ju të mund ta përballoni”.¹⁴ Ju mundeni, nëse dëshironi, të ndërprisni zakone e të mposhtni një varësi dhe të largoheni prej asaj që nuk është e denjë për asnjë anëtar të Kishës. Ashtu si porositi Alma, ne duhet “të [jemi] vigilentë, dhe të [lulitemi] vazhdimisht”.¹⁵

Isaia paralajmëroi: “Mjerë ata që e quajnë të mirë të keqen dhe të keqe të mirën, që ndërrojnë terrin në dritë dhe dritën në terr, që ndërrojnë hidhësirën në ëmbëlsi dhe ëmbëlsinë në hidhësi!”¹⁶

Vite më parë vizitova një shkollë në Albëkerki. Mësuesja më tregoi për një fëmijë që solli një kotele në klasë. Siç mund ta merrni me mend, kjo ndërpreu çdo gjë. Ajo i kërkoi ta ngrinte kotelen para fëmijëve.

Shkoi mirë derisa një prej fëmijëve pyeti: “A është kotele çun apo kotele gocë?”

Duke mos dashur t’i hynte atij mësimi, mësuesja tha: “Nuk ka rëndësi. Është thjesht një kotele.”

Por ata ngulën këmbë. Më në fund, një djalë ngriti dorën dhe tha: “Unë e di si mund ta dalloni”.

E detyruar të përballej me këtë, mësuesja tha: “Si mund ta dallosh?”

Dhe studenti u përgjigj: “Ju mund të votoni për këtë!”

Ju mund të qeshni me këtë histori, por, nëse nuk jemi vigilentë, ka nga ata sot që, jo vetëm tolerojnë, por



mbrojnë votimin për të ndryshuar ligje që do të ligjëronin imoralitetin, sikur një votë të ndryshonte në ndonjë mënyrë qëllimet e ligjeve dhe të natyrës së Perëndisë. Një ligj kundër natyrës do të ishte e pamundur të imponohej. Për shembull, çfarë dobie do të kishte një votë kundër ligjit të rëndesës?

Ka ligje edhe morale, edhe materiale “të [shpallura] në mënyrë të pakthyeshme në qiell, përpara krijimit të kësaj bote”, që nuk mund të ndryshohen.¹⁷ Historia vërteton papushim se standardet morale nuk mund të ndryshohen me betejë dhe nuk mund të ndryshohen me votim. Ligjërimi i asaj që është në parim e gabuar apo e ligë, nuk do të pengojë dhimbjen dhe ndëshkimet që do të pasojnë me aq siguri, sa nata pason ditën.

Pavarësisht kundërshtimit, ne jemi të vendosur të qëndrojmë në shteg. Ne do të mbahemi tek parimet e ligjet dhe ordinancat e ungjillit. Nëse ato keqkuptohen ose me patëkeq, ose qëllimisht, ashtu qoftë. Ne nuk mund të ndryshojmë, ne nuk do të ndryshojmë standardin moral. Ne menjëherë e humbasim drejtimin tonë kur nuk i bindemi ligjeve të Perëndisë. Nëse nuk mbrojmë dhe nuk kujdesemi për familjen, qytetërimi dhe liritë tona me siguri do të zhduken.

“Unë, Zoti, lidhem kur ju bëni çfarë ju them; por kur nuk e bëni çfarë ju them, ju nuk keni premtim.”¹⁸

Çdo shpirt i mbyllur në një burg mëkati, faji apo zvetënimi e ka një çelës për portën. Çelësi ka etiketën “pendim”. Nëse dini se si ta përdorni këtë çelës, kundërshtari nuk mund t’ju ndalë. Parimet binjake të pendimit dhe të faljes, për nga fuqia e tejkalojnë forcën e tmerrshme të tunduesit. Nëse jeni kufizuar nga një zakon apo varësi që është e padenjë, ju duhet të ndaloni sjelljen që është e dëmshme. Engjëj do t’ju mësojnë¹⁹ dhe udhëheqës të priftërisë do t’ju drejtojnë përmes atyre periudhave të vështira.

Askund nuk shfaqen më shume bujaria e mirësia dhe mëshira e Perëndisë, sesa në pendim. A e kuptoni fuqinë më të lartë pastruese të Shlyerjes së bërë nga Biri i Perëndisë, Shpëtimtari ynë, Shëlbuesi ynë? Ai tha: “Unë, Perëndia, i kam vuajtur këto gjëra për të gjithë, që ata të mos vuajnë nëse do të pendohen.”²⁰ Në atë akt hyjnor të dashurisë Shpëtimtari pagoi ndëshkimet për mëkatet tona, që ne të mos na duhej të paguanim.

Për ata që e dëshirojnë me të vërtetë, ka një rrugë kthimi. Pendimi ngjan me një detergjent. Edhe njollat e rrënjësura të mëkatit do të pastrohen.

Mbajtësit e priftërisë mbajnë me vete kundërhelmin për të hequr imazhet e tmerrshme të pornografisë dhe për të larë fajin. Priftëria ka fuqinë për të çliruar nga ndikimi i zakoneve tona, madje për të liruar nga varësia, sado i fortë ndikimi sundues. Ajo mund të shërojë shenjat e mëkateve të kaluara.

Unë nuk di fjalë më të bukura e ngushëlluese në të gjithë zbulesën, sesa këto: “Vini re, ai që është penduar për mëkatet e tij, po ai falet dhe unë, Zoti, nuk i kujtoj më ato”²¹.

Ndonjëherë, edhe pas rrëfimit dhe vuajtjes së ndëshkimit, pjesa më e vështirë e pendimit është të falësh vetveten. Ju duhet të arrini të shquani që falja do të thotë falje.

“Kurdo që njerëzit e mi pendohen, unë do t’ua fal shkeljet që kanë bërë kundër meje.”²²

Presidenti Jozef Filding Smith tregoi për një grua të penduar që po përpiquej të gjente rrugëdaljen e saj nga një jetë tepër e pamoralshme. Ajo e pyeti se çfarë duhej të bënte tani.

Si përgjigje, ai i kërkoi t’i lexonte nga Dhjata e Vjetër historinë e gruas së Lotit që u shndërrua në një statujë prej kripe.²³ Pastaj e pyeti: “Çfarë mësimi merr nga këto vargje?”

Ajo u përgjigj: “Zoti do të shkatërrtojë të ligjtë”.

“Nuk është ashtu!” Presidenti Smith tha se mësimi për këtë grua të penduar dhe për ju është: “Mos shih prapa!”²⁴

Mjaft çuditërisht, parandalimi më i thjeshtë e i fuqishëm dhe kura për pornografinë, apo ndonjë vepër të papastër, mund të jetë ta shpërfillësh e ta shmangësh atë. Fshini nga mendja ndonjë mendim të padenjë që përpiqet të zërë rrënjë. Kur të keni vendosur të qëndroni të pastër, ju po mbron lirinë tuaj të zgjedhjes, të dhënë nga Perëndia. Dhe atëherë, siç këshilloi Presidenti Smith: “Mos shihni prapa”.

Unë premtoj se përpara jush ka paqe e lumturi për ju dhe familjen tuaj. Qëllimi përfundimtar i të gjithë veprimtarisë në Kishë është që një burrë dhe gruaja e tij dhe fëmijët e tyre të mund të jenë të lumtur në shtëpi. Dhe unë lutem për bekimet e Zotit mbi ju që po luftoni kundër kësaj murtaje të tmerrshme, për të gjetur shërimin që është i disponueshëm për ne në priftërinë e Zotit. Unë jap dëshmi për atë fuqi në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 1:20.
2. “Familja: Një Proklamim Drejtuar Botës”, *Liahona*, tetor 2004, f. 49.
3. Abrahami 4:27–28.
4. Abrahami 3:25.
5. 2 Nefi 2:25.
6. 2 Nefi 2:26.
7. 1 Korintasve 3:16.
8. 2 Nefi 2:27.
9. Mateu 13:45.
10. Mateu 13:44.
11. Jakobi 6:8; Alma 34:31.
12. Alma 42:8.
13. Alma 41:10.
14. 1 Korintasve 10:13.
15. Alma 13:28.
16. Isaia 5:20.
17. Doktrina e Besëlidhje 130:20.
18. Doktrina e Besëlidhje 82:10.
19. Shih 2 Nefi 32:3.
20. Doktrina e Besëlidhje 19:16.
21. Doktrina e Besëlidhje 58:42.
22. Mosia 26:30.
23. Shih Zanafilla 19:26.
24. Shih Bojd K. Paker, *The Things of the Soul* (1996), f. 116.



Nga Plaku Xhei E. Xhensen,
i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

Fryma e Shenjtë dhe Zbulesa

Fryma e Shenjtë është anëtari i tretë i Kreut-Perëndi dhe, me Atin dhe Birin, Ai i di të gjitha gjërat.

Si plak i ri unë ndodhesha në terrenin e misionit për rreth një vit dhe ndërsa po lexoja shkriimet e shenjta dhe fjalët e apostujve të ditëve të mëvonshme mbi zbulesën dhe Frymën e Shenjtë, pata një zgjim shushatës. Unë nuk kisha dëshmi timen, posaçërisht për Atin dhe Birin. Shkova në mision duke jetuar në dritën e marrë hua nga prindërit e mi të mrekullueshëm. Duke mos dyshuar kurrë në fjalët e tyre, unë nuk kisha menduar të kërkoja dëshminë time shpirtërore. Në një natë shkurti në San Antonio, Teksas, në 1962, unë e dija se duhej ta dija nga vetja ime. Në apartamentin tonë të vogël unë gjeta një vend ku mund të lutesha qetësisht me zë, duke kërkuar: “Atë Qiellor, a je atje? Unë dua ta di vetë?”

Pak më vonë atë natë unë arrita ta di vetë për herë të parë në jetën time se Perëndia dhe Jezusi janë të vërtetë. Unë nuk dëgjova zë të dëgjueshëm as pashë genie qiellore. Unë e dija në të njëjtën mënyrë si ju gjithashtu mund të keni arritur të dini – që është “me anë të dhuratës së papërshkrueshme të Frymës së Shenjtë” (DeB 121:26) dhe shpirtit të zbulesës (shih DeB 8:1–3), që i fliste paqe mendjes sime (shih

DeB 6:23) dhe sigurime zemrës sime (shih Alma 58:11).

Nga ajo përvojë, unë dëshmovava këshillën e Almës që të “[zgjoj dhe të vë në veprim aftësitë e mia], madje deri në një provë mbi fjalët e [Tij]” (Alma 32:27). Këto fjalë ose fara janë shndërruar në pemë, në të vërtetë pemë të dëshmisë. Procesi vazhdon me më shumë prova mbi fjalët, duke rezultuar në pemë të tjera të dëshmisë, tani një pyll i vërtetë mbështetur në zbulesën nëpërmjet dhe nga Fryma e Shenjtë.

Fryma e Shenjtë është një Dhuratë e Dëshiruar.

Kur Shpëtimtari vizitoi Amerikën Ai thirri dymbëdhjetë dishepuj. Një nga mesazhet e Tij drejtuar atyre dhe popullit, ishte mbi Frymën e Shenjtë. Pasi u mësoi atyre, Shpëtimtari u largua dhe premtoi të kthehej ditën tjetër. Njerëzit punuan gjithë natën për të mbledhur sa më shumë njerëz që ishte e mundur që ta dëgjonin Atë.

Dishepujt mblodhën popullin në 12 grupe për t’i mësuar atë që Shpëtimtari u kishte mësuar atyre. Kryesorja ndër mësimet e tyre ishte rëndësia e Frymës së Shenjtë. (Shih 3 Nefi 11–18.) Pastaj njerëzit u gjunjëzuan dhe u

lutën. Dëshira e tyre e zemrës ishte t'u jepej Fryma e Shenjtë. (shih 3 Nefi 19:8–9).

Shpëtimtari iu shfaq atyre dhe përforcoi rëndësinë e Frymës së Shenjtë ndërsa Ai iu lut Atit:

“Atë, të falënderoj që u dhe Frymën e Shenjtë këtyre që unë kam zgjedhur; . . .

Atë, të lutem që t'u japësh Frymën e Shenjtë të gjithë atyre që besojnë në fjalët e tyre.” (3 Nefi 19:20–21).

Nga kjo ngjarje e Librit të Mormonit, unë e kuptoj më mirë përse Presidenti Uilford Udraf tha: “që dhurata e Frymës së Shenjtë është dhurata më e madhe që mund t'i jepet një njeriu. . . .

[Ajo] nuk kufizohet te burrat, as tek apostujt apo profetët; ajo i përket çdo burri dhe gruajë besnike dhe çdo fëmije që është rritur aq sa të marrë ungjillin e Krishtit” (*Teachings of Presidents of the Church: Wilford Woodruff* (2004), f 49).

Zbulesa Jep Përgjigje në Kohë Nevoje

Fryma e Shenjtë është anëtar i tretë i Kreut-Perëndi dhe, me Atin dhe Birin, Ai i di të gjitha gjërat (shih DeB 35:19; 42:17). Ai ka disa role të rëndësishme, ndër to mbi të gjitha është të japë mësim dhe të dëshmojë për Atin dhe Birin (shih 3 Nefi 28:11). Role të tjerë janë që Ai zbulon të vërtetën e të gjitha gjërave (shih Moroni 10:5) dhe Ai udhëheq për të bërë mirë. (see DeB 11:12).

Presidenti Monson është shembull i këtij roli të rëndësishëm të njeriut që udhëhiqet për të bërë mirë. Ai ndjek shembullin e Shpëtimtarit “i cili e përshkoi vendin duke bërë mirë” (Veprat e Apostujve 10:38). Ai u ka mësuar njerëzve rëndësinë e mos anashkallimit të nxitjes shpirtërore nga Fryma e Shenjtë për të vizituar dikë dhe për t'i shërbyer atij apo asaj dhe për ta shpëtuar atë.

Por ndonjëherë, nuk gjendet në kohë nevoje askush si Presidenti Monson, as mësues shtëpie, as motër që përkujdeset, në dispozicion për të shërbyer në kohë nevoje. Në ato situata unë kam arritur të gjej lehtësim dhe drejtim nga Ngushëlluesi, një rol tjetër i Frymës së Shenjtë (shih DeB 36:2).

Nipi ynë Kuinton lindi me defekte të shumëfishta dhe jetoi tri javë pa mbushur vitin, kohë në të cilën ai u shtrua dhe doli nga spitali. Motra Xhensen dhe unë jetonim në Argentinë asaj kohe. Ne vërtet donim që të ishim atje me fëmijët tanë për t'i ngushëlluar dhe për t'u ngushëlluar prej tyre. Ky ishte nipi që ne e donim dhe dëshironim t'i ndodheshim pranë. Ne mundeshim vetëm të luteshim dhe ne e bëmë këtë me zjarr!

Motra Xhensen dhe unë ishim në një turne misioni kur morëm lajmin

se Kuintoni kishte vdekur. Ne qëndruam në paradhomën e shtëpisë së mbledhjeve dhe përqafuam dhe ngushëlluam njëri-tjetrin. Unë ju dëshmoj se na erdhi një siguri nga Fryma e Shenjtë, një paqe që tejkalon çdo zgjarësi dhe vazhdon deri sot (shi Filipianëve 4:7). Ne gjithashtu u bëmë dëshmitarë të dhuratës së përshtatshme të Frymës së Shenjtë në jetën e birit dhe të nuses sonë dhe të fëmijëve të tyre, që deri sot flasin për atë kohë me një besim, paqe dhe ngushëllim të tillë.

Zbulesa dhe Libri i Mormonit

E njëjta dhuratë e zbulesës ka ndikuar në dëshminë time për Librin e Mormonit. Unë e kam lexuar, studiuar, kërkuar dhe agjësuar për të përsëri dhe përsëri. Fryma e Shenjtë ka zbuluar për mua të vërtetën dhe shenjtërinë e tij.

Misionarë kohëplotë dhe një motër në Las Kaobas të Republikës Dominikane, përgatiten për një shërbim pagëzimi ndërmjet sesioneve të konferencës së përgjithshme.





Presidenti Gordon B. Hinkli e quajti Librin e Mormonit një nga katër gurët kryesorë të qoshes të Kishës, bashkë me Vegimin e Parë të Jozef Smithit, rivendosjen e priftërisë dhe sigurisht dëshminë tonë për Jezu Krishtin, guri kryesor i qoshes (shih Efesianëve 2:19–21). “Këto katër dhurata të mëdha të dhëna nga Perëndia”, shpjegoi ai, “janë gurët e patundur qoshes që mbajnë Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, si dhe dëshmitë dhe bindjet personale të anëtarëve të saj” (“Four Cornerstones of Faith,” *Liahona*, shkurt 2004, f. 7).

Këto katër dhurata të dhëna nga Perëndia janë bërë spirancat e besimit dhe të dëshmisë sime, secili i konfirmuar tek unë nga zbulesa nëpërmjet Frymës së Shenjtë. Sidoqoftë, për disa minuta, unë do të doja të përqendrohem në dy nga këto dhurata gurë të qoshes – Vegimi i Parë dhe Libri i Mormonit. Është domethënëse që secili fillon në një mjedis familjar, ku fëmijët lindën nga prindër të perëndishëm dhe u mësuan mirë prej tyre (shih 1 Nefi 1:1). Ngjarjet në jetën e Lehit dhe të Jozef Smithit janë paralele të njëra-tjetrës (shih 1 Nefi 1 dhe Joseph Smith – Historia 1):

- Secili ka një nevojë të veçantë. E Lehit është të shpëtojë veten dhe familjen e tij nga shkatërrimi i afërt i Jeruzalemit dhe e Jozef Smithit të dijë cila kishë është e vërtetë.
- Secili lutet.
- Secili ka një vegim të Atit dhe të Birit.
- Secilit i është dhënë një libër.
- Të dy luten.
- Secili merr zbulesë nga Fryma e Shenjtë dhe nga vizionet dhe ëndrrat.
- Së fundi, njerëz të ligj i kërcënojnë ata. Lehi dhe familja e tij shpëtojnë dhe mbijetojnë. Jozefi martirizohet.

A ka ndonjë çudi që misionarët i ftojnë kërkuesit e sinqertë të së vërtetës të fillojnë studimin e Librit të Mormonit te 1 Nefi? Ky libër është *i ngjeshur* me Shpirtin e Zotit. Në këto kapituj të parë ka një mesazh të qartë se zbulesa dhe Fryma e Shenjtë u jepen jo vetëm profetëve por gjithashtu etërve, nënave dhe fëmijëve.

Mesazhi mbi zbulesën dhe Frymën e Shenjtë vazhdon nëpër gjithë Librin e Mormonit. Këto të vërteta janë përmbledhur nga Profeti Jozef Smith: “Hiq Librin e Mormonit dhe zbulesat dhe ku mbetet feja jonë? Ne

nuk kemi asgjë” (*Teachings of Presidents of the Church: Joseph Smith* [2007], f. 196).

Si shenjtore të ditëve të mëvonshme, ne kemi dëshmi për Librin e Mormonit që na janë dhënë nëpërmjet zbulesës, duke na siguruar se kjo fe dhe doktrinat e saj janë të vërteta (shih hyrje te Libri i Mormont).

Gjërat e Shpirtit janë të shenjta dhe të vështira për t’u shprehur. Ne, si Amoni, deklarojmë: “Vini re, unë ju them juve, unë nuk mund të tregoj as pjesën më të vogël të asaj që ndiej” (Alma 26:16).

Sidoqoftë, unë dëshmoj se Fryma e Shenjtë është i vërtetë dhe Ai është provuesi, zbuluesi, ngushëlluesi, udhëzuesi dhe mësuesi hyjnor.

Përlësisht unë sjell dëshmi se kjo Kishë e vërtetë dhe e gjallë, kjo fe, mbështetet mbi këto katër gurë qosheje. Unë dëshmoj se Jezu Krishti është në të vërtetë guri kryesor i qoshes (shih Efesianëve 2:19–21). Presidenti Tomas S. Monson është profet i Zotit dhe këta 15 burra ulur pas meje janë profetë, shikues, apostuj dhe zbulues. Ata mbajnë priftërinë e shenjtë dhe çelësat e mbretërisë. Unë i dua, i nderoj dhe i mbështes ata. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Meri N. Kuk,

Këshilltare e Parë në Presidencën e Përgjithshme të Të Rejave

Bëhu Shembull për Besimtarët

Dëshiroj t'ju ftoj të "bëh[eni] shembull për besimtarët . . . në besim dhe në dëlirësi".

Pak kohë më parë, në familjen tonë lindi Rubi e vogël. Kur po i shihja fytyrën e saj të ëmbël, u mrekullova me dijen se, përpara se të vinte në Tokë, ajo jetoi në praninë e Atit tonë Qiellor. Ajo e kishte pranuar planin e Tij të madh të lumturisë dhe kishte zgjedhur ta ndiqte Atë dhe Jezu Krishtin, Shpëtimtarin tonë.¹ Për shkak të vendimit të saj, asaj i ishte lejuar të vinte në Tokë për të përjetuar vdekshmërinë dhe për të përparuar drejt jetës së përjetshme. Me shpirtin e bashkuar me trupin e saj, Rubi ka hyrë në një kohë mësimi në të cilën ajo mund ta provojë veten, të zgjedhë të ndjekë Krishtin dhe të përgatitet që të jetë e denjë për jetën e përjetshme.

Rubi erdhi e dëlirë në këtë tokë, por, si pjesë e planit, ajo do të përballlet me sprovat e tundimeve dhe do të bëjë gabime. Megjithatë, nëpërmjet Shlyerjes së Shpëtimtarit tonë, Rubi mund të marrë falje, një plotësi të gëzimit dhe të jetë sërish e dëlirë – e gatshme të jetojë përgjithmonë në praninë e Atit tonë Qiellor.

Disa orë pas lindjes së saj, pata privilegjin ta mbaja në krahët e mi këtë fëmijë të çmuar. I thashë nënës së saj: "Oh, ne duhet t'i mësojmë Rubit

se si të jetë grua e virtetshme, e dëlirë dhe tepër e çmuar siç nënkupton emri i saj"².

Nëna e saj u përgjigj: "Po filloj që sot".

Çfarë do të bëjë nëna e Rubit që "të fillojë që sot"? Si mundemi ne si prindër, gjyshër dhe udhëheqës t'i nisim dhe mbajmë fëmijët tanë – rininë tonë – në shtegun drejt jetës së përjetshme? Ne duhet të "bëh[emi] shembull për besimtarët"³.

Profeti Brigam Jang tha: "Nuk duhet t'i lejojmë kurrë vetes të bëjmë diçka të cilën nuk duam të shohim ta bëjnë fëmijët tanë. Duhet t'u japim atë shembull që ne urojmë që ata ta kopjojnë."⁴ Secili prej nesh mund të fillojë sot duke qenë ai shembull i mirë.

Sot dëshiroj t'ju ftoj të "bëh[eni] shembull për besimtarët . . . në besim dhe në dëlirësi"⁵ – dy parime që kërkohen për shpëtim.

Bëhuni shembull për besimtarët në besim. Forconi aktivisht vetë besimin dhe dëshminë tuaj për Jezu Krishtin, duke u përgatitur kështu t'u dëshmoni me fjalë dhe shembull fëmijëve tuaj.

Më lejoni t'ju tregoj për një nënë të shkëlqyer, jeta e së cilës ishte një shembull besimi. Kur Profeti Jozef

Smith qe djalë shumë i vogël, ai vështrroi dhe mësoi për besimin në Perëndi nga nëna e tij, Lusi Mak Smith. Lusi kërkoi përgjigje duke shqyrtuar shkriimet e shenjta⁶ dhe Jozefi, gjithashtu, e përdori atë praktikë, duke iu drejtuar Biblës për udhërrëfim siç kishte bërë nëna e tij⁷.

Lusi gjithashtu i zgjidhi problemet familjare duke kërkuar privatisht ndihmën e Zotit me anë të lutjes. Një ditë, duke përjetuar mosmarrëveshje në familje në lidhje me temën e fesë, Lusi tha se "u tërhoq tek një korije me pemë qershish të egra e të bukura jo shumë larg dhe iu lut Zotit"⁸.

Lusi gjithashtu u lut me besim të madh kur u përball me çështje personale shëndeti, kur Jozefi thaujse e humbi këmbën e tij prej osteomjelitit dhe kur motra e Jozefit, Sofronia, thaujse vdiq nga ethja e tifos. Në lidhje me sëmundjen e Sofronias, Lusi shkroi: "Unë ia ngula sytë fëmijës sime. . . . Bashkëshorti im dhe unë i shtrenguam duart së bashku dhe ramë në gjunjë pranë shtratit, dhe i zbrazëm hidhërimin dhe lutjet tona në veshët e tij"⁹. Sofronia jetoi. Unë jam e sigurt se fëmijët e Lusit shpesh e panë atë të lutej me besim dhe të merrte përgjigje për ato lutje.

Lusi u lut me besim për udhëheqje dhe Jozefi gjithashtu u tërhoq tek një korije pemësh kur u lut me besim, duke pritur një përgjigje nga Zoti, ashtu si kishte bërë nëna e tij.

Ashtu si Lusi, ne duhet t'u tregojmë fëmijëve dhe rinisë sonë se si ta forcojnë besimin dhe dëshminë e tyre për Jezu Krishtin duke forcuar tonat, përmes studimit të shkrimit të shenjta dhe përmes lutjes, personalisht si dhe me ta.

Ndryshe nga Lusi, sot ne jemi bekuar të kemi më tepër se Biblën. Ne kemi shkrimet e shenjta të ditëve të mëvonshme dhe fjalët e profetëve



tanë të ditëve të mëvonshme që të na “udhëheqin të sigurt”¹⁰ në shtegun drejt jetës së përjetshme. Nga Libri i Mormoni mësojmë për ata në shteg të cilët “u mbajt[ën] vazhdimisht me vendosmëri te shufra e hekurit”¹¹, duke e përqsaur atë me “fjal[ën] e Perëndisë”¹². Në botën e sotme mbushur me tundime, “mbajt[ja] me vendosmëri” mund të jetë sfiduese, ndërsa Satani me mënyrat e tij komplotuese përpiket të na tërheqë larg nga udhët e Perëndisë. Nëse kemi një dorë në shufër dhe një dorë në botë, ne i vemë fëmijët dhe të rinjtë tanë para rrezikut që ta humbasin rrugën e tyre në shteg. Nëse shembulli ynë është pështjellues, atëherë me fjalët e Jakobit, ne e humbasim “besimin e fëmijëve [tanë], për shkak të shembujve [tanë] të këqij”¹³.

Prindër, gjyshër dhe udhëheqës, mesazhi juaj duhet të jetë i qartë. Qartësia mund të rezultojë vetëm nga pasja e të dy duarve në shufër dhe nga jetesa sipas të vërtetave që gjenden në shkrimet e shenjta dhe në fjalët e profetëve të ditëve të mëvonshme. Ju mbase nuk po rrisni një profet si Lusi, por sigurisht ju po rrisni udhëheqësit e së nesërme dhe veprimet tuaja janë po aq prekshëm të lidhura me besimin e tyre.

Tjetra, bëhuni shembull për besimtarët në dëlirësi. E vetmja mënyrë që ne të bëhemi të dëlirë është nëpërmjet Shlyerjes së Shpëtimtarit tonë. Për secilin prej nesh, procesi i bërjes të dëlirë fillon me besim, pendim dhe

besëlidhjen tonë të parë të pagëzimit.

Për t’i ndihmuar fëmijët tanë që ta jetojnë besëlidhjen e tyre të pagëzimit, Plaku Robert D. Hejls këshilloi: “Ne u mësojmë se në çastin kur dalin nga uji, ata dalin nga bota dhe hyjnë në mbretërinë e Perëndisë. Me anë të besëlidhjes, ata bien dakord t’u binden urdhërimeve të Tij.”¹⁴

“Besëlidhjet na vendosin nën një detyrim të fortë që të nderojmë zotimet tona ndaj Perëndisë. Për të mbajtur besëlidhjet tona, ne duhet të braktisim aktivitetet ose interesat që na pengojnë t’i nderojmë ato besëlidhje.”¹⁵

Broshura *Për Forcën e Rinisë* është një mjet i mrekullueshëm për ta ndihmuar rininë të kuptojë këtë detyrim të shenjtë të bërjes së besëlidhjeve dhe bekimet e dëlirësisë, që vijnë nga mbajtja e besëlidhjeve. Ajo përmban fjalë të profetëve të ditëve të mëvonshme – shufrën e hekurit, që do t’i udhëheqë ata të sigurt përgjatë shtegut të ngushtë e të ngushtuar, duke i larguar nga kurthet e Satanit, që mund ta vonojnë përparimin e tyre. Në këtë broshurë, ju do të gjeni gjithashtu bekimet e shumta që vijnë nga bindja dhe nga kërkimi i asaj që është e “virtutshme [dhe e] dashur”¹⁶.

Prindër, siguroni një kopje personale të kësaj broshure dhe lexojeni shpesh. Jetoini standardet ju vetë. Bëni bashkëbisedime të kujdesshme mbi ungjillin me rininë tuaj që do t’i ndihmojnë ata të zhvillojnë vetë dëshirën

e tyre që të jetojnë dhe zbulojnë vetë kuptimin dhe qëllimin e standardeve.

Standardet që gjenden në pjesët “Argëtimi dhe Media” dhe “Veshja dhe Pamja e Jashtme”, mund të jenë veçanërisht sfiduese sepse ato po bien gjithmonë e më tepër në kundërshtim me standardet e botës.

Ne duhet të jemi model i asaj që është e virtutshme dhe e dashur, nga zgjedhjet tona personale të medias. Ne duhet të kemi kujdes që media që ftojmë në shtëpitë tona, të mos mpijë ndjeshmërinë ndaj Shpirtit, të mos dëmtojë marrëdhëniet tona me familjet dhe miqtë tanë, apo të zbulojë përparësi personale që nuk përputhen me parimet e ungjillit. Me anë të shembullit, ne mund t’i ndihmojmë fëmijët tanë të kuptojnë se harxhimi i periudhave të gjata të kohës duke përdorur internetin, rrjetet shoqërore mediatikë dhe telefonat celularë, duke luajtur lojëra kompjuterike, apo duke shikuar televizor na pengon nga aktivitete të frytshme dhe ndërveprime të vlefshme me të tjerët.

Ne gjithashtu jemi model i asaj që është e virtutshme dhe e dashur, me anë të veshjes dhe pamjes sonë të jashtme. Si popull i besëlidhjes, ne kemi përgjegjësinë të kujdesemi, ta mbrojmë dhe ta veshim siç duhet trupin tonë. Ne duhet t’i ndihmojmë fëmijët dhe rininë tonë të kuptojnë se ne i respektojmë trupat tanë si tempuj dhe si dhuratat nga Perëndia¹⁷. Ne e japim shembullin duke refuzuar të blejmë ose veshim rroba të



paturpshme që janë tepër të ngushta, tepër të tejdukshme, ose që ekspozojnë në çfarëdo mënyre tjetër.

Mbajtësit e besëlidhjeve përpiqen fort të jenë të bindur “në të gjitha kohërat . . . dhe në të gjitha vendet”¹⁸ për shkak të dashurisë së tyre për Perëndinë dhe të bekimeve të premtuara prej Tij. Një mbrëmje, ndërsa po shëtisja me bashkëshortin tim, kaluam pranë një feste martese që po zhvillohej në mjedis të hapur. Nuk i njihnim ata njerëz, por patëm menjëherë një mbresë virtyti. Zgjedhjet e tyre të muzikës dhe të veshjeve qenë të këndshme. Fustani rrezatues i nuses që padyshim modest, ashtu siç qenë fustanet e shoqëruesëve të saj. Kjo familje zgjodhi të mos i përziehte udhët e botës me shenjtërinë e asaj dite.

Tani, më lejoni t’i them një fjalë rinisë së mrekullueshme të Kishës sonë. Faleminderit për shembujt tuaj të drejtë ndaj miqve, mësuesve, udhëheqësve dhe familjeve tuaja. E pranoj se shumë prej jush jeni të vetmit anëtarë të Kishës në familjen tuaj. Ju madje mund të vini në kishë të vetëm. Unë ju

lavdëroj për angazhimin dhe shembullin tuaj të drejtë. Kini durim dhe vazhdoni të jetoni drejtësisht. Ka shumë vetë që mund t’ju ndihmojnë juve. Presidenti Tomas S. Monson tha: “Edhe një familje shembullore . . . mund të përdorë gjithë ndihmën mbështetëse që arrin të marrë nga njerëz të mirë që kujdesen sinqerisht”¹⁹.

Kërkoni nëpër lagjen dhe kunjin tuaj udhëheqës dhe miq që janë shembuj për besimtarët, dhe mësoni prej tyre.

Kur isha e re, unë dallova shembuj të besimtarëve. Përveç prindërve të mi, njëra ishte tetoja ime Karma Katler. Më kujtohet gjallërisht ajo ndërsa fliste një natë mbi standardet në kunj, kur isha 16 vjeçe. Ajo na mësoi mbi rëndësinë e të qenit të dëlira dhe të denja për një martesë në tempull. U preka thellë nga dëshmia e saj. E kisha vërejtur jetën e saj të virtytshme që kur isha vajzë fare e vogël, dhe e dija se përputhej me mësimet e saj. Dëshiroja ta ndiqja shembullin e saj.

Të rinj e të reja, *ju* mund të filloni sot duke qenë një shembull për besimtarët në besim dhe dëlirësi. Forcojeni

çdo ditë besimin dhe dëshminë tuaj nëpërmjet studimit të shkrimit të shenjtë dhe lutjes. Mbajeni besëlidhjen tuaj të pagëzimit, që do t’ju mbajë të dëlirë e të denjë për udhëheqjen e Frymës së Shenjtë. Ju mund të filloni sot të bëheni ai shembull që të tjerët ta ndjekin.

Dhe nuk mund ta dish kurrë – ju mund të jeni shembulli, që mund t’i duhet ndonjë ditë Rubit time të vogël. Për tani, Rubi ka një nisje të shkëlqyer në shtegun drejt jetës së përjetshme. Prindërit e saj po vendosin modele drejtësie në shtëpinë e saj, duke e nisur çdo ditë me një vendosmëri për të qenë shembuj për besimtarët. Shpresoj që, duke përdorur lirinë e saj të zgjedhjes, Rubi do të vendosë t’i ndjekë.

Unë jam mirënjohëse për planin e lumturisë dhe dëshmoj se është e vetmja mënyrë se si Rubi – dhe secili prej nesh – mund të jetë sërish i dëlirë dhe të jetojë përgjithmonë në praninë e Atit tonë Qiellor. Secili prej nesh e filloftë sot. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Abrahami 3:22–26.
2. Shih Fjalët e Urta 31:10.
3. 1 Timoteut 4:12.
4. *Teachings of Presidents of the Church: Brigham Young* (1997), f. 173.
5. 1 Timoteut 4:12.
6. Shih Lucy Mack Smith, *History of Joseph Smith by His Mother*, red. Scot Facer Proctor and Maurine Jensen Proctor (1996), f. 50.
7. Shih Joseph Smith – Historia 1:11–12.
8. Smith, *History of Joseph Smith*, f. 58.
9. Smith, *History of Joseph Smith*, f. 69.
10. “The Iron Rod”, *Hymns*, nr. 274.
11. 1 Nefi 8:30.
12. 1 Nefi 11:25.
13. Jakobi [LiM] 2:35.
14. Robert D. Hales, *Return: Four Phases of Our Mortal Journey Home* (2010), f. 60.
15. *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2004), f. 63.
16. Nenet e Besimit 1:13.
17. Shih 1 Korintasve 3:16.
18. Mosia 18:9.
19. Tomas S. Monson, “Shembuj Drejtësie”, *Liahona*, maj 2008, f. 66.



Nga Plaku Dallin H. Oaks,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Dy Linja Komunikimi


Ne duhet të përdorim edhe linjën vetjake, edhe linjën e priftërisë në drejtpeshimin e duhur për të arritur rritjen që është qëllimi i jetës së vdekshme.

Ati ynë Qiellor u ka dhënë fëmijëve të Tij dy linja komunikimi me Të – të cilat ne mund t'i quajmë linja vetjake dhe linja e priftërisë. Të gjithë duhet të kuptojmë dhe të drejtohem nga të dyja këto linja thelbësore të komunikimit.

I. Linja Vetjake

Në linjën vetjake, ne i lutemi drejtpërdrejt Atit tonë Qiellor dhe Ai na përgjigjet neve nëpërmjet kanaleve që ka krijuar, pa ndonjë ndërmjetësues të vdekshëm. Ne lutemi tek Ati ynë Qiellor në emër të Jezu Krishtit dhe Ai na përgjigjet neve nëpërmjet Shpirtit të Tij të Shenjtë dhe në mënyra të tjera. Misioni i Frymës së Shenjtë është të dëshmojë për Atin dhe Birin (Shih Gjoni 15:26; 2 Nefi 31:18; 3 Nefi 28:11), që të na drejtojë ne tek e vërteta (shih Gjoni 14:26; 16:13), dhe të na tregojë neve gjëra që duhet t'i shohim (shih 2 Nefi 32:5). Kjo linjë vetjake e komunikimit me Atin tonë Qiellor nëpërmjet Shpirtit të Tij të Shenjtë është burimi i dëshmisë sonë për të vërtetën, për njohurinë tonë dhe për drejtimin tonë vetjak nga një Atë Qiellor i dashur. Është një karakteristikë thelbësore e planit të Tij të mrekullueshëm të ungjillit, që e lejon secilin nga fëmijët e Tij të marrë një dëshmi vetjake për vërtetësinë e tij.

Kanali i drejtpërdrejtë vetjak i komunikimit me Atin tonë Qiellor nëpërmjet Frymës së Shenjtë bazohet te denjësia dhe është aq thelbësor sa që ne jemi urdhëruar të përtërijmë besëlidhjet tona duke marrë pjesë në sakrament çdo ditë Shabati. Në këtë mënyrë ne kualifikohemi për premtimin që ne të mund të kemi gjithmonë pranë Shpirtin e Tij që të na drejtojë.



Në këtë linjë vetjake të komunikimit me Zotin, besimi dhe praktika jonë është e ngjashme me atë të atyre të krishterëve që këmbëngulin se ndërmjetësit njerëzorë midis Perëndisë dhe njeriut janë të panevojshëm, sepse të gjithë kanë qasje të drejtpërdrejtë te Perëndia, sipas parimit që përqafoi Martin Luteri, që sot njihet si “priftëria e të gjithë besimtarëve”. Unë do të flas më shumë për këtë më pas.

Linja vetjake është e një rëndësie kulmore në vendimet vetjake dhe në drejtimin e familjes. Fatkeqësisht, disa anëtarë të kishës sonë e nënvlef-tësojnë nevojën për këtë linjë të drejtpërdrejtë vetjake. Ngaqë është sigurisht e rëndësishme udhëheqja profetike – linja e priftërisë, që vepron në radhë të parë për të drejtuar komunikimet hyjnore në çështjet e Kishës – disa kërkojnë që udhëheqësit e tyre të priftërisë të marrin vendime vetjake për ta, vendime që ata duhet t'i marrin vetë nëpërmjet frymëzimit në linjën e tyre vetjake. Vendimet vetjake dhe të drejtimit familjar janë parimisht çështje të linjës vetjake.

Unë e ndiej se duhet të shtoj dy porosi të tjera që ne duhet t'i kujtojmë në lidhje me këtë linjë vetjake të çmuar, të drejtpërdrejtë të komunikimit me Atin tonë Qiellor.

E para, në plotësinë e saj linja vetjake nuk funksionon e pavarur nga linja e priftërisë. Dhurata e Frymës së Shenjtë – mjeti i komunikimit nga Perëndia te njeriu – jepet nga autoriteti i priftërisë, kur autorizohet nga ata që mbajnë çelësa priftërie. Ajo nuk fitohet thjesht nga dëshira apo besimi. Dhe e drejta për shoqërimin e vazhdueshëm të këtij Shpirti është e nevojshme të pohohet në çdo Shabat kur ne marrim pjesë denjësisht në sakrament dhe përtërijmë besëlidhjet tona të pagëzimit për bindje dhe shërbim.



Në mënyrë të ngjashme, ne nuk mund të komunikojmë në mënyrë të besueshme nëpërmjet linjës së drejtpërdrejtë vetjake nëse ne jemi të pabindur ndaj linjës së priftërisë ose jo në përputhje me të. Zoti ka thënë se: “fuqitë e qiellit nuk mund të kontrollohen, as përdoren, veçse mbi bazën e parimeve të drejtësisë” (DeB 121:36). Fatkeqësisht, është e zakonshme për persona që shkelin urdhërimet e Perëndisë apo janë të pabindur ndaj këshillës së udhëheqësve të tyre të priftërisë, të deklarojnë se Perëndia u ka zbuluar atyre se ata janë të justifikuar të mos u binden disa urdhërimeve apo të mos ndjekin disa këshilla. Të tillë persona mund të jenë duke marrë zbuluesë apo frymëzim, por nuk është prej burimit që ata supozojnë. Djalli është ati i gënjeshtreve dhe ai përherë dëshiron të pengojë punën e Perëndisë nëpërmjet imitimeve të tij të shkathta.

II. Linja e Priftërisë

Ndryshe nga linja vetjake, në të cilën Ati ynë Qiellor komunikon me ne drejtpërdrejt nëpërmjet Frymës së Shenjtë, linja e komunikimit e priftërisë ka ndërmjetësit shtesë dhe të

nevojshëm, që janë Shpëtimtari ynë Jezu Krishti; Kisha e Tij; dhe udhëheqësit e caktuar të Tij.

Për shkak të asaj që Ai bëri me sakrificën e Tij shlyese, Jezu Krishti ka fuqinë të caktojë kushtet që ne duhet të përmbushim për t'u kualifikuar për bekimet e shlyerjes së tij. Kjo është arsyeja pse ne kemi urdhërime dhe ordianca. Kjo është pse ne bëjmë besëlidhje. Kjo është pse ne kualifikohemi për bekimet e premtuara. Ato të gjitha vijnë nëpërmjet mëshirës dhe hirrit të Shenjtit të Izraelit, “pas gjithçkaje që ne mund të bëjmë” (2 Nefi 25:23).

Gjatë shërbesës së Tij tokësore Jezu Krishti dha autoritetin e priftërisë që mban emrin e Tij dhe Ai krijoi një kishë që gjithashtu, mban emrin e Tij. Në këtë epokë të fundit, autoriteti i Tij i priftërisë u rivendos dhe Kisha e Tij u rikrijua nëpërmjet mesazheve nga Qielli drejtuar Profetit Jozef Smith. Kjo priftëri e rivendosur dhe kjo Kishë e rikrijuar janë në qendër të linjës së priftërisë.

Linja e priftërisë është kanali me të cilin Perëndia u ka folur fëmijëve të Tij nëpërmjet shkrimeve të shenjta në kohët e shkuara. Dhe është kjo linjë nëpërmjet së cilës, Ai aktualisht flet

nëpërmjet mësimëve e këshillave të profetëve dhe apostujve të gjallë dhe udhëheqësve të tjerë të frymëzuar. Kjo është mënyra me të cilën ne marrim ordiancat e kërkuara. Kjo është mënyra me të cilën ne marrim thirrje për të shërbyer në Kishën e Tij. Kisha e Tij është rruga dhe priftëria e Tij është fuqia nëpërmjet së cilës, ne privilegjuohemi të marrim pjesë në ato veprimtari të përbashkëta që janë thelbësore për të përmbushur punën e Zotit. Këto përfshijnë predikimin e ungjillit, ndërtimin e tempujve dhe të kishave dhe ndihmën për të varfërit.

Në lidhje me këtë linjë të priftërisë, besimi dhe praktika jonë është e ngjashme me këmbënguljen e disa të krishterëve që ceremonitë autoritare (sakramentet) janë thelbësore dhe duhet të kryhen nga një i autorizuar dhe i zgjedhur nga Jezu Krishti (shih Gjoni 15:16). Ne besojmë të njëjtën gjë, por sigurisht ndryshojmë nga të krishterët e tjerë nga mënyra që e kemi arritur atë autoritet.

Disa anëtarë ose ish anëtarë të Kishës sonë nuk arrijnë ta njohin rëndësinë e linjës së priftërisë. Ata nënvleftësojnë rëndësinë e Kishës dhe të udhëheqësve të saj e programeve

të saj. Duke u mbështetur tërësisht në linjën vetjake, ata shkojnë në rrugën e tyre, duke pretenduar të krijojnë doktrinë dhe të drejtojnë organizata rivalizuese në kundërshtim me mësimet e profetëve-udhëheqës. Me këtë ata pasqyrojnë armiqësinë moderne ndaj asaj që me përcmim quhet “fe e organizuar”. Ata që nuk pranojnë nevojën për fe të organizuar nuk pranojnë punën e Mjeshtrit, që krijoi Kishën e Tij dhe zyrtarët e saj në kohën e lashtë dhe që i rivendosën ato në kohët moderne.

Feja e organizuar, e krijuar nga autoritet hyjnor, është thelbësore, siç na mësoi Apostulli Pal:

“Për përsosjen e shenjtoreve, për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit,

derisa të arrijmë të gjithë te uniteti i besimit dhe të njohjes së Birit të Perëndisë, te një njeri i përsosur, në masën e shtatit të plotësisë së Krishtit” (Efesianëve 4:12–13).

Ne duhet të gjithë të kujtojmë thënien e Zotit në zbulesën moderne se

zëri i shërbëtorëve të Zotit është zëri i Zotit (shih DeB 1:38; 21:5; 68:4).

Unë dëshiroj të shtoj dy porosi që ne duhet të kujtojmë në lidhje me besimin tonë te linja jetike e priftërisë.

E para, linja e priftërisë nuk e zëvendëson nevojën për linjën vetjake. Ne të gjithë kemi nevojë për dëshmi vetjake të së vërtetës. Me përparimin e besimit tonë, ne natyrshëm mbështetemi në fjalët dhe besimin e të tjerëve, si prindërit, mësuesit apo udhëheqësit e priftërisë (shih DeB 46:14). Por nëse ne varemi vetëm nga një udhëheqës i veçantë priftërie apo mësues për dëshminë tonë vetjake për të vërtetën, në vend që ta marrim atë dëshmi nëpërmjet linjës vetjake, ne do të jemi gjithmonë të prekshëm nga zhgënjimi prej veprimit të atij personi. Kur është puna për një njohuri apo dëshmi të pjekur të së vërtetës, ne nuk duhet të jemi të varur nga një ndërmjetës i vdekshëm midis nesh dhe Atit tonë Qiellor.

E dyta, si edhe linja vetjake, linja e priftërisë nuk mund të funksionojë plotësisht dhe siç duhet në dobinë tonë përveç kur ne jemi të denjë dhe të bindur. Shumë shkrime të shenjta na mësojnë se nëse vijojmë në shkelje serioze të urdhërimeve të Perëndisë ne do “të dëbohe[mil] nga prania e tij” (Alma 38:1). Kur ajo ndodh, Zoti dhe shërbëtorët e Tij kanë një kufizim të fortë për të na dhënë neve ndihmë shpirtërore dhe ne nuk mund ta arrijmë atë vetë.

Historia na jep një shembull të gjallë të rëndësisë së shërbëtorëve të Zotit të përgatitur të komunikojnë me Shpirtin. Profeti i ri Jozef Smith nuk mundej të përkthente kur ishte i inatosur apo i turbulluar.

David Uitmeri kujtonte: “Një mëngjes kur ai ishte duke u përgatitur për të vazhduar përkthimin, diçka nuk shkonte me shtëpinë dhe ai u zemërua për këtë. Diçka që Ema,

bashkëshortja e tij, kishte bërë. Oliveri dhe unë u ngjitëm sipër dhe Jozefi erdhi atje shpejt më pas për të vazhduar përkthimin, por ai nuk mund të bënte asgjë. Ai nuk mund të përkthente asnjë rrokje. Ai zbriti shkallët, jashtë në kopshtin me fruta dhe iu lut Zotit; pati kaluar rreth një orë – u kthye përsëri në shtëpi, i kërkoi falje Emës dhe pastaj erdhi sipër ku qemë ne dhe përkthimi vazhdoi në rregull. Ai nuk mund të bënte asgjë, po të mos ishte i përlurur dhe besnik.”¹

III. Nevoja për Të Dyja Linjat

Unë do të përfundoj me shembuj të tjerë lidhur me nevojën për të dyja linjat që Ati ynë Qiellor ka krijuar për komunikim me fëmijët e Tij. Të dyja linjat janë thelbësore për qëllimin e Tij për të bërë të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e fëmijëve të Tij. Një tregim i hershëm në shkrimet e shenjta për këtë nevojë, është këshilla e vjehërrit Jethro që Moisiu nuk duhet të përpiqet të bëjë aq shumë. Njerëzit po prisnin për udhëheqësin e tyre të priftërisë nga mëngjesi deri në mbrëmje për “për t’u këshilluar me Perëndinë” (Eksodi 18:15) dhe gjithashtu që të “[g]ykojë] njërin dhe tjetrin” (vargu 16). Ne shpesh vërejmë se si Jethro e këshillonte Moisiun të caktojë gjykatës për të trajtuar konfliktet vetjake (shih vargjet 21–22). Por Jethro gjithashtu, i dha Moisiut një këshillë që ilustron rëndësinë e linjës vetjake: “Mësoju atyre statutet dhe ligjet dhe tregoju rrugën nëpër të cilën duhet të ecin dhe atë që [ata] duhet të bëjnë” (vargu 20; theksimi shtuar).

Me fjalë të tjera, izraelitëve që shkonin pas Moisiut duhej t’u mësohej që të mos ia paraqisnin çdo çështje atij udhëheqësi të priftërisë. Ata duhej të kuptonin urdhërimet dhe të kërkonin frymëzim për të zgjidhur vet shumicën e problemeve.





Ngjarje të kohëve të fundit në Kili ilustrjnë nevojën e të dyja linjave. Kili pësoi një tërmet shkatërrimtar. Shumë nga anëtarët tanë humbën shtëpitë; disa humbën anëtarë të familjes. Shumë humbën besimin. Shpejt – sepse Kisha jonë është e përgatitur t’u përgjigjet shkatërrimeve të tilla, – u siguruan ushqime, strehë dhe ndihma të tjera materiale. Shenjtorët e Kilit dëgjuan zërin e Zotit nëpërmjet Kishës së Tij dhe udhëheqësve të saj që iu përgjigjën nevojave të tyre materiale. Por sado e fortë linja e priftërisë, ajo nuk ishte e mjaftueshme. Çdo anëtar pati nevojë ta kërkojë Zotin në lutje dhe të marrë mesazhin e drejtpërdrejtë të ngushëllimit dhe të drejtimit që vjen nëpërmjet Frymës së Shenjtë tek ata që kërkojnë dhe mbajnë vesh.

Puna jonë misionare është një shembull tjetër i nevojës për të dyja linjat. Burrat dhe gratë që janë thirrur të jenë misionarë, janë të denjë dhe me vullnet për shkak të mësimave që kanë marrë nëpërmjet linjës së priftërisë dhe të dëshmisë që ata kanë marrë nëpërmjet linjës vetjake. Ata janë thirrur nëpërmjet linjës së priftërisë.

Pastaj, si përfaqësues të Zotit dhe nën drejtimin e linjës së Tij të priftërisë, ata mësojnë kërkuesit. Kërkues të sinqertë të së vërtetës mbajnë vesh dhe misionarët i nxisin ata të lutën për të ditur vet të vërtetën e mesazhit nëpërmjet linjës vetjake.

Një shembull i fundit lidhet me ato parime të temës së autoritetit të priftërisë në familje dhe në Kishë.² I gjithë autoriteti i priftërisë në Kishë funksionon nën drejtimin e njërit që mban çelësat e duhur të priftërisë. Kjo është linja e priftërisë. Por autoriteti që kryeson në familje – qoftë babai apo nëna prind i vetëm – funksionon në çështje familjare pa qenë nevojë të merret autorizim nga ndonjë që mban çelësat e priftërisë. Ai është si linja vetjake. Të dyja linjat duhet të jenë duke funksionuar në jetën tonë familjare dhe në jetën tonë personale, nëse ne duhet të kemi rritje dhe të arrijmë destinacionin e përcaktuar nga plani i Atit tonë Qiellor për fëmijët e Tij.

Ne duhet të përdorim edhe linjën vetjake, edhe linjën e priftërisë në drejtpeshimin e duhur për të arritur rritjen që është qëllimi i jetës

së vdekshme. Nëse praktika fetare vetjake mbështetet me tepëri në linjën vetjake, individualizmi e fshin rëndësinë e autoritetit hyjnor. Nëse praktika fetare vetjake mbështetet me tepëri në linjën e priftërisë, rritja individuale çalon. Fëmijët e Perëndisë kanë nevojë për të dyja linjat për të arritur destinacionin e tyre të përjetshëm. Ungjilli i rivendosur na i mëson të dyja, dhe Kisha e rivendosur i siguron të dyja.

Unë dëshmoj për profetin e Zotit, Presidentin Tomas S. Monson, i cili mban çelësat që drejtojnë linjën e priftërisë. Unë dëshmoj për Zotin Jezu Krisht, kisha e të cilit kjo është. Dhe unë dëshmoj për ungjillin e rivendosur, e vërteta e të cilit mund të mësohet nga secili prej nesh nëpërmjet linjës së çmueshme vetjake me Atin tonë Qiellor. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Në "Letter from Elder W. H. Kelley," *The Saints' Herald*, 1 mars 1882, f. 68. Një tregim i ngjashëm citohet në B. H. Roberts, *A Comprehensive History of the Church*, 1:131.
2. Shih Dallin H. Oaks, "Autoriteti i Priftërisë në Familje dhe në Kishë", *Liahona*, nëntor 2005, f. 24–27.



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Dhurata Hyjnore e Mirënjohjes

Një zemër mirënjohëse . . . rezulton nga shprehja e mirënjohjes Atit tonë Qiellor për bekimet e Tij dhe atyre përreth nesh për gjithçka që ata sjellin në jetën tonë.

Ky ka qenë një sesion i mrekullueshëm. Kur u caktova President i Kishës, thashë: “Do marr një detyrë për vete. Do jem këshilluesi për Korin e Tabernakullit”. Jam shumë krenar për korin tim!

Një herë mamaja ime tha për mua: “Tomi, jam shumë krenare për gjithçka që ke bërë. Por kam një vërejtje për të të bërë. Ti duhet të kishe vazhduar me pianon.”

Kështu që shkova tek pianoja dhe luajta një numër muzikor për të: “Ja ku po shkojmë, [ja ku po shkojmë] në një festë ditëlindjeje”¹. Pastaj i dhashë një puthje në ballë dhe ajo më përqafoi.

Mendoj për të. Mendoj për babain tim. Mendoj për të gjithë ata Autoritete të Përgjithshme që kanë ndikuar tek unë dhe për të tjerë, përfshirë të vejat që vizitoja – 85 prej tyre – me një pulë për furrën, ndonjëherë me pak para për xhepin e tyre.

Vizitova njërën vonë një natë. Ishte mesnatë dhe shkova tek shtëpia e pleqve dhe recepionistja tha: “Jam e sigurt që është duke fjetur, por më tha që ta zgjoj me çdo kusht, sepse ajo tha: ‘E di se do të vijë’”.

I mbajta dorën; ajo më thirri në emër. Ishte plotësisht zgjuar. Ajo ma shtrëngoi dorën duke e puthur dhe tha: “E dija se do vije”. Si të mos vija?

Ashtu më prek mua muzika e bukur.

Vëllezër e motra të mia të dashura, ne kemi dëgjuar mesazhe të frymëzuarara të së vërtetës, të shpresës dhe të dashurisë. Mendimet tona janë kthyer drejt Atij që shleu mëkatet tona, që na tregoi mënyrën si të jetojmë dhe si të lutemi; dhe që tregoi nëpërmjet vetë veprimeve të Tij bekimet e shërbimit – madje Zoti dhe Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti.

Në librin e Llukës, kapitulli 17, ne lexojmë për Të:

“Dhe ndodhi që duke udhëtuar për në Jeruzalem, ai kaloi nëpër Samari dhe Galile.

Dhe, kur po hynte në një fshat, [takoi] para dhjetë lebrozë, të cilët ndaluan larg,

dhe duke ngritur zërin, thanë: “Mjeshtër, Jezus, ki mëshirë për ne.”

Dhe ai, si i pa, u tha atyre: “Shkoni e paraqituni te priftërinjtë”. Dhe ndodhi që, ndërsa ata po shkonin, u pastruan.

Dhe një nga ata, si e pa se u shërrua, u kthye mbrapa dhe përlëvdonte Perëndinë me zë të lartë.

Dhe ra përmbys me fytyrë për tokë te këmbët e Jezusit, duke e falënderuar. Ky ishte Samaritan.

Jezusi atëherë filloi të thotë: “A nuk u shërruan që të dhjetë? Ku janë nëntë të tjerët?

A nuk gjet asnjë që të kthehet për të dhënë lavdi Perëndisë, përveç këtij të huaj?”

Dhe ai i tha atij: “Çohu dhe shko; besimi yt të shëroi.”²

Përmes ndërhyrjes hyjnore, ata që ishin lebrozë u shpëtuan nga një vdekje mizore dhe e ngadaltë dhe iu dha një mundësi e re në jetë. Mirënjohja e shprehur prej njërit meritoi bekimin e Zotit, mosmirënjohja e treguar nga të nëntët meritoi zhgënjimin e Tij.

Vëllezër e motra të mia, a kujtohem të japim falënderime për bekimet që marrim? Dhënia e sinqertë e falënderimeve jo vetëm na ndihmon të njohim bekimet tona, por gjithashtu hap dyert e qiellit dhe na ndihmon të ndiejmë dashurinë e Perëndisë.

Miku im i dashur Presidenti Gordon B. Hinkli tha: “Kur ecni në jetë me mirënjohje, ju nuk ecni me kryelartësi e krekosje dhe egoizëm; ju ecni me një shpirt falënderimi që ju ka hije dhe do të bekojë jetën tuaj.”³

Në librin e Mateut, në Bibël, ne kemi një tjetër rrëfim për mirënjohjen, këtë herë si një shprehje nga Shpëtimtari. Ndërsa udhëtoi në shkretëtirë për tre ditë, më shumë se 4000 njerëz e ndoqën dhe udhëtuan me Të. Ai pati mëshirë për ta, sepse nuk kishin ngrënë gjatë gjithë tre ditëve. Dishepujt e Tij, gjithsesi, pyetën: “Po ku mund të gjejmë në këtë vend të shkretë aq bukë sa të ngopim një turmë kaq të madhe?” Si shumëkush prej nesh, dishepujt panë vetëm atë që mungonte.



“Dhe Jezusi u tha atyre: ‘Sa bukë keni?’ [Dishepujt] thanë: ‘Shtatë dhe pak peshq të vegjël’.

Atëherë [Jezusi] u dha urdhër turmave që të uleshin përtokë.

Pastaj i mori shtatë bukët dhe peshqit, *falënderoi*, i theu dhe ua dha dishepujve të tij, dhe dishepujt turmës.”

Vini re se Shpëtimtari falënderoi për atë që kishin – dhe një mrekulli vijoi: “Dhe të gjithë hëngrën dhe u ngopën; dhe ngritën tepricën e copave, shtatë kosha plot.”⁴

Ne të gjithë kemi përjetuar periudha kur vëmendja jonë më tepër qëndron tek ajo që na mungon, sesa tek bekimet tona. Filozofi grek Epiktitus tha: “Është njeri i mençur ai që nuk vlerësohet për gjërat që nuk ka, por gëzohet për ato që ka.”⁵

Mirënjohja është një parim hyjnor. Zoti shpalli, nëpërmjet një zbuluese dhënë Profetit Jozef Smith:

“Falënderoje Zotin, Perëndinë tënd, në gjithçka. . . .

Dhe në asgjë nuk e fyen njeriu Perëndinë apo kundër askujt nuk ndizet zemërimi i tij, përveç atyre që nuk e pohojnë dorën e tij në gjithçka.”⁶

Në Librin e Mormonit na thuhet që të “jetoni çdo ditë me falënderime për

mëshirat dhe bekimet e shumta që [Perëndia] ju jep”⁷.

Pavarësisht rrethanave tona, secili prej nesh ka shumë për të qenë mirënjohës, sikur vetëm të ndaleshim e të mendonim bekimet tona.

Kjo është një periudhë e mrekullueshme për të qenë në tokë. Ndërkohë që sot ka shumë nga ajo që është e gabuar në botë, ka shumë gjëra që janë të drejta dhe të mira. Ka martesat që ia dalin, prindërit që i duan fëmijët e tyre dhe sakrifikojnë për ta, miq që kujdesen për ne dhe na ndihmojnë, mësues që japin mësim. Jetët tona janë bekuar në mënyra të panumërta.

Ne mund të ngremë shpirtërisht veten dhe gjithashtu të tjerët, kur refuzojmë të mbetemi në arenën e mendimit negativ dhe kultivojmë brenda zemrës sonë zakonet e mirënjohjes. Nëse mosmirënjohja futet mes mëkateve serioze, atëherë mirënjohja zë vendin e saj mes virtyteve më fisnike. Dikush ka thënë se “mirënjohja nuk është vetëm më e madhërishmja e virtyteve, por prindi i të gjitha të tjerave”⁸.

Si mund të kultivojmë brenda zemrave tona zakonet e mirënjohjes? Presidenti Jozef F. Smith, i gjashti President i Kishës, ofroi një përgjigje.

Ai tha: “Njeriu mirënjohës sheh kaç shumë gjëra në botë për të qenë falënderues, dhe për të e mira ia tejkallon të ligës. Dashuria e mposht zilinë dhe drita e largon errësirën nga jeta e tij.”

Ai vijoi: “Krenaria shkatërron mirënjohjen tonë dhe ngre egoizmin në vend të saj. Sa më të lumtur jemi në prani të një shpirti mirënjohës e të dashur dhe sa të kujdesshëm duhet të jemi për të kultivuar, nëpërmjet një jete plot lutje, një zakon falënderimi kundrejt Perëndisë dhe njeriut!”⁹

Presidenti Smith po na shpjegon që një jetë plot lutje është çelësi për fitimin e mirënjohjes.

A na bëjnë pasuritë materiale të lumtur dhe mirënjohës? Ndoshta për çastin. Megjithatë, ato gjëra që sigurojnë lumturi dhe mirënjohje të thellë e që zgjat janë gjëra që paratë nuk mund t’i blejnë: familjet tona, ungjilli, miqtë e mirë, shëndeti ynë, aftësitë tona, dashuria që marrim prej atyre që kemi përreth. Fatkeqësisht, këto janë disa prej gjërave që ne ia lejojmë vetes t’i marrim pa i vlerësuar.

Autori anglez Aldous Haksli shkroi: “Shumica e qenieve njerëzore kanë pothuaj një aftësi të pafundme për t’i marrë gjërat si të mirëqena.”¹⁰

Ne shpesh marrim si gjëra të mirëqena pikërisht njerëzit që meritojnë më shumë mirënjohjen tonë. Le të mos presim derisa të jetë tepër vonë për ne për të shprehur atë mirënjohje. Duke folur për njerëzit e dashur që kishte humbur, një burrë e tregoi keqardhjen e tij kështu: “Më kujtohen ato ditë të lumtura dhe shpesh dëshiroj që të mund të shpreh në veshët e të vdekurit mirënjohjen që e merituan në jetë dhe që iu kthye aq keq”¹¹.

Humbja e njerëzve të dashur sjell pothuaj në mënyrë të pashmangshme keqardhje në zemrën tonë. Le t’i zvogëlojmë ndjenja të tilla me sa më shumë njerëzi të jetë e mundur, duke



ua shprehur shpesh dashurinë dhe mirënjohjen tonë. Ne kurrë nuk e dimë se sa shpejt do të jetë tepër vonë.

Një zemër mirënjohëse, pra, rezulton nga shprehja e mirënjohjes. Atit tonë Qiellor për bekimet e Tij dhe atyre përreth nesh për gjithçka që ata sjellin në jetën tonë. Kjo kërkon përpjekje të ndërgjegjshme – të paktën, derisa vërtet të kemi mësuar dhe kultivuar një zakon mirënjohjeje. Shpesh ne ndihemi mirënjohës dhe *kemi ndër mend* t'i shprehim falënderimet tona, por harrojmë ta bëjmë ose thjesht nuk arrijmë ta bëjmë. Dikush ka thënë se “të ndiesh mirënjohje dhe të mos e shprehësh atë, është si të mbështjellësh një dhuratë dhe të mos e japësh”¹².

Kur hasim sfida dhe probleme në jetën tonë, shpesh është e vështirë për ne të përqendrohemi tek bekimet tona. Megjithatë, nëse kërkojmë mjaftueshëm thellë dhe vështrojmë mjaftueshëm fort, ne do të jemi në gjendje të ndiejmë dhe të kuptojmë pikërisht se sa shumë na është dhënë.

Po ju tregoj një histori për një familje e cila qe në gjendje të gjente bekime në mes sfidash të rënda. Kjo është një histori që e lexova shumë vite më parë dhe e kam ruajtur për shkak të mesazhit që përcjell. U shkrua nga Gordon Grin dhe u shfaq në një revistë amerikane mbi 50 vjet më parë.

Gordoni tregon se si u rrit në një fermë në Kanada, ku atij dhe vëllezërve e motrave të tij u duhej të nxitonin për në shtëpi pas shkolle, ndërsa fëmijët e tjerë luanin me top dhe shkonin të notonin. Gjithsesi, babai i tyre pati aftësinë t'i ndihmonte të kuptonin që puna e tyre vlente diçka. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë pas kohës së korjes, kur familja festonte Ditën e Falënderimit, sepse në atë ditë babai i tyre i jepte një dhuratë të mrekullueshme. Ai bënte një inventar të gjithçkaje që kishin.

Mëngjesin e Ditës së Falënderimit ai i çonte tek qilari me fuçi të mollëve, kova me panxhar, karota të paketuara në rërë dhe male thasësh me patate si edhe bizele, misër, bishtaja, pelte, luleshtrydhe dhe ushqime të tjera të konservuara që mbushnin raftet e tyre. Ai i vinte fëmijët të numëronin çdo gjë me kujdes. Pastaj ata dilnin jashtë në hangar dhe llogaritnin sa ton bar të thatë kishte aty dhe sa shinikë grurë në hambar. Ata numëronin lopët, derrat, zogjtë, gjelat e detit dhe patat. Babai u thoshte se donte të shihte si ishin sistemuar, por ata e dinin se, në të vërtetë, ai donte që ata të kuptonin në atë ditë feste se me sa bollëk Perëndia i kishte bekuar dhe i kishte shpërblyer për gjithë orët e tyre të punës. Së fundmi, kur uleshin në gostinë që nëna e tyre kishte përgatitur, bekimet ishin diçka që ata i ndienin.

Gordoni, megjithatë, vuri në dukje se Dita e Falënderimit që ai e kujtonte me më shumë falënderim, ishte viti në të cilin dukej se nuk kishin asgjë për të cilën të ishin mirënjohës.

Viti nisi mbarë: ata kishin tepëricë bari të thatë, plot farëra, katër pjella derrash dhe babai i tyre kishte ca para mënjanë, në mënyrë që një ditë të mund të ishte në gjendje të blinte një ngarkues bari – një makinë e mrekullueshme që shumica e fermerëve thjesht ëndërronin ta kishin. Gjithashtu qe viti që energjia elektrike hyri në qytetin e tyre – megjithëse jo tek ata, sepse ata nuk ishin në gjendje.

Një natë, kur nëna e Gordonit po lante një parg të madh rrobash, i ati hyri dhe mori radhën tek dërrasa e larjes së rrobave dhe i kërkoi së shoqes të çlodhej e të bënte punimin e saj me shtiza. Ai tha: “Ti harxhon më shumë kohë duke larë se duke fjetur. A mendon se duhet të dorëzohemi dhe të marrim energjinë elektrike?” Megjithëse e ngazëllyer nga e ardhmja, ajo derdhi një apo dy lot kur mendoi për ngarkuesin e barit që nuk do të blihej.

Kështu që linja elektrike u ngjit lart deri tek rrugica e tyre atë vit. Megjithëse nuk qe ndonjë gjë e jashtëzakonshme, ata morën një makinë larëse që punonte gjithë ditën vetë dhe llamba dritash të shkëlqyeshme që vareshin në çdo tavan. Nuk kishte më fenerë për t'u mbushur me vaj, jo më



fitila për t'u prerë, jo më oxhak tërë blözë për t'u pastruar. Krejt fenerët u kaluan në papafingo.

Ardhja e energjisë elektrike në fermën e tyre, ishte pothuaj gjëja e fundit e mirë që u ndodhi atë vit. Sapo të mbjellat e tyre po fillonin të dilnin nga toka, filluan shirat. Kur më në fund uji u tërhoq, nuk kishte mbetur asnjë bimë gjëkund. Ata i mbollën prapë, por më shumë shira i goditën të mbjellat në tokë. Patatet e tyre u kalbën në baltë. Ata shitën dy lopë dhe të gjithë derrat dhe gjënë e gjallë tjetër që kishin pasur ndërmend të mbanin, duke marrë çmime shumë të ulta për to, sepse gjithkujt tjetër i duhej të bënte po të njëjtën gjë. Gjithçka që korrën atë vit, ishte një ngastër rrepash që njëfarësoj i kishte mbijetuar stuhive.

Atëherë erdhi përsëri Dita e Falënderimit. Mamaja e tyre tha: "Ndoshta më mirë ta harrojmë atë këtë vit. Nuk na ka mbetur madje as një patë."

Gjithsesi, mëngjesin e Ditës së Falënderimit, babai i Gordonit erdhi me një lepur të madh dhe i kërkoi së shoqes ta gatuate. Qejfprishur, ajo filloi punën, duke nënkuptuar se do të kërkonte shumë kohë për t'u gatuar ajo gjëja e vjetër me mish të fortë. Kur, më në fund, ai u vendos në tryezë me disa prej rrepave që kishin mbijetuar, fëmijët refuzuan që të hanin. Nëna e Gordonit qau dhe atëherë babai i tij bëri diçka të çuditshme. Ai u ngjit në papafingo, mori një fener me vaj, e solli sërish në tryezë dhe e ndezi.

U tha fëmijëve të shkëpusnin dritat elektrike. Kur ishte sërish vetëm feneri, ata mezi mund ta besonin që kishte qenë aq errët më përpara. Çuditëshin se si kishin parë ndonjëherë diçka pa dritat e shndritshme të mundësuar nga energjia elektrike.

Ushqimi u bekua dhe gjithkush hëngri. Kur darka mbaroi, ata të gjithë u ulën qetësisht. Gordonit shkroi:

"Në zbehtësinë e përlurur të fenerit të vjetër ne po fillonim të shihnim qartë përsëri. . . .

[Qe] një vakt i këndshëm. Lepuri i vjetër shijoi si gjeldeti dhe rrepat ishin më të butat që mund të kujtoheshin. . . .

. . . Shtëpia [jonë] . . . , me gjithë mungesat e saj, ishte aq e pasur [për] ne."¹³

Vëllezër e motra të mia, të shprehësh mirënjohje është e hirshme dhe e respektueshme; të vësh në veprim mirënjohjen është bujare dhe fisnike por, të jetosh përgjithmonë me mirënjohje në zemër, është si të prekësh qiellin.

Ndërsa e mbyll këtë paradite, lutja ime është që, përveç çdo gjëje tjetër për të cilën jemi mirënjohës, të mund të pasqyrojmë përherë mirënjohjen tonë për Zotin dhe Shpëtimtarin tonë, Jezu Krishtin. Ungjilli i tij i lavdishëm u jep përgjigje pyetjeve të mëdha të jetës: Nga kemi ardhur? Përse jemi këtu? Ku shkojnë shpirtrat tanë kur vdesim? Ai ungjill u sjell atyre që jetojnë në errësirë, dritën e së vërtetës hyjnore.

Ai na mësoi si të lutemi. Ai na mësoi si të jetojmë. Ai na mësoi si të vdesim. Jeta e Tij është një trashëgimi dashurie. Të sëmuret Ai i shëroi; të shtypurit Ai i ngriti; mëkatarin Ai e shpëtoi.

Së fundmi, Ai qëndroi i vetëm. Disa Apostuj dyshuan; njëri e tradhtoi Atë. Ushtarët romakë shpuan ijën e Tij. Turma e zemëruar i mori jetën Atij. Por ende ushtojnë, që nga kodra e Golgotës, fjalët e Tij të mëshirshme: "O Atë,

fali ata sepse nuk dinë ç'bëjnë"¹⁴.

Kush ishte ky "Njeri dhembjesh, . . . i familjarizuar me vuajtjen"?¹⁵ "Kush është ky Mbret i lavdisë"¹⁶, ky Zot i zotërve? Ai është Zoti ynë. Ai është Shpëtimtari ynë. Ai është Biri i Perëndisë. Ai është Vepronjësi i Shpëtimtari Tonë. Ai na bën shenjë: "Ndiqmëni!"¹⁷ Ai udhëzon: "Shko dhe bëj kështu edhe ti"¹⁸. Ai lutet: "Zbatoni urdhërimet e mia"¹⁹.

Le ta ndjekim Atë. Le të matemi me shembullin e Tij. Le t'u bindemi fjalëve të Tij. Duke bërë kështu, ne i japim Atij dhuratën hyjnore të mirënjohjes.

Lutja ime e sinqertë nga zemra është që ne të mund të pasqyrojmë në jetët tona individuale atë virtyt të mrekullueshëm të mirënjohjes. Depërtoftë ajo thellësisht shpirtrat tanë, tani dhe përherë. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, Shpëtimtarit tonë, amen. ■

SHËNIME

1. Xhon Tompson, "Birthday Party", *Teaching Little Fingers to Play* (1936), f. 8.
2. Lluca 17:11-19.
3. *Teachings of Gordon B. Hinckley* (1997), f. 250.
4. Shih Mateu 15:32-38; theksimi është shtuar.
5. *The Discourses of Epictetus; with the Encheiridion and Fragments*, përkthyer nga George Long (1888), f. 429.
6. Doktrina e Besëlidhje 59:7, 21.
7. Alma 34:38.
8. Cicero, në *A New Dictionary of Quotations on Historical Principles*, përzgjedhur nga H. L. Mencken (1942), f. 491.
9. Jozef F. Smith, *Gospel Doctrine*, botimi i 5-të (1939), f. 263.
10. Aldous Huxley, *Themes and Variations* (1954), f. 66.
11. William H. Davies, *The Autobiography of a Super-Tramp* (1908), f. 4.
12. William Arthur Ward, në Allen Klein, përmbledhje, *Change Your Life!* (2010), f. 15.
13. Përshtatur nga H. Gordon Green, "The Thanksgiving I Don't Forget", *Reader's Digest*, nëntor 1956, f. 69-71.
14. Lluca 23:34.
15. Isaia 53:3.
16. Psalmi 24:8.
17. Mateu 4:19.
18. Lluca 10:37.
19. Gjoni 14:15.



Nga Plaku L. Tom Perri,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Priftëria e Aaronit

Priftëria që ju mbani, është një dhuratë e veçantë, sepse dhuruesi është Vetë Zoti. Përdoreni atë, lartësojeni atë dhe jetoni të denjë për të.

Kur flisja në një konferencë të përgjithshme 25 vite përpara, unë paraqita një ndihmesë pamore që qëndronte pranë meje. Ishte nipi im më i madh. Ai pati marrë së fundi priftërinë Aarone dhe ishte shuguruar dhjak. Unë përfitova nga ai rast për t'i drejtuar vërejtjet e mia mbi rëndësinë e marrjes së priftërisë Aarone.

Unë i thashë nipit tim:

“Unë nuk jam tepër i kënaqur me kushtet materiale që ti dhe të rinjtë e tjerë po trashëgoni ndërsa merrni përsipër rolin tuaj për të ecur drejt bu rrërimin. Ndërsa ata prej nesh që janë më të moshuar kanë qenë në një moshë dhe pozitë për ta ndikuar botën, unë besoj se ne kemi dështuar rëndë përpara jush me lejimin që të krijohen këto kushte në botë. Kjo ju vendos juve në një pozitë ku shumë nga ata me të cilët ju duhet të shoqërohemi nuk janë edukuar me një kuptim apo respekt për vlerat tradicionale. Kështu, presioni nga shokët bëhet shumë më i vështirë dhe i skajshëm.

“Ne kemi sjellë në shtëpi radiot, videomagnetofonët dhe televizorët. Ndërsa secili ka mundësinë të sigurojë argëtim të shëndetshëm, shumë nga ajo që është prodhuar për të na

kënaqur duke e dëgjuar dhe parë, nuk është e cilësisë për të frymëzuar dhe nxitur të rinjtë. Në fakt, shumë nga ajo që është prodhuar është degjeneruese. Rrotullimi i një çelësi në vetë shtëpinë tuaj ka forcën e shkatërrimit brenda jush të një ndjesie mbi atë që është e drejtë dhe atë që është e gabuar” (“I Confer the Priesthood of Aaron”, *Ensign*, nëntor 1985, f. 46).

Sa më shumë ndryshojnë gjërat, aq më shumë ato mbeten po ato – përveç teknologjisë. Unë jam i tunduar të pyes të rinjtë e Priftërisë Aarone nëse ata madje e dinë çfarë është një magnetofon. Për ata që nuk e dinë, është diçka që ne ishim mësuar të shkonim në dhomën e familjes dhe ta ndiznim që të mund të dëgjonim muzikë. Përfytyroni që – ne duhej të shkonim tek ai, në vend që ta merrnim me vete kudo.


Unë gjithashtu i mësova nipit tim Terri katër mësimet sipas historisë së Danielit në Dhiatën e Vjetër. Unë i thashë atij 1) ta mbajë trupin e tij të shëndetshëm dhe të pastër; 2) të zhvillojë mendjen e tij dhe të bëhet i urtë; 3) të jetë i fortë dhe t'i rezistojë tundimit në një botë të mbushur me të; dhe, 4) të mirëbesojë në Zot, veçanërisht kur ti ke nevojë për mbrojtjen e Tij.

Unë e mbylla këshillën për Terrin me këto fjalë: “Këto histori në shkrimet e shenja nuk do të vjetërohen kurrë. Ato do të jenë po aq emocionuese për ty kur t'i lexosh ato si dhjak, mësues, prift, misionar, mësues shtëpie, president i kuorumit të pleqve, apo çfarëdo tjetër që Zoti të thërret që ti të bësh. Ato do të të mësojnë ty të kesh besim, kurajë, dashuri për bashkëqytetarët e tu, siguri dhe besim në Zot” (*Ensign*, nëntor 1985, f. 48).

Unë jam i lumtur t'ju tregoj se Terri ka qenë besnik ndaj detyrës që i dhashë atij 25 vite më parë. Ai më vonë mori Priftërinë Melkizedeke, shërbeu një mision besnikërisht dhe aktualisht shërben si president kuorumi pleqsh dhe sigurisht është baba i një vajze të mrekullueshme.

Shumë ka ndryshuar në çerekun e fundit të shekullit. Një gjë tjetër që ka ndodhur është se shumë nga nipërit dhe mbesat e mia janë rritur dhe kanë fëmijët e tyre. Këtë verë unë pata rastin të qëndroja në një rreth mbajtësish të priftërisë dhe të vendosja duart e mia mbi kokën e stërnipit tim më të madh, ndërsa babai i tij i dha atij Priftërinë Aarone. Edhe pse stërnipi im nuk është i pranishëm në këmbë krahas meje, unë do të doja t'i drejtoja vërejtjet e mia atij dhe të gjithëve juve të rinj të mrekullueshëm që mbani Priftërinë Aarone.

Është një bekim shumë i veçantë të marrësh Priftërinë Aarone. Historia ka regjistruar ditën e lavdishme kur priftëria u rivendos në tokë, duke u dhënë burrave të drejtën që përsëri të vepronin si përfaqësues të Perëndisë kur kryenin ordinancat e shenja të priftërisë. Ishte më 5 prill 1829, kur Oliver Kaudri arriti në shtëpinë e Jozef Smithit në Harmoni të Pensilvanisë. Oliveri e pyeti Profetin Jozef Smith rreth punës së tij në përkthimin e kronikave të lashta, Librin e Mormonit.



I bindur për natyrën hyjnore të punës, Oliveri pranoi të vepronte si shkruar për përfundimin e përkthimit. Puna e përkthimit përparoi shpejt sapo Oliveri mori përsipër të shërbente si shkruar.

Më 15 maj 1829, Jozefi dhe Oliveri patën arritur te 3 Nefi. Historia e Shpëtimtarit të ringjallur që vizitonte Hemisferën Perëndimore, dhe mësimet e Tij mbi pagëzimin i drithëruan ata. Ndërsa po lexonin te 3 Nefi ata filluan të pyesnin veten mbi pagëzimin. Cila mënyrë pagëzimi ishte e saktë dhe kush kishte autoritetin ta kryente këtë ordinancë të shenjtë shpëtuese? Ata kërkuar një përgjigje për këto pyetje themelore doktrinale. Ata vendosën të kërkojnë një përgjigje me anë të lutjes dhe shkuan në një vend pranë brigjeve të lumit Suskuehana. Ata hapën zemrën e tyre dhe qiejt u hapën për ta. Një engjëll u shfaq duke u prezantuar si Gjon Pagëzori dhe i tha Jozefit dhe Oliverit se ai po vepronte nën drejtimin e Pjetrit, Jakobit dhe të Gjonit që mbanin priftërinë më të lartë (shih Jozef Smith – Historia 1:72).

Duke vendosur duart e tij mbi kokat e tyre, ai tha: “Mbi ju,

bashkëshërbëtorët e mi, në emër të Mesias, unë jap Priftërinë e Aaronit, e cila mban çelësat e shërbesës së engjëjve dhe të ungjillit të pendimit e të pagëzimit me zhytje për heqjen e mëkateve; dhe kjo nuk do të merret më kurrë nga toka, derisa bijtë e Levit vërtet t’i ofrojnë përsëri një ofertë Zotit në drejtësi (DeB 13:1).

Më vonë, Oliveri e tregoi hollësisht këtë ngjarje me këto fjalë: “Por . . . mendo, mendo më shumë për një çast çfarë gëzimi i mbushi zemrat tona dhe me çfarë habie duhej të përkuleshim ne, . . . kur morëm nën dorën e tij Priftërinë e Shenjtë”. (Jozef Smith – Historia 1:71, shënim fundfaqeje).

Pasi njerëzimi pati pritur për shekuj që autoriteti i Perëndisë të rivendosej, fuqia dhe lavdia e Priftërisë së shenjtë Aarone u rikthyen në tokë. Në seksionin 107 të Doktrinës e Besëlidhjeve, ne mësojmë pse priftëria më e vogël është quajtur Priftëria Aarone:

“Priftëria e dytë quhet Priftëria e Aaronit, sepse iu dha Aaronit dhe farës së tij, përgjatë gjithë brezave të tyre.

Përse quhet priftëria më e vogël është ngaqë ajo është një shtesë e më

të madhes ose Priftërisë Melkizedeke dhe ka fuqi në administrimin e ordinancave të jashtme. . . .

Fuqia dhe autoriteti i priftërisë më të vogël ose Aarone është të mbajë çelësat e shërbesës së engjëjve dhe të administrojë në ordinancat e jashtme, letrën e ungjillit, pagëzimit e pendimit për heqjen e mëkateve, në përputhje me besëlidhjet dhe urdhërimet” (DeB 107:13–14; 20).

Jo vetëm të rinjtë e Priftërisë Aarone marrin fuqinë dhe autoritetin që të jenë përfaqësues të Zotit në kryerjen e përgjegjësive të tyre të priftërisë, por ata gjithashtu marrin çelësat e shërbesës së engjëjve.

Të rinj të Priftërisë Aarone, unë ju dëshmoj se Zoti është lidhur me besëlidhje solemne që të bekojë jetën tuaj sipas besnikërisë suaj. Nëse do të dëgjoni me vëmendje zërin e paralajmërimit nga Fryma e Shenjtë dhe do të ndiqni udhëzimin e Tij, ju do të bekoheni me shërbesën e engjëjve. Ky bekim do ta rrisë urtësinë, diturinë, forcën dhe lavdinë në jetën tuaj. Ky është një bekim i sigurt që ju është premtuar juve nga Zoti.

Disa muaj përpara unë pata rastin të merrja pjesë në një mbledhje agjërimi dhe dëshmishë në një lagje. Njëri që u ngrit për të dhënë dëshminë e tij, ishte një këshilltar i Priftërisë Aarone. Dëshmia e tij më bëri të kem një vlerësim të ri për atë se çfarë do të thotë për një mbajtës të Priftërisë Aarone të mbajë çelësat e shërbesës së engjëjve.

Ky këshilltar përshkroi disa nga përvojat e tij me Priftërinë Aarone të lagjes atij mëngjesi. Kur po ecte drejt kishës, ai vuri re dy dhjakë të rinj me zarfa oferte të agjërimin duke shkuar në shtëpitë e anëtarëve. Atij i bëri përshtypje mënyra si ishin veshur ata me veshjet më të mira të së dielës dhe si e shihnin detyrën e tyre me një dinjitet të qetë. Pastaj ai i shoqëroi dy priftërinjtë për të administruar sakramentin në një shtëpi banimi për burra të paaftë fizikisht dhe mendërisht. Ky ishte rasti i parë për këta dy të rinj për ta vizituar këtë shtëpi dhe këshilltari i tyre vuri re mënyrën respektuese dhe dashamirëse me të cilën ata e shihnin detyrën e tyre të priftërisë.

Pastaj këshilltari tregoi një përjetim të shkurtër që preku thellë zemrën e tij, sepse një nga priftërinjtë i kujtoi atij se çfarë do të thotë në të vërtetë të jesh një shërbyes i vërtetë i Jezu Krishtit – saktësisht, një engjëll shërbyes. Prifti i ri që po shpërndante ujin në kongregacion, shkoi te një burrë që dukej se kishte një sindromë Daun (Down). Gjendja e burrit e pengoi atë të merrte kupën nga tabakaja për ta pirë. Ky prift i ri menjëherë e vlerësoi situatën. Ai vendosi dorën e tij të majtë prapa kokës së burrit që ai të mund të ishte në një pozicion për të pirë dhe me dorën e tij të djathtë mori një kupë nga tabakaja dhe me mirësi dhe butësisht e ngriti atë te buzët e burrit. Një shprehje vlerësimi u duk në fytyrën e burrit – shprehja e dikujt të cilit dikush tjetër i ka shërbyer.



Ky prift i mrekullueshëm i ri pastaj vazhdoi detyrën e tij duke shpërndarë ujin e bekuar tek anëtarët e tjerë të kongregacionit.

Këshilltari shprehu në dëshminë e tij ndjenjat që pati në atë moment të dhimbsur. Ai tha se qau heshturazi me gëzim dhe se e dinte që Kisha ishte në duar të mira me këta të rinj të dashur e të bindur, mbajtës të Priftërisë Aarone.

Presidenti Ezra Taft Benson njëherë tha: “Më jepni një të ri që e ka mbatur veten të pastër moralisht dhe ka marrë pjesë besnikërisht në mbledhjet e Kishës. Më jepni mua një të ri që ka lartësuar priftërinë e tij dhe ka fituar Çmimin Detyrë ndaj Perëndisë (Duty to God), dhe është një Skautist

Shqiponjë (Eagle Scout). Më jepni mua një të ri që ka përfunduar seminarin dhe ka një dëshmi të zjarrtë për Librin e Mormonit. Më jepni mua një të ri të tillë dhe unë do t’ju jap juve një të ri që mund të kryejë mrekullira për Zotin në fushën e misionit dhe gjatë gjithë jetës së tij” (“To the ‘Youth of the Noble Birthright’”, *Ensign*, maj 1986, f. 45).

Prindër të këtyre të rinjve dhe të rejave të mrekullueshme, ne ju ngarkojmë juve me përgjegjësinë e shenjtë që t’u mësoni fëmijëve tuaj doktrinën e priftërisë së shenjtë. Fëmijët tuaj duhet të mësojnë në moshë të hershme për bekimet e pasjes së priftërisë së përjetshme të Zotit dhe atë që duhet të

bëjnë individualisht që të kualifikohen për këto bekime.

Peshkopë, ju keni çelësat e priftërisë për të kryesuar të rinjtë e Priftërisë Aarone, që të uleni në këshill me ta dhe t'u mësoni atyre detyrat e tyre të priftërisë. Ju lutem sigurohuni që çdo i ri që është i denjë të marrë Priftërinë Aarone, të kuptojë detyrimet dhe bekimet që i vijnë atij si mbajtës i priftërisë. Ndhimoheni atë të mësojë ta lartësojë priftërinë tani duke i dhënë atij detyra të rëndësishme dhe duke e ndihmuar atë t'u shërbejë dhe të kryejë shërbesa të tjerëve.

Të rinj, unë ju ftoj juve ta ngrini jetën tuaj mbi një themel të vërtetë dhe drejtësisë. Ky është i vetmi themel që do t'u qëndrojë presioneve të kësaj jete dhe do të durojë përjetësisht. Priftëria që ju mbani, është një dhuratë e veçantë, sepse dhuruesi është Vetë Zoti. Përdoreni atë, lartësojeni atë dhe jetoni të denjë për të. Unë dua që ju të dini se unë kam një dëshmi të veçantë dhe personale për fuqinë e saj. Ajo e ka bekuar jetën time në aq shumë mënyra.

Unë gjithashtu ju ftoj juve të vendosni sot se ju do ta nderoni këtë bekim të madh dhe do të përgatiteni të përparoni në çdo detyrë të Priftërisë Aarone – dhjak, mësues dhe prift. Përgatiteni veten për bekimin e madh të marrjes së Priftërisë Melkizedeke, që ju do të keni nevojë të jeni të denjë ta merrni përpara se të shërbeni si misionar me kohë të plotë. Zoti ka nevojë për ju që ta përgatisni veten për shërbimin për Të, veçanërisht për përgjegjësinë e madhe që do të keni duke shpallur ungjillin e Tij botës. Unë ju premtoj se nëse ju do të përgatiteni të merrni priftërinë e Tij të shenjtë, Ai do të derdhë vërtet bekime mbi kokën tuaj. Këtë dëshmi unë e lë me ju në emër të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, madje Jezusit Krishtit, amen. ■



Nga Plaku Dejvid A. Bednar,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Merrni Frymën e Shenjtë

Këto katër fjalë – “Merre Frymën e Shenjtë” – nuk janë një shqiptim pasiv; përkundrazi, ato përbëjnë një urdhër priftërie një këshillim autoritar për të vepruar dhe jo thjesht që të detyrohemi të veprojmë.

Mesazhi im përqendrohet në rëndësinë e përpjekjes në jetën tonë të përditshme për ta marrë në praktikë Frymën e Shenjtë. Unë lutem dhe e ftoj Shpirtin e Zotit ta udhëzojë dhe ta ngrejë moralisht secilin prej nesh.

Dhurata e Frymës së Shenjtë

Në dhjetor 1839, ndërkohë që ishin në Uashington D.C., për të kërkuar korrigjim për padrejtësitë e bëra kundrejt shenjtoreve të Misurit, Jozef Smithi dhe Elias Higbi i shkruan Hajrëm Smithit: “Në intervistën tonë me Presidentin [e Shteteve të Bashkuara], ai na pyeti se ku ndryshonte besimi ynë nga besimet e tjera të kohës. Vëllai Jozef tha se ne ndryshonim në mënyrën e pagëzimit dhe të dhuratës së Frymës së Shenjtë me anë të vënies së duarve. Ne besonim se të gjitha ndryshimet e tjera ishin pjesë e dhuratës së Frymës së Shenjtë” (*Teachings of Presidents of the Church: Joseph Smith* [2007], f. 97).

Fryma e Shenjtë është pjesëtari i tretë i Kreut-Perëndi; ai është një

personazh i shpirtit dhe jep dëshmi për gjithë të vërtetën. Në shkrimet e shenjta, Frymës së Shenjtë i referohen si Ngushëlluesi (shih Gjoni 14:16–27; Moroni 8:26), një mësues (shih Gjoni 14:26; DeB 50:14) dhe një zbulues (shih 2 Nefi 32:5). Zbulesat nga Ati dhe Biri përçohen nëpërmjet Frymës së Shenjtë. Ai është lajmëtari dhe dëshmitari për Atin e Birin.

Fryma e Shenjtë u shfaqet burrave e grave në tokë edhe si fuqia edhe si dhurata e Frymës së Shenjtë. Fuqia mund të vijë tek një person përpara pagëzimit; ajo është dëshmia bindëse se Jezu Krishti është Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë. Nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, kërkuesit e sinqertë mund të sigurojnë një bindje për vërtetësinë e ungjillit të Shpëtimtarit, e Librit të Mormonit, e realitetit të Rivendosjes dhe e thirrjes profetike të Jozef Smithit.

Dhurata e Frymës së Shenjtë jepet vetëm pas pagëzimit të duhur e të autorizuar dhe me anë të vendosjes së duarve nga ata që mbajnë Priftërinë Melkizedeke. Zoti shpalli:

“Po, pendohuni e pagëzohuni, secili prej jush, për shlyerjen e mëkateve tuaja; po, pagëzohuni madje me ujë dhe më pas vjen pagëzimi prej zjarrit dhe prej Frymës së Shenjtë. . . .

Dhe këdo që ka besim, do ta konfirmoni në kishën time, me anë të vënies së duarve, dhe unë do t’u jap dhuratën e Frymës së Shenjtë atyre” (DeB 33:11, 15).

Apostulli Pal ua qartësoi këtë praktikë efesianëve kur pyeti:

“A e keni marrë Frymën e Shenjtë, kur besuat?” Ata iu përgjigjën: ‘Ne as që kemi dëgjuar se paska Frymë të Shenjtë’.

Dhe ai u tha atyre: ‘Me se, pra, u pagëzuat?’ Ata u përgjigjën: ‘Me pagëzimin e Gjonit’.

Atëherë Pali tha: ‘Gjoni pagëzoi me pagëzimin e pendimit, duke i thënë popullit se duhet t’i besonte atij që do të vinte pas tij, domethënë Jezu Krishtit’.

Dhe ata, si dëgjuan, u pagëzuan në emër të Zotit Jezus.

Dhe, kur Pali vuri duart mbi ta, Fryma e Shenjtë zbriti mbi ta dhe ata folën në gjuhë të tjera dhe profetizuan” (Veprat e Apostujve 19:2–6).

Pagëzimi me zhytje është “ordinanca paraprirëse e ungjillit dhe duhet të pasohet nga pagëzimi i Shpirtit që të jetë i plotë” (Bible Dictionary, “Baptism”). Profeti Jozef Smith shpjegoi se “pagëzimi është një ordinancë e shenjtë përgatitore për marrjen e Frymës së Shenjtë; është kanali dhe çelësi nga ku do të administrohet Fryma e Shenjtë. Dhurata e Frymës së Shenjtë me anë të vendosjes së duarve, nuk mund të merret nëpërmjet asnjë parimi tjetër përveç parimit të drejtësisë” (Teachings: Joseph Smith, f. 95–96).

Ordinanca e konfirmimit të një anëtari të ri të Kishës dhe dhënia e dhuratës së Frymës së Shenjtë është edhe e thjeshtë edhe e thellë. Mbajtës



të denjë të Priftërisë Melkizedeke e vendosin duart mbi kokën e një individi dhe e thërrasin atë me emër. Pastaj, me autoritetin e priftërisë së shenjtë dhe në emrin e Shpëtimtarit, individi konfirmohet anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme dhe shqiptohet kjo frazë e rëndësishme: “Merre Frymën e Shenjtë”.


Thjeshtësia e kësaj ordinance mund të bëjë që të mos e vëmë re domethënien e saj. Këto katër fjalë – “Merre Frymën e Shenjtë” – nuk janë një shqiptim pasiv; përkundrazi, ato përbëjnë një urdhër priftërie – një këshillim autoritar për të vepruar dhe jo thjeshtë që të detyrohemi të veprojmë (shih 2 Nefi 2:26). Fryma e Shenjtë nuk bëhet vepruese në jetën tonë thjeshtë sepse duart janë vendosur mbi kokë dhe ato katër fjalë të rëndësishme janë shqiptuar. Kur e marrim këtë ordinancë, secili prej nesh pranon një përgjegjësi të shenjtë e të vazhdueshme

për të dëshiruar, kërkuar, punuar dhe jetuar në mënyrë të tillë që ne vërtet “ta marrim Frymën e Shenjtë” dhe dhuratat e tij shpirtërore shoqëruese. “Sepse çfarë dobie ka një njeri, nëse një dhuratë i jepet atij dhe ai nuk e pranon dhuratën? Vini re, ai nuk gëzohet në atë që i jepet, as nuk gëzohet në atë që është dhënësi i dhuratës” (DeB 88:33).

Çfarë duhet të bëjmë ne që ta shndërrojmë këtë këshillim autoritar për të kërkuar shoqërimin e pjesëtarit të tretë të Kreut-Perëndi në një realitet të vazhdueshëm? Më lejoni të sugjeroj se ne duhet 1) të dëshirojmë sinqerisht ta marrim Frymën e Shenjtë; 2) ta ftojmë siç duhet Frymën e Shenjtë në jetën tonë; dhe 3) t’u bindemi besnikërisht urdhërimeve të Perëndisë.

Të Dëshirojmë Sinqerisht

Së pari ne duhet të dëshirojmë, të jemi të etur dhe të kërkojmë



shoqërimin e Frymës së Shenjtë. Ju dhe unë mund të mësojmë një mësim të shkëlqyer mbi dëshirat e drejta nga dishepujt besnikë të Mësuesit, të përshkruara në Librin e Mormonit:

“Dhe të dymbëdhjetët mësuan turmën dhe vini re, ata e bënë turmën të ulej në gjunjë mbi faqen e tokës dhe t’i lutej Atit në emrin e Jezusit. . . .

Dhe ata u lutën për atë gjë që dëshironin më shumë; dhe ata dëshironin që t’u jepej Fryma e Shenjtë” (3 Nefi 19:6, 9).

A kujtohemi edhe ne njëlloj të lutemi me zell e vazhdueshëm për atë që duhet ta dëshirojmë më së shumti, madje Frymën e Shenjtë? Apo hutohemi nga përkujdesjet e botës dhe rutina e jetës së përditshme dhe e marrim për të mirëqenë ose madje e shpërfillim këtë më të çmuarën e të gjitha dhuratave? Marrja e Frymës së Shenjtë fillon me dëshirën tonë të sinqertë e të vazhdueshme për shoqërimin e Tij në jetën tonë.

Ta Ftojme siç Duhet

Ne e marrim dhe e njohim më me gatishmëri Shpirtin e Zotit kur e ftojmë Atë siç duhet në jetën tonë. Ne nuk mund ta detyrojmë, shtrëngojmë, ose urdhërojmë Frymën e Shenjtë. Përkundrazi, ne duhet ta ftojmë Atë në jetën tonë me të njëjtën mirësi dhe butësi me të cilën Ai na trajton ne (shih DeB 42:14).

Ftesat tona për shoqërimin e Frymës së Shenjtë ndodhin në shumë mënyra: nëpërmjet bërjes dhe mbajtjes së

besëlidhjeve; duke u lutur sinqerisht si individë dhe familje; duke i kërkuar me zell shkrimet e shenjta; nëpërmjet forcimit të marrëdhënieve të duhura me pjesëtarët e familjes dhe miqtë; duke kërkuar të kemi mendime, veprime dhe fjalor të virtytshëm; dhe duke adhuruar në shtëpitë tona, në tempullin e shenjtë dhe në Kishë. Përkundrazi, shkujdesja ose shkelja e besëlidhjeve dhe zotimeve, dështimi për lutje dhe studim të shkrimeve të shenjta dhe mendimet, veprimet e fjalori i pavend, bëjnë që Shpirti të tërhiqet ose të na shmangë krejtësisht.

Ashtu si e mësoi popullin e tij Mbreti Beniamin: “Dhe tani, unë ju them juve, vëllezërit e mi, që pasi ju të keni ditur dhe t’ju jenë mësuar të gjitha këto gjëra, në qoftë se ju do të shkelni dhe do të shkoni kundër asaj që është folur, që ju do të largoheni nga Shpirti i Zotit, që ai të mos ketë më vend në ju për t’ju udhëhequr në udhët e urtësisë, që ju të mund të jeni të bekuar, të begatuar dhe të ruajtur” (Mosia 2:36).

Të Bindemi Besnikërisht

Bindja besnikërisht ndaj urdhërimeve të Perëndisë është thelbësore për marrjen e Frymës së Shenjtë. Ne kujtohemi për këtë të vërtetë çdo javë kur dëgjojmë lutjet e sakramentit dhe marrim denjësisht bukën dhe ujin. Kur ne garantojmë gatishmërinë tonë për të marrë mbi vete emrin e Jezu Krishtit, për ta kujtuar gjithmonë Atë dhe për të mbajtur urdhërimet e Tij, neve

na premtohet se mund të kemi gjithmonë Shpirtin e Tij me ne (shih DeB 20:77). Kështu, gjithçka që na mëson ungjilli i Shpëtimtarit që të bëjmë e të bëhemi, ka për qëllim të na bekojë me shoqërimin e Frymës së Shenjtë.

Merrni parasysh arsyet pse lutemi dhe studiojmë shkrimet e shenjta. Po, ne jemi të etur të komunikojmë në lutje me Atin Qiellor në emrin e Birit të Tij. Dhe po, ne dëshirojmë të pajisemi me dritën dhe dijen e disponueshme në veprat standarde. Por ju lutem, kujtoni se këto zakone të shenjta kryesisht janë mënyra përmes të cilave ne kujtojmë gjithmonë Atin Qiellor e Birin e Tij të Dashur dhe janë kushte paraprake për shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë.

Mendonin mbi arsyet pse adhurojmë në Shtëpinë e Zotit dhe në mbledhjet tona të Shabatit. Po, ne u shërbejmë të afërmve tanë të vdekur në tempull – dhe familjeve e miqve tanë në lagjet e degët ku banojmë. Dhe po, ne gëzohe mi me shoqërimin e drejtë që gjejmë mes vëllezërve dhe motrave tona. Por kryesisht ne mbledhemi





së bashku në unitet për të kërkuar bekimet dhe udhëzim nga Fryma e Shenjtë.

Lutja, studimi, mbledhja, adhurimi, shërbimi dhe bindja nuk janë pika të veçuara e të pavarura në një listë të gjatë të ungjillit të gjërave për të bërë. Përkundrazi, secila prej këtyre praktikave të drejta është një element i rëndësishëm në një kërkim shpirtëror kryesor për të përmbushur urdhrin për të marrë Frymën e Shenjtë. Urdhërimet nga Perëndia që u bindemi, dhe këshilla e frymëzuar nga udhëheqësit e Kishës që e ndjekim, përqendrohen kryesisht mbi sigurimin e shoqërimit të Shpirtit. Në thelb, të gjitha mësimet dhe aktivitetet e ungjillit qendërohen në vajtjen tek Krishti duke marrë Frymën e Shenjtë në jetën tonë.

Ju dhe unë duhet të përpiqemi fort që të bëhemi si luftëtarët e rinj të përshkruar në Librin e Mormonit, të cilët “zbatonin çdo fjalë të urdhërit me përpikmëri; po, dhe madje u bë çdo gjë sipas besimit të tyre; . . .

. . . Dhe janë të zellshëm që të kujtojnë Zotin, Perëndinë e tyre, nga dita në ditë; po, përpiqen të zbatojnë ligjet e tij dhe gjykimet e tij dhe urdhërimet e tij përherë (Alma 57:21; 58:40).

Dëshmia

Zoti ka deklaruar se Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është e “vetmja] kishë [e] vërtetë dhe [e] gjallë mbi faqen e tërë dheut” (DeB 1:30). Kjo Kishë e rivendosi është e vërtetë sepse është Kisha e Shpëtimtarit; Ai është “udha, e vërteta dhe jeta” (Gjoni 14:6). Dhe është një Kishë e gjallë për shkak të funksionimit dhe dhuratave të Frymës së Shenjtë. Sa të bekuar jemi që jetojmë në një kohë kur priftëria është në tokë dhe ne mund të marrim Frymën e Shenjtë!

Disa vite pasi Profeti Jozef Smith ishte martirizuar, ai iu shfaq Presidentit Brigam Jang dhe i dha këtë këshillë për çdo kohë: “Thuaju njerëzve të jenë të përvullur dhe besnikë, dhe të sigurt për të mbajtur Shpirtin e Zotit dhe ai do t’i udhëheqë saktë. Kini kujdes dhe mos e largoni zërin e qetë e të ulët; ai do t’ju mësojë [çfarë] të bëni dhe ku të shkoni; ai do të japë frytet e mbretërisë. Thuaju vëllezërve t’i mbajnë zemrat të hapura që të mbeten të gatshëm për të qenë të bindur për të vërtetën, kështu që kur t’u vijë Fryma e Shenjtë, zemra e tyre do të jetë gati për ta marrë atë. Ata mund ta dallojnë Shpirtin e Zotit nga gjithë shpirtat e tjerë. Ai do t’u pëshpërisë paqe e

gëzim shpirtëror të tyre dhe ai do të heqë keqdashjen, urrejtjen, zilinë, grindjen dhe gjithë të ligën nga zemra e tyre; dhe e gjithë dëshira e tyre do të jetë për të bërë mirë, për të sjellë drejtësinë dhe për të ndërtuar mbretërinë e Perëndisë. Thuaju vëllezërve se nëse do të ndjekin Shpirtin e Zotit, ata do të jenë krejt në rregull” (*Teachings: Joseph Smith*, f. 98).

Unë lutem që ne do të dëshirojmë sinqerisht dhe do ta ftojmë siç duhet Frymën e Shenjtë në jetën tonë të përditshme. Unë lutem gjithashtu që secili prej nesh t’u bindet besnikërisht urdhërimeve dhe ta marrë vërtet Frymën e Shenjtë. Unë premtoj se bekimet e përshkruara Brigam Jangut nga Profeti Jozef Smith janë të zbatueshme dhe të arritshme për çdo individ që e dëgjon ose lexon këtë mesazh.

Unë jap dëshmi për realitetin e gjallë të Atit dhe Birit. Unë dëshmoj se Fryma e Shenjtë është një zbulues, ngushëllues dhe mësuesi themelor prej të cilit duhet të mësojmë. Dhe unë dëshmoj se bekimet dhe dhuratat e Shpirtit funksionojnë në Kishën e rivendosi, të vërtetë dhe të gjallë të Jezu Krishtit në këto ditë të mëvonshme. Unë dëshmoj kështu, në emrin e shenjtë të Zotit Jezu Krisht, amen. ■



Nga Plaku Leri R. Lorens,
i Të Shtatëdhjetëve

Prindërim Trimëror

Ajo çfarë i nevojitet vërtet botës është prindërimi trimëror nga nëna dhe etër që nuk kanë frikë të shprehin dhe mbrojnë standardet e tyre.

Do të doja t'u flisja sot prindërve të adoleshentëve. Të rinjtë tuaj të shkëlqyer dhe energjikë janë e ardhmja e Kishës dhe, për atë arsye, janë një objekt kryesor i kundërshtarit. Shumë prej jush, nëna dhe etër besnikë, po e dëgjoni sot konferencën, duke u lutur për përgjigje që t'ju ndihmojnë të udhëhiqni fëmijët tuaj përmes këtyre viteve të rëndësishme. Nipërit e mbesat e mia më të mëdha kohët e fundit janë bërë adoleshentë, kështu që kjo temë është e rëndësishme për mua. Nuk ka prindër të përsosur dhe përgjigje të lehta, por ka parime të së vërtetës, ku ne mund të mbështetemi.

Tema e Aktiviteteve të Përbashkëta të Të Rinjve dhe Të Rejave për vitin 2010 është marrë nga Libri i Jozueut. Ajo fillon: “Ji[ni të] fortë dhe trim[a]; mos ki[ni] frikë” (Jozueu 1:9). Kjo frazë nga shkrimet e shenjta do të ishte një temë e mirë për prindërit gjithashtu. Në këto ditë të fundit, ajo çfarë i nevojitet vërtet botës është prindërimi trimëror nga nëna dhe etër, që nuk kanë frikë të shprehin dhe mbrojnë standardet e tyre.

Përfytyroni për një çast sikur bija juaj të qëndronte mbi shinat e hekurudhës dhe ju të dëgjoni fishkëllimën e trenit. A do ta paralajmëronit që të largohej

nga shinat? Apo do të ngurronit, duke u shqetësuar se mos ajo mund të mendojë se jeni mbrojtës me të tepërt? Nëse ajo do ta shpërfillte paralajmërimin tuaj, a do ta lëviznit shpejt për në një vend të sigurt? Sigurisht që do ta bënit! Dashuria për bijën tuaj do të mbizotëronte mbi të gjitha gjykimet e tjera. Ju do ta vlerësonit jetën e saj më tepër se miratimin e saj të përkohshëm.

Sfidat dhe tundimet po u vijnë adoleshentëve tanë me shpejtësinë dhe forcën e një treni transporti. Siç na kujtohet në proklamatin për familjen, prindërit janë përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve të tyre.¹ Kjo do të thotë shpirtërisht si dhe fizikisht.

Në Librin e Mormonit, lexojmë për Almën e Ri që këshillonte birin e tij të prapë. Koriantoni kishte bërë disa gabime serioze kur shërbente një mision mes zoramitëve. Alma e donte atë aq shumë sa të fliste drejtpërsëdrejti për problemin. Ai shprehu zhgënjimin e tij të thellë që i biri kishte qenë i pamoralshëm dhe i shpjegoi atij pasojat serioze të mëkatit.

Unë frymëzohem çdo herë që lexoj këto fjalë trimërore nga Alma: “Dhe tani Shpirti i Zotit më thotë mua: Urdhëroji fëmijët e tu të bëjnë mirë, . . . ; prandaj, të urdhëroj biri im, në frikën e Perëndisë, që të

përmbahesh nga paudhësitë e tua” (Alma 39:12). Kjo ndërhyrje e hershme nga babai i tij u bë një pikë kthese për Koriantonin. Ai u pendua dhe shërbeu besnikërisht pas kësaj (shih Alma 42:31; 43:1–2).

Krahasojeni shembullin e Almës me atë të një babai tjetër nga shkrimet e shenjta, Eliut në Dhiatën e Vjetër. Eliu shërbeu si prift i lartë në Izrael gjatë fëmijërisë së Samuel profetit. Shkrimet e shenjta shpjegojnë se Zoti e qortoi rreptë atë, “sepse bijtë e tij janë bërë të neveritshëm dhe ai nuk i ka frenuar” (1 Samuelit 3:13). Bijtë e Eliut nuk u penduan kurrë dhe i gjithë Izraeli vuajti për shkak të marrëzisë së tyre. Ndodhia e Eliut na mëson se prindërit që i duan fëmijët e tyre, nuk mund ta lejojnë që të frikësohen prej tyre.

Disa vite më parë në një konferencë të përgjithshme, Plaku Xho J. Kristensen na kujtoi që “prindërimi nuk është një konkurim popullariteti”.² Në të njëjtin shpirt, Plaku Robert D. Hejls vërejt: “Nganjëherë ne druhemi nga fëmijët tanë – druhemi t'i këshillojmë ata nga frika se mos i fyejmë”.³

Vite më parë, biri ynë 17-vjeçar donte të shkonte në një udhëtim fundjave me miqtë e tij, që ishin që të gjithë djem të mirë. Ai kërkoi leje të shkonte. Dëshiroja të thoshja po, por për ndonjë arsye, nuk u ndjeva mirë lidhur me udhëtimin. Ia tregova ndjenjat e mia gruas sime, që qe mjaft mbështetëse. “Ne duhet ta dëgjojmë atë zë paralajmërues”, tha ajo.

Sigurisht, biri ynë qe i zhgënjyer dhe pyeti se përse nuk dëshironim që të shkonte. Iu përgjigja ndershmërisht se nuk e dija përse. “Thjesht nuk ndihem mirë për atë”, i shpjegova, “dhe të dua aq shumë sa nuk mund t'i shpërfill këto ndjenja të brendshme.” U befasova mjaft kur ai tha: “Në rregull, Babi. E kuptoj”.



Të rinjtë kuptojnë më shumë nga sa e mendojmë ne, sepse dhe ata e kanë dhuratën e Frymës së Shenjtë. Ata po përpiqen ta njohin Shpirtin kur Ai flet dhe ata po vëzhgojnë shembullin tonë. Prej nesh, ata mësojnë t'u kushtojnë vëmendje nxitjeve të tyre – që nëse “nuk ndihen mirë në lidhje me diçka”, është më e mira të mos e vazhdojnë atë.

Është shumë e rëndësishme që bashkëshortët e bashkëshortet të jenë të bashkuar kur marrin vendime prindërore. Nëse cilido prej prindërve nuk ndihet mirë për diçka, atëherë leja nuk duhet të jepet. Nëse cilido nuk ndihet rehat për një film, një shfaqje televizive, një lojë kompjuterike, një mbrëmje, një veshje, një kostum banjoe, apo një aktivitet në internet, kini trimërinë ta mbështesni njëri-tjetrin dhe të thoni “jo”.

Do të doja të ndaja me ju një letër nga një nënë zemërthyer. Biri i saj adoleshent gradualisht e humbi Shpirtin dhe u largua nga aktiviteti në Kishë. Ajo shpjegoi se si ndodhi kjo: “Gjatë gjithë viteve të adoleshencës të birit tim, u shqetësova dhe u përpoqa

ta ndaloja të luante lojëra kompjuterike të dhunshme. Fola me bashkëshortin tim dhe i tregova artikuj në *Ensign* dhe në gazeta që paralajmëronin për këto lojëra. Por bashkëshorti im ndiente se ishte në rregull. Ai tha se biri ynë nuk ishte përjashta duke përdorur drogë dhe duhet të mos shqetësohesha më. Ka pasur raste që do t'i fshihja pajisjet komanduese dhe bashkëshorti im do t'ia jepte. Filloi të ishte më e lehtë për mua të lëshoja pe, . . . sesa të luftoja. Unë vërtet ndiej se lojërat kompjuterike janë po aq varëskrijuese sa drogat. Do të bëja gjithçka që t'i ndaloja prindërit e tjerë nga kalimi përmes kësaj përvoje.”

Vëllezër e Motra, nëse bashkëshort-ja/i juaj nuk ndihet mirë lidhur me diçka, tregoni respekt për ato ndjenja. Nëse merrni rrugën e lehtë duke mos thënë ose bërë ndonjë gjë, ju mund të jeni duke mundësuar sjellje shkatërruese.

Prindërit mund të parandalojnë mjaft dëshpërim duke u mësuar fëmijëve të tyre t'i shtyjnë marrëdhëniet romantike derisa të vijë koha kur ata të jenë gati për martesë. Çiftimi i

parakohshëm me një të dashur është i rrezikshëm. Bërja “çift” krijon intimitet emocional, i cili tepër shpesh çon në intimitet fizik. Satani e di këtë vijueshmëri dhe e përdor në përfitim të tij. Ai do të bëjë gjithçka mundet që t'i pengojë të rinjtë të shërbejnë misione dhe të pengojë martesën në tempull.

Është jetike që prindërit të kenë trimëri t'i shprehin standardet dhe të ndërhyjnë përpara se t'ia dalë Satani. Presidenti Boyd K. Paker na ka mësuar se “kur përfshihet moraliteti, ne i kemi të dyja, *të drejtën* dhe *detyrimin* për të ngritur një zë paralajmërues”⁴.

Kam besuar gjithmonë se natën vonë nuk ndodh asgjë vërtet e mirë dhe se të rinjtë duhet ta dinë se në çfarë ore pritet të kthehen në shtëpi natën.

Tregohet një masë e madhe urtësie kur prindërit rrinë zgjuar dhe presin që fëmijët e tyre të kthehen në shtëpi. Të rinjtë dhe të rejtat bëjnë zgjedhje shumë më të mira kur e dinë se prindërit e tyre po i presin që të dëgjojnë për mbrëmjen dhe për t'i puthur për t'u uruar natën e mirë.



Më lejoni të shpreh paralajmërimin tim personal për një praktikë, që është e zakonshme në shumë kultura. Po u referohem fjetjeve jashtë shtëpisë ose kalimit të natës në shtëpinë e një miku. Si Peshkop, kam zbuluar se një numër tepër i madh të rinjsh e shkelën për herë të parë Fjalën e Urtësisë ose ligjin e dëlirësisë si pjesë e një fjetjeje jashtë shtëpisë. Tepër shpesh, ekspozimi i tyre i parë ndaj pornografisë dhe madje përballa e tyre e parë me policinë ndodhi kur ata po e kalonin natën larg shtëpisë.

Trysnia e shokëve bëhet më e fuqishme kur fëmijët janë larg ndikimit tonë dhe kur mekanizmat e tyre mbrojtëse dobësohen natën vonë. Nëse ndiheni ndonjëherë në merak për një aktivitet natën, mos kini frikë t'i përgjigjeni atij zëri paralajmërues

të brendshëm. Gjithmonë të jeni plot lutje kur është fjala për të mbrojtur fëmijët tuaj të çmuar.

Prindërimi trimëror nuk përfshin gjithmonë që të themi "jo". Prindërve gjithashtu u duhet trimëri për të thënë "po" për këshillën e profetëve të ditëve moderne. Udhëheqësit tanë të Kishës na kanë këshilluar të krijojmë modele të drejta në shtëpitë tona. Merrni parasysh pesë praktika themelore, që kanë fuqi për ta forcuar rininë tonë: lutja familjare, studimi familjar i shkrimit të shenjtë, mbrëmja familjare, darka familjare së bashku dhe intervistat e rregullta kokë më kokë me secilin fëmijë.

Kërkon trimëri t'i mbledhësh fëmijët nga çfarëdo gjëje që po bëjnë, dhe të gjunjëzohesh së bashku si familje. Kërkon trimëri ta fikësh televizorin

e kompjuterin dhe ta udhëheqësh familjen tënde përmes fragmenteve të shkrimeve të shenjta çdo ditë. Kërkon trimëri të refuzosh ftesa të tjera mbrëmjen e së hënës, që të mund ta rezervosh atë mbrëmje për familjen tënde. Kërkon trimëri dhe forcë vullneti të shmangësh programimin e ngjeshur, që familja jote të mund të jetë në shtëpi për vaktin ushqimor.

Një nga mënyrat më efikase si mund të ndikojmë bijtë dhe bijat tona është të këshillohemi me ta në intervista private. Duke i dëgjuar me vëmendje, mund të zbulojmë dëshirat e zemrave të tyre, t'i ndihmojmë të vendosin synime të drejta dhe gjithashtu të ndajmë me ta përshtypjet shpirtërore, që kemi marrë për ta. Këshillimi kërkon trimëri.

Përpiquini të përfytyroni se si mund të bëhet brezi i ri nëse këto pesë modele të drejta praktikohen vazhdimisht në çdo shtëpi. Të rinjtë tanë mund të bëhen si ushtria e Helamanit: të pamposhtshëm (shih Alma 57:25–26).

Prindërimi për adoleshentët në ditët e mëvonshme është një detyrë shumë përlulëse. Satani dhe pasuesit e tij po përpiqen fort ta rrëzojnë këtë brez; Zoti po mbështetet tek prindër të guximshëm për t'i lartësuar ata. Prindër "Ji[ni të] fortë dhe trim[a]; mos ki[ni] frikë" (Jozueu 1:9). Unë e di se Perëndia i dëgjon dhe do t'u përgjigjet lutjeve tuaja. Unë dëshmoj se Zoti i mbështet dhe i bekon prindërit trima. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih "Familja: Një Proklamata Dërguar Botës", *Liahona*, tetor 2004, f. 49.
2. Joe J. Christensen, "Rearing Children in a Polluted Environment", *Ensign*, nëntor 1993, f. 11.
3. Robert D. Hales, "With All the Feeling of a Tender Parent: A Message of Hope to Families", *Liahona*, maj 2004, f. 90.
4. Boyd K. Packer, "Our Moral Environment", *Ensign*, maj 1992, f. 67.



Nga Plaku Per G. Malm,
i Të Shtatëdhjetëve

Prehuni në Shpirtrat Tuaj

Gjetja e prehjes në shpirtin tonë përfshin paqe në mendje dhe në zemër, që janë rezultat i mësimit dhe i ndjekjes së doktrinës së Krishtit.

Në qendrën e Gotenborgut të Suedisë, ka një bulevard të mrekullueshëm me pemë të rritura në secilën anë. Një ditë pashë një vrimë në trungun e njëres nga pemët gjigande, kështu vëreja me kureshtje brenda dhe pashë se pema ishte tërësisht zgavër. Zgavër po, por bosh jo! Ajo ishte e mbushur me të gjitha llojet e mbeturinave.

U befasova që pema mund të qëndronte ende. Kështu vëreja lart dhe pashë një rrip të gjerë çeliku të mbërthyer rreth pjesës së sipërme të trungut. Ngjitur te brezi ishin disa tela çeliku dhe ato vetë ishin shtrënguar dhe fiksuar te ndërtesat pranë. Nga larg dukej si pemë e tjera; vetëm kur vëreje brenda mund të diktoje se ishte zgavër në vend që të kishte një trung solid, të fortë. Shumë vite më parë, diçka kishte filluar procesin e dobësimit të trungut pak këtu dhe pak atje. Kjo nuk ndodhi brenda natës. Sidoqoftë, pikërisht si bëhet pak nga pak fidani i ri i pemës një dru i fortë, kështu mund të rritemi hap pas hapi në aftësinë për të qenë të fortë dhe të mbushur nga brenda deri jashtë, në kontrast me pemën zgavër.

Është nëpërmjet shërimit me Shlyerjen e Jezu Krishtit që ne mund të kemi forcën të qëndrojmë të lartë e të fortë dhe t'i kemi shpirtrat tanë të mbushur – me dritë, kuptim, gëzim dhe dashuri. Ftesa e Tij drejtohet “të gjithë të vijnë tek ai dhe të marrin pjesë në mirësinë e tij; dhe ai nuk ia mohon askujt që shkon tek ai” (2 Nefi 26:33). Premtimi i tij është:

“Ejani tek unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t’ju jap çlodhje.

Merrni mbi vete zgjedhën time dhe mësoni nga unë, sepse unë jam zemërbutë dhe i përlulur nga zemra; dhe ju do të gjeni prehje për shpirtrat tuaj” (Mateu 11:28–29).

Për këtë prehje Presidenti Jozef F. Smith tha: “Për mendimin tim, ajo do të thotë të futesh në njohjen dhe dashurinë për Perëndinë, të kesh besim në qëllimin e tij dhe në planin e tij, në një masë të tillë që ne e dimë se e kemi drejt dhe se ne nuk po gjuajmë për diçka tjetër, ne nuk trazohemi nga çdo erë doktrine apo nga dinakëria dhe zhdërvjelltësia e njerëzve që rrijnë në pritje për të mashtruar. Ne dimë për doktrinën që

është e Perëndisë dhe ne nuk i bëjmë pyetje askujt për të; ata ndihen mirë me opinionet e tyre, me idetë e tyre dhe me hallakatjet e tyre. Njeriu që ka arritur atë nivel besimi në Perëndi që çdo dyshim dhe frikë është flakur prej tij, ai ka hyrë në ‘prehjen e Perëndisë’” (*Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith* [1998], f. 56).

Gjetja e prehjes në shpirtin tonë përfshin paqe në mendje dhe në zemër, që janë rezultat i mësimit dhe i ndjekjes së doktrinës së Krishtit dhe i të bërit duar të zgjatura të Krishtit për shërbim dhe ndihmë ndaj të tjerëve. Besimi në Jezu Krisht dhe ndjekja e mësimëve të Tij na japin neve një shpresë të qëndrueshme dhe kjo shpresë bëhet një spirancë e fortë të shpirtrat tanë. Ne mund të bëhemi të qëndrueshëm dhe të patundur. Ne mund të kemi një paqe të përhershme të brendshme; ne mund të hyjmë në prehjen e Zotit. Vetëm nëse largohemi nga drita dhe nga e vërteta një ndjenjë zbrazëtie, si e pemës, do të pushtojë vatrat më të thella të shpirtrave tanë dhe ne madje mund të tentojmë ta mbushim atë zbrazëti me gjëra pa ndonjë vlerë të përhershme.

Duke pasur parasysh ekzistencën tonë si fëmijë shpirtërorë përpara se të vinim në tokë dhe pavdekësinë në jetën e mëpasme, kjo jetë tokësore është vërtet veçse një moment i shkurtër.

Kjo është, gjithsesi, një ditë prove, por ajo është gjithashtu një ditë mundësish kur ne zgjedhim të ndjekim ftesën për të mos shpenzuar kot ditët e provës tonë (shih 2 Nefi 9:27). Mendimet që kemi brenda mendjes sonë, ndjenjat që ushqejmë brenda zemrës sonë dhe veprimet që zgjedhim të kryejmë, do të kenë të gjitha një efekt vendimtar në jetën tonë, edhe këtu edhe në të mëpasshmen.

Një zakon i dobishëm është të ngremë shikimin çdo ditë me qëllim që të mbajmë një këndvështrim të



përjetshëm të gjërave që planifikojmë dhe bëjmë, veçanërisht nëse dallojmë një prirje që të presim gjersa një e nesërme e ardhshme do të bëjë atë që ne e dimë se duhet ta ndjekim, ndërkohë që kemi të tashmen tonë sot.

Përgjatë rrugës ne ndihmohemi në zgjedhjet tona nëpërmjet ndikimit mbështetës të Shpirtit. Tani, nëse zgjedhim të veprojmë në kundërshtim me dritën dhe kuptimin që kemi, ne do të përjetojmë një vetëdije të keqe, që patjetër nuk ndihet mirë. Por një vetëdije e keqe është një bekim në atë që ne menjëherë kujtohem se është koha për t'u penduar. Kur jemi të përlurur dhe duam të bëjmë atë që është e drejtë, ne do të jemi në ankth për të vepruar menjëherë për të ndryshuar mënyrat tona, ndërsa ata që janë krenarë dhe që mund të kërkojnë "të bëhe[n] ligj në vetvete" (DeB 88:35) do ta lejojnë Satanin t'i udhëheqë "ata për qafe me një fije liri, derisa i lidh me

litarët e tij të fortë, përgjithnjë" (2 Nefi 26:22), përveç nëse shpirti i pendesës hyn në zemrat e tyre. Ndjekja e ndikimeve të liga kurrë nuk mund të rezultojë në një ndjenjë paqeje thjesht sepse paqja është një dhuratë nga Perëndia dhe ajo vjen vetëm nëpërmjet Shpirtit të Perëndisë. "Ligësia kurrë nuk ka qenë lumturi" (Alma 41:10).

Në veprimet tona të përditshme, shpesh janë gjërat e vogla dhe të thjeshta që do të kenë një ndikim afatgjatë (shih Alma 37:6–7). Ajo që themi, mënyra si veprojmë dhe si zgjedhim të reagojmë do të ndikojnë jo vetëm ne vetë, por gjithashtu ata përreth nesh. Ne mund të ndërtojmë ose mund të prishim. Një shembull i thjeshtë dhe pozitiv është një histori e treguar mbi gjyshen time. Ajo dërgoi një nga fëmijët e saj të vegjël për të blerë disa vezë. Fëmija i besuar ndoshta ishte i gëzuar kur po kthehej në shtëpi përgjatë rrugës, por shumica e vezëve ishin thyer

kur arriti në shtëpi. Një mik i familjes ishte atje dhe e këshilloi gjyshen që ta qortonte fëmijën që u soll aq keq. Por në vend të kësaj, gjyshja me qetësi dhe urtësi tha: "Jo, kjo nuk do t'i bëjë përsëri të plota vezët. Ne thjesht do të përdorim atë që mundemi dhe do të bëjmë disa petulla që do të mund t'i shijojmë bashkë."

Kur mësojmë të trajtojmë gjërat e vogla dhe të thjeshta të përditshme me një mënyrë të urtë dhe të frymëzuar, rezultati është një ndikim pozitiv që do të forcojë harmoninë në shpirtat tanë dhe do të ndërtojë dhe forcojë ata përreth nesh. Kjo është kështu sepse çdo gjë që na fiton të bëjmë mirë, "është dërguar nëpërmjet fuqisë dhe dhuratës së Krishtit; prandaj [ne] mund të di[më] me një njohuri të përsosur se është nga Perëndia" (Moroni 7:16).

Tani, pema e zgavruar, për të cilën ju fola, nuk është më. Disa të rinj vendosën fishekzjarre në hapësirat bosh, që e bënë pemën të merrte zjarr. Ajo nuk mund të shpëtohej dhe duhej të rrëzohej. Ruhuni nga gjërat që do të shkatërrohen nga brenda, qofshin të mëdha apo të vogla! Ato mund të kenë një ndikim shpërthyes dhe të shkaktojnë vdekje shpirtërore.

Le të përqendrohemi në vend të tyre në ato gjëra që do të ndihmojnë për një paqe të përhershme të mendjes dhe të zemrës. Atëherë "do të forcohet vetbesimi [ynë] në prani të Perëndisë" (DeB 121:45). Premtimi për të hyrë në prehjen e Perëndisë, për të marrë dhuratën e paqes, është larg një kënaqësie të përkohshme, tokësore. Ai është vërtet një dhuratë hyjnore: "Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: po jo si e jep bota; zemra juaj mos u tronditë dhe mos u frikësoftë" (Gjoni 14:27). Ai ka fuqinë të shërojë dhe të forcojë shpirtin. Ai është Jezu Krishti, për të cilin unë dëshmoj në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku Zhairo Mazagardi,
i Të Shtatëdhjetëve

Shmangia e Grackës së Mëkatit

*Qëndroni të fortë dhe bëni zgjedhje të mira që do t'ju
lejojnë që të hani frutin e pemës së jetës.*

Një mëngjes të bukur me diell, e ftova mbesën time pothuaj tetëvjeçare, Vikin, të shëtiste me mua pranë një liqeni, që, në fakt, është një rezervuar ujor për qytetin tonë të bukur.

Shëtisnim të gëzuar, duke dëgjuar zhurmën e këndshme të përroit të kthjellët si kristali, që rridhte përgjatë shtegut tonë. Shtegu ravijëzohej nga pemë të bukura të gjelbra dhe lule me aromë të këndshme. Mund të dëgjoni zogj që këndonin.

Unë e pyeta mbesën time sykaltër, gazmore e të pafajshme se si po përgatitej për pagëzim.

Ajo u përgjigj me një pyetje: “Gjysh, çfarë është mëkati?”

Në heshtje u luta për frymëzim dhe u përpoqa të përgjigjesha aq thjesht sa mundja: “Mëkati është mosbindje e qëllimshme ndaj urdhërimeve të Perëndisë. Ai e trishton Atin Qiellor dhe rezultatet janë vuajtja dhe trishtimi.”

Qartazi e shqetësuar, ajo më pyeti: “E si na zë ai neve?”

Pyetja, së pari, zbulon pastërti, por ajo gjithashtu zbulon shqetësim për mënyrën se si të shmangët përfshirja në mëkat.

Që ajo ta kuptonte më qartë, unë përdora si ilustrim elemente natyrore që kishim përreth. Duke vazhduar zbritjen e shtegut tonë, anash një gardhi prej teli me gjemba gjetëm një shtyllë guri me madhësi të konsiderueshme; ishte një formacion i rëndë, përreth të cilit rriteshin lule, shkurre dhe pemë të shkurtra. Me kohë, këto bimë do të bëheshin më të mëdha se vetë shtylla.

M'u kujtua që pak më tutje shtegu do të gjenim një shtyllë tjetër që tashmë ishte pushtuar pak nga pak, pothuaj pa u vënë re, nga bimësia që rritej përreth saj. Përfytyroj që shtylla nuk do ta merrte me mend se, pavarësisht forcës së saj, ajo mund të rrethohej e të shkatërrohej nga bimët e brishta. Shtylla do të mendonte: “S'ka problem. Jam e fortë dhe e madhe, dhe kjo bimë e vogël nuk do të më dëmtojë.”

Kështu, ndërsa pema pranë bëhet më e madhe, shtylla në fillim nuk e vë re; më pas shtylla fillon ta pëlqejë hijen që jep pema. Por pema vazhdon të rritet dhe e rrethon shtyllën me dy degë, të cilat fillimisht duken të brishta, por që me kohë gërshtohen dhe e rrethojnë shtyllën.

Shtylla ende nuk e ka të qartë se ç'po ndodh.

Në shëtitjen tonë, shpejt e gjetëm shtyllën e këtij subjekti. Ajo ishte e shkullur nga toka. Mbesa ime e vogël shikoi me ndjenjë përshtypjeje dhe më pyeti: “Gjysh, a është kjo pema e mëkatit?”

Unë atëherë i shpjegova që kjo ishte vetëm një simbol apo një shembull i mënyrës se si na zë mëkati.

Nuk e di se ç'ndikim do të ketë mbi të biseda jonë, por mua më bëri të mendoja për fytyrat e shumta të mëkatit dhe mënyrën se si hyn vjedhurazi në jetën tonë, nëse e lejojmë në të.

Ne duhet të jemi vigjilentë, sepse zgjedhjet e vogla mund të sjellin pasoja të mëdha, sikurse rënia herët për të fjetur dhe zgjimi herët kanë pasoja të mëdha. Doktrina e Besëlidhjet 88:124 na mëson: “Ngrihuni herët, që trupat tuaja dhe mendjet tuaja të mund të fuqizohen”. Ata që shkojnë të flenë herët, zgjohen të çlodhur, me trupin dhe mendjen të forcuar e të bekuar nga Zoti në saje të bindjes.

Ato që mund të duken me rëndësi të vogël, siç është vajtja vonë në shtrat, mosbërja e lutjeve për një ditë, kapërcimi i agjërimit ose thyerja e Shabatit – kësi rrëshqitjesh të vogla – do të na bëjnë të humbasim pak nga pak ndjeshmërinë, duke lejuar që të bëjmë gjëra më të këqija.

Kur isha adoleshent, ora e mbylles në shtëpi ishte 10:00 e mbrëmjes. Sot kjo është koha kur disa dalin për t'u argëtuar. Megjithatë, dimë se pikërisht nata është koha që ndodhin disa nga gjërat më të këqija. Pikërisht gjatë orëve të errëta është koha që disa të rinj shkojnë në vende me mjedise të papërshtatshme, ku muzika dhe teksti nuk i lejojnë të kenë shoqërinë e Frymës së Shenjtë. Atëherë, nën këto rrethana, ata bëhen pre e lehtë për mëkatin.



Shpeshherë rënia pre ndaj mëkatit fillon kur dikush zgjedh miq, standartet e të cilëve nuk janë në pajtim me ungjillin; dhe, që të jetë popullor apo i pranuar prej shokëve, personi më pas bën lëshime me parimet dhe ligjet, duke zbritur një shteg që do t'i sjellë vetëm dhembje e trishtim këtij personi dhe njerëzve të dashur të tij, apo të saj.

Duhet të jemi vigjilentë për të mos lejuar që mëkati të rritet rreth nesh. Format e mëkatit janë gjithkund – madje, për shembull, edhe në një kompjuter apo telefon celular. Këto teknologji janë të dobishme dhe mund të na sjellin dobi. Por përdorimi i tyre i pavend – siç është përfshirja në lojërat që shpërdorojnë kohë, programe që të drejtojnë në kënaqësi mishtore apo në gjëra shumë më të këqija, si pornografia – është shkatërrimtar. Pornografia shkatërron karakterin dhe bën që përdoruesi saj të zhytet në rërën thithëse të ndyrësisë, nga e cila personi mund të shpëtojë vetëm me shumë ndihmë.

Ky përbindësh i tmerrshëm i shkatëron dhembje dhe vuajtje si përdoruesit, ashtu edhe fëmijëve të pafajshëm të tij apo të saj, bashkëshortes, atit dhe nënës. Fryti i kënaqësisë mishtore është hidhërim dhe dëshpërim. Fryti i bindjes e i sakrificës është ëmbëlsi dhe gëzim i pasosur.

Vendimet lidhur me standartet që ndiqen duhen bërë që më përpara,

jo kur shfaqet tundimi. Parimet tona udhëzuese duhet të jenë:

- Këtë do ta bëj, sepse është e drejtë, se vjen nga Zoti dhe do të më sjellë lumturi.
- Këtë nuk do ta bëj, sepse do të më çojë larg prej së vërtetës, prej Zotit dhe prej lumturisë së përrjetshme që Ai u premton besnikëve dhe të bindurve.

Meqë Ati e dinte se ne do të bënim zgjedhje të gabuara, Ai, në planin e Tij të mrekullueshëm të dashurisë, siguroi një Shpëtimtar të botës për të shlyer mëkatet e të gjithë atyre që pendohen; të cilët vijnë tek Ai duke kërkuar ndihmë, ngushëllim dhe falje; dhe të cilët janë të gatshëm të marrin mbi vete emrin e Tij, Jezu Krishtit.

Nëse mëkatojmë, ne duhet të kërkojmë shpejt ndihmë, sepse të vetëm nuk mund t'i shpëtojmë grackës së mëkatit, ashtu sikurse shtylla e gardhit të lartpërmendur nuk mund të vetëçlirohet. Dikush duhet të na ndihmojë që të çlirohemi nga rrethimi vdekjeprurës.

Prindërit mund të ndihmojnë dhe peshkopi është thirrur nga Perëndia që të na ndihmojë. Pikërisht tek ai duhet të shkojmë e t'i hapim zemrën.

Doktrina e Besëlidhje 58:42–43 shpjegon:

“Vini re, ai që është penduar për mëkatet e tij, po ai falet dhe unë, Zoti, nuk i kujtoj më ato.

Në këtë mënyrë ju mund të dini nëse një njeri pendohet për mëkatet e tij – vini re, ai do t'i rrëfejë ato e do t'i braktisë ato.”

Pak muaj pas shëtitjes sonë pranë liqenit, mbesa ime u intervistua nga peshkopi i saj – i ati – për pagëzimin. Mbas intervistës e pyeta se si shkoi. Ajo m'u përgjigj, pothuaj me qortim: “Gjysh, intervista është private. Ti e di këtë.”

Peshkopë, shpresoj se atë përgjigje ju e merrni seriozisht. Më duket që mbesa ime arriti të kuptonte shumë në një kohë fare të shkurtër.

Ashtu sikurse pema që kam përkshkruar solli trishtim, dhimbje, vuajtje dhe grackë, një pemë tjetër mund të sjellë të kundërtën. Ajo përmendet te 1 Nefi 8:10–12:

“Dhe ndodhi që pashë një pemë, fruti i së cilës ishte i dëshirueshëm për ta bërë dikë të lumtur.

Dhe ndodhi që unë shkova përpara dhe hëngra nga fruti i saj, dhe vura re se ishte më i ëmbël se gjithçka që kisha shijuar ndonjëherë më parë. Po, dhe vura re se fruti i saj ishte i bardhë, mbi çdo bardhësi që kisha parë ndonjëherë.

Dhe ndërsa po haja frutin e saj, ai ma mbushi shpirtin tim me një gëzim jashtëzakonisht të madh.”


Të dashur vëllezër dhe motra, qëndroni të fortë dhe bëni zgjedhje të mira që do t'ju lejojnë që të hani frutin e pemës së jetës. Nëse, për ndonjë arsye, keni gabuar ose keni lënë shtegun, dora jonë qëndron e shtrirë dhe ne ju themi: "Ejani. Ka shpresë. Ne ju duam dhe dëshirojmë t'ju ndihmojmë që të jeni të lumtur."

Ati Qiellor na do aq shumë, sa ka dhënë Birin e Tij të vetëm, Jezun Krishtin.

Jezun Krishtin na do aq shumë, sa dha jetën e Tij në shlyerje të mëkateve tona!

Çfarë jemi të gatshëm të japim ne, që të jemi të pastër dhe të marrim atë gëzim?

Për këto të vërteta jap dëshminë time në emrin e shenjtë të Jezun Krishtit, amen. ■



Nga Plaku Mervin B. Arnold,
i Të Shtatëdhjetëve

Çfarë Keni Bërë Ju Me Emrin Tim?

Një ditë secilit nga neve do t'i duhet të japë llogari te Shpëtimtari ynë, Jezun Krishtin, për atë që ne kemi bërë me emrin e Tij.

Kur Presidenti Xhorxh Albert Smith ishte i ri, gjyshi i tij i vdekur, Xhorxh A. Smith, iu shfaq atij në një ëndërr dhe e pyeti: "Unë do të doja të di çfarë ke bërë ti me emrin tim." Presidenti Smith u përgjigj: "Unë nuk kam bërë kurrë ndonjë gjë me emrin tend, që të ndihesh i turpëruar"¹.

Çdo javë kur ne marrim pjesë në sakrament, ne bëjmë besëlidhje dhe premtojmë se ne duam të marrim përsipër emrin e Krishtit, gjithmonë ta kujtojmë Atë dhe të mbajmë urdhërimet e Tij. Nëse duam të veprojmë kështu, neve na premtohet bekimi më i mrekullueshëm – që Shpirti i Tij do të jetë gjithmonë me ne.²

Pikërisht ashtu si Presidenti Xhorxh Albert Smith duhej të jepte llogari ndaj gjyshit për çka kishte bërë me emrin e tij, një ditë secilit nga neve do t'i duhet të japë llogari te Shpëtimtari ynë, Jezun Krishtin, për atë që ne kemi bërë me emrin e Tij.

Rëndësia e të paturit të një emri të mirë përmendet te Fjalët e Urta, ku lexojmë: "Një emër i mirë është më i pëlqyeshëm se pasuritë e mëdha, dhe hiri është më i pëlqyeshëm se

argjendi dhe ari"³ dhe "Emri i të drejtit bekohet!"⁴

Ndërsa mendoja mbi këto shkrime të shenjta dhe rëndësinë e të paturit të një emri të mirë, një mori kujtimesh më erdhën në mendje mbi emrin e mirë dhe trashëgiminë që prindërit e mi u lanë katër vëllezërve, dy motrave të mia dhe mua. Prindërit e mi nuk patën pasuritë e botës, as nuk patën argjend apo flori. Të nëntë ne u rritëm në një shtëpi me dy dhoma gjumi dhe një banjë me një verandë të mbyllur prapa ku flinin motrat e mia. Kur prindërit e mi vdiqën, vëllezërit, motrat e mia dhe unë u mblodhëm për të ndarë pasuritë e tyre tokësore, që ishin të pakta në numër. Nëna ime la disa veshje, disa mobilje të përdorura dhe pak gjëra të tjera personale. Babai im la disa vegla marangozi, disa pushkë të vjetra gjahu dhe pak të tjera. Të vetmet gjëra me ndonjë vlerë monetare ishin një shtëpi modeste dhe një llogari e vogël kursimesh.

Së bashku ne qamë pa ndruajtje, duke falënderuar, duke ditur se ata na kishin lënë neve diçka shumë më të çmueshme sesa argjendi dhe floriri. Ata na kishin dhënë neve dashurinë

e tyre dhe kohën e tyre. Ata shpesh kishin dhënë dëshmi të së vërtetës së ungjillit, që ne mund ta lexojmë në ditarët e tyre të çmuar. Jo aq me fjalë por më shumë me shembull, ata na patën mësuar ne të punojmë fort, të jemi të ndershëm dhe të paguajmë të dhjetë të plotë. Ata gjithashtu mbollën tek ne një dëshirë për të çuar më tej arsimimin tonë, të shërbenim në një mision dhe, më e rëndësishmja, të gjenim një shok apo shoqe të përjetshme, të martoheshim në tempull dhe të duronim deri në fund. Me të vërtetë, ata na lanë neve trashëgiminë e një emri të mirë, për të cilin ne do të jemi përgjithmonë mirënjohës.

Kur profeti i dashur Haleman dhe bashkëshortja e tij u bekuan me dy bij, ata i quajtën ata Lehi dhe Nefi. Helamani u tregoi bijve të tij përse ata kishin marrë emrat e dy paraardhësve të tyre „që kishin jetuar në tokë, thuajse 600 vite përpara lindjes së tyre. Ai tha:

Ai tha: “Vini re, bijtë e mi . . . , unë ju dhashë emrat e prindërve tanë të parë [Lehi dhe Nefi] . . . ; dhe këtë gjë e bëra, që kur ju të kujtoni emrat tuaj . . . ju mund të kujtoni *veprat e tyre*; dhe kur t’i kujtoni *veprat e tyre*, *ju mund të dini siç është thënë dhe gjithashtu shkruar, që ato qenë të mira.*

Kur qe 15 vjeçe, Motra Arnold (e përfaqësuar këtu nga e bija), kuptoi fuqinë mbrojtëse të urdhërimeve kur po ruante bagëtinë që po kulloste.



Prandaj, bijtë e mi, unë do të doja që ju të bëni atë që është e mirë, *që të mund të thuhet dhe gjithashtu të shkruhet për ju, madje ashtu siç u tha dhe u shkrua për ta.*

. . . *që ju të mund të kenit atë dhuratë të çmueshme të jetës së përjetshme.*⁵

Vëllezër dhe motra, pas 600 vitesh, si do të kujtohen emrat tanë?

Duke folur rrethi mënyrën se si ne mund të marrim mbi vete emrin e Krishtit dhe kështu të mbrojmë emrin tonë të mirë, Moroni na mësoi:

“Dhe përsëri, unë do t’ju këshilloja që ju të vini te Krishti dhe të merrni çdo dhuratë të mirë dhe të mos prekni dhuratën e ligë, as gjënë e papastër. . . .

Po, *ejani te Krishti* dhe përsosuni në të dhe i mohoni vetes çdo ligësi”.⁶

Në broshurën e frymëzuar *Për Forcën e Rinisë*, ne lexojmë: “Liria e zgjedhjes është një parim i dhënë nga Perëndia, i përjetshëm që mban në vetvete përgjegjësitë morale për zgjedhjet e bëra. Ndërsa [ne] jemi të lirë të zgjedhim [vetë], [ne] nuk jemi të lirë të zgjedhim pasojat e veprimeve [tona]. Kur [ne] bëjmë një zgjedhje, [ne] do të marrim pasojat e asaj zgjedhjeje”.⁷

Pak pasi e dashura ime, Devona, dhe unë u martuam, ajo më tregoi një

histori sesi e kishte mësuar në rininë e saj këtë doktrinë të rëndësishme që ne jemi të lirë të zgjedhim, por ne nuk jemi të lirë të zgjedhim pasojat e veprimeve tona. Me ndihmën e motrës sime Shelli, unë do të doja ta tregoja përvojën e Motrës Arnold:

“Kur isha 15 vjeç, unë shpesh ndieja se kishte tepër shumë rregulla dhe urdhërime. Unë nuk isha e sigurt nëse një adoleshent normal që i pëlqen të argëtohet, do të mund ta gëzonte jetën me kaq shumë kufizime. Për më tepër, orët e shumta të shpenzuara duke punuar në fermën e babait tim po preknin rëndshëm kohën time me miqtë.

Këtë verë të veçantë, një nga punët e mia ishte të siguroja që lopët që kullotnin në kullotën malore nuk do të shpërthenin gardhin dhe të futeshin në fushën me grurë. Një lopë duke kullotur në grurin që rritej, mund të fryhej, duke shkaktuar bllokim frymëmarrjeje dhe ngordhje. Një lopë veçanërisht po përpiquej vazhdimisht ta fuste kokën nëpër gardh. Një mëngjes, ndërsa po shkoja me kalë përgjatë vijës së gardhit duke kontrolluar bagëtitë, unë pashë se lopa kishte shpërthyer gardhin dhe ishte futur në fushën me grurë. Për tmerrin tim, unë pashë se ajo po hante në fushën e grurit për një kohë jo të vogël sepse tashmë ajo ishte fryrë dhe i ngjante shumë një tollumbaceje. Mendova: ‘Ti lopë budallaqe! Ai gardh ishte që të të mbronte ty dhe ti prapë çave nëpër të dhe ke ngrënë aq shumë grurë sa jeta jote është në rrezik.’

Unë nxitova për në ndërtesën e fermës për të marrë babanë tim. Gjithsesi, kur u kthyem, unë e gjeta atë të ngordhur shtrirë në tokë. U dëshpërova nga humbja e asaj lope. Ne i kishim siguruar asaj një kullotë malore të mrekullueshme për të kullotur dhe një gardh për ta mbajtur larg grurit të


rezikshëm, por përsëri ajo me budallallëk shpërtheu nëpër gardh dhe i shkaktoi vetes ngordhjen.

“Ndërsa mendoja mbi rolin e gardhit, unë kuptova se ai ishte një mbrojtje, njësoj si urdhërimet dhe rregullat e prindërve të mi ishin një mbrojtje. Urdhërimet dhe rregullat ishin për të mirën time. Unë kuptova se bindja ndaj urdhërimeve mund të më shpëtojë nga vdekja fizike dhe shpirtërore. Ai ndriçim ishte një pikë kthese në jetën time”.

Motra Arnold mësoi se Ati ynë Qiellor bujar, i urtë dhe i dashur na ka dhënë neve urdhërime jo për të na kufizuar, siç do të donin kundërshtarët të besonim, por për të bekuar jetën tonë dhe për të mbrojtur emrin dhe trashëgiminë tonë të mirë për brezat e ardhshëm – pikërisht siç ato kishin bërë për Lehin dhe Nefin. Pikërisht si lopa që mori pasojat e zgjedhjes së saj, secili nga ne duhet të mësojë se bari nuk është *kurrë* më i gjelbër në anën tjetër të gardhit – as do të jetë *kurrë*, sepse “ligësia *kurrë* nuk ka qenë lumturi”⁸. Secili nga ne do të marrë pasojat e zgjedhjeve të veta kur kjo jetë të mbarojë. Urdhërimet janë të qarta, ato janë mbrojtëse – ato nuk janë kufizuese – dhe bekimet e mrekullueshme të bindjes janë të panumërta!

Ati ynë Qiellor e dinte se ne të gjithë do të bënim gabime. Unë jam kaq mirënjohës për Shlyerjen, që e lejon secilin prej nesh të pendohet, të bëjë rregullimet e nevojshme që edhe një herë të mund të jetë një me Shpëtimtarin tonë dhe të ndiejë paqen e ëmbël të faljes.

Shpëtimtari ynë na fton çdo ditë të pastrojmë emrin tonë dhe të kthehemi në praninë e Tij. Nxitja e Tij është plot me dashuri dhe dhembshuri. Përfytyroni me mua përqaftimin e Shpëtimtarit ndërsa po lexoj fjalët e Tij: “A nuk do të ktheheni tani tek unë dhe



të pendoheni për mëkatet tuaja dhe të ktheheni në besim, që të mund t’ju shëroj?”⁹

Sot unë do të doja t’i drejtoj të njëjtën nxitje secilit prej jush që prindërit e mi, që do të kujtohen përgjithmonë për shkak të emrit të tyre të mirë, më drejtuan mua. Përpara se të veproni, përfytyroni Shpëtimtarin ulur në anën tuaj dhe pyesni veten: “A do ta mendoja, a do ta thoshja, apo a do ta bëja unë atë duke ditur se Ai është atje?” Sepse me siguri Ai është atje. Presidenti ynë i dashur Tomas S. Monson, që unë dëshmoj se është një profet, shpesh citon vargun e mëposhtëm të shkrimit të shenjtë kur flet për Zotin dhe Shpëtimtarin tonë: “Unë do të shkoj përpara fytyrës suaj. Unë do të jem në të djathtën e në të majtën tuaj dhe Shpirti im do të jetë në zemrat tuaja”¹⁰.

Në atë ditë të lavdishme kur ne të qëndrojmë përpara Shpëtimtarit tonë të dashur për të treguar se çfarë kemi bërë me emrin e Tij, qofshim në gjendje të deklarojmë: “Luftën e mirë e luftova, e përfundova vrapimin, e ruajta besimin.”¹¹ “Unë e kam nderuar emrin Tënd”. Unë dëshmoj se Jezusi është Krishti. Ai vdiq që ne të mund të jetojmë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. *Presidents of the Church Student Manual* (Church Educational System manual, 2003), f. 134.
2. Shih Doktrina e Besëlidhje 20:77.
3. Fjalët e Urta 22:1.
4. Fjalët e Urta 10:7.
5. Helamani 5:6–8; korsivet shtuar.
6. Moroni 10:30,32; korsivet shtuar.
7. *For the Strength of Youth* (broshurë, 2001), f. 4.
8. Alma 41:10.
9. 3 Nefi 9:13.
10. Doktrina e Besëlidhje 84:88.
11. 2 Timoteu 4:7.



Nga Plaku M. Rasëll Ballard,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

O, Ai Plani Dredharak i të Ligut

Ka shpresë për personat e rënë në varësi dhe kjo shpresë vjen përmes Shlyerjes së Zotit Jezu Krishti.

Vëllezër dhe motra, mbërritja e stinës së vjeshtës këtu në Malet Shkëmbore, sjell me vete ngjyrat e shkëlqyera të gjetheve që, nga të gjelbra, shndërrohen në ngjyra të ndezura portokalli, të kuqe e të verdhë. Gjatë vjeshtës e gjithë natyra është në një gjendje kalimtare, në përgatitje për bukurinë e ashpër e të ftohtë të dimrit.

Vjeshta është një kohë veçanërisht emocionuese për peshkatarët që gjuajnë me karrema artificialë, pasi kjo është koha që troftat nxiten nga një uri pothuaj e pangopur për t'u ushqyer, në mënyrë që të fuqizojnë trupin ndaj mungesës së ushqimit dimëror.

Qëllimi i një peshkatori të tillë është që ta zërë troftën nëpërmjet një mashtrimi të zotë. Peshkatori i aftë studion sjelljen e troftës, të motit, të rrymës së ujit dhe të llojeve të insekteve që trofta ha dhe se kur insektet çelin. Ai shpeshherë do t'i përgatisë me dorë karremat që përdor. Ai e di se këto insekte artificialë, ku kanë futur grepa të imët, duhet të jenë një mashtrim i përkryer, sepse trofta do të dallonte edhe të metën më të vockël dhe nuk do ta pranonte karremin.

Ç'rrenqethje është të vështrosh një troftë të çajë sipërfaqen e ujit, të

rrefusë karremin dhe të rezistojë derisa më në fund të lodhet dhe të tërhiqet me rrokel. Gara qëndron tek ndeshja e njohurisë dhe e aftësisë së peshkatarit kundrejt troftës fisnike.

Përdorimi i karremave artificialë për ta gabuar dhe zënë peshkun, është një shembull i mënyrës si Luciferi shpeshherë na tundon, mashtron e përpiket të na fusë në kurth.

Sikurse peshkatori i karremave artificialë, i cili e di që troftat nxiten nga uria, Luciferi e njeh "urinë" ose dobësitë tona dhe na tundon me karrema të rremë të cilat, nëse i marrim, mund të shkaktojnë shkaputjen tonë nga përroi i jetës tek ndikimi i tij i pamëshirshëm. Dhe ndryshe nga peshkatori i karremave artificialë, i cili e zë dhe sërish e lëshon peshkun të padëmtuar në ujë, Luciferi nuk lejon vullnetarisht që të ikësh. Synimi i tij është që ta bëjë viktimën të mjerë aq sa është vetë.

Lehi tha: "Dhe për shkak se ai [Luciferi] kishte rënë nga qielli dhe ishte bërë i mjeruar përgjithmonë, ai kërkoi gjithashtu mjerimin e të gjithë njerëzimit" (2 Nefi 2:18).

I shtoj sot zërin tim zërave të Vëllezërve të mi se Luciferi është një inteligjencë e zgjuar dhe dinake. Një

nga mënyrat që ai përdor kundër nesh, është aftësia e tij për të gënjer e mashtruar, që të na bindë se e keqja është e mirë dhe e mira është e keqe. Pikërisht që nga fillimi, në Këshillin në Qiell, Satani "kërkoi të shkatërronte lirinë e njeriut për të zgjedhur, të cilën, unë, Zoti Perëndi, ia kisha dhënë atij. . . .

Dhe ai u bë Satani, po, madje djalli, ati i të gjitha gënjeshtreve, për të mashtruar dhe verbuar njerëzit dhe për t'i bërë ata robër të vullnetit të tij" (Moisiu 4:3-4).

Beteja lidhur me lirinë e zgjedhjes të dhënë njeriut nga Perëndia, sot vazhdon. Satani dhe të bindurit e tij kanë karremat e tyre kudo rreth nesh, duke shpresuar që ne të lëkundemi dhe të marrim karremat artificialë të tij, në mënyrë që të na zërë me mjete të falsifikuara. Ai përdor varësinë për të vjedhur lirinë e zgjedhjes. Sipas fjalorit, varësia e çdo lloji do të thotë të dorëzohesh ndaj diçkaje, kësaj duke hequr dorë nga liria e zgjedhjes e duke u bërë i varur nga ndonjë substancë ose sjellje jetëshkatërruese¹.

Studiuesit na thonë se në trurin tonë ka një mekanizëm të quajtur qendra e kënaqësisë². Kur aktivizohet nga disa droga apo sjellje, ajo mposht pjesën e trurit që sundon forcën e vullnetit, gjykimin, logjikën dhe moralin tonë. Kjo e çon personin e rënë në varësi në braktisjen e asaj që ai ose ajo e di se është e drejtë. Dhe, kur kjo ndodh, grepi është vendosur dhe Luciferi merr kontrollin.

Satani di si t'i shfrytëzojë e të na zërë në kurth me substanca dhe sjellje artificiale të kënaqësisë së përkohshme. Kam vëzhguar ndikimin që ndodh kur dikush mundohet të fitojë sërish kontrollin, për t'u çliruar nga abuzimi dhe varësia shkatërruese e për të rifituar vetërespektin dhe pavarësinë.



Disa nga drogat vesformuese që, nëse me to abuzohet, mund të rrëmbejnë trurin dhe të heqin lirinë e zgjedhjes, përfshijnë: nikotinën; droga me bazë opiumin – heroina, morfina dhe qetësues të tjerë dhembjesh; qetësuesit nervorë; kokainën; alkoolin; marijuanën; dhe metamfetaminën.

Unë jam mirënjohës për doktorët që janë trajnuar për të këshilluar mjekime të përshtatshme për të lehtësuar dhembjen dhe vuajtjen. Fatkeqësisht, shumë nga komunitetet tona sot, përfshirë dhe disa nga anëtarët tanë, bien në varësi dhe më pas abuzojnë me mjekimet e këshilluara. Luciferi, ati i gjithë gënjeshtrove, e di këtë dhe përdor ndikimin e tij për të vjedhur lirinë e zgjedhjes së dikujt dhe e zë abuzuesin me zinxhirët e tij të tmerrshëm (shih 2 Nefi 28:22).

Para pak kohe, fola me një motër e cila ndodhej në njësinë e psikiatrisë të një spitali lokal. Ajo më tregoi udhëtimin e saj të trishtë, nga shëndeti i saj i plotë mendor dhe fizik, martesë dhe familja e saj e mrekullueshme, deri në sëmundjen mendore, shëndetin dobësues dhe shkatërrimin e familjes së saj – ku që të gjitha filluan me abuzimin me qetësues dhembjesh të dhënë me recetë.

Dy vjet përpara bisedës sonë, ajo e lëndoi shpinën në një aksident me makinë. Mjeku i saj i këshilloi një mjekim për të qetësuar dhembjen pothuajse të padurueshme. Ajo mendoi se i nevojitej diçka më shumë, prandaj falsifikoi recetat dhe përfundimisht vazhdoi me blerjen e heroinës. Kjo çoi në ndalimin dhe burgosjen e saj. Mania e saj me drogat bëri që martesë të dështojë. Bashkëshorti i saj e ndau dhe mbajti kujdestarinë e fëmijëve. Ajo më tregoi që, përveç ndihmës për të topitur dhimbjen e saj, drogat gjithashtu siguronin një ndjesi kohëshkurtër, por të shtuar euforie dhe mirëqenieje. Por secila dozë e drogave zgjaste vetëm pak orë dhe, me çdo përdorim, zgjatja e qetësimit dukej se pakësohej. Ajo filloi të merrte droga gjithnjë e më shumë dhe u kap nga cikli i mbrapshtë i varësisë. Drogat u bënë jeta e saj. Një natë para se të flisja me të, ajo u përpoq të vetëvritej. Ajo tha se nuk mund të luftonte më me dhembjen fizike, emocionale dhe shpirtërore. Ndihej e zënë në grackë, pa asnjë rrugëdalje – pa asnjë shpresë.

Problemi i kësaj motre me abuzimin me ilaçet e recetës dhe të tjera, nuk është i veçantë; ai po ndodh gjithkund rreth nesh. Në disa vende

vdesin më shumë njerëz nga abuzimi me ilaçet e recetës, sesa vdesin nga aksidente automobilistike³. Vëllezër dhe motra, qëndroni larg nga çdo lloj substance që mund t'ju fusë në kurth. Madje edhe një rruftje e diçkaje ose një tabletë apo një e pirë e alkoolit, mund të çojë në vesformim. Një i alkoolizuar që po shërohej më tregoi se një e pirë e vetme përbën ndryshimin mes varësisë dhe mendjethjelltësisë. Satani e di këtë. Mos e lejoni t'ju kapë me karremat e tij artificialë, që me të shpejtë mund të kthehen në varësi.

Tani, vëllezër e motra, ju lutem të mos e keqkuptoni atë që po them. Unë nuk po vë në dyshim mjekimet e këshilluara për ata që vuajnë me sëmundje të trajtueshme apo dhembje të mëdha fizike. Ato janë vërtet një bekim. Ajo që unë po them është që duhet të ndjekim me kujdes dozat e këshilluara nga mjekët. Dhe nevojitet që mjekime të tilla t'i mbajmë në një vend të sigurt, ku fëmijët apo tjetërkush të mos arrijë t'i marrë.

Ekziston gjithashtu një shqetësim i madh lidhur me disa nga sjelljet dëmtuese e vesformuese si kumari dhe e keqja e pornografisë, që janë aq shkatërruese për personin dhe aq të shfrenuara në shoqërinë tonë. Kujtoni, vëllezër e motra, çdo lloj varësie është t'i dorëzohesh diçkaje, kësajohiqet dorë nga liria e zgjedhjes e bëhesh i varur. Kështu, lojërat elektronike dhe mesazhet në celularë i duhen shtuar listës. Disa lojtarë deklarojnë se shpenzojnë deri në 18 orë në ditë duke kaluar nivel pas niveli në lojë elektronike, duke neglizhuar të gjitha aspektet e tjera të jetës së tyre. Mesazhet në celularë mund të bëhen një varësi, duke shkaktuar që komunikimi i rëndësishëm ndërpersonal dhe njerëzor të zhduket. Jo shumë kohë më parë, një peshkop më tregoi se dy nga të rinjtë e tij po qëndronin

pranë e pranë duke i shkruar mesazhe njëri-tjetrit, në vend që të flisnin me njëri-tjetrin.

Studimi mjekësor e përshkruan varësinë si “një sëmundje të trurit”⁴. Kjo është e vërtetë, por unë besoj që, kur Satani e ka futur dikë në dorë, ajo bëhet gjithashtu një sëmundje e shpirtit. Por, pavarësisht se në çfarë cikli varësie është kapur dikush, ka gjithnjë shpresë. Profeti Lehi u mësoi bijve të tij këtë të vërtetë hyjnore: “Kështu që, njerëzit janë të lirë sipas mishit; dhe të gjitha gjërat u janë dhënë atyre të cilat janë të nevojshme për njeriun. Dhe ata janë të lirë të zgjedhin lirinë dhe jetën e përrjetshme, nëpërmjet Ndërmjetësit të madh të të gjithë njerëzve, ose të zgjedhin robërinë dhe vdekjen, sipas robërisë dhe fuqisë së djallit” (2 Nefi 2:27).

Nëse dikush që ka rënë në varësi, ka dëshirë ta mposhtë vesin, atëherë ka një rrugë drejt lirisë shpirtërore – një mënyrë për të shpëtuar nga robëria – një rrugë që është e provuar. Ajo fillon me lutjen – komunikimin e sinqertë, të zjarrtë dhe të vazhdueshëm me Krijuesin e shpirtave dhe të trupave tanë, Atin tonë Qiellor. Është i njëjti parim si në ndërprerjen e një zakoni të keq apo në pendimin për mëkatin e çfarëdo lloji. Formula për shndërrimin e zemrës sonë, trupit tonë, mendjes sonë dhe shpirtit tonë gjendet në shkrimet e shenjta.

Profeti Mormon na këshilloi: “Prandaj, vëllezër të mi të dashur, lutjuni Atit me gjithë fuqinë e zemrës suaj, që të mbusheni me dashurinë e tij . . . që ju të mund të bëheni bijtë e Perëndisë; . . . që ne të mund të pastrohemi, madje ashtu si ai është i pastër” (Mormoni 7:48).

Ky dhe shumë shkrime të shenjta të tjera na dëshmojnë se ka shpresë për personin që ka rënë në varësi dhe kjo shpresë vjen përmes Shlyerjes së Zotit

Jezu Krishti e duke u përlulur përpara Perëndisë, duke u përgjyruar për t’u çliuar nga robëria e varësisë dhe duke ofruar gjithë shpirtin tonë tek Ai në lutje të zjarrtë.

Udhëheqësit e priftërisë mund të ndihmojnë teksa ata që kanë varësi kërkojnë këshillë prej tyre. Aty ku është e nevojshme, ata mund t’i adresojnë tek këshilluesit e kualifikuar e të licensuar dhe tek LDS Family Services (Shërbimet Familjare të SHDM). Programi i shërimit nga varësia, i përshtatur nga 12 hapat origjinalë të organizatës Alcoholics Anonymous (Të Alkoolizuarit Anonimë), mund të merret pa vështirësi përmes Shërbimeve Familjare të SHDM.

Për ata që po luftojnë me varësinë në mënyrë vetjake apo brenda familjes suaj, e përsëris, lutja e zjarrtë është çelësi në fitimin e forcës shpirtërore për të gjetur paqen dhe mposhtur një dëshirim vesformues. Ati Qiellor i do të gjithë fëmijët e Tij, prandaj, falënderojeni dhe shprehni besim të sinqertë në Të. Kërkojini Atij forcë për të mposhtur varësinë që po përjetoni. Lëreni mënjane gjithë krenarinë dhe kthejeni jetën tuaj dhe zemrën tuaj drejt Tij. Kërkoni të mbusheni me fuqinë e dashurisë së pastër të Krishtit. Mund të duhet ta bëni këtë shumë herë, por ju dëshmoj se trupi, mendja dhe shpirti juaj mund të shndërrohen, të pastrohen e të shërohen dhe ju do të çliroheni. Jezusi tha: “Unë jam drita e botës; kush më ndjek nuk do të ecë në errësirë, por do të ketë dritën e jetës” (Gjoni 8:12).

Ngaqë synimi ynë është që të bëhemi më shumë si Shpëtimtari ynë dhe, përfundimisht, të bëhemi të pranueshëm për të jetuar me Atin tonë Qiellor, secili nga ne duhet të përjetojë në zemër ndryshimin e fuqishëm që përshkruhet nga profeti Alma në Librin e Mormonit (shih Alma

5:14). Dashuria jonë për Atin tonë Qiellor dhe Zotin Jezu Krishti duhet të pasqyrohet në zgjedhjet dhe veprimet tona të përditshme. Ata kanë premtuar paqe, gëzim dhe lumturi për ata të cilët i zbatojnë urdhërimet e Tyre.

Vëllezër dhe motra, qofshim ne të gjithë të vetëdijshëm për karremat artificialë që na paraqiten nga peshkari i shtirë i njerëzve, Luciferi. Paçim urtësinë dhe mprehtësinë shpirtërore për të dalluar e kundërshtuar ofertat e tij të shumta të rrezikshme.

E për ata prej jush të cilët kanë rënë pre e ndonjë lloj varësie, ka shpresë, sepse Perëndia i do të gjithë fëmijët e Tij dhe sepse Shlyerja e Zotit Jezu Krishti i bën të mundura të gjitha gjërat.

E kam parë bekimin e mrekullueshëm të shërimit që e bën dikë të lirë nga zinxhirët e varësisë. Zoti është Bariu ynë dhe nuk do të na mungojë gjë kur ne mirëbesojmë në fuqinë e Shlyerjes. E di që Zoti mund t’i çlirojë e do t’i çlirojë nga robëria personat e rënë në varësi, sepse, ashtu siç shpalli Apostulli Pal, “unë mund të bëj gjithçka me anë të Krishtit që më forcon” (Filipianëve 4:13). Lutem që kjo, vëllezër e motra, të mund të jetë kështu për ata që mund të jenë duke luftuar me këtë sfidë në këtë kohë të jetës së tyre dhe lutem kështu në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Në formë emri, *addiction* (varësi) ka tre kuptime, ku njëri është “një i nënshtruar ndaj një padroni” (www.audioenglish.net/dictionary/addiction.htm)
2. Shih National Institute on Drug Abuse, *Drugs, Brains, and Behavior – the Science of Addiction* (2010), 18, drugabuse.gov/scienceofaddiction/sciofaddiction.pdf.
3. Shih Erika Potter, “Drug Deaths Overtake Auto Deaths in Utah”, dhjetor 2009, universe.byu.edu/node/4477.
4. Shih National Institute on Drug Abuse, “The Neurobiology of Drug Addiction”, seksioni IV, nr. 30, drugabuse.gov/pubs/teaching/teaching2/teaching5.html; shih edhe drugabuse.gov/funding/budget08.html.



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Derisa Prapë të Takohemi

Ne duhet të durojmë deri në fund, sepse synimi ynë është jeta e përjetshme në praninë e Atit tonë në Qiell.

Vëllezër dhe Motra të mia, zemra ime është plot ndërsa po i afrohem fundit të kësaj konference të përgjithshme të mrekullueshme të Kishës. Jemi ushqyer shpirtërisht ndërsa kemi dëgjuar këshillën dhe dëshmitë e atyre që kanë marrë pjesë në secilin sesion. Jam i sigurt se flas për të gjithë anëtarët kudo qofshin, kur shpreh vlerësim të thellë për të vërtetat që na janë mësuar. Ne mund të përsërisnim fjalët, që gjenden në Librin e Mormonit, e atyre që dëgjuan predikimin e të madhit Mbreti Beniamin dhe që “thirrën me një zë, duke thënë: Po, ne i besojmë të gjitha fjalët që ti na ke folur; dhe ne gjithashtu dimë për sigurinë dhe vërtetësinë e tyre, për shkak të Shpirtit të Zotit të Plotfuqishëm”¹.

Shpresoj se do të marrim kohë që të lexojmë bisedat e konferencës, të cilat do të shtypen në numrin e nëntorit të revistave *Ensign* dhe *Liahona*, sepse meritojnë studimin tonë të kujdesshëm.

Çfarë bekimi është që kemi qenë në gjendje të takohemi këtu, në këtë Qendër madhështore të Konferencave, në paqe, rehati dhe siguri. Kemi pasur një transmetim të pashembullt të konferencës, duke mbërritur tek njerëzit

kudo nëpër kontinente dhe oqeanë. Edhe pse jemi shumë larg prej shumëkujt nga ju, ne e ndiejmë shpirtin tuaj dhe ju dërgojmë dashurinë dhe vlerësimin tonë.

Vëllezërve tanë që u liruan nga detyra në këtë Konferencë: më lejoni t’ju shpreh mirënjohjen e përzemërt të të gjithëve ne për vitet tuaja të shumta të shërbimit të përkushtuar. Të panumërt janë ata që janë bekuar nga kontributet tuaja për punën e Zotit.

Kori i Tabernakullit dhe koret e tjera që kanë marrë pjesë në sesione, kanë sjellë vërtet muzikë qiellore, që e ka shtuar dhe zbukuruar gjithçka tjetër që u zhvillua. Ju falënderoj që ndani me ne talentet dhe aftësitë tuaja muzikore.

I dua dhe i vlerësoj këshilltarët e mi besnikë, Presidentin Henri B. Ajring dhe Presidentin Diter F. Uhtdorf. Ata janë vërtet burra të urtësisë e të kuptimit dhe shërbimi i tyre është i paçmueshëm. Nuk do të mund të bëja gjithçka që jam thirrur të bëj, pa pasur mbështetjen dhe ndihmën e tyre. I dua dhe i admiroj Vëllezërit e mi të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve dhe të gjithë ata që janë në kuorumet e Të Shtatëdhjetëve dhe në Peshkopatën Kryesuese. Ata shërbejnë me vetëmohim dhe efektshmëri. Ngjashëm, unë shpreh vlerësimin tim për gratë dhe burrat që shërbejnë si drejtues të organizatave ndihmëse të përgjithshme.

Sa të bekuar jemi që kemi ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit. Ai u jep përgjigje pyetjeve në lidhje me atë se nga kemi ardhur, pse jemi këtu dhe ku do të shkojmë kur të largohemi nga



kjo jetë. Ai i jep kuptim, qëllim dhe shpresë jetës sonë.

Ne jetojmë në një botë të trazuar, në një botë me shumë sfida. Ne jemi këtu në këtë tokë që të merremi me sfidat tona individuale me maksimumin e aftësive tona, që të mësojmë prej tyre dhe që t'i kapërcejmë ato. Ne duhet të durojmë deri në fund, sepse synimi ynë është jeta e përvetshme në praninë e Atit tonë në Qiell. Ai na do dhe nuk do asgjë tjetër për ne, përveç suksesit tonë në këtë synim. Ai do të na ndihmojë dhe do të na bekojë kur i drejtohem Atij në lutjet tona, kur i studiojmë fjalët e Tij dhe kur u bindemi urdhërimeve të Tij. Në to gjendet siguri; në to gjendet paqe.

Perëndia ju bekoftë, Vëllezër e Motra të mia. Ju falënderoj për lutjet tuaja në të mirën time dhe në të mirë të të gjithë Autoriteteve të Përgjithshme. Jemi thellësisht mirënjohës për ju dhe për gjithçka bëni që ta çoni më tej Mbretërinë e Perëndisë në tokë.

Bekimet e qiejve qofshin me ju. Shtëpitë tuaja u mbushshin me dashuri e mirësjellje dhe me Shpirtin e Zotit. I ushqefshi vazhdimisht dëshmitë tuaja të ungjillit, që të jenë një mbrojtje për ju kundër goditjeve të Satanit.

Konferenca tani mbaroi. Ndërsa kthehemi në shtëpitë tona, u ktheshim të sigurt. Shpirti që kemi ndier këtu, qoftë me ne e banoftë në ne kur merremi me ato gjëra që na mbushin kohën çdo ditë. Tregofshim mirësi më të rritur kundrejt njëri-tjetrit; u gjendshim gjithmonë duke bërë punën e Zotit.

Unë ju dua; unë lutem për ju. Ju jap lamtumirën derisa prapë të takohemi pas gjashtë muajsh. Në emrin e Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, madje Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIM

1. Mosia 5:2.



Nga Xhuli B. Bek

Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës

“Motra në Mbretërinë Time”: Historia dhe Puna e Shoqatës së Ndihmës

Studimi i historisë së Shoqatës së Ndihmës jep një përkufizim dhe shprehje të asaj se cilat jemi ne si dishepuj dhe ndjekëse të Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit.

Kjo mbledhje është një dhuratë për të gjitha bijat e Atit Qiellor që dëshirojnë të mësojnë mendimin dhe vullnetin e Tij dhe të kuptojnë përgjegjësitë e tyre në planin e Tij. Unë kam vizituar shumë nga ju këtë vit të fundit dhe zemra ime është prekur ndërsa kam vështruar në sytë tuaj, ju kam përqaftuar, kam qeshur me ju, kam qarë me ju dhe kam ndjekur hidhërimin, gëzimin dhe triumfin tuaj. Secila prej jush çmohet tej çdo përshkrimi dhe njihet prej Atit tonë Qiellor. Si bija të Perëndisë, ju po përgatiteni për planet e përvetshme dhe secila prej jush ka një identitet, natyrë dhe përgjegjësi femërore. Suksesi i familjeve, komuniteteve, kjo Kishë dhe plani i çmuar i shpëtimtarit varen nga besnikëria juaj. Oh, motra të dashura, sa ju duam dhe lutemi për ju!

Të gjithë ne jemi në mes të një përvetshme vetjake tokësore. Dy motra që kam takuar kohët e fundit, përfaqësojnë atë se si duhet jetuar besnikërisht. Një motër jeton në një shtëpi të bukur në Brazilin qendror. Shtëpia e saj me tulla të kuqe të bukura, vendosur në një oborr me tokë të kuqe, rrethuar nga një mur me blloqe të kuqe është një qiell dhe strehë nga bota jashtë. Fëmijët e saj me sy të ndritur dinë t'i këndojnë këngët e Fillores dhe në muret e shtëpisë së saj varen piktura të Shpëtimtarit, tempujve dhe profetëve të Perëndisë, të prera nga revista *Liahona*. Ajo dhe bashkëshorti i saj bënë sakrificë vetjake për t'u vulosur në tempull në mënyrë që fëmijët e tyre të mund të lindin në beslidhje. Ajo më tregoi se i lutet vazhdimisht Zotit që t'i japë forcë

dhe frymëzim të mjaftueshëm për t'i sjellë fëmijët e saj në dritën, të vërtetën dhe forcën e ungjillit.

Një motër tjetër jeton vetëm në një apartament të vogël në katin e 80-të të një ndërtese në Hong-Kong. Ajo ka disa vështirësi fizike, por është gëzueshëm e pavarur. Ajo është anëtarja e vetme e Kishës në familjen e saj. Në një raft të vogël janë shkrimet e shenjta të saj, manualët e Shoqatës së Ndhmës dhe libra të tjerë të Kishës. Ajo ka krijuar një mjedis plot Shpirt në shtëpi dhe është dritë për këdo në degën e saj.

Paralajmërimë

Ne e dimë se shumë motra jetojnë në kushte shtypëse apo të rrezikshme. Disa janë gjithnjë të uritura dhe disa duhet të mbledhin gjithë kurajën e tyre të ditës për të vazhduar në besim megjithë zhgënjimet dhe tradhëtitë nga të tjerët. Ngaqë ne jetojmë në ditët e fundit të kësaj toke, ka shenja të një lufte të madhe kudo. Mite dhe keqkuptime lidhur me forcën, qëllimin dhe pozitën e grave shenjtoresh të ditëve të mëvonshme, gëlojnë. Mite që dominojnë, lënë të kuptohet se ne jemi me rëndësi më të pakët se burrat, se ne jemi në përgjithësi të ëmbla por të painformuara dhe se pavarësisht se çfarë bëjmë, ne kurrë nuk do të arrijmë të jemi të pranueshme nga Ati ynë Qiellor. Ashtu siç tha Apostulli Pjetër, ka “midis jush mësues të rremë, të cilët do të fusin fshehurazi herezi shkatërruese dhe, duke mohuar Zotërinë që i bleu ata”¹.

Libri i Mormonit përshkruan çfarë po ndodh:

“Pasi vini re, në atë ditë ai do të tërbohohet në zemrat e fëmijëve të njerëzve dhe do t'i nxitë në zemërim kundër asaj që është e mirë.

Dhe të tjerë ai do t'i paqësojë dhe do t'i përkundë në siguri trupore, që



ata do të thonë: Gjithçka është mirë në Sion; po, Sioni lulëzon, gjithçka është mirë – dhe kështu djalli gënjen shpirtat e tyre dhe ai i çon me kujdes poshtë në ferr.

Dhe vini re, të tjerët ai i lajkaton dhe u thotë se nuk ka ferr; dhe ai u thotë atyre: Unë nuk jam djall, pasi nuk ka asnjë – dhe kështu ai pëshpërit në veshët e tyre, derisa i kap ata me zinxhirët e tij të tmerrshëm.”²

Në klimën në rritje për privilegje, justifikim, apati dhe joshje, bijat e Perëndisë që nuk janë syçelëta, plot lutje dhe të frymëzuara, janë me rrezik në rritje që të bëhen çka shkrimet e shenjta e përshkruajnë si “femrat e ngarkuara me mëkate”³, që adhurrojnë “perënditë e huaja”⁴. Mjerisht, si rezultat i vështirësive të jetës dhe të herezive të përhapura të botës, shumë motra besojnë mitet më shumë sesa të vërtetën. Kjo vihet re në konstatimet se shumë nuk po bëjnë gjërat thelbësore si lutja dhe leximi i shkrimeve të shenjta. Zoti Vetë ka thënë se kjo është “një ditë paralajmërimi dhe jo një ditë fjalësh të shumta”⁵.

Shoqata e Ndhmës u Organizua që të Jetë Mbrojtje dhe Strehë

Me qëllim që të mbikëqyrë, mësojë dhe frymëzojë bijat e Tij në këto kohë të rrezikshme, Perëndia autorizoi Profetin Jozef Smith të organizonte gratë e Kishës. Kjo organizatë e caktuar hyjnisht dhe e drejtuar nga priftëria, quhet Shoqatë e Ndhmës.

Qëllimi i Shoqatës së Ndhmës është të përgatisë bijat e Perëndisë për bekimet e jetës së përjetshme ndërsa ato rriten në besim dhe në drejtësinë e tyre, forcojnë familjet e shtëpitë dhe kërkojnë e ndihmojnë ata që janë në nevojë.

Shoqata e Ndhmës sqaron punën tonë dhe na bashkon si bija të Perëndisë në mbrojtje të planit të Tij. Në këtë ditë të identiteteve të ngatërruara, rrëmujës dhe shushatjes, Shoqata e Ndhmës është një busull dhe udhëzues për t'u mësuar të vërtetën grave besnike. Gratë e drejta sot kërkojnë një vërshim të zbulues që t'i rezistojnë çoroditjes, të luftojnë të keqen e shkatërrimin shpirtëror dhe të ngrihen mbi fatkeqësitë personale duke rritur besimin e tyre, duke forcuar familjet e tyre dhe duke u dhënë lehtësim të tjerëve.

Historia dhe Puna e Shoqatës së Ndhmës

Presidenca jonë është lutur, ka agjëruar, ka menduar thellë dhe është këshilluar me profetët, shikuesit dhe zbuluesit për të mësuar atë që Perëndia do të donte për të ndihmuar bijat e Tij që të jenë të forta përballë “fatkeqësisë që do të vinte mbi banorët e tokës”⁶. Një përgjigje ka ardhur që motrat e Kishës duhet të dinë dhe të mësojnë nga historia e Shoqatës së Ndhmës. Kuptimi i historisë së Shoqatës së Ndhmës forcon identitetin themelor dhe vetëdijen për vlerat e veta të grave besnike.

Prandaj, një histori e Shoqatës së Ndihmës për Kishën është duke u përfunduar dhe do të jetë në dispozicion për përdorim nga ne vitin tjetër. Duke i paraprirë kësaj, historisë së Shoqatës së Ndihmës po i kushtohet një vëmendje në rritje, e tillë si në faqen e vizitave mësimore të *Liahonas*. Përgatitja e historisë ka qenë një përvojë e frymëzuar dhe befusuese.

Ndërsa kemi studiuar historinë e Shoqatës së Ndihmës, ne kemi mësuar se vizioni i Zotit dhe qëllimi i Shoqatës së Ndihmës nuk ishte për një mbledhje të përgjumur të dielën. Ai kishte në mendje diçka shumë-shumë më të madhe sesa një klub gruaje apo grupi me interes të veçantë argëtimi.

Ai synonte që Shoqata e Ndihmës të ndihmojë të ngrejë popullin e Tij dhe ta përgatisë atë për bekimet e tempullit. Ai e krijoi këtë organizatë për të përfshirë bijat e Tij në punën e Tij dhe që të kërkojë ndihmën e tyre në ndërtimin e mbretërisë së Tij dhe forcimin e shtëpive të Sionit.

Historia Na Mëson se Cilat Jemi Ne

Ne e studiojmë historinë tonë që të mësojmë se cilat jemi. Ka një uri në mbarë botën midis grave të mira për të ditur identitetin, vlerën dhe rëndësinë e tyre. Studimi dhe zbatimi i historisë së Shoqatës së Ndihmës jep një përkufizim dhe shprehje të asaj se cilat jemi ne si dishepuj dhe ndjekëse të Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Besnikëria dhe shërbimi ynë janë shenja të kthimit dhe zotimit tonë për ta kujtuar dhe ndjekur Atë. Në qershor të 1830-ës, në fillimin e Rivendosjes së Kishës së Tij, Zoti zgjodhi udhëheqësen e Tij të parë femër të kësaj periudhe ungjillore dhe në një zbulesë asaj, Ai tha: "Ndërsa unë të flas ty, Emma Smith, bija ime; pasi me të vërtetë të them, tërë ata që marrin ungjillin tim, janë bij dhe bija në mbretërinë time"⁷.

Historia e Shoqatës së Ndihmës na mëson se Ati ynë Qiellor i njeht bijat e Tij. Ai i do ato, Ai u ka dhënë atyre përgjegjësi të veçanta dhe Ai u ka folur dhe i ka drejtuar ato gjatë misionit të tyre në vdekshmëri. Përveç kësaj, historia e Shoqatës së Ndihmës lartëson dhe vërteton pozitën e grave dhe tregon se si ato punojnë në marrëdhënie me udhëheqësit besnikë të priftërisë.

Historia Na Mëson Çfarë Duhet të Bëjmë

Ne e studiojmë historinë tonë që të mësojmë se çfarë duhet të bëjmë. Nëpërmjet historisë sonë ne mësojmë për t'u përgatitur për bekimet e jetës së përjetshme. Shoqata e Ndihmës, si një organizatë, ka pasur gjithmonë përgjegjësinë për të organizuar energjitë e motrave në lagjet dhe degët e Sionit. Nëpërmjet mbledhjeve të Shoqatës së Ndihmës, shërbesës së mësueseve vizitore dhe shërbimeve të tyre të kombinuara, motrat e Perëndisë mësohen, mbrohen dhe frymëzohen në përgjegjësinë e tyre në punën dhe mbretërinë e Zotit. Presidentet e Shoqatës së Ndihmës të lagjeve dhe të degëve janë veçuar për ta drejtuar atë punë.

Një vit përpara në këtë mbledhje, u njoftuan politika lidhur me mbledhje të Shoqatës së Ndihmës. Ne jemi të lumtura të raportojmë se në shumicën e lagjeve dhe të degëve kudo në botë, presidentat e Shoqatës së Ndihmës dhe motrat kanë përqaftuar ato politika dhe shpirtin e tyre. Ishte një gëzim të shihje një rigjallërim të qëllimit historik dhe të punës së Shoqatës së Ndihmës. Ne kemi parë gjithashtu një rritje në dinjitet, identitet dhe zbulesë të Shoqatës së Ndihmës ndërsa të gjitha mbledhjet e motrave tani emërtohen dhe njoftohen thjesht ashtu siç janë – mbledhje të Shoqatës së Ndihmës. Ne po shohim një rritje të besimit

e të drejtësisë vetjake, një forcim të familjeve e të shtëpive dhe më shumë ndihmë që ofrohet nga motrat e Shoqatës së Ndihmës, nëpërmjet përdorimit të drejtë të mbledhjeve të Shoqatës së Ndihmës. Të gjitha politikat lidhur me mbledhjen e Shoqatës së Ndihmës, vizitat mësimore dhe punë të tjera të Shoqatës së Ndihmës kanë themelin e tyre në historinë e Shoqatës së Ndihmës dhe janë miratuar nga Presidentja e Parë.

Ka qenë gjithnjë përgjegjësi e Shoqatës së Ndihmës që të marrë pjesë në veprën e shpëtimit. Qysh nga fillimi i Kishës së rivendosur, motrat kanë qenë atje të parat, të fundit dhe gjithnjë në përgjigje të ndodhive të jetës së përditshme. Nga Shoqata e Ndihmës, motrat përparojnë për të shërbyer te Fillorja, Të Rejat, Shkolla e së Dielës e në përpjekje të tjera dhe ato janë fenerë drite e virtyti për brezin që rritet. Shërbimi personal ngre çdo motër të veçantë dhe shërbimi i bashkuar i miliona grave besnike krijon një forcë gjigande besimi në veprën e Zotit. Historia tregon se, qysh në fillimin e Rivendosjes, motrat kanë qenë në ballë për përhapjen e ungjillit dhe ato vazhdojnë në këtë përpjekje duke shërbyer në misione, duke përgatitur të rinjtë e të rejat për të shërbyer misione dhe duke ftuar miqtë, fqinjët e anëtarët e familjeve të tyre të marrin pjesë në bekimet e ungjillit. Ne gjithashtu mësojmë nga historia se Profeti Jozef Smith i përdori mbledhjet e Shoqatës së Ndihmës për të udhëzuar motrat në përgjegjësitë dhe përgatitjen e tyre për në tempull. Sot, historia familjare dhe puna e tempullit vazhdojnë të jenë ndër detyrimet parësore të Shoqatës së Ndihmës.

Kuptimi ynë për qëllimin tonë historik i ndihmon gratë të mësojnë të vendosin përparësi siç duhet, që ato të "mos shpenzojnë" para për atë



në një motëri të madhe botërore me të reja dhe të moshuara, të pasura dhe të varfra, të arsimuara dhe analfabete, beqare dhe të martuara, bija të forta dhe të patundura të Perëndisë.

Njohja e Historisë Mund të na Ndhimjohë Ne të Ndryshojmë

Ne e studiojmë historinë tonë sepse ajo na ndihmon neve që të ndryshojmë. Së fundi, vlera e historisë nuk është aq shumë te datat, kohët dhe vendet. Ajo është e vlefshme sepse na mëson neve parimet, qëllimet dhe modelet që ne duhet të ndjekim, ajo na ndihmon të dimë kush jemi e çfarë duhet të bëjmë dhe na bashkon në forcimin e shtëpive të Sionit e në ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë në tokë. Shoqata e Ndhimës, kur vepron në mënyrë të frymëzuar, mund t'i zëvendësojë frikën, dyshimin dhe egoizmin me besim, shpresë dhe dashuri. Ndërsa ne çojmë veprën e Zotit përpara, historia e Shoqatës së Ndhimës do të vazhdojë të shkruhet nga motra besnike kudo në botë. Zoti po e forcon Shoqatën e Ndhimës në të tashmen që jetojmë dhe po përgatit një të ardhme të lavdishme për bijat e Tij.

Unë sjell dëshminë time për vërtetësinë e Atit tonë Qiellor dhe Birit të Tij, Jezu Krishtit. Nëpërmjet Profetit Jozef Smith, ungjilli, lajmi i mirë për identitetin dhe qëllimin tonë, u rivendos në tokë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. 2 Pjetrit 2:1.
2. 2 Nefi 28:20–22.
3. 2 Timoteut 3:6.
4. Jozueu 24:23.
5. Doktrina e Besëlidhje 63:58.
6. Doktrina e Besëlidhje 1:17.
7. Doktrina e Besëlidhje 25:1.
8. 2 Nefi 9:51.
9. Shih Titit 2:4–5.
10. Shih Mateu 6:4; 3 Nefi 13:4.

që nuk ka vlerë, as punën [e tyre] për atë që nuk mund të japë kënaqësi”⁸. Shoqata e Ndhimës gjithmonë ka pasur përgjegjësinë të bëjë siç mësoi Apostulli Pal: t’u mësojnë të rejave të jenë matura, të përmbajtura e të dëlira dhe t’u mësojnë atyre që janë të martuara, të duan bashkëshortët e tyre, të duan fëmijët e tyre dhe të forcojnë shtëpitë e tyre.⁹ Historia e Shoqatës së Ndhimës na mëson neve të kujdesemi për gjëra thelbësore që do të na shpëtojnë e shenjtërojnë, dhe gjëra që janë të nevojshme për t’u bërë personalisht të afta të mbështetemi tek vetja dhe të dobishme në mbretërinë e Zotit.

Një temë e përhershme në tërë historinë tonë është se motrat që përdorin fuqinë e Frymës së Shenjtë, veprojnë me frymëzimin e Zotit në jetën e tyre dhe marrin zbulesë për përgjegjësitë e tyre.

Historia Bashkon Gra Besnike

Ne e studiojmë historinë tonë sepse ajo i bashkon gratë besnike. Historia e Shoqatës së Ndhimës është një histori plot Shpirt e grave të forta, besnike, të vendosura. Si pjesë e

Kishës së rivendosur të Zotit, Shoqata e Ndhimës tani mund të gjendet në afërsisht 170 kombe. Kudo në botë, çdo gruajë të rritur në Kishën e Zotit mund t’i jepen përgjegjësi serioze dhe të rëndësishme.

Vajzat dhe gratë e reja në Kishë mësojnë të vendosin qëllime nëpërmjet Besimit në Perëndi dhe programeve të Përparimit Personal, që i përqendrojnë ato drejt tempullit dhe përgjegjësi të tyre të ardhshme. Në Shoqatën e Ndhimës ato vazhdojnë të përparojnë drejt bekimeve të tempullit dhe jetës së përjetshme duke rritur besimin dhe drejtësinë e tyre personale, duke forcuar familjet e shtëpitë e tyre dhe duke kërkuar e ndihmuar ata që janë në nevojë. Motrat besnike mësojnë ta bëjnë këtë me shumë pak brohori apo njohje për punën që ato bëjnë. Kjo është sepse Shoqata e Ndhimës lulëzon duke dhënë mësimet e Zotit Jezu Krisht, që tha se kur ne japim ndihmat (apo ofertat) fshehtas, Ati ynë në Qiell, që sheh në fshehtësi, do të na shpërblejë neve haptazi¹⁰.

Gjatë historisë dhe veprës së Shoqatës së Ndhimës, ne jemi të lidhura



Nga Silvia H. Ollred,
Këshilltare e Parë në Presidencën e Përgjithshme
të Shoqatës së Ndhmës

Të Qëndrueshme dhe të Patundura

Në qoftë se jemi besnike dhe durojmë deri në fund, do të marrim të gjitha bekimet e Atit Qiellor, madje jetë të përjetshme dhe ekzaltim.

Jam mirënjohëse që jam pjesë e këtij takimi të grave besnike anembanë botës. Kam takuar mijëra prej jush në vende të ndryshme. Besnikëria dhe devocioni juaj më kanë forcuar. Shembujt tuaj të mirësisë e të zotimit ndaj ungjillit, më kanë frymëzuar. Veprat tuaja të heshtura të shërbimit vetëmohues dhe fjalët tuaja të dëshmisë e të sigurisë, më kanë dhënë përlësi.

Sonte, secilës nga ju do t'i bëj të njëjtën pyetje që i kam bërë shumëkujt prej jush në bisedat tona.

1. Çfarë ju ndihmon që të jeni të qëndrueshme dhe të patundura, kur përballeni me sfida që ju provojnë në besim?
2. Çfarë ju jep mbështetje mes provave dhe fatkeqësisë?
3. Çfarë ju ndihmon të duroni e të bëheni një dishepull i vërtetë i Krishtit?

Disa nga përgjigjet që më keni dhënë përfshijnë këto:

1. Njohuria që ju keni se Ati Qiellor ju do dhe përkujdeset për ju.

2. Shpresa që keni se, përmes sakrificës shlyese të Jezu Krishtit, të gjitha bekimet që u premtohen besnikëve, do të realizohen.
3. Njohuria që keni për planin e shëlbimit.

Mesazhi im i sotëm do të zgjerohet mbi këto pohime që ju kanë ardhur nga zemra.

Romakëve 8:16 thotë: “Vetë Fryma i dëshmon frymës sonë se ne jemi bij të Perëndisë”. Hera e parë që më kujtohet të kem ndier me siguri të plotë se Ati Qiellor më njihte, më donte dhe përkujdesej për mua, që atëherë kur hyra në ujin e pagëzimit, në moshën 15-vjeçare. Para asaj kohe, e dija që Perëndia ekzistonte dhe që Jezu Krishti ishte Shpëtimtari i botës. Besoja tek Ata dhe i doja Ata, por asnjëherë nuk e kisha ndier dashurinë dhe përkujdesjen e Tyre për mua, personalisht, deri atë ditë kur iu gëzova mundësisë për të bërë besëlidhjet e pagëzimit.

Kuptova se sa e madhe kishte qenë mrekullia që unë të gjendesha e të mësohesha nga misionarët, veçanërisht kur kishte vetëm një grusht misionarësh në mes të dy milion

njerëzve! E dija atëherë që Ati Qiellor më njihte e më donte në mënyrë aq të veçantë, sa i udhëhoqi misionarët drejt shtëpisë sime.

E di që Perëndia është Perëndi i dashurisë. Kjo është e vërtetë, sepse ne jemi fëmijët e Tij dhe Ai dëshiron që ne të gjithë të kemi gëzim dhe lumturi të përjetshme. Puna dhe lavdia e Tij është që ne të kemi pavdekësi dhe jetë të përjetshme¹. Ajo është arsyeja pse Ai dha për ne një plan të lumturisë. Qëllimi ynë i jetës është të fitojmë jetë të përjetshme dhe ekzaltim për veten dhe të ndihmojmë të tjerët të veprojnë po ashtu. Ai e krijoi këtë tokë që ne të fitonim një trup fizik dhe të provoheshim në besim. Ai na dha dhuratën e çmuar të lirisë së zgjedhjes, nëpërmjet së cilës mund të zgjedhim shtegun që të çon drejt lumturisë së përjetshme. Plani i lumturisë i Atit Qiellor është për ju dhe për mua. Është për të gjithë fëmijët e Tij.

“Kështu Perëndia krijoi njeriun simbas shëmbëlltyrës së vet, simbas shëmbëlltyrës së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin e femrën.

Dhe Perëndia i bekoj; dhe Perëndia u tha atyre: ‘Të jeni të frytshëm dhe shumëzohuni, mbushni tokën.’²

“Dhe ai u dha urdhërime, që ata duhej ta adhuronin Zotin, Perëndinë e tyre. . . . Dhe Adami iu bind urdhërimeve të Zotit”³.

Adami dhe Eva lindën fëmijë dhe plani vazhdoi të zbatohet.

E di që çdonjëra prej nesh ka një rol jetësor dhe thelbësor si bijë e Perëndisë. Ai u ka dhuruar bijave të Tij veçori hyjnore, për qëllimin e përparimit të punës së Tij. Perëndia u ka besuar grave punën e shenjtë të lindjes e të rritjes së fëmijëve. Asnjë punë tjetër nuk është më e rëndësishme. Ajo është thirrje e shenjtë. Detyra më fisnike e një gruaje është vepra e shenjtë e ngritjes së familjeve të

përjetshme, në rastin ideal në ortakëri me bashkëshortin e saj.

Jam e vetëdijshme që disa nga motrat tona ende nuk i kanë marrë bekimet e martesës apo të pasjes së fëmijëve. Ju siguroj se, në kohën e duhur, ju do t'i merrni të gjitha bekimet që iu premtuan besnikeve. Ju duhet “të shkoni përpara me një vendosmëri në Krisht, duke pasur një ndriçim të përkryer të shpresës . . . dhe të duroni deri në fund” që të keni jetë të përjetshme⁴. Në pikëpamjen e të përjetshmes, bekimet e munguara “do të jenë veçse një çast i shkurtër”⁵.

Veç kësaj, nuk nevojitet të jeni të martuara për t'i zbatuar urdhërimet dhe për t'i edukuar familjet, miqtë dhe fqinjët. Dhuntitë, talentet, aftësitë dhe fuqitë tuaja shpirtërore nevojiten së tepërmi në ngritjen e mbretërisë. Zoti mbështetet në gatishmërinë tuaj për t'i kryer këto detyra thelbësore.

Zoti thotë:

“Unë nuk do të [të] harroj.

Ja, unë të kam gdhendur mbi pëllëmbët e duarve të mia; muret e tua më rrinë gjithnjë para syve”⁶.

Zoti ju do. Ai i di shpresat tuaja dhe zhgënjimet tuaja. Ai nuk do t'ju harrojë, sepse dhembjet dhe vuajtjet tuaja janë vazhdimisht para Tij.

Shprehja më e madhe e dashurisë që Perëndia ka për ne, ishte gatishmëria për të dërguar Birin e Tij të Dashur, Jezu Krishtin, që të shlyente mëkatet tona, të ishte Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë.

Tek Gjoni 3:16 lexojmë: “Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme”.

Shpëtimtari thotë: “Sikurse Ati më ka dashur mua, ashtu edhe unë ju kam dashur juve”⁷.

Gatishmëria e Jezu Krishtit që të ishte qengji i sakrificës, qe shprehje e



dashurisë së Tij për Atin dhe e dashurisë së tij të pafundme për secilën prej nesh.

Isaia e përshkruan vuajtjen e Shpëtimtarit:

“Ai mbante sëmundjet tona dhe kishte marrë përsipër dhembjet tona. . . .

. . . Ai u tejpua për shkak të shkeljeve tona, u shtyp për paudhësitë tona; . . . dhe për shkak të vurratave të tij ne jemi shëruar”⁸.

Zoti Vetë ka shpallur: “Unë, Perëndia, i kam vuajtur këto gjëra për të gjithë, që ata të mos vuajnë nëse do të pendohen”⁹.

Ai këputi lidhjet e vdekjes dhe bëri të mundur që i gjithë njerëzimi të ringjallet. Ai na dha dhuratën e pavdekësisë.

Jezu Krishti mori mbi Vete mëkatet tona, vuajti dhe vdiq që të kënaqë kërkesat e drejtësisë, që ne të mos vuanim, nëse pendohemi.

Pranimin e Jezu Krishtit si Shpëtimtarin tonë ne e tregojmë kur vëmë besimin tonë tek Ai, pendohemi për mëkatet tona dhe marrim ordinancat shpëtuese të kërkuara për të hyrë në praninë e Perëndisë. Ordinancat shpëtuese janë simbole të besëlidhjeve që bëjmë. Besëlidhjet e bindjes ndaj ligjeve dhe urdhërimeve të Tij

na zotojnë ndaj Perëndisë dhe na forcojnë besimin. Besimi dhe vendosmëria jonë në Krisht do të na japë guximin dhe bindjen e sigurt që na nevojitet për t'u bërë ballë sfidave të jetës, që janë pjesë e përvojës sonë në jetën e vdekshme.

Pak mbas thirrjes së bashkëshortit tim për të kryesuar mbi Misionin e Asunsionit në Paraguai më 1992, ne ishim të pranishëm në konferencën e një dege në një komunitet të veçantë të Çakos Paraguaiane¹⁰. Udhëtuam katër orë në rrugë të shtruar e, më pas, shtatë orë të tjera në një rrugë primitive. Rreziqet dhe parehatia e udhëtimit të gjatë shpejt u harruan kur u përshëndetëm me anëtarët e gëzuar e mikpritës të Mistolarit.

Hulio Jegros ishte presidenti në moshë të re i degës dhe ai e bashkëshortja e tij, Margarita, ishin një nga pak familjet që qenë vulosur në tempull. Unë u kërkova të tregonin përvojën e udhëtimit të tyre në tempull.

Për atë kohë, tempulli më i afert ishte Tempulli i Buenos-Airesit në Argjentinë. Udhëtimi nga Mistolari kërkonte 27 orë në një drejtim, që të arrije në tempull dhe ata kishin shkuar bashkë me dy fëmijët e tyre të vegjël. Ishte mesi i një dimri shumë të ftohtë, por, me shumë sakrificë, ata mbërritën



Okland, Zelanda e Re

në tempull, ku u vulosën së bashku si familje e përjetshme. Në udhën e kthimit, dy të vegjlit u sëmuren shumë dhe vdiqën. Ata i varrosën gjatë udhës dhe u kthyen në shtëpi me krahët bosh.

Ishin të trishtuar e të vetmuar, por çuditërisht ndien ngushëllim dhe paqe. Për atë që përjetuan ata thanë: “Fëmijët tanë qenë vulosur me ne në shtëpinë e Zotit. E dimë se do t’i kemi përsëri tek ne për gjithë përjetësinë. Kjo dije na ka dhënë paqe dhe ngushëllim. Duhet t’u mbetem të denjë e besnikë besëlidhjeve që bëmë në tempull dhe më pas do të ribashkohemi me ta.”

Si e rrisim ne besimin dhe shpresën tonë, që të jenë si ato të këtyre anëtarëve besnikë nga Paraguai?

Si e forcojmë ne besimin tonë ndaj pohimeve, që unë i kam dëgjuar vazhdimisht nga kaq shumë prej jush, se ju besoni në dashurinë që Perëndia ka për ju, se besoni vërtet që do të merrni bekimet e Tij dhe se ju e kuptoni planin e shëlbimit përmes Shpëtimtarit Jezu Krishti dhe pjesën tuaj të rëndësishme në planin e Tij?

Do të këshilloj katër gjëra që mua më kanë ndihmuar: lutje, studim i shkrimit të shenjtë, bindje dhe shërbim.

Lutja

Lutja është veprimi i komunikimit me Atin Qiellor. Kur lutemi, ne po-
hojmë besimin tek Ai dhe fuqia e Tij për të na bekuar.

Tek Alma 37:37 lexojmë: “Këshillohu me Zotin për të gjitha veprimet e tua dhe ai do të të drejtojë për të mirë; po, kur të biesh në mbrëmje, bjer për Zotin, që ai të mund të të ruajë në gjumin tënd; dhe kur të ngrihesh në mëngjes, le të jetë zemra jote plot falenderime ndaj Perëndisë; dhe në qoftë se i bën këto gjëra, ti do të ngrihesh në ditën e fundit”.

Studimi i Shkrimit të Shenjtë

Një njohje dhe një kuptim i planit të Atit Qiellor ndihmon që të dimë se cilët jemi dhe çfarë duhet të bëhemi.

Zoti urdhëronte “Ju hetoni Shkrimet sepse mendoni të keni nëpërmjet tyre jetë të përjetshme; dhe ato janë këto që dëshmojnë për mua”¹¹.

Nevojitet shumë që çdo grua të studiojë shkrimet e shenjtja. Kur ne i kemi më të njohura të vërtetat e shkri-
meve të shenjtja, do të jemi të aftë t’i zbatojmë në jetën tonë dhe do të kemi më shumë fuqi për të përmbushur qëllimet e Perëndisë. Lutja dhe studimi i shkrimit të shenjtë në mënyrë vetjake të përditshme gjithashtu ftojnë në jetën tonë ndikimin dhe fuqinë e Frymës së Shenjtë.

Bindja

Zoti thotë: “Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia”¹². Bindja jonë e vërtetë do të na ndihmojë që të zhvillojmë veçoritë e perëndishmërisë dhe të ndryshojmë në zemër.

Tek Doktrina e Besëlidhjet ne këshillohemi:

“Kapu pas besëlidhjeve që ke bërë. . . .

Zbato urdhërimet e mia vazhdimisht dhe një kurorë drejtësie do të marrësh”¹³.

Zotimi ynë për të jetuar ungjillin e ushqen besimin dhe shpresën tonë të Jezu Krishti.


Shërbimi

Ne kemi mundësi të shumta për t’i shërbyer Atij. Secilës motër i është kërkuar të kërkojë me zell e të ndihmojë të varfrin dhe nevojtarin që ndodhet mes nesh dhe përreth nesh. “I varfri dhe nevojtar” përfshin ata që kanë nevoja shpirtërore dhe emocionale. Secila ka gjithashtu përgjegjësi të shpëtojë të vdekurit tanë, që mund të kryhet duke punuar për historinë familjare ose me anë të punës në tempull. Jemi urdhëruar të ndajmë me të tjerët ungjillin dhe janë të shumta mënyrat për të marrë pjesë në punën misionare. Të gjitha këto janë mënyra me të cilat mund t’i shërbejmë Zotit. Ati ynë Qiellor pret nga të fuqishmit që të forcojnë të dobtit dhe besimi juaj vetjak do të forcohet ndërsa ju forconi e kujdeseni për fëmijët e Tij.

Unë e di që Ati Qiellor e do secilin fëmijë të Tij në mënyrë të përkryer, personale dhe të pandryshueshme. E di që ne, si gra, kemi një pjesë thelbësore në planin e lumturisë. Përpjekja më e mirë e jona është gjithçka që Ai na kërkon dhe çdonjëra prej nesh është e nevojshme në ngritjen e mbretërisë. Shlyerja është e vërtetë. Jezu Krishti është Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë. Dëshmoj që, në qoftë se jemi besnike dhe durojmë deri në fund, do të marrim të gjitha bekimet e Atit Qiellor, madje jetë të përjetshme dhe ekzaltim. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Moisiu 1:39.
2. Zanafilla 1:27–28.
3. Moisiu 5:5.
4. 2 Nefi 31:20.
5. Doktrina e Besëlidhje 121:7.
6. Isaia 49:15–16.
7. Gjoni 15:9.
8. Isaia 53:4–5.
9. Doktrina e Besëlidhje 19:16.
10. Zona me reshje të pakta e me popullsi të rrallë e Paraguait perëndimor.
11. Gjoni 5:39
12. Gjoni 14:15.
13. Doktrina e Besëlidhje 25:13, 15.



Nga Barbara Tompson,
Këshilltare e Dytë në Presidencën e Përgjithshme
të Shoqatës së Ndihmës

Dhe Kini Dhemshuri Për Njërën Duke Përdorur Dallim

Bukuria e vizitës mësimore është të shohësh jetët të ndryshojnë, lotët të fshihen, dëshmitë të rriten, njerëzit të duhen, familjet të forcohen.

Motrat e mia të dashura, ç'bekim është të jesh me ju, të ndiesh forcën dhe dashurinë tuaj për Zotin. Faleminderit për dashurinë dhe dhembshurinë që ndani me të tjerët për ditë.

E dimë se në ditët e hershme të Shoqatës së Ndihmës në Navu, motrat shkuan nga shtëpia në shtëpi, duke i shërbyer njëra-tjetrës, duke përcaktuar nevoja, duke sjellë ushqim, duke u kujdesur për të sëmurët dhe duke treguar dhembshuri për çdo grua dhe familjen e saj¹. Kjo sjellë në mendje shkrimin tek Juda: "Dhe kini dhemshuri për njërin duke përdorur dallim"². Ndërsa meditoj për këtë shkrim të shenjtë dhe kuptimin e tij, mendimet e mia shkojnë tek Shpëtimtari dhe herët e shumta që shkrimet e shenja flasin për dashurinë e dhembshurinë që Krishti pati për këdo.

Në Dhiatën e Re, lexojmë shpesh se Krishti "kishte dhembshuri"³ për njerëzit, ndërsa u përgjigjej nevojave të tyre. Ai kishte dhembshuri kur pa se ata

ishin të uritur dhe i ushqueu, ose kur ishin të sëmurë dhe i shëroi, ose kur qenë në nevojë për pasurim shpirtëror dhe Ai u dha mësim.

Dhembshuri do të thotë të ndiesh dashuri e mëshirë ndaj një personi tjetër. Do të thotë të kesh simpati dhe dëshirë të lehtësosh vuajtjet e të tjerëve. Do të thotë të tregosh mirësi e butësi ndaj një tjetri.

Shpëtimtari na ka kërkuar të bëjmë gjërat që bëri Ai⁴, të mbajmë barrat e njëri-tjetrit, të ngushëllojmë ata që kanë nevojë të ngushëllohen, të vajtojmë me ata që vajtojnë⁵, të ushqejmë të uriturit, të vizitojmë të sëmurët⁶, të ndihmojmë të dobët, të ngremë duart që varen poshtë⁷ dhe "t'ia mësoj[më] njëri-tjetrit doktrinën e mbretërisë"⁸. Për mua, këto fjalë dhe veprime përshkruajnë mësueset vizitore – ato që u shërbejnë të tjerave.

Vizita mësimore u jep grave mundësinë ta mbrojnë, forcojnë dhe mësojnë njëra-tjetrën. Shumë ngjashëm si një mësues në Priftërinë

Aarone ngarkohet me përgjegjësinë që të "vëzhgojë mbi kishën gjithmonë dhe të jetë me ta e t'i forcojë ata"⁹, një mësuese vizitore e tregon dashurinë e saj duke marrë parasysh plot lutje çdo grua për të cilën është thirrur t'i shërbejë.

Motra Xhuli B. Bek na ka kujtuar: "Meqenëse ne ndjekim shembullin dhe mësimet e Jezu Krishtit, ne e vlerësojmë këtë detyrë të shenjtë për të dashur, ditur, shërbyer, kuptuar, dhënë mësim dhe për të bërë shërbesë në emrin e Tij"¹⁰.

Sot, dëshiroj të flas për dy gjëra:

- Bekimet që u sillni të tjerave, ndërsa shërbeni si mësuese vizitore.
- Dhe bekimet që merrni, ndërsa u shërbeni të tjerave.

Bekimet që u Sillni të Tjerave Ndërsa Shërbeni si Mësuese Vizitore

Jo shumë kohë më parë, takova një grup grash në Ankorixh të Alaskës. Ishin rreth 12 gra në dhomë dhe 6 të tjera u bashkuan me telefon me alto-parlant nga qytete e qyteza në mbarë Alaskën. Shumë prej këtyre grave jetonin qindra kilometra larg nga ndërtesa e Kishës. Këto gra më mësuan mbi vizitën mësimore.

Që t'u bëje një vizitë personalisht të gjitha atyre motrave do të duhej një fluturim me aeroplan, lundrim me anije, ose udhëtim në largësi shumë të mëdha me makinë. Qartazi, koha dhe shpenzimi i bënin të pamundura vizitat në shtëpi. Megjithatë, këto motra ndiheshin të lidhura ngushtë sepse po luteshin nxehtësisht për njëra-tjetrën dhe po kërkonin udhëheqjen e Shpirtit të Shenjtë për të ditur se çfarë u nevojitej motrave të tyre, edhe pse nuk ishin shumë shpesh atje personalisht. Ato ia dolën të qëndronin në kontakt me telefon, internet dhe postë. Ato shërbenin me dashuri sepse kishin bërë



besëlidhje me Zotin dhe dëshironin të bekonin e forconin motrat e tyre.

Një tjetër palë e përkushtuar mësuesesh vizitore në Republikën Demokratike të Kongos ecën në largësi të mëdha për të vizituar një grua dhe foshnjën e saj. Këto motra përgatitën plot lutje një mesazh dhe dëshironin të dinin se si mund të sillnin një ndryshim në jetën e gruas së dashur që po vizitonin. Gruaja u emocionua nga vizita e tyre. Për atë, vizita e tyre qe një kumtim nga qielli i dhënë vetëm asaj. Kur mësueset vizitore u takuan në shtëpinë e saj të përlulur, motra, familja e saj dhe mësueset vizitore, të gjithë u ngritën moralisht dhe u bekuan. Ecja e gjatë nuk dukej një sakrificë. Këto mësuese vizitore patën dhembshuri, duke sjellë një ndryshim për mirë dhe duke bekuar jetën e kësaj gruaje.

Largësitë e mëdha, shpenzimet dhe çështjet e sigurisë i bëjnë të pamundur kontaktet mujore personalisht në disa zona të Kishës, por me anë të fuqisë së zbulësës personale, motrat që vërtet kërkojnë ta duan njëra-tjetrën dhe po e ruajnë dhe e forcojnë njëra-tjetrën, gjejnë mënyra kuptim-plote për ta përmbushur këtë thirrje nga Zoti.

Një presidente e frymëzuar e Shoqatës së Ndihmës këshillohet me peshkopin e saj dhe plot lutje i kryen detyrat e vizitave mësimore për ta ndihmuar atë në vëzhgimin dhe kujdesin për çdo grua në lagje. Kur e kuptojmë

këtë proces këshillimi dhe zbulëse, e kuptojmë më mirë përgjegjësinë tonë të rëndësishme për të shërbyer dhe mund të mbështetemi më me siguri tek Shpirti që të udhëheqë përpjekjet tona.

Unë jam njëra që ka vizituar disa gra çdo muaj dhe pastaj, kam deklaruar me krenari e me një psherëtimë lehtësimi: "Vizitat e mia mësimore janë kryer!" Epo, pjesa për të cilën raportoj mund të jetë kryer, por nëse ajo është e vetmja arsye pse e bëj, sa turp!

Bukuria e vizitës mësimore nuk është të shohësh 100 për qind në raportin mujor; bukuria e vizitës mësimore është të shohësh jetët të ndryshojnë, lotët të fshihen, dëshmitë të rriten, njerëzit të duhen, familjet të forcohen, njerëzit të gëzohen, të uriturit të ushqehen, të sëmurët të vizitohen dhe ata që po vajtojnë, të ngushëllohen. Në të vërtetë, vizita mësimore kurrë nuk është e *kryer* sepse ne vëzhgojmë dhe forcojmë gjithmonë.

Një tjetër bekim i vizitës mësimore është të rritemi në unitet dhe dashuri. Shkrimet e shenjta na këshillojnë se si ta arrijmë këtë: "Dhe ai i urdhëroi ata që . . . të shikonin përpara me një qëllim të vetëm, duke pasur një besim dhe një pagëzim, duke pasur zemrat e tyre të thurura në bashkim dhe në dashuri kundrejt njëri-tjetrit"¹¹.

Shumë gra kanë raportuar se arsyeja e kthimit në aktivitet në Kishë ishte sepse një mësuese vizitore besnike erdhi muaj pas muaji dhe u shërbeu atyre, duke i shpëtuar ato, duke i dashur ato, duke i bekuar ato.

Nganjëherë, mesazhi do të jetë gjëja më e rëndësishme që ndani në një vizitë të caktuar. Disa gra kanë pak pasurim shpirtëror në jetën e tyre përveç mesazhit që sillni ju. Mesazhet e Vizitave Mësimore tek *Liahona* janë mesazhe të ungjillit që e ndihmojnë çdo grua të rritet në besimin e saj,

forcojnë familjen e saj dhe theksojnë shërbimin me dashuri hyjnore.

Nganjëherë, bekimi më i rëndësishëm në vizitën tuaj do të jetë që thjesht të dëgjoni. Dëgjimi sjell ngushëllim, mirëkuptim dhe shërim. Herë të tjera akoma, mund t'ju duhet të përvishni mëngët dhe të shkoni të punoni në shtëpi ose të ndihmoni për të qetësuar një fëmijë që qan.

Bekimet që Merrni Ndërsa u Shërbeni të Tjerave

Bekimet që merrni ndërsa u shërbeni të tjerave, janë të shumta. Nganjëherë kam thënë: "Oh, më duhet ta kryej vizitën time mësimore!" (Ato kanë qenë kohë kur kam harruar se po vizitoja e po u jepja mësim grave. Ato qenë kohët kur e konsideroja atë si një barrë dhe jo si një bekim.) Mund të them ndershmërisht se kur shkoja në vizitë mësimore, gjithmonë ndihesha më mirë. Ndihesha e lartësuar, që më donin dhe e bekuar, zakonisht shumë më tepër se motra që po vizitoja. Dashuria ime u shtua. Dëshira ime për të shërbyer u shtua. Dhe munda të shoh se çfarë mënyre të mrekullueshme ka planifikuar për ne Ati Qiellor që të mbrojmë dhe kujdesemi për njëra-tjetrën.

Bekime të tjera të qenies mësuese vizitore janë se ne arrijmë të njohim dhe të bëhemi mike me ato që përndryshe mbase nuk do t'i kishim njohur mirë. Nganjëherë, ajo na lejon të jemi një përgjigje për lutjet e dikujt. Gjithashtu, zbulësa personale dhe përvojat shpirtërore janë të lidhura ngushtë me vizitën mësimore.

Kam përjetuar disa përvoja të jetës sime nga më të përlulur, të gëzueshmet dhe shpirtëroret kur kam ndenjur në shtëpitë e grave në vetë lagjen time dhe nëpër botë. Ne i kemi mësuar ungjillin njëra-tjetrës. Ne kemi qarë së bashku, kemi qeshur së

bashku, kemi zgjidhur probleme së bashku dhe unë jam ngritur moralisht dhe jam bekuar.

Një mbrëmje, pranë fundit të muajit, po përgatitesha të largohesha nga qyteti dhe ende nuk e kisha vizituar njërën nga motrat e mia. Ishte vonë në mbrëmje. Nuk kisha lënë takim. Nuk mora në telefon. Nuk kisha shoqe. Por vendosa se qe e rëndësishme ta vizitoja shoqen time, Xhulin. E bija e Xhulit, Ashli, kishte lindur me një sëmundje kockash të brishta. Megjithëse Ashli qe gati gjashtë vjeçe, ajo qe shumë e vogël dhe nuk bënte dot shumë gjëra përveç që të lëvizte krahët dhe të fliste. Ajo rrinte mbi një shtrojë lëkure deleje gjithë ditën, çdo ditë. Ashli qe një fëmijë e lumtur dhe e gëzuar dhe më pëlqente shumë t'i rrija rrotull asaj.

Në atë natë të veçantë kur unë shkova në shtëpi, Xhuli më ftoi të hyja dhe Ashli thirri se donte të më tregonte diçka. Unë hyra dhe u gjuhëzoza në dysheme në njërën anë të Ashlit dhe nëna e saj qe në anën tjetër. Ashli tha: "Shiko se çfarë mund të bëj!" Pastaj, me pak ndihmë nga nëna e saj, Ashli mundi të rrotullohej brinjazi dhe të kthehej përsëri. Asaj iu deshën gati gjashtë vite që të përmbushte këtë synim të mrekullueshëm. Ndërsa duartrokitem dhe brohoritem, dhe qeshëm, dhe qamë së bashku në atë rast të veçantë, unë falënderova Atin Qiellor që kisha shkuar për vizitën mësimore dhe nuk e kisha humbur këtë ngjarje të shkëlqyer. Edhe pse ajo vizitë ka ndodhur shumë vite më parë dhe e ëmbla Ashli ka ndërruar jetë qysh atëherë, do të jem mirënjohëse përgjithmonë që pata atë përvojë të veçantë me të.

Vetë nëna ime e shtrenjtë qe një mësuese vizitore e shkëlqyer dhe e përkushtuar për shumë vite. Ajo vazhdimisht mendonte për mënyra si mund të bekonte familjet që vizitonte. Ajo u kushtonte vëmendje të veçantë



fëmijëve të grave që vizitonte, duke shpresuar të forconte familjet. Mund të kujtoj një pesëvjeçar që vraponte drejt nënës time në Kishë, duke deklaruar: "Ti je mësuesja ime vizitore. Unë të dua!" Qenia pjesë e jetëve të grave të mrekullueshme dhe familjeve të tyre, qe një bekim për nënën time.

Jo të gjitha përvojat e lidhura me vizitat mësimore janë të ngrohta e të mrekullueshme. Nganjëherë është e vështirë, si për shembull të vizitosh një shtëpi ku vërtet nuk je e mirëpritur, ose kur është e vështirë të takohesh me një motër me program shumë të ngjeshur. Mund të kërkojë më shumë kohë të ndërtohet një marrëdhënie të mirë me disa motra. Por kur vërtet përpiqemi ta duam, të kujdesemi dhe të lutemi për motrën, Fryma e Shenjtë do të na ndihmojë të gjejmë një mënyrë për ta mbrojtur dhe forcuar atë.

Presidenti Tomas S. Monson është mjeshtër për të shërbyer siç bëri Shpëtimtari. Atë e gjen vazhdimisht duke vizituar dhe ndihmuar të tjerët. Ai ka thënë: "Ne jemi të rrethuar nga ata që kanë nevojë për vëmendjen tonë, nxitjen tonë, mbështetjen tonë, ngushëllimin tonë, dashamirësinë tonë. . . . Ne jemi duart e Zotit këtu në tokë, me autorizimin për të shërbyer dhe për të ngritur moralisht fëmijët e Tij. Ai varet nga secili prej nesh."¹²

"Dhe askush s'mund të ndihmojë në këtë punë, nëse nuk do të jetë [e] përlurur dhe plot dashuri, duke patur besim, shpresë dhe dashuri hyjnore, duke qenë [e] matur në gjithë gjërat, çfarëdo që do t'i besohet kujdesit të [saj]."¹³

Gratë, të cilave u bëjmë vizita mësimore, i janë besuar përkujdesit tonë. Le të kemi dashuri e dhembshuri dhe kështu të sjellim një ndryshim në jetën e atyre që i janë besuar përkujdesit tonë.

Motra, unë ju dua. Unë lutem që ju të ndieni dashurinë e Atit tonë Qiellor dhe të Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Unë ju dëshmoj se Shpëtimtari jeton, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Jill Mulvay Derr, Janath Russell Cannon, and Maureen Ursenbach Beecher, *Women of Covenant: The Story of Relief Society* (1992), f. 32–33.
2. Juda 1:22.
3. Mateu 9:36; 14:14.
4. Shih Gjoni 13:15.
5. Shih Mosia 18:8–9.
6. Shih Mosia 4:26.
7. Shih Doktrina e Besëlidhje 81:5.
8. Doktrina e Besëlidhje 88:77.
9. Doktrina e Besëlidhje 20:53.
10. Xhuli B. Bek, "Shoqata e Ndihmës: Një Punë e Shenjtë", *Liahona*, nëntor 2009, f. 113.
11. Mosia 18:21.
12. Tomas S. Monson "Çfarë Kam Bërë për Dikë Sot?" *Liahona*, nëntor 2009, f. 86.
13. Doktrina e Besëlidhje 12:8.



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Dashuria Nuk Ligështohet Kurrë

Në vend që të jemi gjykues dhe kritikë për njëri-tjetrin, le të kemi dashurinë e pastër të Krishtit për bashkudhëtarët tanë në këtë udhëtim përmes jetës.

Shipirtrat tanë janë gëzuar sonte dhe janë drejtuar drejt qiellit. Ne jemi bekuar me muzikë të mrekullueshme dhe mesazhe të frymëzuara. Shpirti i Zotit është këtu. Unë lutem për frymëzimin e Tij që të jetë me ne tani, ndërsa po ndaj me ju disa prej mendimeve dhe ndjenjave të mia.

Unë po filloj me një anekdotë e cila ilustron një gjë që do të doja të paraqisja.

Një çift i ri, Lisa dhe Xhoni, u transferuan në një lagje të re. Një mëngjes ndërsa po hanin mëngjes, Lisa pa nga dritarja dhe vështrroi fqinjën përbrë që po varte rrobat e saja të lara.

“Këto rroba nuk janë të pastra!” thirri Lisa. “Fqinja jonë nuk di si t’i lajë rrobat!”

Xhoni vështrroi por qëndroi i heshtur.

Sa herë që fqinja do të varte rrobat e saja të lara për tharje, Lisa do të bënte të njëjtat komente.

Pak javë më vonë, Lisa u befasua të shihte nga dritarja dhe të vinte re rroba të lara mirë, pastër që vareshin në oborrin e fqinjës së saj. Ajo i tha bashkëshortit të saj: “Shih Xhon – ajo

më në fund mësoi si të lajë siç duhet! Çuditem si e ka bërë.”

Xhoni u përgjigj: “Mirë, e dashur, unë e kam përgjigjen për ty. Ti do të jesh e interesuar të dish se unë u çova herët këtë mëngjes dhe lava dritaret tona!”

Sonte unë do të doja të ndaja me ju disa mendime lidhur me atë se si ne e shohim njëri-tjetrin. A po shohim ne nëpër një dritare që ka nevojë për pas-trim? A po bëjmë gjykime kur ne nuk i kemi të gjitha faktet? Çfarë shohim ne kur vështrojmë tek të tjerët? Çfarë gjykimesh bëjmë ne rreth tyre?

Shpëtimtari tha: “Mos gjykoni”.¹ Ai vazhdoi: “Pse shikon lëmishten që është në syrin e vëllait tënd dhe nuk shikon trarin që është në syrin tënd?”² Ose, për të parafrazuar, përse vë re ti atë që është rrobë e pa larë në shtëpinë e fqinjit tënd por nuk sheh dritaren e ndotur në vetë shtëpinë tënde?

Askush nga ne nuk është i përsosur. Unë nuk njoh askënd që do të thoshte se është i tillë. Dhe përsëri për disa arsye, megjithë papërsosmëritë tona, ne kemi një prirje për të përmendur ato të të tjerëve. Ne bëjmë gjykime lidhur me veprimet apo mosveprimet e tyre.

Në të vërtetë nuk ka mënyrë se si ne të mund të dimë zemrën, prirjet apo rrethanat e dikujt, që mund të thotë apo bëjë diçka të cilën ne gjejmë arsye ta kritikojmë. Prandaj vjen urdhërimi: “Mos gjykoni”.

Dyzet e shtatë vite përpara kësaj konference të përgjithshme, unë u thirra në Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve. Në atë kohë, unë kisha shërbyer në një nga komitetet e përgjithshme të priftërisë të Kishës dhe kështu, përpara se të paraqitej emri im, unë u ula me shokët e mi anëtarë të atij komiteti të priftërisë, siç duhej të bëja. Bashkëshortja ime, gjithsesi, nuk kishte ide ku të shkonte dhe askënd me kë të ulej dhe, në fakt, nuk qe në gjendje të gjente vend askund në Tabernakull. Një mikeshë e dashur e jona, që ishte anëtare e njërit prej bordeve të përgjithshme të organizatave ndihmëse dhe që ishte ulur në vendet e caktuara për anëtarët e bordit, i kërkoi Motrës Monson të ulej me të. Kjo grua nuk dinte asgjë për thirrjen time – që do të njoftohej pas pak – por ajo e vuri re Motrën Monson, kuptoi shqetësimin e saj dhe bujarisht i ofroi asaj një vend. Bashkëshortja ime e dashur ndjeu lehtësim dhe mirënjohje nga ky gjest mirësie. Duke u ulur, gjithsesi, ajo dëgjoi pëshpëritje të zëshme prapa saj ndërsa një nga anëtarët e bordit u shprehu bezdinë atyre përreth saj që një nga shoqet e saj të bordit pati guximin të ftonte një “të jashtme” të ulej në këtë zonë të rezervuar vetëm për to. Nuk kishte asnjë justifikim për sjelljen e saj të pakëndshme, pavarësisht se *kush* mund të qe ftuar të ulej atje. Sidoqoftë, unë vetëm mund ta përfytyroj se si është ndier ajo grua kur mësoi se “ndërhyrësja” ishte bashkëshortja e apostullit më të ri.

Jo vetëm që ne jemi të prirur të gjykojmë veprimet dhe fjalët e të tjerëve,

por shumë nga ne gjykojnë paraqitjet: veshjet, stilin e flokëve, përmasat. Lista mund të vazhdojë e të vazhdojë.

Një shembull i shkëlqyer i të gjykuarit sipas pamjes që botuar në një revistë kombëtare shumë vite përpara. Është një tregim i vërtetë – një që mund ta keni dëgjuar por që ia vlen të përsëritet.

Një grua me emrin Meri Bartels kishte një shtëpi drejtpërdrejt në anën tjetër të rrugës përballë hyrjes së një klinike spitalore. Familja e saj jetonte në katin kryesor dhe kishte dhënë me qira dhomat sipër për pacientët e jashtëm të klinikës.

Një mbrëmje një plak me pamje vërtet të tmerrshme erdhi te dera duke kërkuar nëse kishte vend për të që të kalonte natën. Ai ishte i kërrusur e i rrëgjuar dhe fytyra e tij që shtrembëruar nga enjtja – e kuqe dhe e ashpër. Ai tha se kishte kërkuar për një dhomë qysh nga dreka por pa sukses. “Më duket se është për shkak të fytyrës sime”, tha ai. “Unë e di se ajo duket e tmerrshme, por doktori im thotë se ajo edhe mund të përmirësohet pas trajtimit të tjerë.” Ai tha se do të ishte i lumtur të flinte në karrigen lëkundëse në verandë. Ndërsa po fliste me të, Meri kuptoi se ky plak trupvogël kishte një zemër tejet të madhe të ngjeshur në atë trup të imët. Edhe pse dhomat e saj ishin mbushur, i tha atij të priste në karrige dhe ajo do t’i gjente një vend për të fjetur.

Në kohën e fjetjes bashkëshorti i Merit hapi një shtrat portativ për burrin. Kur ajo kontrolloi në mëngjes, shtresat dhe mbulesat e krevatit ishin palosur me kujdes dhe ai ishte jashtë në karrigen lëkundëse. Ai nuk e pranoi mëngjesin, por pikërisht kur u largua për autobusin e tij, pyeti nëse mund të vinte përsëri herën tjetër kur të kishte kurë. “Unë nuk do t’ju ngatërroj aspak juve”, premtoi ai. “Unë



mund të fle në një karrige.” Meri e siguroi atë se ishte i mirëpritur të vinte përsëri.

Pas disa vitesh ai shkoi për trajtim dhe ndenji në shtëpinë e Merit, plaku, që ishte peshkatar nga profesioni, gjithnjë kishte dhurata me produkte deti ose perime nga kopshti i tij. Herë të tjera ai dërgonte pako me postë.

Kur Meri mori këto dhurata të menduara, ajo shpesh mendoi për një koment që fqinja e saj ngjitur bëri pasi plaku i shtrembëruar, i kruspullosur ishte larguar nga shtëpia e Merit atë mëngjes të parë. “A e mbajte atë burrë me pamje të tmerrshme mbrëmë? Unë e ktheva mbrapsht. Ju mund të humbisni klientët duke mbajtur njerëz të tillë.”

Meri e dinte se ata mund të kishin humbur klientë një herë apo dy, por ajo mendoi: “Oh, nëse vetëm do ta kishin njohur atë, ndoshta sëmundjet e tyre do të kishin qenë më të lehta për t’i duruar.”

Pasi burri vdiq, Meri po vizitonte një mikeshë që kishte një serë. Duke parë lulet e mikeshës së saj, ajo vuri re një krizantemë të mrekullueshme të artë por u hutua ngaqë ajo po rritej në një vazo të shtypur, të vjetër, të ndryshkur. Mikësja e saj shpjegoi: “Mua m’u mbaruan vazot dhe, duke ditur sa e bukur mund të jetë kjo, mendova se nuk do ta kishte problem këtë kovë të vjetër. Është sa për një

kohë të shkurtër, derisa të mund ta vendos jashtë në kopsht.”

Meri buzëqeshi ndërsa përfytyronte pikërisht një skenë të tillë në qiell. “Këtu është një veçanërisht i bukur”, mund të kishte thënë Perëndia kur arriti te shpirti i plakut trupvogël. “Ai nuk do ta ketë problem të fillonte në këtë trup të vogël, të shformuar.” Por kjo që shumë përpara, dhe në kopshtin e Perëndisë sa lart duhet të qëndrojë ky shpirt i dashur!³

Dukjet mund të jenë aq mashtruese, një masë aq e varfër për një njeri. Shpëtimtari këshilloi: “Mos gjykoni sipas pamjes së jashtme”⁴.

Një anëtare e organizatës së grave u ankua njëherë kur një grua ishte zgjedhur të përfaqësonte organizatën. Ajo kurrë nuk e kishte takuar gruan, por ajo kishte parë një fotografi të saj dhe nuk e kishte pëlqyer atë që kishte parë, duke e vlerësuar të ishte mbipeshë. Ajo komentoi: “Nga mijëra gra në këtë organizatë, sigurisht një përfaqësuese më e mirë mund të ishte zgjedhur”.

Vërtet, gruaja që që zgjedhur nuk ishte “e dobët si modelet”. Por ato që e njihnin atë dhe dinin cilësitë e saj, panë tek ajo shumë më tepër sesa pasqyrohej në fotografi. Fotografia tregonte se ajo kishte një buzëqeshje miqësore dhe pamje sigurie. Ajo çka nuk e tregonte fotografia ishte se ajo ishte një shoqe besnike dhe dhe mbshur, një grua inteligjente që donte



Zotin dhe që i donte dhe u shërbente bijve të Tij. Ajo nuk tregonte se ajo kishte dalë vullnetare në komunitet dhe ishte një fqinjë e kujdesshme dhe e interesuar. Shkurt, fotografia nuk zbulonte cila ishte në të vërtetë ajo.

Unë pyes: nëse qëndrimet, aktet dhe prirjet shpirtërore do të pasqyroheshin në *tipare fizike*, a do të ishte pamja e asaj gruaje që u ankua, po aq e dashur sa ajo e gruas që ajo kritikoi?

Motra të mia të dashura, secila prej jush është unike. Ju jeni të ndryshme nga njëra-tjetra në shumë mënyra të tjera. Ka nga ju që janë të martuara. Disa nga ju qëndrojnë në shtëpi me fëmijët vet, ndërsa të tjera punojnë jashtë shtëpive të veta. Disa nga ju jeni me fëmijë të larguar nga shtëpia. Ka nga ato prej jush që janë martuar, por nuk kanë fëmijë. Ka nga ato që janë divorcuar, nga ato që janë vejushe. Shumë prej jush janë beqare. Disa nga ju kanë diploma kolegj; disa nuk kanë. Ka nga ato që mund të përballojnë modat më të fundit dhe nga ato që janë me fat që të kenë një veshje të përshtatshme të diele. Të tilla dallime janë thujse pafund. A na tundojnë këto dallime që të gjykojmë njëra-tjetrën?

Nënë Tereza, një murgeshë katolike që punoi midis të varfërve në Indi shumicën e jetës së saj, tha këtë të vërtetë të thellë: “Nëse ju i gjykoni njerëzit, ju nuk keni kohë t’i doni

ata”⁵. Shpëtimtari ka këshilluar: “Ky është urdhërimi im: ta doni njeri-tjetrin, ashtu si unë ju kam dashur”⁶. Unë pyes: *a mund ta duam ne njëri-tjetrin, siç Shpëtimtari ka urdhëruar, nëse ne e gjykojmë njëri-tjetrin?* Unë përgjigjem – me Nënë Terezën: jo, ne nuk mundemi.

Apostulli Jakob na mësoi: “Në qoftë se ndokush nga ju mendon se është fetar, edhe nuk i vë fre gjuhës së vet, sigurisht ai e mashtron zemrën e vet, feja e këtij [ose asaj] është e kotë”⁷.

Unë e kam dashur gjithmonë moton e Shoqatës tuaj të Ndihmës: “Dashuria nuk ligështohet kurrë”⁸. Çfarë është dashuria? Profeti Mormon na mëson se “dashuria hyjnore është dashuria e pastër e Krishtit”⁹. Në mesazhin e tij të lamtumirës drejtuar lamanitëve, Moroni tha: “Në qoftë se nuk keni dashuri hyjnore, ju nuk mund të shpëtoheni në asnjë mënyrë në mbretërinë e Perëndisë”¹⁰.

Unë e konsideroj dashurinë hyjnore – apo “dashurinë e pastër të Krishtit” – të jetë e kundërta e kritikës dhe e gjykimit. Duke folur për dashurinë hyjnore, unë nuk kam në mendje në këtë moment lehtësimin e vuajtjeve nëpërmjet dhënies nga materiali ynë. Kjo, sigurisht, është e nevojshme dhe e përshtatshme. Sonte, gjithsesi, unë kam parasysh dashurinë hyjnore që shfaqet kur ne jemi tolerantë ndaj të tjerëve dhe shpirtbutë ndaj veprimeve

të tyre; llojin e dashurisë hyjnore që fal, llojin dashurisë hyjnore që është e durueshme.

Unë kam në mendje dashurinë hyjnore që na nxit të jemi të këndshëm, të dashur dhe të mëshirshëm, jo vetëm në kohë sëmundjeje dhe pikëllimi, dhe ankthi, por gjithashtu në kohë dobësie apo gabimi nga ana e të tjerëve.

Ka një nevojë të madhe për dashuri hyjnore që u kushton vëmendje atyre që nuk bien në sy, u jep shpresë atyre që janë shkukuruar, ndihmë atyre që vuajnë. Dashuria hyjnore e vërtetë është dashuri në veprim. Nevoja për dashuri hyjnore është kudo.

E nevojshme është dashuria hyjnore që kundërshton të gjejë kënaqësi duke dëgjuar apo duke përsëritur raportet e fatkeqësive që u ndodhin të tjerëve, pavarësisht se duke bërë kështu fatkeqi mund të përfitojë. Edukatori dhe politikani amerikan Horac Man njëherë tha: “Të të vijë keq për ankthin është veç njerëzore; ta lehtësosh atë është e Perëndishme”¹¹.

Dashuria hyjnore është të kesh durim me dikë që na ka lënë në baltë. Është t’i rezistosh impulsit për t’u ndier lehtësisht i ofenduar. Ajo është të pranosh dobësitë dhe mangësitë. Ajo është t’i pranosh njerëzit ashtu siç janë në të vërtetë. Ajo është të shohësh përtej dukjeve të tipareve që nuk do të zbehen me kalimin e kohës. Ajo është t’i rezistosh impulsit për të klasifikuar të tjerët.

Dashuria, ajo dashuri e pastër e Krishtit, manifestohet kur një grup të rejash nga një lagje beqarësh e beqarësh udhëton me qindra kilometra për të marrë pjesë në funeralin e nënës së njëres nga Motrat e tyre të Shoqatës së Ndihmës. Dashuria shfaqet kur mësueset vizitore kthehen muaj pas muaji, vit pas viti tek e njëjta motër e painteruar, disi kritike. Ajo është e dukshme kur kujtohen për një të ve të

moshuar dhe e marrin në funksione të lagjes dhe në veprimtari të Shoqatës së Ndihmës. Ajo ndihet kur një motër e ulur vetëm në Shoqatën e Ndihmës merr ftesë: “Eja – ulu pranë nesh”.

Në qindra mënyra të vogla, të gjitha ju mbani mantelin e dashurisë hyjnore. Jeta nuk është e përsosur për asnjë nga ne. Në vend që të jemi gjykues dhe kritikë për njëri-tjetrin, le të kemi dashurinë e pastër të Krishtit për bashkudhëtarët tanë në këtë udhëtim përmes jetës. Le të njohim se kush prej nesh po bën më të mirën e vet për të përballuar sfidat që i dalin në rrugë dhe le të përpiqemi të bëjmë më të mirën *tonë* për të dhënë ndihmë.

Dashuria hyjnore është përkufizuar si “lloji më i lartë, më fisnik, më i fortë i dashurisë”¹², “dashuria e pastër e Krishtit . . . ; dhe kushdo që gjendet [e] zotëruar prej saj në ditën e fundit, do të jetë mirë me të”¹³.

“Dashuria nuk ligështohet kurrë”. Le t’ju udhëheqë kjo moto e përhershme e Shoqatës së Ndihmës, kjo e vërtetë pa kohë, në çdo gjë që bëni. Le të përshkojë ajo vetë shpirtat tuaj dhe të gjejë shprehje në gjithë mendimet dhe veprimet tuaja.

Unë shpreh dashurinë time për ju, motra të mia, dhe lutem që bekimet e Qiellit të jenë kurdoherë tuajat. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Mateu 7:1.
2. Mateu 7:3.
3. Përshatur nga *Guideposts*, qershor 1965, f. 24.
4. Gjoni 7:24.
5. Mother Teresa, në R. M. Lala, *A Touch of Greatness: Encounters with the Eminent* (2001), x.
6. Gjoni 15:12
7. Jakobi 1:26.
8. 1 Korintasve 13:8.
9. Moroni 7:41.
10. Moroni 10:5.
11. Horace Mann, *Lectures on Education* (1845), f. 297.
12. Bible Dictionary, “Charity”.
13. Moroni 7:41.

Treguesi i Ngjarjeve në Konferencë

Më poshtë vijon një listë përvojash të përzgjedhura nga fjalimet e konferencës së përgjithshme për përdorim në studimin vetjak, mbërmbjen familjare dhe mësimdhënie tjetër. Numri i referohet faqes së parë të bisedës.

Folësi	Ngjarja
Plaku Xhefri R. Holland	Prindërit e Xhefri R. Hollandit paguajnë për misionin e tij (6).
Rozmari M. Uixon	Fëmijët luten ndërsa nëna e tyre drejton makinën nëpër një stuhi bore (9).
Plaku D. Tod Kristoferson	Gjyshi i D. Tod Kristofersonit qeth dele dhe paguan për një mision (16). Një ortak biznesi i ndan pasuritë në mënyrë të pabarabartë (16).
Plaku Robert D. Hejls	Robert D. Hejls lustron dyshe-menë derisa ngec në një cep (24).
Plaku Kuentin L. Kuk	Një peshkop ndihmon një burrë të pendohet për pandershmërinë (27).
Plaku Rasëll M. Nelson	Rasëll M. Nelsoni ua jep miqve Librin e Mormonit (47). Një i ri bashkohet me Kishën pasi bën kërkime në mormon.org (47).
Plaku Patrik Kiëron	Patrik Kiëronin e pickon një akrep (50).
Plaku Huan A. Uceda	Një atë inatoset me të bijën gjatë një studimi familjar të shkrimit të shenjtë (53).
Presidenti Henri B. Ajring	Spenser W. Kimballi viziton në spital babain e Henri B. Ajringut (59).
Presidenti Tomas S. Monson	Klejton M. Kristenseni nuk pranon të luajë basketboll të dielën (67).
Presidenti Henri B. Ajring	Një presidente e Shoqatës së Ndihmës mbledh rroba për t’ua dhënë të varfërve (70).
Presidenti Bojd K. Paker	Një grua të penduar e nxisin të mos shohë prapa (74).
Plaku Xhei E. Xhensen	Xhei E. Xhensen lutet dhe merr një dëshmi nëpërmjet Frymës së Shenjtë (77).
Presidenti Tomas S. Monson	Një familje mëson të japë falënderime edhe gjatë kohëve të vështira (87).
Plaku L. Tom Peri	Një prift i ri ndihmon një burrë me paaftësi që të marrë sakramentin (91).
Plaku Leri R. Lorens	Prindërit i kërkojnë të birit të qëndrojë në shtëpi sepse kanë një ndjenjë të keqe lidhur me një aktivitet (98).
Plaku Mervin B. Arnold	Një lopë ngordh pasi ha grurë me tepricë (105).
Plaku M. Rasëll Ballard	Një grua fillon të bjerë në varësi nëpërmjet ilaçeve të dhëna me recetë (108).
Silvia H. Ollred	Një familje goditet nga fatkeqësia ndërsa po ktheheshin pas vulosjes në tempull (116).
Barbara Tompson	Barbara Tompsoni bekohet nëpërmjet vizitës mësimore tek nëna e Ashlit (119).
Presidenti Tomas S. Monson	Një çift që drejton një pension, e lejojnë një burrë të shfytëruar të qëndrojë në shtëpinë e tyre (122).

Presidencat e Përgjithshme të Organizatave Ndhmëse


SHOQATA E NDIHMËS



Silvia H. Ollred
Këshilltare e Parë



Xhuli B. Bek
Presidente



Barbara Tompson
Këshilltare e Dytë

TË REJAT



Meri N. Kuk
Këshilltare e Parë



Elen S. Dalton
Presidente



En M. Dib
Këshilltare e Dytë

FILLORJA



Xhin A. Stivens
Këshilltare e Parë



Rozmari M. Uiksom
Presidente



Sheril A. Esplin
Këshilltare e Dytë

TË RINJTË



Leri M. Gibson
Këshilltar i Parë



Dejvid L. Bek
President



Adrián Oçoa
Këshilltar i Dytë

SHKOLLA E SË DIELËS



Dejvid M. Mek-Konki
Këshilltar i Parë



Rasëll T. Osguthorp
President



Methju O. Riçardson
Këshilltar i Dytë

Mësimet për Kohën Tonë

Mësimet e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndhmës të dielën e katërt të muajit do t'u kushtohen "Mësimeve për Kohën Tonë". Secili mësim mund të përgatitet nga një ose më shumë biseda, që janë dhënë në konferencën e përgjithshme më të fundit. Presidentët e kunjeve dhe të distrikteve mund të zgjedhin se cilat biseda duhet të përdoren, ose ata mund t'ia japin këtë përgjegjësi peshkopëve dhe presidentëve të degëve. Udhëheqësit duhet të theksojnë vlerën për vëllezërit e Priftërisë Melkizedeke dhe motrat e Shoqatës së Ndhmës që të studiojnë të njëjtat biseda në të njëjtën të diel.

Ata që marrin pjesë në mësimet e të dielave të katërta, nxiten të studiojnë dhe të sjellin në klasë botimin e revistës të konferencës së përgjithshme më të fundit.

Sugjerime për Përgatitjen e një Mësimi nga Bisedat

Lutuni që Shpirti i Shenjtë të jetë me ju kur studioni

dhe jepni mësim bisedën(at). Mund të tundoheni të përgatitni mësimin duke përdorur materiale të tjera, por bisedat e konferencës janë materiali mësimor i miratuar. Detyra juaj është të ndihmoni të tjerët të mësojnë dhe të jetojnë ungjillin siç mësohet në konferencën e përgjithshme më të fundit të Kishës.


Rishiheni bisedën(at), duke kërkuar parime dhe doktrina që plotësojnë nevojat e anëtarëve të klasës. Gjithashtu kërkoni ndodhi, referenca shkrimi të shenjtë dhe deklarata nga biseda(t), që do t'ju ndihmojnë të jepni mësim mbi këto të vërteta.

Bëni një plan se si të jepni mësim mbi parimet dhe doktrinën. Plani juaj duhet të përfshijë çështje që ndihmojnë anëtarët e klasës:

- Të kërkojnë parime dhe doktrina në bisedë(at).
- Të mendojnë për domethënien e tyre.
- Të ndajnë së bashku kuptimet, idetë, përvojat dhe dëshmitë.
- Të zbatojnë këto parime dhe doktrina në jetën e tyre. ■

MUAJT	MATERIALE PËR MËSIMET E SË DIELËS SË KATËRT
Nëntor 2010 – Prill 2011	Biseda të botuara në <i>Liahonën*</i> e nëntorit 2010
Maj 2011 – Tetor 2011	Biseda të botuara në <i>Liahonën*</i> e majit 2011

* Këto biseda janë të disponueshme (në shumë gjuhë) në faqen conference.lds.org.



Presidenti Monson Bën Thirrje për Misionarë dhe Njofton për Pesë Tempuj të Rinj

Presidenti Tomas S. Monson e hapi Konferencën e Përgjithshme Gjysmëvjetoare të 180-të të Kishës, që u mbajt të shtunën dhe të dielën, më 2 dhe 3 tetor 2010, duke bërë thirrje që më shumë anëtarë të shërbejnë në misione dhe duke njoftuar për pesë tempuj të rinj.

Presidenti Monson përsëriti thirrjen që “çdo i ri i denjë dhe i aftë” të përgatitet për të shërbyer; ka mirëpritur të rejat që dëshirojnë të shërbejnë; dhe shprehu një nevojë të Kishës që të shërbejnë “shumë-shumë më tepër çifte në moshë”.

“Shërbimi misionar është një detyrë priftërie”, tha ai, “një detyrim që Zoti e pret prej nesh, të cilëve na është dhënë kaq shumë.”

Presidenti Monson njoftoi se pesë tempuj të rinj janë planifikuar për ndërtim në Hartford në Konetikat të SHBA-së, Indianapolis në Indiana të SHBA-së, Lisbonë në Portugal, Tihuana në Meksikë dhe Urdaneta në Filipine.

Tempujt e rinj e çojnë në 23 numrin e tempujve që janë njoftuar ose janë

në ndërtim. Pasi të përfundohen, këta 23 tempuj do ta çojnë në 157 numrin e përgjithshëm të tempujve të Kishës në mbarë botën.

“Ne vazhdojmë të ndërtojmë tempuj”, tha Presidenti Monson. “. . . Vazhdojmë me besnikëri që të shkojmë në tempuj, që po ndërtohen gjithnjë e më afër anëtarëve tanë” (“Ndërsa Prapë Takohe mi së Bashku”, *Liahona* dhe *Ensign*, nëntor 2010, f. 4).

Tempujt e rinj do të jenë të parët për Kishën në Portugal, Indiana dhe Konetikat. Tempulli i Urdanetës do të jetë tempulli i tretë i Kishës në Filipine dhe Tempulli i Tihuanas do të jetë tempulli i trembëdhjetë i Meksikës.

Gjatë gjashtë muajve ndërmjet konferencave të përgjithshme të prillit dhe të tetorit, Kisha përkushtoi katër tempuj të rinj: Tempullin e Gila-Vellit në Arizonë; e Vankuverit në Kolumbian Britanike, e Sebusë në Filipine dhe e Kievit në Ukrainë. Tempulli i Laies në Havai është programuar të ripërkushtohet më 21 nëntor 2010, pasi i është nënshtruar një restaurimi të gjerë. ■

Programohet Trajnim i Përbotshëm i Udhëheqjes

Një transmetim i trajnimit të përbotshëm të udhëheqjes do të zhvillohet më 13 nëntor 2010.

Ky transmetim do të japë udhëzime mbi manualët e reja të Kishës: *Handbook 1: Stake Presidents and Bishops* [Manuali 1: Presidentët e Kunjeve dhe Peshkopët] dhe *Handbook 2: Administering the Church* [Manuali 2: Administrimi i Kishës].

Anëtarët e mëposhtëm ftohen të marrin pjesë në këtë transmetim: Autoritetet e Përgjithshme, të Shtatëdhjetët Zonalë, presidentat e kunjeve, misioneve, tempujve dhe distrikteve; nëpunësit e kunjeve dhe distrikteve; sekretarët ekzekutivë të kunjeve dhe distrikteve; këshilltarët e lartë; presidentat e Shoqatës së Ndihmës, Të Rinjve, Të Rejave, Fillores dhe Shkollës të së Dielës të kunjeve dhe distrikteve; peshkopatat; presidentat e degëve; nëpunësit e lagjeve dhe të degëve; sekretarët ekzekutivë të lagjeve dhe degëve; udhëheqësit dhe ndihmësit e grupeve të priftërinjve të lartë; presidentat e kuorumeve të pleqve; presidentat e Shoqatës së Ndihmës, Të Rinjve, Të Rejave, Fillores dhe Shkollës të së Dielës të lagjeve dhe degëve; udhëheqësit e misionit të lagjeve.

Trajnimi do të transmetohet në më shumë se 30 gjuhë. Kontaktoni udhëheqësit vendore të priftërisë për më shumë informacion mbi mundësinë e ndjekjes së transmetimit. ■

Anëtarët e Mbajnë Gjallë Konferencën në Jetën e Përditshme

Ju i keni dëgjuar mesazhet, ju keni ndier Shpirtin, ju jeni angazhuar ta ndiqni këshillën. Por tani që konferenca e përgjithshme mbaroi, si do

ta bëni pjesë të jetës suaj për gjashtë muajt e ardhshëm?

Anëtarë të Kishës në mbarë botën tregojnë se çfarë i ndihmon të kujtojnë e të zbatojnë mesazhet e konferencës së përgjithshme.

Përfshijeni Konferencën e Përgjithshme në Jetën Tuaj të Përditshme

Dëgjojin fjalimet ndërsa bëni gjimnastikë, drejtoni makinën, bëni punë shtëpie apo bëheni gati për ditën.

—Xhejms, Ontario, Kanada

Vërin pjesëtarët e familjes të zgjedhin me radhë biseda për t'i dëgjuar gjatë ngrënies së mëngjesit.

—Ashli, Uashington, SHBA

Shikoni familjarisht të dielave pjesë të konferencës së përgjithshme.

—Grent, Kaliforni, SHBA

Bëjini Fjalimet Pjesë të Mbrëmjes Familjare

Përzgjidhni mesazhet që dëshironi t'i shqyrtoni si familje dhe caktojuani pjesëtarëve të familjes që t'i japin mësim në mbrëmjet e ardhshme familjare.

—Vern dhe Xhenifer, Juta, SHBA

Lexoni ose shikoni një fjalim dhe kërkonte synime për të cilat mund të punoni familjarisht.

—Toni, Arizonë, SHBA



Përdorini Fjalimet për Studim të Shkrimit të Shenjtë

Shkëmbeni radhë mes leximit të shkrimeve të shenjta në mëngjes dhe leximit të një fjalimi të konferencës së përgjithshme në mbrëmje.

—Dajena, Uashington, SHBA

Lexojuni fëmijëve tuaj çdo natë një fjalim si histori para kohës së gjumit.

—Hedhër, Juta, SHBA

Shihni referimet e shkrimit të shenjtë të çdo fjalimi, pasi ta keni lexuar fjalimin.

—Beki, Juta, SHBA

Nënvizoni çdo gjë që folësit na kanë kërkuar posaçërisht që ta bëjmë dhe përqendrohuni në ndjekjen e këshillës së tyre.

—Helena, Australi

Studioni Sipas Temave

Bëni një listë që të përputhë temat e pasqyruara në konferencën e

përgjithshme me gjërat që dëshironi të përmirësoni në jetën tuaj. Studiojin temat një e nga një ndërsa përpiqeni të përmirësoheni përpara konferencës tjetër të përgjithshme.

—Rebeka, Teksas, SHBA

Përqendrohuni në një temë të veçantë për disa ditë gjatë studimit tuaj të shkrimit të shenjtë ose për disa javë në mbrëmjen familjare.

—Francis, Nigeri

Ndajini Mesazhet me të Tjerët

Përfshini në buletine e në fletushka të Kishës citime nga konferenca e përgjithshme.

—Tod, Virxhinia Perëndimore, SHBA

Organizoni ose bashkohuni me një klub leximi të librave të konferencës së përgjithshme, qoftë në internet ose personalisht. Çdo javë, studioni një fjalim dhe shkoni në klubin e leximit i përgatitur për të ndarë kuptime.

—Stefani, Juta, SHBA

Korrigjime

Në pjesën e brendshme të koptinës së botimit të konferencës së majit 2010, fjalja e tretë në diçiturën për pikturën *Harmoni*, në *Pensilvani*, nga Al Rounds, duhet të shkruante: “Këtu Profeti Jozef përktheu pjesën më të madhe të Librit të Mormonit”.

Në numrat e tetorit 2010 të

revistave *Ensign* dhe *Liahona*, *Tempuj të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme*, fotografitë e Tempullit të Uashington D.C. në faqet 4 dhe 5 dhe fotografia e Tempullit të Portlandit në Oregon në kapakun e pasëm të broshurës së tempujve u realizuan nga Robert A. Boyd. ■



FAMILJA

NJË PROKLAMATË DREJTUAR BOTËS

PRESIDENCIA E PARË DHE KËSHILLI I DYMBËDHJETË APOSTUJVE TË KISHËS SË Jezu KRISHTIT TË SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME

NE, PRESIDENCIA E PARË dhe Këshilli i Dymbëdhjetë Apostujve të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, solemnisht shpallim se martesë midis një burri dhe një gruaje shugurohet nga Perëndia dhe se familja është thelbësore në planin e Krijuesit për destinacionin e përjetshëm të fëmijëve të Tij.

TË GJITHA QENIET NJERËZORE, meshkuj dhe femra, janë krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë. Secili është një bir ose bijë shpirtërore e dashur e prindërve qiellorë dhe, si i tillë, secili ka një natyrë dhe destinacion hyjnor. Gjinia është një karakteristikë thelbësore e identitetit dhe qëllimit individual të jetës para lindjes, të jetës së vdekshme dhe asaj të përjetshme.

NË MBRETËRINË PARATOKËSORE, bijtë dhe bijat shpirtërore e njihnin dhe e adhuronin Perëndinë si Atin e tyre të Amshuar dhe e pranuan planin e Tij, me anë të të cilit fëmijët e Tij mund të merrnin një trup fizik, mund të fitonin përvojë tokësore për të përparuar drejt përsosjes dhe së fundi, mund të arrinin destinacionin e tyre hyjnor si trashëgimtarë të jetës së përjetshme. Plani hyjnor i lumturisë bën të mundur që marrëdhëniet familjare të vazhdojnë përtej varrit. Ordinancat dhe besëlidhjet e shenjta që janë në dispozicion në tempujt e shenjtë, bëjnë të mundur që individët të kthehen në praninë e Perëndisë dhe që familjet të bashkohen përjetësisht.

URDHËRIMI I PARË që Perëndia i dha Adamit dhe Evës, ishte rreth potencialit të tyre si burrë e grua për të qenë prindër. Ne deklarojmë se urdhërimi i Perëndisë për fëmijët e Tij që të shumohen dhe të mbushin tokën, mbetet i vlefshëm. Ne më tej deklarojmë se Perëndia ka urdhëruar që fuqitë e shenjta të krijimit të jetës duhet të përdoren vetëm midis burrit dhe gruas, ligjërisht të martuar si bashkëshort e bashkëshorte.

NË DEKLARIMË se mënyra me anë të së cilës krijohet jeta e vdekshme është caktuar dhe drejtuar nga Perëndia. Ne pohojmë shenjtërinë e jetës dhe rëndësinë e saj në planin e përjetshëm të Perëndisë.

BASHKËSHORTI DHE BASHKËSHORTJA kanë një përgjegjësi solemne të duan dhe të kujdesen për njëri-tjetrin dhe për

fëmijët e tyre. “Bijtë janë një trashëgimi që vjen nga Zoti” (Psalmi 127:3). Prindërit kanë një detyrë të shenjtë për të rritur fëmijët e tyre me dashuri dhe drejtësi, për të plotësuar nevojat e tyre fizike dhe shpirtërore dhe për t’i mësuar ata ta duan e t’i shërbejnë njëri-tjetrit, të zbatojnë urdhërimet e Perëndisë dhe të jenë qytetarë që u binden ligjeve kudo që jetojnë. Bashkëshortët dhe bashkëshortet, nënat dhe etërit, do të mbahen përgjegjës përpara Perëndisë për plotësimin e këtyre detyrimeve.

FAMILJA shugurohet nga Perëndia. Martesa midis burrit dhe gruas është thelbësore në planin e Tij të përjetshëm. Fëmijët kanë të drejtën të lindin nga prindër brenda lidhjeve të martesës dhe të rriten nga një atë dhe një nënë të cilët i nderojnë me besnikëri të plotë besëlidhjet e martesës. Lumturia në jetën familjare është e mundur të arrihet më mirë kur bazohet në mësimet e Zotit Jezu Krisht. Martesat dhe familjet e suksesshme ngrihen dhe ruhen me parimet e besimit, lutjes, pendimit, faljes, respektit, dashurisë, dhembshurisë, punës dhe aktiviteteve të shëndosha argëtuese. Nëpërmjet planit hyjnor, etërit duhet të kryesojnë familjet e tyre me dashuri e drejtësi dhe janë përgjegjës për të siguruar gjërat e nevojshme për jetën dhe mbrojtjen për familjet e tyre. Nënat janë kryesisht përgjegjëse për edukimin e fëmijëve të tyre. Në këto përgjegjësi të shenjta, etërit dhe nënat kanë detyrim të ndihmojnë njëri-tjetrin si partnerë të barabartë. Paaftësia, vdekja ose rrethana të tjera mund të bëjnë të nevojshme përshtatjen ose ndryshimin e këtyre roleve. Të afërm të tjerë duhet të ndihmojnë kur është e nevojshme.

NË PARALAJMËROJMË se individët që shkelin besëlidhjet e dëlirësisë, që abuzojnë me bashkëshorten ose fëmijët apo që dështojnë në përbushjen e përgjegjësisë të tyre familjare, do të qëndrojnë një ditë përgjegjës përpara Perëndisë. Për më tepër, ne paralajmërojmë se shpërbërja e familjes do të sjellë mbi individët, komunitetet dhe kombet fatkeqësitë e parashikuara nga profetët e lashtë dhe modernë.

NË U BËJMË THIRRJE qytetarëve dhe zyrtarëve të përgjegjshëm të qeverive kudo që janë të nxisin ato masa të krijuara për të ruajtur dhe forcuar familjen si njësi themelore e shoqërisë.

Kjo proklamata u lexua nga Presidenti Gordon B. Hinkli si pjesë e mesazhit të tij në Mbledhjen e Përgjithshme të Shoqatës së Ndhmës të zhvilluar më 23 shtator 1995, në Solt Lejk Siti, Juta.



“Të rinj, ju këshilloj që të përgatiteni për shërbimin si misionar. Mbajeni veten të pastër, të dëlirë dhe të denjë për të përfaqësuar Zotin. Ruani shëndetin dhe forcën tuaj . . .”, tha Presidenti Tomas S. Monson gjatë sesionit të hapjes së Konferencës së Përgjithshme Gjysmëvjetore të 180-të. “Një fjalë për ju motra të reja: ndonëse ju nuk keni të njëjtën përgjegjësi priftërore siç e kanë të rinjtë për të shërbyer misione kohëplota, ju gjithashtu jepni një kontribut të çmuar si misionare dhe ne e mirëpresim shërbimin tuaj. Dhe tani për ju vëllezër e motra në moshë: ne kemi nevojë për shumë-shumë më tepër çifte në moshë. . . . Janë pak ato kohë të jetës suaj kur do të shijoni shpirtin e ëmbël dhe kënaqësinë që vijnë nga dhënia e shërbimit kohëplotë së bashku në veprën e Mësuesit.”